



RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

“MBI AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË NË ISH-DREJTORINË E ALUIZNI QARKU ELBASAN, SOT AGJENSIA SHTETËRORE E KADASTRËS ELBASAN”

Tiranë, më 25.09.2019



<i>Nr</i>	<i>Përmbajtja</i>	<i>Faqe</i>
I.	Përmbledhje Ekzekutive.....	1-26
II.	Hyrje.....	26-30
	a. Objektivat dhe qëllimi	
	b. Identifikimi i çështjes	
	c. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
	d. Përgjegjësitë e audituesve	
	e. Kriteret e Vlerësimit	
	f. Standartet e auditimit	
III.	Përshkrimi i auditimit.....	30-221
	III.1.Zbatimi i procedurave ligjore në legalizimin e ndërtimeve informale	
	Krijimi i bazës së të dhënave për ndërtimet pa leje dhe përpunimi i tyre.Evidentimi dhe diferencimi në subjektet përfitues ose jo nga procesi i legalizimit.Procedurat e miratimit dhe dhënies së lejes së legalizimit nga Drejtoria Qendrore dhe Rajonale e Legalizimit (ALUIZNI) dhe regjistrimi në ZVRPP, sipas kategorive përkatëse (bazuar ne risk). Auditim mbi bazueshmërinë ligjore të shqyrtimit dhe zgjidhjes së ankesave dhe respektimi i afateve ligjor për kthim përgjigje.Auditim në lidhje me regjistrimet e lejeve të legalizimit dhe pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukture (per periudhen objekt auditimi).....	30-198
	III.2.Auditim mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit	
	Respektimi i procedurave të hartimit dhe miratimit të buxhetit. Respektimin e procedurave për çeljen e fondeve në degën e thesarit.Rregullshmëria e plotësimit dhe përpunimit të dokumentacionit për shpenzimet e të ardhurat nga kryerja e legalizimeve.Përdorimi efektiv i fondeve të buxhetit. Shkaqet e tejkalimeve dhe mosrealizimeve. Nxjerrja e përgjegjësive për deviacionet. Rakordimet që janë kryer me Degën e Thesarin për arkëtimet nga legalizimet.....	198-202
	III.3.Zbatimi i dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës	
	Hartimi, miratimi dhe respektimi i strukturave organike të miratuara.Përcaktimi i pagave sipas klasifikimit të funksioneve dhe vendeve të punës në shërbimin civil dhe atyre me kod pune. Zbatimi i vendimeve të Komisionit të Shërbimit Civil dhe të Gjykatave, me qëllim evidentimin e rasteve kur nga entet publike paguhen për një pozicion pune njëkohësisht dy persona.....	202-207
	III.4.Mbi administrimi, ruajtja, dokumentimi dhe qarkullimi i aseteve dhe aktiveve	



Rregullariteti i veprimeve të kryera nëpërmjet arkës dhe bankës në lekë dhe në valutë, në përputhje me disiplinën financiare. Inventarizimet dhe përputhshmëria e administrimit të aktiveve dhe inventarëve.....207-212

III.5. Prokurimi i fondeve publike për mallra, ndërtime dhe shërbime

Argumentimi ligjor i procedurave të prokurimit që ka zgjedhur enti prokurues. Zbatimi i procedurave të prokurimit, nga nxjerrja e urdhrit të prokurimit deri në shpalljen e fituesit. Lidhja dhe zbatimi i kontratave, kontrolli fizik për marrjen në dorëzim të mallrave, shërbimeve dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit. Kontroll në lidhje me procedurën e marrjes në dorëzim të objekteve dhe pasqyrimi i vlerës së investimit në aktivet e qëndrueshme.....212-217

III.6. Të ndryshme dhe trajtimi i indicieve të ardhura nga qytetarë në KLSH.....217-221

IV. Gjetje dhe Rekomandime.....221-242

V. Konkluzione dhe Opinioni i auditimit.....242-243

VI. Aneksë.....243-355

VII. Dokumentacion shoqërues.....356-356

I- PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.a. Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) ushtroi auditim në Ish-Drejtorinë e Aluizni Qarku Elbasan, (sot Agjensia Shtetërore e Kadastrës Elbasan) duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me zbatimin e procedurave ligjore në legalizimin e ndërtimeve informale. Gjatë periudhës së auditimit nga data 01.01.2017 deri në 31.05.2019 “Mbi nivelin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve, si dhe auditimin e përgjegjësisë në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për pranim dhe administrim të dokumentacionit përlegalizimet. Vlersimi i përputhshmërisë së procedurave të prokurimit dhe zërave kryesorë financiarë” është konstatuar se veprimtaria e Ish-Drejtorisë së Aluizni Qarku Elbasan, (sot Agjensia Shtetërore e Kadastrës Elbasan), në drejtim të çështjeve që lidhen me procedurën e pranimit dhe administrimit të dokumentacionit për legalizimet e ndërtimeve informale, nuk ka qenë plotësisht efektive, pasi pavarësisht punës së bërë në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tij, konstatohet se:

Në Ish-Drejtorinë e Aluizni Qarku Elbasan, (sot Agjensia Shtetërore e Kadastrës Elbasan) referuar bazës së të dhënave të disponuar nga viti 2006 deri në maj të vitit 2019 janë vetëdeklaruar 48,000 objekte informale, në vitin 2006 deri në vitin 2012 janë vetëdeklaruar 18,859 objekte informale, në vitin 2013 janë vetëdeklaruar 3,756 objekte informale, në vitin 2014, kanë vetëdeklaruar 22,286 objekte informale, në vitin 2015 janë vetëdeklaruar 1202 objekte informale nga viti 2016 deri në



vitet 2019 kane vet deklaruar 1897 objekte (shif tabelën e vetdeklarimeve sipas viteve). Nga këto nga viti 2006 deri në maj 2019 janë dhënë gjithsej 12,785 legalizimi ose 26 përqind e totalit janë paisur me leje legalizimi, pra ngelen për tu legalizuar dhe 35,215.

Në subjektin e audituar gjatë procesit të auditimit në terren, mbas ballafaqimit me personat përgjegjës në subjekt, nga grupi i auditimit janë mbajtur 10 Akt konstatime dhe 3 Akt verifikime të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit. Në përfundim të punës në terren është kryer takimi ballafaques me përfaqësuesit e Ish-Drejtorisë së Aluizni Qarku Elbasan, (sot Agjensia Shtetërore e Kadastrës Elbasan). Mbi aktet e mbajtura në periudhën e auditimit dhe Projekt Raportin janë paraqitur observacionet nga Ish-Drejtoriae Aluizni Qarku Elbasan, (sot Agjensia Shtetërore e Kadastrës Elbasan). Nga Grupi Auditimi u caktua data 19.09.2019 për ballafaqimin përfundimtar në ambientet e KLSH-së, ku u diskutua dhe u ballafaquan argumentat mbi gjetjet nga auditimi me subjektin e audituar.

- Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan, në marrjen e vendimeve “Për kualifikimin për legalizim të objektit informal” ka vepruar pa marrë konfirmim mbi pagesën e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë për dalje me vendim kualifikimi duke krijuar një mungesë të ardhurash në buxhetin e shtetit në vlerën 42,986,822lekë.

- Për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2017 deri 31.05.2019, janë lëshuar 6243 leje legalizimi për objektet informale të legalizuara. Nga 6243 leje legalizimi të lëshuara, 2130 leje legalizimi ose rreth 34 % e këtyre lejeve të legalizimit (6243) janë lëshuar vetëm për objektin me shënimin në lejen e legalizimit “*Kalimi i pronësisë për parcelën ndërtimore do miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave*”, ndërsa sipas të dhënave konstatohet se periodikisht brenda periudhës objekt auditimi, kanë dalë nga arkiva e institucionit për tu punuar 11387 dosje të objekteve informale, për një pjesë të të cilave është kryer edhe kualifikimi i objekteve informale për të vazhduar procedurat deri në lëshimin e lejes së legalizimit, ndërkohë sipas pasqyrave të paraqitura konstatohet se janë kthyer 4,309 dosje pra me një diferencë 835 dosje të cilat kanë dalë dhe nuk janë bërë hyrje në arshivë dhe nuk ka asnjë të dhënë apo dokument për administrimin e tyre,

- Në 6 raste, janë legalizuar objekte social-ekonomikë, të kombinuara, banimi, të objekteve që ndodhen në Zonën e Mbrojtur të Parkut Kombëtar “Shebenik-Jabllanicë”, sipas VKM nr. 640, datë 21.05.2008, kategoria e dytë e zonave të mbrojtura,

- Në 5 raste, janë lëshuar leje legalizime për objekt social-ekonomik të ndodhur brenda pasurisë “Pyll” dhe “Shkëmb”, me status juridik “Shtet”.

- Në 2 raste, janë legalizuar objekte social-ekonomike dhe banimi, të cilat ndodhen pjesërisht në terriore të institucioneve publike dhe shtetërore, brenda vijës kufizuese të Spitalit “Baki Kongoli”, brenda vijës kufizuese të objektit shtetëror të ujësjellësit “Pompë uji”.

- Në 2 raste, janë legalizuar objekte informale, ku nga verifikimi në dokumentacionin hartografik të paraqitur, në gen-planin, në proces-verbalin e verifikimit në terren, në skicën fushore, si dhe nga matja e kryer në hartën vektoriale dhe në sistemin dixhital zyrtar “geoportal-albania”, u konstatua se legalizimi i këtyre objekteve ishte kryer në pozicionimin e pronës, në një distancë prej 69-94 m nga bregu i Lumit Devoll, me të cilin kufizohen objektet e legalizuara.

- Në 3 raste, janë legalizuar objekte informale, në një distancë prej 12 m – 21 m nga bregu i përrenjve, me të cilin kufizohen objektet e legalizuara, distancë brenda së cilës pasuria shtetërore është e patjetërsueshme dhe e paparashkrueshme, për rrjedhojë nuk duhej pranuar për legalizim objektet në fjalë.

- Në 3 raste, konstatohet se objektet e legalizuara ndodhen në distancë me të vogël se 10 m nga rrugët nacionale të kategorisë “C”, dhe më pak se 5 m prej rrugës rajonale të kategorisë “F”.



- Në 3 raste,janë legalizuar objekte informale, në kushtet kur janë ndërtuar në një distancë shumë afër hekurudhës më pak 25 m dhe në dosje nuk ka asnjë dokumentacion që vërteton marrjen e konfirmimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave për legalizimin e objektit.
- Në 13 raste, janë legalizuar objekte informale në kushtet kur parcelat ndërtimore janë në zërat kadastrale “Arë”, “Vreshtë”, “Pemishte”, “Ullishte”, “Ledh”, etj. dhelejet e legalizimit janë lëshuar në mungesë të dokumentacionit: kërkesa për miratimin në Këshillin e Qarkut, të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Agjencisë Rajonale të Mjedisit. Pra, nuk ka asnjë dokumentacion nga këto organe, për t’i dhënë lejen dhe miratimi e këtryre lejeve të legalizimit sjell automatikisht ndryshimin e zërit kadastral gjatë regjistrimit në ZVRPP Elbasan.
- Në 56 raste,ka kryer legalizime dhe dokumentacioni i dosjeve së këtyre lejeve legalizimi është i pa plotësuar me inventarin e përkatës të rregullt të dokumentacionit dhe numrit të fletëve për çdo dokument, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit Nr. 9154, date 06.11.2003, “Për Arkivat”.
- Në 33 raste,ka kryer legalizime të objekteve social-ekonomikë dhe të kombinuar, duke i kaluar në ZVRPP për t’u regjistruar me kufizime sipas hipotekës ligjore, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1.
- Në 73 raste, ka kryer legalizime të objekteve informale në kushtet kur në dosjet mungojnë vërtetimet për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 27, germa “ç”, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.
- Në 56 raste, ka kryer legalizime të objekteve informale, në kushtet kur në proces-verbalet e verifikimit në terren mungojnë datat e mbajtjes së tij dhe nuk mund të përcaktohet afati kohor proces-verbal verifikimi – vendim kualifikimi, ose në kushte kur ky afat kohor është më shumë se 60 ditë, duke vepruar kështu në kundërshtim me vendimin e KM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose nëlartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar, pika 8.
- Në 28 raste, ka kryer legalizimin e objekteve informale në kushtet kur afati kohor ndermjet datës së vendimit për kualifikim dhe datës së lejes së legalizimit është më shumë se 30 ditë, duke vepruar në kundërshtim me Urdhrin nr. 37, datë 19.01.2016 “Për miratimin e plan veprimit për shqyrtimin administrative të praktikave të legalizimit të ndërtimeve pa leje”, pika 6- Miratimi i lejes së legalizimit përpara kalimit të pronësisë, germa “a”.
- Në 97 raste, ka kryer legalizimin e objekteve informale, në kushtet kur proces-verbalet e verifikimit në terren nuk janë plotësuar me rubrikat për: datën e mbajtjes, sipërfaqet e parcelës ndërtimore, njolla e objektit, numri i kateve dhe destinacioni i sipërfaqeve. Përsa i përket pasurive kufitare (të saktësuara në përshkrim) nuk janë shënuar numrat e pasurive dhe distancat nga pasuritë kufitare. Këto mungesa, vecanërisht mungesa e sipërfaqes së parcelës ndërtimore dhe distancave nga objektet kufitare e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale. Sa sipër është në kundërshtim me rubrikat sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.
- Në 4 raste,sipas lejeve të legalizimit nr. 402604, datë 24.04.2017; nr. 4050132, datë 28.04.2017; nr. 5030602, datë 28.04.2017; nr. 4150123, datë 28.04.2017, ka kryer legalizimin e objekteve informale në kushtet kur në dosje mungojnë fotografitë të 1 ose 2 pamjeve të objektit, në kundërshtim me urdhërin nr. 46, datë 18.7.2006 dhe “Manual i procedurave mbi procesin e vetëdeklarimit”,pika 7/1.
- Në 3 raste, ka vijuar procedurat e lëshimit të lejes së legalizimit bazuar vetëm në deklaratën noteriale të poseduesit të ndërtimit për prishjen e ndërtimit të vjetër, por në dosje nuk ka asnjë dokumentacion tjetër nga institucionet vendore si organet kompetente që japin lejen përkatëse për



prishjen e objektit, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 8405 datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar, Neni 49, pikën 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.

- Në 7 raste, janë legalizuar objekte informale, të cilat sipas shkresave të ZVRPP-së, figurojnë të regjistruara në pronësi “Shtet”, të pa plotësuar seksionet D dhe E të KPP-ve, (Kartelat e pasurive të Paluajtshme), të cilat sipas deklaratave noteriale të qytetarëve, rezultojnë se janë prishur dhe në vend të tyre janë ndërtuar banesa të reja. *Por, konstatohet se në dosje nuk ndodhen dokumente që të provojnë faktin se institucioni përgjegjës (administrues) ka kryer procedurat për pasqyrimin e gjendjes ekzistuese në inventarin e pronave të paluajtshme të shtetit. Përveç kësaj, në dosje nuk ndodhet shkresë drejtuar institucioneve përgjegjëse të administrimit të institucioneve shtetërore, gjë që duhej bërë duke njoftuar paraprakisht këto institucione.* Sa sipër është në kundërshtim me vendimin e KM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar me vendimin e KM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dheshtesa në vendimin nr. 280, datë 1.4.2015, të këshillit të ministrave, “për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, pika 13 dhe nenin 13/1.

Sa më sipër konstatohet se nga Drejtoria ALUIZNI Elbasan, është vepruar në kundërshtim me ligjin për legalizimin e ndërtimeve pa leje, pra kemi të bëjmë me ligjërime të prishjes së pronës shtetërore, pa njoftuar institucionet përkatëse dhe pa u kryer veprimet prej këtyre të fundit, dokumentacione këto që duhej të ishin pjesë e dosjes, para se të lëshohej leja e legalizimit. Sipërfaqja ndërtimore pronë “Shtet”, e vlerësuar me koston mesatare të banesave për sipërfaqe shfrytëzimi për qytetin e Elbasanit, sipas EKB, që është 39,154 lekë/m², sipas UKM nr. 3, datë 28.12.2016, llogaritet: 23,489,268 lekë. ***Vlera e investimit prej 23,489,268 lekë, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit.***

- Në 1 rast, sipas lejës së legalizimit nr. 9898592, datë 22.06.2017, është legalizuar objekti informal “Godinë e kombinuar 9 Kat+1 kat nën tokë”, ku nga auditimi i dosjes plotësuese, rezultojnë leja e sheshit dhe e ndërtimit, të njësuar me origjinalin nr. 07, datë 16.05.2003, është lëshuar nga KRRT Bashkia Elbasan, objekti: “7 kat +podrum (2 katet e para lokale). Sipërfaqja e sheshit 538.75; sipërfaqja e ndërtimit në bazë 370 m². Leja është lëshuar në favor të subjektit “N”, me investitorë A S dhe L Gj, në truallin e z. I Z, z. S P, z. R M. Sa sipër, rezultojnë se kemi të bëjmë me shtesa (anësore apo në lartësi) tej lejes së ndërtimit, me qëllim kalimin e së drejtës së pronësisë apo qiradhënien dhe jo objekt informal, siç del nga leja e legalizimit, për rrjedhojë duhej që investitori të paguante për efekt të legalizimit, 2 përqind të çmimit minimal fiskal, për çdo m² sipërfaqe banimi dhe 5 përqind për veprimtari social ekonomike.

Sipas Aktit të Kolaudimit të disponuar në dosje dhe të firmosur vetëm nga kolaudatori dhe sipas projektit të zbatimit të disponuar gjithashtu në dosje, rezultojnë se sipas lejes së ndërtimit janë parashikuar sipërfaqe lokale shërbimi 789 m², ndërsa sipërfaqe banimi janë parashikuar 1769 m². Sipas lejes së legalizimit janë legalizuar 2470 m² sipërfaqe banimi me një shtesë prej 701 m² (2470-1769), krahasuar me sipërfaqen sipas lejes së ndërtimit. Çmimi minimal fiskal për qytetin e Elbasanit, sipas VKM nr. 132, datë 07.03.2018, është 50,300 lekë/m². Rrjedhimisht për shtesën e mësipërme investitori duhej të paguante një penaltet prej 705,206 (701x50,300x2%).

Lidhur me sipërfaqen e lokaleve të shërbimit këto janë pakësuar nga 789 m² në 518 m², pra është pakësuar me 271 m² (789-518), duke u ndryshuar destinacionin dhe duke i kaluar në sipërfaqe banimi. Për këtë rast investitori duhej të paguante një penaltet prej 1,363,130 (271x50,300x10%). Gjithsej investitori duhej të paguante 2,068,336 lekë (705,206+1,363,130). ***Vlefëta 2,068,336 lekë përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.*** Sa sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë



03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, neni 43.

- Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), **në 1 rast**, me urdhër-shpenzimin nr. 38, datë 27.03.2018, janë kryer shpenzime në shumën 1,395,520 lekë, me objekt “Ekzekutim Vendim Gjyqi”: 1,246,000 lekë dhe “Tarifë shërbimi përmbarimor”: 149,520 lekë, në kredi të përfituesit: shoqërisë përmbarimore ”S B S” shpk, me xhirim datë 27.03.2018, sipas faturës nr. 144, nr. Serie 58125174, dt. 23.03.2018, vendim gjyqi nr.(82-2016-1084) 706, dt.14.07.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, vendimi nr. 4443, datë 26.10.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, Urdhër 94, datë 23.03.2018. Duke kryer mesatarizimin e pagesës kemi për 17 muaj një pagesë prej 1,395,520 lekë, periudhë në të cilën janë paguarde fakto në Sektorin e ALUIZNI-t Librazhd, për një pozicion pune njëkohësisht dy persona, për një periudhë 17 muaj, siç ka përcaktuar gjykata, duke u shpenzuar shuma 1,395,520 lekë, veprim i cili ka efekte financiare negative, me shkak mosndjekjen e procedurave të rregullta ligjore sipas Kodit të Punës dhe kontratës së lidhur, nga strukturat e Drejtorisë së ALUIZNI-t Elbasan.

- Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), **në 1 rast**, ka vijuar procedurat e lëshimit të lejes së legalizimit nr. 2578217, datë 26.10.2018, në emër të A Sh H me mangësi në dokumentacion pasi nga mandat pagesat e administruara në dosje rezulton se është paguar tarifa e shërbimit 8000 lekë vetëm për një njësi, ndërkohë që objekti është legalizuar i gjithi, pra sipërfaqja ndërtimore me leje ndërtimi 1343.1 m² dhe sipërfaqja ndërtimore pa leje ndërtimi 125.2 m², godinë e kombinuar 9 Kat+1 Kat nëntokë, detyrimisht subjekti duhet të paguajë të plotë tarifën e shërbimit **80,000 lekë** (10 *8000 lekë), jo vetëm për shtesën.

- Nga auditimi i procedurave të legalizimit të ndërtimeve informale si dhe evidentimi i sipërfaqeve të lira në pronësi shtet, rezulton se nga ana e Drejtorisë së ALUIZNI-t Elbasan nuk janë evidentuar dhe janë lënë jashtë procesit të legalizimit sipërfaqe parcelë ndërtimore të zaptuara dhe në posedim nga poseduesit, ku sipas genplaneve, hartës fushore, ortofotos digjitale dhe hartës vektoriale të pronësive paraqitur në autocad (*vënë në dispozicion nga drejtoria e ALUIZNI-t*, Elbasan), bie në sy se këto parcela janë zvogëluar me qëllim për të qenë në kufirin deri në 300/500 m² (*brenda/jashtë vijës së verdhë*), për efekt pagese të vlerës së truallit, megjithëse në krah të këtyre parcelave ekzistojnë pjesë parcele të pa legalizuara, e cila është pjesë përbërëse e parcelës ndërtimore të zaptuar, por që është numëruar si parcelë më vete dhe që të dyja bashkë do të rezultonin në sipërfaqen e vetë deklaruar nga poseduesit e parcelës së zaptuar, gjë e cila duket dhe nga skica fushore. Plan vendosja e ndërtimit dhe parcelës së zaptuar pasqyruar në genplan me sipërfaqe të zvogëluar, duke lejuar sipërfaqe të ndërmjetme, kufizuar nga kufijtë e sipërfaqes së legalizuar dhe krijimin e parcelave të pa legalizuara brenda parcelave të zëna, jo funksionale.

Bazuar në metodën e veçimit dhe matjes me autocad dhe shenjave konvencionale të përdorur në genplan, evidentohen sipërfaqe e pa legalizuara që duhet t'i ishin bashkëngjitur sipërfaqes së legalizuar, pasi nga pamjet me ortofoto janë lënë jashtë procesit të legalizimit dhe të pamundura për parcelizim për vetë pozicionin gjeografik që ndodhet, veprime të cilat janë në kundërshtim me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 30, datë 15.01.16 “Për mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së dokumentacionit teknik (*gen-plan, planimetri*)”, i ndryshuar, si dhe shkronja “f” dhe “g” e nenit 3 dhe pika 1 e nenit 17, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, ku si rezultat i mos legalizimit të këtyre sipërfaqeve të zaptuara, në zbatim të nenit 19 dhe 20, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 dhe VKM^{së} nr. 1620 datë 26.11.2008, në 6 raste është evidentuar një sipërfaqe parcelë ndërtimore *brenda/jashtë vijës së verdhë* e pa legalizuar prej 2035.9m² (në total), me një vlerë tarife e cila sipas vlerës së truallit



me çmim tregu referuar zonave kadastrale llogaritet në shumën totale prej 568,673 lekë, duke shkaktuar mungesë të ardhurash në buxhetin të shtetit për fondin e kompensimit të ish-pronarëve.

I.b. Një përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve të auditimit

- **Gjetje nga auditimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan) në marrjen e vendimeve “Për kualifikimin për legalizim të objektit informal”, në të gjitha rastet e audituara ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” nenin 27 “Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit”, pika “ç” –“**vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi**”. Në kualifikimin e objekteve informale, ka dërguar pranë bashkive të Qarkut Elbasan, vetëm shkresën për llogaritjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për **1616 objekte informale** dhe pa marrë konfirmim mbi pagesën e saj për dalje me vendim kualifikimi, duke krijuar një **mungesë të ardhurash në buxhetin e shtetit në vlerën 42,986,822 lekë**.

Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan për nevoja të plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor të objekteve me leje legalizimit të lëshuara, t'i kërkojë bashkive Elbasan, Prenjas, Librazhd, Gramsh, Cerik, Peqin, Belsh, vërtetimet mbi llogaritjen dhe pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë në **vlerën prej 42,986,822 lekë, si dhe të kërkojë që të bëhet regjistrimi në sektorin përkatës të kartelës** në Drejtorinë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, **në refuzim të vendosën masë për kufizimin deri në arkëtimin e plotë të detyrimeve të papaguara**.

- **Gjetje nga auditimi:** Në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Elbasan (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan) për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2017 deri 31.05.2019, janë lëshuar 6243 leje legalizimi për objektet informale të legalizuara. Nga 6243 leje legalizimi të lëshuara, 2130 leje legalizimi ose rreth 34 % e këtyre lejeve të legalizimit (6243) janë lëshuar vetëm për objektin me shënimin në lejen e legalizimit “*Kalimi i pronësisë për parcelën ndërtimore do miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave*”, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 me ndryshime, neni 17 (pika 5).

Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasanë bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore deri në daljen e VKM-ve, për **2130 dosje** të objekteve informale të pajisur me Leje legalizimi të objektit, **për të mundësuar brenda afateve ligjore likuidimin të vleftës përkatëse të parcelave ndërtimore**.

- **Gjetje nga auditimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan) për periudhën objekt auditimi ka lëshuar gjithsej 6243 leje legalizimi për objekte informale, ndërsa sipas të dhënave konstatohet se periodikisht brenda periudhës objekt auditimi, kanë dalë nga arkiva e institucionit për tu punuar **11387 dosje** të objekteve informale, për një pjesë të të cilave është kryer edhe kualifikimi i objekteve informale për të vazhduar procedurat deri në lëshimin e lejes së legalizimit, ndërkohë sipas pasqyrave të paraqitura konstatohet se janë kthyer 4,309 dosje pra **me një diferencë 835 dosje** të cilat kanë dalë dhe **nuk janë bërë hyrje në arshivë** dhe nuk ka asnjë të dhënë apo dokument për administrimin e tyre, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet ligjore për administrimin dhe arshivimin e dokumentacionit. Gjithashtu theksojmë se në dosjet e kthyer në plotë raste janë rikthyer dhe nxjerrë disa herë dosjet dhe pa asnjë motiv, nuk përshkruhet arsyeja e tyre e rikthimit në arshivë në sasinë **4,309** kur rezulton se për këto subjekte janë kryer matjet, gent planet, planimetritë dhe nuk kanë marrë vendime duke shkelur të gjitha afatet ligjore dhe deri tani nuk



janë legalizuar duke e zgjatur këtë afat me vite, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, neni 27, 28, ligjin Nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat” si dhe VKM nr.589, datë 10.09.2014, pika 10 i ndryshuar me VKM nr.634, datë 07.09.2016 si dhe VKM nr.280, datë 01.04.2015 i ndryshuar, kreu i IV, pika (8), si dhe VKM nr.1095, datë 28.12.2015 pika 2, si dhe me nenin 15 pika 4 e Rregullores me nr.117, datë 14.07.2015.

Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, të marrë masa që në vazhdimësi për objekte informale të pajisur me leje legalizimi të evidentojë respektimin e afateve të matjeve në terren, kualifikimin e tyre deri në lëshimin e lejes së legalizimit, si dhe për objektet informale për të cilat kanë përfunduar evidentimin faktik në terren të ndërtimeve pa leje, evidentimi i gjendjes juridike të truallit, si dhe hartimi i genplanit dhe planimetrive, por pa përfunduar procesi i legalizimit. Të operojë me vazhdimin e procedurave të legalizimit, duke i trajtuar në funksion të afatit kohor të qëndrimit në arkivë si dhe të bëhet dokumentimi i vazhdueshëm i lëvizjes së dosjeve që futen dhe nxirren nga arkiva për punë.

- **Gjetje nga auditimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan) nuk ka mbajtur evidencë më vete të ankesave të trajtuara ndër vite, afatet e shqyrtimit të tyre, përgjigjet dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre, gjithashtu nuk është ngarkuar me urdhër të veçantë një person kompetent apo një grup specialistësh për shqyrtimin e ankesave, në asnjë nga dokumentet e punës të paraqitura për auditim nuk është adresuar përgjegjësia për shqyrtimin e ankesave, por ato i janë adresuar specialistëve përkatës rast pas rasti. Gjithashtu ka munguar bashkëpunimi dhe rakordimi ndërmjet sektorëve madje duke lënë pa adresuar problematikat e ngritura në ankesat e qytetarëve si dhe zgjidhjen brenda afateve ligjore, konkretisht gjatë periudhës 01.01.2017-31.05.2019, në 779 raste nuk është kthyer asnjë përgjigje për ankesat e bëra nga qytetarët apo institucione të ndryshme. Veprimet dhe mosveprimet më sipër bien në kundërshtim me kërkesat e Kodit të Procedurës Administrative, ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, të marrë masa dhe të caktojë me urdhër një person kompetent për mbajtjen e evidencave të ankesave të trajtuara ndër vite, afatet e shqyrtimit të tyre, përgjigjet dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre, arshivimin e dokumentacionit që fakton kthimin e përgjigjes si dhe të marrë masa të rrisë bashkëpunimin ndërmjet sektorëve duke adresuar problematikat e ngritura në ankesa si dhe dhënien e zgjidhjeve ligjore të problemeve.

- **Gjetje nga auditimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), në 56 raste, sipas Aneksit nr. 8 “*Dosje të lejeve legalizimit pa plotësuar inventarin*”, ka kryer legalizime dhe dokumentacioni i dosjeve së këtyre lejeve legalizimi është i pa plotësuar me inventarin e përkatës të rregullt të dokumentacionit dhe numrit të fletëve për çdo dokument, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”.

Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, të marrë masa duke plotësuar me inventarët e dosjeve 56 rastet e konstatuara, si dhe të gjithë dosjet e tjera që janë të painventarizuara, e në të ardhmen ky proces të kryhet menjëherë pas lëshimit të lejeve të legalizimit, duke vepruar sipas ligjit.

- **Gjetje nga auditimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), në 6 raste, sipas lejeve të legalizimit nr. 2578009, datë 28.09.2018, nr. 2580609, datë 09.04.2019, nr.2578351, datë 31.10.2018, nr. 2578186, datë



24.10.2018, nr. 2578530, datë 22.11.2018, nr. 2580608, datë 09.04.2019 dhe ka kryer legalizime të objekteve social-ekonomikë, të kombinuara, banimi, ku nga auditimi konstatohet se ka patur shkëmbim informacioni mes Drejtorisë së ALUIZNI-t Elbasan dhe strukturave përkatëse që përcaktojnë vendndodhjen e objekteve të legalizuara, prej ku rezulton se objektet ndodhen në Zonën e Mbrojtur të Parkut Kombëtar “Shebenik-Jabllanicë”, sipas VKM nr. 640, datë 21.05.2008, kategoria e dytë e zonave të mbrojtura.

Sa më sipër konfirmohet nëpërmjet shkresave nr. 774/1, datë 03.07.2018, shkresës nr. 227, datë 18.09.2018, të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe shkresa të tjera të Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura Elbasan, në të cilat nuk ka konfirmim për legalizim të objekteve informale dhe shprehet se “Përsa i përket legalizimit të tyre nuk është në kompetencën tonë shqyrtimi dhe vlerësimi i këtij procesi”. Përveç se nga këmbimi i informacionit vendodhja e 7 objekteve në Zonën e Mbrojtur të Parkut Kombëtar “Shebenik-Jabllanicë”, sipas VKM nr. 640, datë 21.05.2008, kategoria e dytë e zonave të mbrojtura, u përcaktua edhe nga verifikimi me sistemin geoportal të rakorduar me hartën dixhitale të legalizimeve që na u vu në dispozicion nga ASHK Elbasan.

Meqenëse ky proces nuk është në kompetencën e AKZM, do të merren për referencë dispozitat ligjore të cilat bëjnë të domosdoshme pajisjen me lejet mjedisore dhe miratimin paraprak nga Këshilli Kombëtar i Territorit. Në kushtet kur kritere të tilla nuk gjenden të dokumentuara në praktikën e lejes së legalizimit, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Elbasan duhej të kishte refuzuar lëshimin e lejes së legalizimit dhe duhej të kishte kryer skualifikimin e objektit.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Përpërcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dheshtesa në vendimin nr. 280, datë 01.04.2015, të këshillit të ministrave, “për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, pika 2, germa “ë” ku citohet: Ndërtimi informal i llojit “objekt”, i ngritur brenda vijës kufizuese të zonës informale të miratuar dhe i përfshirë në fushën e zbatimit të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, përjashtohet nga legalizimi në një nga rastet e mëposhtme: “Është ngritur brenda zonave dhe/ose nënzonave të mbrojtura, shkalla e mbrojtjes të të cilave nuk lejon ndërtime, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 8906, datë 6.6.2002, “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij”, Ligji nr. 8906, datë 6.6.2002 është shfuqizuar nga ligji nr. 81/2017, datë 04.05.2017 “Për zonat e mbrojtura”, neni 16, pika 2, germa “a”, neni 33, të ligjit nr. 81/2017, datë 04.05.2017, “Veprimtaritë që lejohen pasi të jenë pajisur me miratim paraprak”, VKM nr. 640, datë 21.05.2018 “Për shpalljen “Park Kombëtar” të ekosistemit natyror Shebenik-Jabllanicë”, pika 4, germa “ç”.

Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasantë marrë masa të vendosë masë kufizimi dhe të fillojë procedurat me grup pune për rivlerësimin edhe një herë të dokumentacionit tekniko ligjor mbi bazën e të cilit janë lëshuar 7 lejet e legalizimit, duke njoftuar subjektet për fillimin e procedurave përkatëse sipas kërkesave të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”.

Gjithashtutë merren masa për të ardhmen duke lëshuar leje legalizimi për objekte informale, në kushtet e respektimit të zonës së mbrojtur të miratuar me akte ligjore e nënligjore, mbi bazën e konfirmimit nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe lejeve të lëshuara nga ana e këtij institucioni, për vazhdimin e procesit të legalizimit, vetëm mbi bazën e lejeve mjedisore në zona ku mundësohet vazhdimi i veprimtarive tradicionale dhe ekonomike, e ku mund të ushtrohen



veprimtari të reja, dhe për rastet e trashëgimisë kulturore me leje të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe të shërbimit arkeologjik, duke vepruar sipas ligjit.

- **Gjetje nga auditimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), në 5 raste, sipas lejeve të legalizimit nr. 2580387, datë 31.01.2019, nr. 2580609, datë 09.04.2019, nr. 74854213, datë 28.06.2018, nr. 2580387, datë 31.01.20018, nr. 2580608, datë 09.04.2019 ka kryer legalizime për objekt social-ekonomik, të ndodhur në zonën kadastrale nr. 1742, Gjinar, 1715, Dorëz, ku nga auditimi konstatohet se sipas shkresave të ZVRPP Elbasan, pasuritë në fjalë ndodhen brenda pasurisë “Pyll” dhe “Shkëmb”, me status juridik “Shtet”.

Sa sipër, nga ana e ALUIZNI-t Elbasan, janë miratuar leje legalizimi për godinë social-ekonomike në tokë “Pyll” e “Shkëmb” dhe përveç kësaj është ndryshuar edhe zëri kadastral dhe regjimi i tokës në “Truall”, në një kohë që kompetenca për ndryshimin e zërit kadastral nga “Pyll” e “Shkëmb” në “Truall”, për pyjet dhe tokat me bimësi pyjore, me sipërfaqe deri në 1 ha i takon Ministrit të Mjedisit, vetëm në kushtet e një investimi afatgjatë për ndërtimin e strukturave turistike, etj. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar. Siç shihet sa më sipër, legalizimi i 5 objekteve informale dhe ndryshimi i destinacionit të sipërfaqeve të zërit kadastral “Pyll” në “Truall”, është i paligjshëm, pasi ***nuk përfshihet në asnjërën nga veprimtaritë e përmendura*** më sipër dhe nuk ka kërkesë për heqjen nga fondi kullosor apo urdhër Ministri që të ketë bërë miratim për këtë ndryshim destinacioni.

Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasantë marrë masa të vendosë masë kufizimi dhe të fillojë procedurat me grup pune për rivlerësimin edhe një herë të dokumentacionit tekniko ligjor mbi bazën e të cilit janë lëshuar 5 lejet e legalizimit, duke njoftuar subjektet për fillimin e procedurave përkatëse sipas kërkesave të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”.

Gjithashtutë merren masa për të ardhmenduke lëshuar leje legalizimi për objekte informale, në kushtet e respektimit të zonave pyjore e kullosore, në zërat kadastrale “Pyll”, “Shkëmb”, Tokë e Pafrytshme (TPF), zallishte, ranishte, etj., duke ndikuar në ruajtjen e ekosistemit, përjashtuar vetëm në rastet dhe qëllime publike, duke marrë konfirmimin zyrtar nga ana e Ministrit përkatës për sipërfaqet deri në 1 ha, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke vepruar sipas ligjit.

- **Gjetje nga auditimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), në 2 raste, sipas lejeve të legalizimit nr. 2579709, datë 31.07.2018, nr. 2579037, datë 21.09.2018, ka kryer legalizime të ndërtimeve informale, ku nga auditimi dhe verifikimi sipas hartave dixhitale që na u vunë në dispozicion nga DSHK Elbasan, konkretisht harta me emërtimin: “Leje 2018-2019 Totale.dëg”, konstatohen se janë kryer legalizime të objekteve social-ekonomike dhe banimi, të cilat ndodhen pjesërisht në territore të institucioneve publike dhe shtetërore, brenda vijës kufizuese të Spitalit “Baki Kongoli”, brenda vijës kufizuese të objektit shtetëror të ujësjellësit “Pompë uji”. Sa sipër është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar me vendimin e KM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dheshtesa në vendimin nr. 280, datë 1.4.2015, të këshillit të ministrave”, pika 2, germa “c”, dhe Drejtoria e ALUIZNI-t Elbasan duhej të kishte proceduar me refuzimin e kërkesave, mos lëshimin e lejeve së legalizimit si dhe skualifikimin e objekteve.

Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasantë marrë masa të vendosë masë kufizimi dhe të fillojë procedurat me grup pune për rivlerësimin edhe një herë të dokumentacionit tekniko ligjor mbi bazën e të cilit janë lëshuar 2 lejet e legalizimit, duke njoftuar



subjektet për fillimin e procedurave përkatëse sipas kërkesave të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”.

- **Gjetje nga auditimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), në 2 raste, sipas lejeve të legalizimit nr. 2570569, datë 23.07.2018, nr. 2570316, datë 31.05.2018, ka kryer legalizimin e objekteve informale, ku nga verifikimi në dokumentacionin hartografik të paraqitur, në gen-planin, në proces-verbalin e verifikimit në terren, në skicën fushore, si dhe nga matja e kryer në hartën vektoriale dhe në sistemin dixhital zyrtar “geoportal-albania”, u konstatua se legalizimi i këtyre objekteve ishte kryer në pozicionimin e pronës, në një distancë prej 69-94 m nga bregu i Lumit Devoll, me të cilin kufizohen objektet e legalizuara, distancë brenda së cilës pasuria shtetërore është e patjetërsueshme dhe e paparashkrueshme. Në dosje nuk u gjetën plane ose studime të planifikimit dhe rregullimit të territorit, ose dokumente të miratuara në Këshillin Kombëtar të Ujit, për rrjedhojë nuk duhej të ishin pranuar për legalizim këto 2 objekte. Veprimet e kryera më sipër, janë kryer në kundërshtim me ligjin nr. 111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, neni 2, neni 4, pika 8; neni 5 dhe neni 84.

Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan të marrë masa të vendosë masë kufizimi dhe të fillojë procedurat me grup pune për rivlerësimin edhe një herë të dokumentacionit tekniko ligjor mbi bazën e të cilit janë lëshuar 2 lejet e legalizimit, duke njoftuar subjektet për fillimin e procedurave përkatëse sipas kërkesave të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”.

Gjithashtutë merren masa për të ardhmenduke lëshuar leje legalizimi për objekte informale, në kushtet e respektimit të zonave të brigjeve të ujrave sipërfaqësore, si lumenj, përrenj, rezervuare, etj., vetëm mbi bazën e planeve dhe studimeve të planifikimit dhe rregullimit të territorit, të miratuara paraprakisht në Këshillin Kombëtar të Ujit, duke vepruar sipas ligjit.

- **Gjetje nga auditimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), në 3 raste, sipas lejeve të legalizimit nr. 8555516, datë 25.10.2017, nr. 306028, datë 20.11.2017, nr. 85585968, datë 21.10.2017, ka kryer legalizimin e ndërtimeve informale, ku nga verifikimi në dokumentacionin hartografik të paraqitur, në Gen-Planin me shkallë zvogëlimi 1:500 dhe 1:2500, në proces-verbalin e verifikimit në terren, në skicën fushore, si dhe nga matja e kryer në hartën vektoriale dhe në sistemin dixhital zyrtar “geoportal-albania”, u konstatua se legalizimi i objekteve ishte kryer në pozicionimin e pronës, në një distancë prej 12 m – 21 m nga bregu i përrenjve, me të cilin kufizohen objektet e legalizuara, distancë brenda së cilës pasuria shtetërore është e patjetërsueshme dhe e paparashkrueshme, për rrjedhojë nuk duhej pranuar për legalizim objektet në fjalë. Veprimet e kryera më sipër, janë kryer në kundërshtim me ligjin nr. 111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 1, pika 2, germa “a”; neni 4, pika 8; neni 5 dhe neni 84, si dhe me VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dheshtesa në vendimin nr. 280, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, Kreu II, pika 2, germa “h”.

Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan të marrë masa të vendosë masë kufizimi dhe të fillojë procedurat me grup pune për rivlerësimin edhe një herë të dokumentacionit tekniko ligjor mbi bazën e të cilit janë lëshuar 3 lejet e legalizimit, duke njoftuar subjektet për fillimin e procedurave përkatëse sipas kërkesave të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”.



Gjithashtutë merren masa për të ardhmenduke lëshuar leje legalizimi për objekte informalë, në kushtet e respektimit të zonave të brigjeve të ujrave sipërfaqësore, si lumenj, përrenj, rezervuare, etj, brenda largësisë të përcaktuar mbi bazën e planeve dhe studimeve të planifikimit dhe rregullimit të territorit, të miratuara (këto të fundit) paraprakisht në Këshillin Kombëtar të Ujit, duke vepruar sipas ligjit.

- **Gjetje nga auditimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), **në 3 raste**, sipas lejeve të legalizimit nr. 3040868, datë 19.06.2017, nr. 988658, datë 30.06.2017, nr. 2578479, datë 21.11.2018, ka kryer legalizim e objekteve informale, në kushtet ku konstatohet se sipas azhurnimit me sistemin zyrtar geoportal-albania, proces-verbalit të verifikimit në terren dhe skicën fushore, si dhe nga matja e kryer në 2 harta vektoriale Gen-planet me shkallë 1:500 dhe 1:2500, konstatohet se objektet e legalizuara ndodhen në distancë me të vogël se 10 m nga rrugët nacionale të kategorisë “C”, dhe më pak se 5 m prej rrugës rajonale të kategorisë “F”. Veprimet më sipër bien në kundërshtim me VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dheshtesa në vendimin nr. 280, datë 01.04.2015, të Këshillit të Ministrave, ...”, pika 4, germa “b”/i, VKKT me nr. 5, datë 29.12.2014, pika 7, VKM Nr.153 datë 07.04.2000 “Për miratimin e Rregullores në zbatim të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, Neni 27, pika 3.

Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan të marrë masa të vendosë masë kufizimi dhe të fillojë procedurat me grup pune për rivlerësimin edhe një herë të dokumentacionit tekniko ligjor mbi bazën e të cilit janë lëshuar 3 lejet e legalizimit, duke njoftuar subjektet për fillimin e procedurave përkatëse sipas kërkesave të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”.

- **Gjetje nga auditimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), **në 3 raste**, sipas lejeve të legalizimit nr.3054852, datë 21.06.2017, nr. 2526985, datë 10.11.2017, nr. 2580684, datë 15.04.2019, ka kryer legalizimin e objekteve informalë, në kushtet kur konstatohet se sipas materialit hartografik dhe pozicionimit të pronës, të paraqitur në 2 gen-planet me shkallë zvogëlimi 1:500 dhe 1:2500, nga matjet që u bënë në këto gen-plane, 3 objektet informalë të legalizuar **janë ndërtuar në një distancë shumë afër hekurudhës më pak 25 m** dhe në dosje nuk ka asnjë dokumentacion që vërteton marrjen e konfirmimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave për legalizimin e objektit, veprime këto që bien në kundërshtim me nenin 45, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, pika 5 e Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrin të regjistruesit”, Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, të ndryshuar dhe pika 2, germa “b”, pika 3, pika 4, germë “a”, pika 5 të VKM nr. 280, date 01.04.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”.

Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan të marrë masa të vendosë masë kufizimi dhe të fillojë procedurat me grup pune për rivlerësimin edhe një herë të dokumentacionit tekniko ligjor mbi bazën e të cilit janë lëshuar 3 lejet e legalizimit, duke njoftuar subjektet për fillimin e procedurave përkatëse sipas kërkesave të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”.

- **Gjetje nga auditimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), **në 33 raste**, sipas lejeve të legalizimit në Aneksin nr. 9 “Objekte social ekonomike pa paguar parcelën ndërtimore”, ka kryer legalizime të objekteve



social-ekonomikë dhe të kombinuar, duke i kaluar në ZVRPP për t'u regjistruar me kufizime sipas hipotekës ligjore, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1.

Në dosje nuk rezulton të ketë dokument financiar për pagesën e parcelës ndërtimore, pra nuk është paguar vlera e parcelës ndërtimore, në një kohë që objektet janë me funksion **“Social-Ekonomik”** ose **“I Kombinuar”** dhe nuk duhej vendosur hipotekë ligjore si dhe nuk duhej lëshuar leja e legalizimit pa u paguar vlera e parcelës ndërtimore sipas vendimit të KM për këtë qëllim. Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1 dhe VKM nr. 1095, datë 28.12.2015 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet ALUIZNI-t dhe ZQRPP-së, dhe të procedurave apokufizimeve që zbatohen përfekt të regjistrimit të pasurivetë legalizuara”, Kreu III.

- **Rekomandim:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, të marrë masa për të ardhmen, duke lëshuar leje legalizimi për objekte informale, vetëm në rastin kur subjekti apo njëri prej subjekteve që disponojnë ndërtimin **me funksion banimi** nuk shlyejnë detyrimet financiare të parashikuara në ligj për vlerën e parcelës ndërtimore të objektit pa leje. Në këto raste të mos përfshihen rastet **e objekteve social-ekonomike dhe të kombinuara**, për të cilat lejet e legalizimit të lëshohen vetëm në rastin e kryerjes së pagesës për parcelën ndërtimore, të miratuar me VKM, duke vepruar sipas ligjit.

- **Gjetje nga auditimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), **në 73 raste**, ka kryer legalizime të objekteve informalë në kushtet kur në dosjet mungojnë vërtetimet për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 27, germa “ç”, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

- **Rekomandim:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, të plotësojë dosjet më vërtetimet për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, të lëshuara nga organet e pushtetit vendor dhe të marrë masa për të ardhmen, duke lëshuar leje legalizimi për objekte informalë, në kushtet e disponimit në dosjet përkatëse të këtyre vërtetimeve, sipas ligjit.

- **Gjetje nga auditimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), **në 56 raste**, ka kryer legalizime të objekteve informalë, në kushtet kur në proces-verbalet e verifikimit në terren mungojnë datat e mbajtjes së tij dhe nuk mund të përcaktohet afati kohor proces-verbal verifikimi – vendim kualifikimi, ose në kushte kur ky afat kohor është më shumë se 60 ditë, duke vepruar kështu në kundërshtim me VKM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar, pika 8.

Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, të marrë masa për të ardhmen, duke lëshuar leje legalizimi për objekte informale, sipas afateve të përcaktuara në limitin prej 60 ditësh i afatit kohor proces-verbal verifikimi – vendim kualifikimi, sipas ligjit.

- **Gjetje nga auditimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), **në 28 raste**, ka kryer legalizimin e objekteve informalë në kushtet kur afati kohor ndërmjet datës së vendimit për kualifikim dhe datës së lejes së legalizimit është më shumë se 30 ditë, duke vepruar në kundërshtim me Urdhrin nr. 37, datë 19.01.2016 “Për miratimin e plan veprimit për shqyrtimin administrativ të praktikave të legalizimit të ndërtimeve pa leje”, pika 6- Miratimi i lejes së legalizimit përpara kalimit të pronësisë, germa “a”.

Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, të marrë masa për të ardhmen, duke lëshuar leje legalizimi për objekte informale, sipas afateve të përcaktuara në limitin prej 30 ditësh i afatit vendim kualifikimi – leje legalizimi, sipas ligjit.



- **Gjetje nga auditimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), në **97 raste**, ka kryer legalizimin e objekteve informale, në kushtet kur proces-verbale të verifikimit në terren nuk janë plotësuar me rubrikat për: datën e mbajtjes, sipërfaqet e parcelës ndërtimore, njolla e objektit, numri i kateve dhe destinacioni i sipërfaqeve. Përsa i përket pasurive kufitare (të saktësuara në përshkrim) nuk janë shënuar numrat e pasurive dhe distancat nga pasuritë kufitare. Këto mungesa, veçanërisht mungesa e sipërfaqes së parcelës ndërtimore dhe distancave nga objektet kufitare e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale. Sa sipër është në kundërshtim me rubrikat sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, të marrë masa për të ardhmen, duke lëshuar leje legalizimi për objekte informale, në kushtet e plotësimit të rregullt dhe pa mangësi të proces-verbaleve të verifikimit në terren, në rubrikat sipas formularit: datën e mbajtjes, sipërfaqet e parcelës ndërtimore, njolla e objektit, numri i kateve dhe destinacioni i sipërfaqeve, numrat e pasurive kufitare (të saktësuara në përshkrim) dhe distancat e objektit nga këto pasuri kufitare, duke e kthyer proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument të vërtetë, si dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale, sipas ligjit.

- **Gjetje nga auditimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), sipas lejeve të legalizimit nr. 2578564, datë 23.11.2018; nr. 2578574, datë 23.11.2018; nr. 2578732, datë 28.03.2018; nr. 2578524, datë 22.11.2018; nr. 2578501, datë 21.11.2018; nr. 2578729, datë 28.03.2018; nr. 2578140, datë 22.10.2018; nr. 2580216, datë 20.12.2018, ka kryer legalizimin e objekteve informale, në kushtet kur në dosje disponohen të panënshkruara nga deklaruesi:

-deklarata personale, që merr përsipër përgjegjësinë për çdo pasojë, që mund të rrjedhë nga shkaqe natyrore dhe/ose nga përdorimi i banesës. Sipas këtij ligji, shteti nuk është përgjegjës për kompensimin ose dëmshpërblim në raste fatkeqësish, për shkak faktorëve, që ndikojnë në qëndrueshmërinë e objektit.

-deklarata për zbatimin e planit rregullues, sipas së cilës deklaruesi pranon zbatimin e planit rregullues/studimit urbanistik pjesor, përfshirë këtu: respektimin e hapësirave publike, gjelbërimin, tipin e rrethimit, ngjyrat, ndriçimin, parkimin, etj.

Sa më sipër është në kundërshtim me nenin 27, germa “dh”, të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

- **Rekomandim:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, të marrë masa për të ardhmen, duke lëshuar leje legalizimi për objekte informale, në kushtet e plotësimit të dosjeve të legalizimit me dokumente të nënshkruara nga deklaruesi, përkatësisht deklarata personale dhe deklarata për zbatimin e planit rregullues.

- **Gjetje nga auditimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), në **13 raste**, sipas lejeve të legalizimit nr. 2578186, datë 24.10.2018; nr. 2570316, datë 31.05.2018; nr. 3040868, datë 19.06.2017; nr. 2578524, datë 22.11.2018; nr. 2030156, datë 30.05.2017; nr. 9858742, datë 20.10.2017; nr. 2580216, datë 20.12.2018; nr. 2578427, datë 20.11.2018; nr. 3151001, datë 21.06.2017; nr. 3737510, datë 14.11.2017; nr. 58598748, datë 16.10.2017; nr. 2578197, datë 25.10.2018, nr. 2578479, datë 21.11.2018, ka kryer legalizimin e objekteve informale në kushtet kur parcelat ndërtimore janë në zërat kadastrale “Arë”, “Vreshtë”, “Pemishte”, “Ullishte”, “Ledh”, etj, dhe lejet e legalizimit janë lëshuar në mungesë të dokumentacionit: kërkesa për miratimin në Këshillin e Qarkut, të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Agjencisë Rajonale të Mjedisit. Pra nuk ka asnjë



dokumentacion nga këto organe, për t'i dhënë lejen dhe miratimin e këtyre lejeve të legalizimit sjell automatikisht ndryshimin e zërit kadastral gjatë regjistrimit në ZVRPP Elbasan.

Sa më sipër veprimet janë kryer në zonat “*Territore të tjera*”, në kundërshtim me nenet 10, 11, 14, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar dhe VKM nr. 515, datë 13.5.2009 e VKM nr. 589, datë 10.9.2014, “Për përcaktimin e afateve, të mënyrës dhe kohës së ushtrimit nga ALUIZNI të përgjegjësive të zyrave të urbanistikës dhe të këshillave të qarqeve, gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale” si dhe Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit me nr. 5, datë 29.12.2014 “Për identifikimin e zonave të urbanizuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në miratimin e hartave ku mund të ndërhyhet në funksion të zhvillimit urban”, pika 9 ku përcaktohet: “Konvertimi nga tokë “Arë” në tokë “Truall” për sipërfaqet brenda zonave të urbanizuara do të bëhet sipas procedurave përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi”.

- **Rekomandim:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan të marrë masa të vendosë masë kufizimi dhe të fillojë procedurat me grup pune për rivlerësimin edhe një herë të dokumentacionit tekniko ligjor mbi bazën e të cilit janë lëshuar 13 lejet e legalizimit, duke njoftuar subjektet për fillimin e procedurave përkatëse sipas kërkesave të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”.

Gjithashtutë merren masa për të ardhmen duke lëshuar leje legalizimi për objekte informale, në kushtet kur parcelat ndërtimore janë në zërin kadastral “Truall”, ose në zona informale këto të miratuara nga KRRTRSH/KKT. Në rastet kur parcelat ndërtimore janë në zonat “*Territore të tjera*”, zërat kadastrale “Arë”, “Vreshtë”, “Pemishte”, Ullishte”, “Ledh”, etj., lejet e legalizimit të lëshohen në disponim të dokumentacionit: kërkesa për miratimin në Këshillin e Qarkut, të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Agjencisë Rajonale të Mjedisit, sipas ligjit.

- **Gjetje nga auditimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), ka lëshuar leje e legalizimi në kushtet kur proces-verbalet e verifikimit në terren mbajnë datë më të vonshme se vendimet për kualifikim të objekteve informale dhe lejet e legalizimit, pra procedurat janë bërë formale.

- **Rekomandim:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, të marrë masa për të ardhmen, duke lëshuar leje legalizimi për objekte informale, në kushtet e plotësimit rrjedhës kronologjike të dokumentacionit të miratuar, duke shmangur dokumentat formale.

- **Gjetje nga auditimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), në 4 raste, sipas lejeve të legalizimit nr. 402604, datë 24.04.2017; nr. 4050132, datë 28.04.2017; nr. 5030602, datë 28.04.2017; nr. 4150123, datë 28.04.2017, ka kryer legalizimin e objekteve informale në kushtet kur në dosje mungojnë fotografitë të 1 ose 2 pamjeve të objektit, në kundërshtim me urdhërin nr. 46, datë 18.7.2006 dhe “Manual i procedurave mbi procesin e vetëdeklarimit”, pika 7/1.

- **Rekomandim:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, të marrë masa për të ardhmen, duke lëshuar leje legalizimi për objekte informale, në kushtet e plotësimit të dosjeve të legalizimit me fotografitë në të katër pamjet, sipas ligjit.

- **Gjetje nga auditimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), në 1 rast, ka kryer legalizimin e objektit informal sipas Leje legalizimi nr. 2578256, datë 29.10.2018, ndërtim për Godinë banim 5 Kat, në emër të Isen Qazim Samurri, pa marrë konfirmimin nga OSHE nëse nga ndërtimi informal çenohet linja e tensionit të lartë. Me shkresën nr. 4529 prot, datë 25.06.2018, kërkesë për informacion, drejtuar OSHE Elbasan, ALUIZNI Elbasan ka kërkuar informacion nëse pranë objektit informal ka linjë të tensionit të lartë dhe nëse ky objekt është ndërtuar në kundërshtim me Rregulloren e Shfrytëzimit teknik të Nën Stacioneve dhe Linjave Elektrike të sistemit energjitik. Në dosje nuk administrohet kthimi përgjigje për shkresën e sipërcituar. Nga verifikimi imazheve dixhitale dhe



hartografike rezulton se objekti është ndërtuar në distancë shumë të afërt me linjën e tension të lartë dhe parcela ndërtimore shtrihet nën linjën e tensionit të lartë. Sa sipër veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me VKM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dheshtesa në vendimin nr. 280, datë 1.4.2015, të këshillit të ministrave, “për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, pika 2, germa “ç” dhe “g” dhe përcaktimet e Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.

- **Rekomandim:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasantë marrë masa të vendosë masë kufizimi dhe të fillojë procedurat me grup pune për rivlerësimin edhe një herë të dokumentacionit tekniko ligjor mbi bazën e të cilit është lëshuar leja e legalizimit nr. 2578256, datë 29.10.2018, në emër të Isen Q S, duke njoftuar subjektin për fillimin e procedurave përkatëse sipas kërkesave të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.

- **Gjetje nga auditimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), në 1 rast, ka kryer legalizimin e objektit informalë Leje legalizimi nr. 2580637, datë 09.04.2019, ndërtim për Godinë Social Ekonomike 1 Kat në emër të I Xh H, pa marrë konfirmimin nga Bashkia Belsh nëse çenohet infrastruktura publike si dhe në kushtet kur objekti nuk është ndërtuar para datës 27.06.2014, afati ligjor brenda të cilit duhet të jenë ndërtuar objektet e vetëdeklaruar. Me shkresën nr. 3003 prot, datë 09.04.2019, Kërkesë për informacion dhe miratim, drejtuar Bashkisë Belsh, ALUIZNI Elbasan ka kërkuar informacion nga Bashkia Belsh si autoriteti përgjegjës si dhe konfirmimin në lidhje me vazhdimin e procedurave administrative të legalizimit të objektit informal, dhe nëse ky objekt çenon hapsirat publike ose jo. Në dosje nuk administrohet shkresa kthim përgjigje për këtë shkresë. Me shkresën pa numër prot, datë 10.04.2019, Bashkia Belsh ka lëshuar vërtetim, sipas të cilit vërtetohet se shtetasi I Xh H, posedon një objekt shërbimi të ndërtuar para vitit 2014. Nga verifikimi i imazheve hartografike dhe digjitale rezulton se objekti nuk është ndërtuar para datës 27.06.2014, afati ligjor brenda të cilit duhet të jenë ndërtuar objektet e vetëdeklaruar.

Gjithashtu vërtetimi i dhënë nga Bashkia në lidhje me periudhën e ndërtimit nuk është kompetencë e këtij autoriteti dhe nuk ka vlerë për procesin e legalizimit, pasi nuk prodhon pasoja juridike. Sa sipër veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dheshtesa në vendimin nr. 280, datë 01.04.2015, të këshillit të ministrave, “për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, si dhe Nenin 2, pika 1, përcaktimet e Ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.

- **Rekomandim:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasantë marrë masa të vendosë masë kufizimi dhe të fillojë procedurat me grup pune për rivlerësimin edhe një herë të dokumentacionit tekniko ligjor mbi bazën e të cilit është lëshuar leja e legalizimit nr. 2580637, datë 09.04.2019, në emër të I Xh H duke njoftuar subjektin për fillimin e procedurave përkatëse sipas kërkesave të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.

- **Gjetje nga auditimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), në 3 raste, ka vijuar procedurat e lëshimit të lejes së legalizimit bazuar vetëm në deklaratën noteriale të poseduesit të ndërtimit për prishjen e ndërtimit të vjetër, por në dosje nuk ka asnjë dokumentacion tjetër nga institucionet vendore si organet



kompetente që japin lejen përkatëse për prishjen e objektit, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 8405 datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar, Neni 49, pikën 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.

- **Rekomandim:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasantë marrë masa, që në çdo rast të regjistrimit të lejeve të legalizimit për objektet informalë të ndërtuara mbi objektet e vjetra, të kërkojë paraqitjen e dokumentacionit ligjor lëshuar nga organet kompetente vendore për prishjen e objektit të vjetër në përputhje me përcaktimet ligjore.

- **Gjetje nga auditimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (Drejtorja Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), në 1 rast, ka vijuar procedurat e lëshimit të lejes së legalizimit nr. 2578217, datë 26.10.2018, në emër të A Sh H, me mangësi në dokumentacion pasi sipas lejes së ndërtimit sipërfaqja sheshit të ndërtimit është 2492 m² dhe sipërfaqja e ndërtimit është 1500 m², ndërkohë që sipas lejes së legalizimit sipërfaqja e parcelës ndërtimore është 1468.3 m² dhe sipërfaqja e ndërtimit është po 1468.3 m², pra jemi në kushtet kur subjekti fillimisht sipas lejes së ndërtimit të miratuar, ka disponuar një sipërfaqe sheshi dhe sipërfaqe ndërtimit më të madhe, ndërkohë që pasi i është nënshtruar procesit të legalizimit për shkak të shmangies nga leja e ndërtimit, sipërfaqja e sheshit është zvogëluar në 1468.3 m² dhe sipërfaqja e ndërtimit është zvogëluar në 1468.3 m² (1343.1 m² + 125.2 m²), pra ka mospërputhje. Gjithashtu referuar Akt-Kolaudimi pa datë, sipërfaqja e sheshit të ndërtimit është 2492 m² dhe sipërfaqja e ndërtimit është 1400 m², ka mospërputhje me lejen e ndërtimit dhe vërtetimet e lëshuara nga Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Elbasan. Zvogëlimi i sipërfaqes së sheshit të ndërtimit si rezultat i kalimit nga leja e ndërtimit drejt procesit të legalizimit, bie në kundërshtim me vet qëllimin dhe objektin e ligjit të legalizimeve nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, Neni 1, pika 1 dhe 2, Neni 15/1, pasi subjekti i nështrohet procesit të legalizimit për shtesat anësore osë në lartësi tej lejes së ndërtimit dhe jo zvogëlimit të sipërfaqes së truallit apo ndërtimit. Gjithashtu në dosje nuk administrohen planimetrit për të gjitha katet e ndërtimit si dhe përmbledhësja e sipërfaqeve për çdo njësi duke përfshirë dhe ambjentet e përbashkëta.

- **Rekomandim:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasantë marrë masa të vendosë masë kufizimi dhe të fillojë procedurat me grup pune për rivlerësimin edhe një herë të dokumentacionit tekniko ligjor mbi bazën e të cilit është lëshuar leja e legalizimit nr. 2578217, datë 26.10.2018, në emër të A Sh H, duke njoftuar subjektin për fillimin e procedurave përkatëse sipas kërkesave të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.

- **Gjetje nga auditimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (Drejtorja Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), ka vijuar procedurën e lëshimit të lejeve të legalizimit nr. 80090065, datë 16.05.2017, nr. 8080059, datë 10.05.2017, nr. 8090078, datë 18.05.2017, nr. 2030003, datë 17.05.2017, ma mangësi në dokumentacion pasi procesverbali i përgatitjes dhe vlerësimit të dosjes i mbajtur me datë 11.05.2017, në rubrikën mbi çështjet e pronësisë, ka shënimin *ka përgjigje nga ZVRPP për statusin juridik me cilësimin “në pronë të tretëve”*, ndërsa sipas shkresës së ZVRPP nr. 3476 datë 15.06.2015, kthim përgjigje statusi juridik i aplikimit për legalizim objekti nr. 168 me deklarues Xh A S për pasurinë nr. 36/30 figuron “tokë arë”.

-Në vendime cilësohet se “Subjekti ka më shumë se një ndërtim informal” ndërsa nuk ka deklarata noteriale për përzgjedhjen nga qytetari të objektit që do legalizojë me kushte favorizues dhe pranimin e kushtit që për subjektin tjetër që do të legalizosh detyrimet financiare do të llogariten me çmimet e tregut.

-Gjithashtu ALUIZNI Elbasan ka miratuar lejen e legalizimit për ndërtimin pa leje për këto pasuri, pa konfirmuar statusin juridik të pasurisë, çka sjell ndryshimin automatikisht të zërit kadastral gjatë regjistrimit në ZVRPP në mungesë të dokumentacionit; kërkesa për miratimin në Këshillin e



Qarkut, të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Agjencisë Rajonale të Mjedisit. Pra, nuk ka asnjë dokumentacion nga këto organe, për t'i dhënë lejen, veprimin të kryer për legalizim në zonat “Territore të tjera”, gjë e cila bie në kundërshtim me nenet 10, 11, 14, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar dhe VKM nr. 515, datë 13.5.2009 e VKM nr. 589, datë 10.9.2014, “Për përcaktimin e afateve, të mënyrës dhe kohës së ushtrimit nga ALUIZNI të përgjegjësive të zyrave të urbanistikës dhe të këshillave të qarqeve, gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale” si dhe Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit me nr. 5, datë 29.12.2014 “Për identifikimin e zonave të urbanizuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në miratimin e hartave ku mund të ndërhyhet në funksion të zhvillimit urban”, pika 9 ku përcaktohet: “Konvertimi nga tokë “Arë” në tokë “Truall” për sipërfaqet brenda zonave të urbanizuara do të bëhet sipas procedurave përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi”.

-Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan,të marrë masa për vendosjen e kufizimit mbi pasuritë e regjistruara sipas lejeve të legalizimitnr. 80090065, datë 16.05.2017, nr. 8080059, datë 10.05.2017, nr. 8090078, datë 18.05.2017, nr. 2030003, datë 17.05.2017 dhe nr. 2090058, datë 17.05.2017, deri në plotësimin dhe rregullimin e të metave në procedurën e regjistrimitnë zbatim të pikës b, nenit 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”.

- Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan(Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan),ka vijuar procedurën e lëshimit të lejeve të legalizimit nr. 8090078, datë 18.05.2017, nr. 8090087, datë 17.05. 2017, me mangësi në dokumentacion pasi në dosje nuk ka korrespondencë shkresore me Autoritetin Rrugor Shqiptar për të përcaktuar nëse parcela ndërtimore bie mbi projektin infrastrukturor, gjithashtu kartela e pasurisë e administruar në dosje mban datën 08.07.2000, ndërkohë që vendimi i kualifikimit mban nr. 20213 datë 10.05 2017 , ndërsa leja e legalizimit është dhënë në datë 18.05.2017, pra kartela nuk është e rifreskuar për të paraqitur gjedjen juridike të pronës në muajin e fundit.

-Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan,të marrë masa për vendosjen e kufizimit mbi pasuritë e regjistruara sipas lejeve të legalizimitnr. 8090078, datë 18.05.2017 dhe nr. 8090087, datë 17.05. 2017 deri në plotësimin dhe rregullimin e të metave në procedurën e regjistrimitnë zbatim të pikës b, nenit 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”.

- Gjetje nga auditim: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan(Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan),ka vijuar procedurën e lëshimit të lejeve të legalizimit nr. 1020033 datë 18.06.2017, dhe nr. 1020034, datë 18.05.2017, në kushtet kur në dosje gjenden dy leje legalizimi por nuk administrohet vërtetimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë sipas shkresës nr. 5405 prot, datë 31.05.2017, drejtuar njësisë së qeverisjes vendore, sipas deklaratave noteriale të qytetarit është një objekt dy katesh sipas dosjes 840 e cila legalizohet sipas kriterëve favorizuese të ligjit dhe objekti tjetër i cili duhet të legalizohet me çmimet e tregut, gjithashtu në leje nuk është cilësuar që objekti njëkatësh është për aktivitet social.

- Me shkresën nr. 8075 prot, datë 31.10.2016 ALUIZNI Elbasan drejtuar ZVRPP, ka kërkuar informacion për gjëndjen juridike të pronës. ZVRPP nuk sqaron për gjëndjen juridike të parcelave mbi të cilën janë ndërtuar dy objektet informale.Në procesverbalin e verifikimit në terren datë 09.10.2017, nuk janë shënuar kërkesat për qëllimin e shfrytëzimit të objekteve, funksionin e hapësirave sipas faktit dhe pasuritë kufitare të saktësuarra më shkrim me numra dhe fjalë.

- Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan,të marrë masa për vendosjen e kufizimit mbi pasuritë e regjistruara sipas lejeve të legalizimit nr. 1020033 në emër të Petrit Haxhi Shegadhe nr. 1020034, datë 18.05.2017, në emër të P H deri në plotësimin



dhe rregullimin e të metave në procedurën e regjistrimit në zbatim të pikës b, nenit 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”.

- **Gjetje nga auditimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), në **1 rast**, me urdhër-shpenzimin nr. 38, datë 27.03.2018, janë kryer shpenzime në shumën 1,395,520 lekë, me objekt “Ekzekutim Vendim Gjyqi”: 1,246,000 lekë dhe “Tarifë shërbimi përmbarimor”: 149,520 lekë, në kredi të përfituesit: shoqërisë përmbarimore ”S B S” shpk, me xhirim datë 27.03.2018, sipas faturës nr. 144, nr. Serie 58125174, dt. 23.03.2018, vendim gjyqi nr.(82-2016-1084) 706, dt.14.07.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, vendim gjykate nr. 4443, datë 26.10.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, Urdhër 94, datë 23.03.2018.

- Në pjesën vërejtëse dhe arësyetimit ligjor dhe analizës së fakteve të vendimit nr.(82-2016-1084) 706, dt.14.07.2016, të gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, si indice për fillimin e procedurës gjyqësore është marrë urdhëri nr. 477, datë 25.04.2016 i Titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, sipas të cilit punonjësja e financës lirohet nga detyra si specialiste në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe emërohet si specialiste në Sektorin e legalizimit Librazhd, pranë Drejtorisë së ALUIZNI-t Elbasan. Gjykata e ka çmuar të arësyeshme duke e marrë këtë shkresë de facto, si masë largimi nga puna, kjo e arësytuar proceduralisht nga rrethanat objektive dhe subjektive të çështjes, mosndjekjen e procedurave administrativo-ligjore sipas kontratës së punës së lidhur me punëdhënësit dhe punëmarrësit dhe mosrespektimin e dispozitave të Kodit të Punës, lidhur me këtë.

- Në pjesën “Arësyetimi ligjor dhe analiza e fakteve”, gjykata parashtron se “Shkaku për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës jo vetëm që nuk argumentohet nga pala e paditur (ALUIZNI Elbasan), por është edhe një interpretim abuziv me dispozitat e Kodit të Punës, duke mos argumentuar shkurtimin e vendeve të punës”. Pas daljes së urdhërit të largimit nga puna, punonjësja e larguar është zëvendësuar me një specialiste tjetër.

Sa sipër duke kryer mesatarizimin e pagesës kemi për 17 muaj një pagesë prej 1,395,520 lekë, periudhë në të cilën janë paguarde fakto në Sektorin e ALUIZNI-t Librazhd, për një pozicion pune njëkohësisht dy persona, për një periudhë 17 muaj, siç ka përcaktuar gjykata, duke u shpenzuar shuma 1,395,520 lekë, veprim i cili ka efekte financiare negative, me shkak mosndjekjen e procedurave të rregullta ligjore sipas Kodit të Punës dhe kontratës së lidhur, nga strukturat e Drejtorisë së ALUIZNI-t Elbasan.

- **Rekomandim:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, të marrë masa për të ardhmen, të zbatojë të gjitha procedurat ligjore lidhur me masat që merren ndaj punonjësve e specialistëve, për “Zgjidhje e kontratës së punës”, duke mos i dhënë shkas punonjësve t’i drejtohen gjykatave dhe të fitojnë të drejtën e mohuar, e ngarkuar shpenzimet buxhetore me mbishpenzime me efekte financiare negative. Në rast të marrjes së vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të zbatohen vendimet vullnetarisht pa qenë e nevojshme ndërhyrja e strukturave të përmbarimit, duke rritur më shumë akoma shpenzimet buxhetore.

- **Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi dhe verifikimi i ankesës së shtetasit Skerdijan Kurti, administruar në KLSH me nr. 46 prot, datë 15.01.2018, ku janë ngritur pretendime për veprime të paligjshme në legalizimin e objektit informal të ndërtuar nga shtetasi F T, pasi është fallsifikuar dokumentacioni duke paraqitur si vetdeklarim për ndërtimin e objektit në vitin 2014, ndërkohë që objekti është ndërtuar në vitin 2017 anës rrugës në vendin e quajtur Kanali me Kemba, **nga auditimi u konstatua:**

Në dosje administrohet vetëdeklarimi nr. 372, datë 21.03.2005, për objektin Magazinë plus lokal, në emër të H H, sipas të cilit sipërfaqe e ndërtimit është 200 m², ndërkohë që sipërfaqja e parcelës ndërtimore është 500 m². Me deklaratën noteriale nr. 1482 rep, 961 kol, datë 20.10.2017, shtetasi H H dhe M H, deklarojnë se procedura e legalizimit do të vazhdojë në emër të T T, duke qenë se



kjo e fundit ka bërë investimin për ndërtimin e objektit. Procesverbali i verifikimit datë 21.08.2017, nuk është plotësuar me distancat përkatëse nga pasuritë kufitare, gjithashtu dhe skicat fushore nuk kanë të dhëna për distancat nga Lumi Shkumbin si dhe rruga Nacionale Elbasan Cerrik. - Në dosje administrohet shkresa nr. 125 prot, datë 31.10.2017, nga Agjencia e Basenit Ujor Shkumbin, kthim përgjigje për shkresën nr. 2576/1 port, datë 30.10.2017 të ALUINI Elbasan, kërkesë për konfirmim të pasurisë nr. 407/20, sipas të cilës Agjencia e Basenit Ujor Shkumbin nuk shprehet për konfirmim por vetëm citon nenin 8 të ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, si referencë për distancat nga brigjet e lumejnve. Theksojmë se shkresa e drejtuar ABUS Elbasan është bërë më pas në kohë nga data e lëshimit të lejes së legalizimit.

Nga verifikimi i imazheve dhe i ortofotos rezulton se objekti ndodhet në një distance prej 115 m nga bregu i Lumit Shkumbin dhe sipas përcaktimeve të nenin 4, pika 8 të ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, në të tilla raste kërkohet miratimi paraprak. Nga ish-ALUIZNI Elbasan është kërkuar konfirmimi me shkresë të hartuar më pas në kohë nga data e lëshimit të lejes së legalizimit, që nuk ka asnjë vlerë ligjore pasi akti është nxjerrë, por edhe në shkresën kthim përgjigj të ABUS Elbasan nuk është dhënë konfirmimi për vazhdimin e procedurave të legalizimit.

- Gjithashtu nga verifikimi i ortofotos datë 27.06.2014, si dhe imazheve dixhitale rezulton se objekti nuk është ndërtuar para datës 27.06.2014, e për pasojë nuk duhet ti nështrohej procesit të legalizimit, veprime këto që bien në kundërshtim me Nenin 1, pika 1 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

- Me shkresën nr. 12414 prot, datë 25.10.2017, drejtuar ZVRPP Elbasan, është përcjellë për regjistrim leja e legalizimit. Me shkresën nr. 7089 prot, datë 10.10.2018, drejtuar ZVRPP Elbasan, është përcjellë për regjistrim dokumentacioni për parcelën ndërtimore, bashkangjitur faturat.

- Me shkresën nr. 2836/2 prot, datë 30.10.2018, ZVRPP Elbasan, administruar në ish-ALUIZNI Elbasan me nr. 7089/1 prot, datë 31.10.2018, ka kthyer dokumentacionin për regjistrimin e parcelës ndërtimore pasi objekti nuk figuron në ortofoton e datës 27.06.2014, si dhe ka kërkuar anulimin e lejes së legalizimit.

- Me shkresën nr. 7089/2 prot, datë 22.02.2019, kërkesë për çregjistrim, ish-ALUIZNI Elbasan drejtuar ish-ZVRPP Elbasan, ka kërkuar çregjistrimin e objektit të regjistruar në emër të T B T dhe kthimin e dokumentacionit origjinal në mënyrë që të bëhet shfuqizimi i lejes së legalizimit.

- **Rekomandim:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan të marrë masa të menjëhershme të çregjistrojë objektin e regjistruar në emër të T B T dhe të bëjë shfuqizimi i lejes së legalizimit. Gjithashtu të ndjekë të gjithë procedurat ligjore në plotësimin e kriterëve për kualifikim të objekteve informale në vazhdimësi.

- **Gjetje nga auditimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), gjatë periudhës 01.01.2017-31.05.2019, rezultoi se nuk ka një evidencë të saktë të proceseve gjyqësore ndër vite, mungon data-base dhe evidentimi rast pas rasti për ecurinë e tyre, ankimimet dhe krijimin e një praktike më vete duke hapur dosje për çdo proces gjyqësor, në përfundim të cilit do t'i nënshtrohet arshivimit, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, neni 26 dhe 40, si dhe ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”.

- **Rekomandim:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan të marrë masa të menjëhershme të caktojë me urdhër të brëndshëm një specialist i cili do të përfaqësojë në vazhdimësi zyrën në proceset gjyqësore, të ndjekë të gjithë shkallët e gjyqësorit duke bërë ankimimet përkatëse si dhe të krijojë database duke evidentuar të gjitha proceset gjyqësore si dhe ecurinë e tyre.



- **Gjetje nga auditimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), në zbatimin, ndjekjen dhe menaxhimin e realizimit të treguesve të Buxhetit për veprimtarinë e viteve 2017 dhe 2018, sipas të dhënave të pasqyruara në tabelë rezulton se, realizimi i fondeve të alokuara është në masën 82 %, me realizim me të ulët paraqitet fondi i parcelës ndërtimore i ndikuar nga mos paraqitja e personave për pagesë si dhe ndryshimi i dispozitave ligjore që favorizon me tej legalizimet deri tek regjistrimi pa pagesë i objekteve ndërtimore. Ky faktor ka ndikuar negativisht në veprimtarinë ekonomiko-financiare të Institucionit. Nga analizat e relacionet e paraqitura konstatohet se nuk janë vënë në dukje se këto fonde janë të pamjaftueshme për vazhdimësinë funksionale të institucionit, apo nevojat për rritjen e tyre për të realizuar objektivat e përcaktuara për plotësimin e detyrave të objekteve për legalizim. Mungesa e herëpashershme e fondeve nga mos arkëtimi i të ardhurave ka bërë të pamundur sigurimin e numrit të nevojshëm të punonjësve me kontratë të domosdoshëm për ndjekjen e procesit të legalizimit.

- **Rekomandim:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, si dhe Drejtoria e Burimeve Mbështetëse të marrin masa për hartimin e buxhetit në periudhat e ardhshme me të ardhurat e arkëtuara nga pagesa e parcelës ndërtimore dhe shërbimet e tjera të institucionit për të siguruar një përputhje të nevojave për fonde me treguesit e shpenzimeve (kryesisht pagat e punonjësve me kontratë) dhe objektivat e vëna për përfundimin e procesit të legalizimit.

- **Gjetje nga auditimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), për vitin 2017 dhe 2018 në organizimin procedurave të prokurimit me vlerë të vogël është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të mallit, procesverbali për marrjen në dorëzim të mallit, janë të detajuara sipas artikujve dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë, por vetëm është shënuar sasia totale e mallit dhe vlera përkatëse sipas kontratës, pa i shënuar ato konkretisht edhe në procesverbalin e marrjes në dorëzim. Veprime këto që bien në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 23 “Specifikimet teknike” dhe nenin 62 “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës”, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, Kreu VI, pika 2, shkronja “ç”, Kreu IX, Neni 77, Mbikëqyrja e kontratës”, pika 1, 2, 3 dhe 4, dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 42 e 43, pika 45. Përveç sa më sipër, konstatohet, se ndërsakërkesa për blerje dhe urdhëri i prokurimit, mbajnë datën 23.12.2016, ofertat e marra nga operatorët ekonomikë: “A” P, AD dhe I shpk, mbajnë datën 20.12.2016, pra janë marrë përpara fillimit të procedurës së prokurimit me vlera të vogla. Prokurimi i kryer në këtë mënyrë mbetet formal.

- **Rekomandim:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, të marrë masa, për çdo rast në procedurat e prokurimit me vlera të vogla, të kryet inventari i dokumentacionit shoqëruar, në ftesat për ofertë të përcaktohen specifikimet teknike, të hartohet relacioni konstatues, të hartohet procesverbali i marrjes në dorëzim të mallit me specifikime të sakta shoqëruar me faturën tatimore.

- **Gjetje nga auditimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), në 1 rast, sipas lejes së legalizimit nr. 9898592, datë 22.06.2017, është legalizuar objekti informal “Godinë e kombinuar 9 Kat+1 kat nën tokë”, ku nga auditimi i dosjes plotësuese, rezulton leja e sheshit dhe e ndërtimit, të njehsuara me origjinalin nr. 07, datë 16.05.2003, është lëshuar nga KRRT Bashkia Elbasan, objekti: “7 kat +podrum (2 katet e para lokale). Sipërfaqja e sheshit 538.75; sipërfaqja e ndërtimit në bazë 370 m². Leja është lëshuar në favor të subjektit “N”, me investitorë A S dhe L Gj, në truallin e z. I Z, z. S P, z. R M.

Sa sipër, rezulton se kemi të bëjmë me shtesa (anësore apo në lartësi) tej lejes së ndërtimit, me qëllim kalimin e së drejtës së pronësisë apo qiradhënien dhe jo objekt informal, siç del nga leja e legalizimit, për rrjedhojë duhej që investitori të paguante për efekt të legalizimit, 2 përqind të



çmimit minimal fiskal, për çdo m² sipërfaqe banimi dhe 5 përqind për veprimtari social ekonomike.

Sipas Aktit të Kolauditimit të disponuar në dosje dhe të firmosur vetëm nga kolaudatori dhe sipas projektit të zbatimit të disponuar gjithashtu në dosje, rezulton se sipas lejes së ndërtimit janë parashikuar sipërfaqe lokal, shërbimi 789 m², ndërsa sipërfaqe banimi janë parashikuar 1769 m². Sipas lejes së legalizimit janë legalizuar 2470 m² sipërfaqe banimi me një shtesë prej 701 m² (2470-1769), krahasuar me sipërfaqen sipas lejes së ndërtimit. Çmimi minimal fiskal për qytetin e Elbasanit, sipas VKM nr. 132, datë 07.03.2018, është 50,300 lekë/m². Rrjedhimisht për shtesën e mësipërme investitori duhej të paguante një penalitet prej 705,206 (701x50,300x2%).

Lidhur me sipërfaqen e lokaleve të shërbimit këto janë pakësuar nga 789 m² në 518 m², pra është pakësuar me 271 m² (789-518), duke u ndryshuar destinacionin dhe duke i kaluar në sipërfaqe banimi. Për këtë rast investitori duhej të paguante një penalitet prej 1,363,130 (271x50,300x10%). Gjithsej investitori duhej të paguante 2,068,336 lekë (705,206+1,363,130). **Vlefëta 2,068,336 lekë përbëndëm ekonomik për buxhetin e shtetit.** Sa sipër bie në kundërshtim ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, neni 43.

- **Rekomandim:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, të marrë masa dhe të ndjekë të gjithë rrugët ligjore për arkëtimine vlerës prej **2,068,336 lekë**, për penalitetin në legalizimin e shtesave informale në objektin me leje ndërtimi, nga ana e subjektit ndërtues “N”/investitorët: A S dhe L Gj.

- **Gjetje nga auditimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), në **1 rast**, ka vijuar procedurat e lëshimit të lejes së legalizimit nr. 2578217, datë 26.10.2018, në emër të A Sh H, me mangësi në dokumentacion pasi nga mandat pagesat e administruara në dosje rezulton se është paguar tarifa e shërbimit 8000 lekë vetëm për një njësi, ndërkohë që objekti është legalizuar i gjithi, pra sipërfaqja ndërtimore me leje ndërtimi 1343.1 m² dhe sipërfaqja ndërtimore pa leje ndërtimi 125.2 m², godinë e kombinuar 9 Kat+1 Kat nëntokë, detyrimisht subjekti duhet të paguajë të plotë tarifën e shërbimit **80,000 lekë** (10 *8000 lekë), jo vetëm për shtesën

- **Rekomandim:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, të marrë masa dhe të ndjekë të gjithë rrugët ligjore për arkëtimine vlerës prej **80,000 lekë**, për mospagesë së tarifës së shërbimit, nga ana e subjektit ndërtues A Sh H.

- **Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të legalizimit të ndërtimeve informale si dhe evidentimi i sipërfaqeve të lira në pronësi shtet, rezulton se nga ana e Drejtorisë së ALUIZNI-t Elbasan nuk janë evidentuar dhe janë lënë jashtë procesit të legalizimit sipërfaqe parcelë ndërtimore të zaptuara dhe në posedim nga poseduesit, ku sipas genplaneve, hartës fushore, ortofotos digjitale dhe hartës vektoriale të pronësive paraqitur në autocad (*vënë në dispozicion nga drejtoria e ALUIZNI-t*, Elbasan), bie në sy se këto parcela janë zvogëluar me qëllim për të qenë në kufirin deri në 300/500 m² (*brenda/jashtë vijës së verdhë*), për efekt pagese të vlerës së truallit, megjithëse në krah të këtyre parcelave ekzistojnë pjesë parcele të pa legalizuara, e cila është pjesë përbërëse e parcelës ndërtimore të zaptuar, por që është numërtuar si parcele më vete dhe që të dyja bashkë do të rezultonin në sipërfaqen e vetë deklaruar nga poseduesit e parcelës së zaptuar, gjë e cila duket dhe nga skica fushore. Plan vendosja e ndërtimit dhe parcelës së zaptuar pasqyruar në genplan me sipërfaqe të zvogëluar, duke lejuar sipërfaqe të ndërmjetme, kufizuar nga kufijtë e sipërfaqes së legalizuar dhe krijimin e parcelave të pa legalizuara brenda parcelave të zëna, jo funksionale.

Bazuar në metodën e veçimit dhe matjes me autocad dhe shenjave konvencionale të përdorur në genplan, evidentohen sipërfaqe e pa legalizuara që duhet t'i ishin bashkëngjitur sipërfaqes së legalizuar, pasi nga pamjet me ortofoto janë lënë jashtë procesit të legalizimit dhe të pamundura



për parcelizim për vetë pozicionin gjeografik që ndodhet, veprime të cilat janë në kundërshtim me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 30, datë 15.01.16 “Për mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së dokumentacionit teknik (*gen-plan, planimetri*)”, i ndryshuar, si dhe shkronja “f” dhe “g” e nenit 3 dhe pika 1 e nenit 17, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, ku si rezultat i mos legalizimit të këtyre sipërfaqeve të zaptuara, në zbatim të nenit 19 dhe 20, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 dhe VKM^{sb} nr. 1620 datë 26.11.2008, **në 6 raste** është evidentuar një sipërfaqe parcelë ndërtimore *brenda/jashtë vijës së verdhë e pa legalizuar prej 2035.9m²* (në total), **me një vlerë tarife e cila sipas vlerës së truallit me çmim tregu referuar zonave kadastrale llogaritet në shumën totale prej 568,673 lekë**, duke shkaktuar mungesë të ardhurash në buxhetin të shtetit për fondin e kompensimit të ish-pronarëve.

- Gjithashtunga ALUIZNI-t Elbasan jo vetëm që nuk janë mbajtur evidenca mbi përfaqet e lira në pronësi shtet lënë jashtë procesit të legalizimit dhe të pamundura për parcelizim për vetë pozicionin gjeografik që kanë, por nuk është marrë asnjë masë për të njoftuar dhe bashkëpunuar me institucionet vendore dhe ato kompetente si Bashkitë e Qarkut Elbasan, vënien në dispozicion të listës së sipërfaqeve të lira, konfirmimin e tyre në pronësi shtet, apo vlerësimin e tyre si troje që përdoren nga qytetarët, pa u taksuar ose për kthim në ambiente publike çlodhëse, lulishte, mungon deklarata noteriale nga individët të cilat pranojnë ose refuzojnë të blejnë truallin sipas çmimit të tregut për pjesën e parcelës të zaptuar e cila është mbi normën ligjore

- **Rekomandim:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan të marrë masa të menjëhershme për të administruar dhe mbajtur evidencë të saktë dhe në mënyrë të vazhdueshme mbi sipërfaqet e lira në pronësi shtet lënë jashtë procesit të legalizimit dhe të pamundura për parcelizim për vetë pozicionin gjeografik që kanë, të njoftojë me shkresë institucionet vendore dhe ato kompetente si Bashkinë Elbasan, duke vënë në dispozicion listën me sipërfaqe të lira, konkretisht për **6 raste** është evidentuar një sipërfaqe parcelë ndërtimore *brenda/jashtë vijës së verdhë e pa legalizuar prej 2035.9m²* (në total), **me një vlerë tarife e cila sipas vlerës së truallit me çmim tregu referuar zonave kadastrale llogaritet në shumën totale prej 568,673 lekë, dhe konrektisht:**

- Subjekti **D D B**, Leje legalizimi nr. 2580608, datë 09.04.2019, për sipërfaqen 114 m², me vlerë 32,946 lekë;

- Subjekti **D D B**, Leje legalizimi nr. 2579621, datë 26.07.2018, për sipërfaqen 198.4 m², me vlerë 57,222 lekë;

- Subjekti **I Q S**, Leje legalizimi nr. 2578256, datë 29.10.2018, për sipërfaqen 579.9 m², me vlerë 167,591 lekë.

- Subjekti **A Q D**, Leje legalizimi nr. 2578443, datë 29.11.2018, për sipërfaqen 275.30 m², me vlerë 64,420 lekë.

- Subjekti **R S D**, Leje legalizimi nr. 2579199, datë 24.05.2018, për sipërfaqen 468.9m², me vlerë 153,034lekë.

- Subjekti **N H J**, Leje legalizimi nr. 2578231, datë 26.10.2018, për sipërfaqen 399.4 m², me vlerë 93,460 lekë.

- **Gjetje nga auditimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), **në 7 raste**, sipas lejeve të legalizimit nr. 2578776, datë 16.04.2018, nr. 2578564, datë 23.11.2018, nr. 2578574, datë 23.11.2018, nr. 2580104, datë 13.12.2018, nr. 8962354, datë 31.12.2018, nr. 2578731, datë 28.03.2018, nr. 2578732, datë 28.03.2018, ka kryer legalizime të. 19, faqe 14, objekteve informale, të cilat sipas shkresave të ZVRPP-së, figurojnë të regjistruara në pronësi “Shtet”, të pa plotësuara seksionet D dhe E të KPP-ve, (Kartelat e pasurive të Paluajtshme), të cilat sipas deklaratave noteriale të qytetarëve, rezultojnë se janë prishur dhe në vend të tyre janë ndërtuar banesa të reja. *Por, konstatohet se në dosje nuk*



ndodhen dokumente që të provojnë faktin se institucioni përgjegjës (administrues) ka kryer procedurat për pasqyrimin e gjendjes ekzistuese në inventarin e pronave të paluajtshme të shtetit. Përveç kësaj, në dosje nuk ndodhet shkresë drejtuar institucioneve përgjegjëse të administrimit të institucioneve shtetërore, gjë që duhej bërë duke njoftuar paraprakisht këto institucione. Sa sipër është në kundërshtim me VKM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar me vendimin e KM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dhështesa në vendimin nr. 280, datë 1.4.2015, të këshillit të ministrave, “për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, pika 13 dhe nenin 13/1.

Sa më sipër konstatohet se nga Drejtoria ALUIZNI Elbasan, është vepruar në kundërshtim me ligjin për legalizimin e ndërtimeve pa leje, pra kemi të bëjmë me ligjërime të prishjes së pronës shtetërore, pa njoftuar institucionet përkatëse dhe pa u kryer veprimet prej këtyre të fundit, dokumentacione këto që duhej të ishin pjesë e dosjes, para se të lëshohej leja e legalizimit. Sipërfaqja ndërtimore pronë “Shtet”, e vlerësuar me koston mesatare të banesave për sipërfaqe shfrytëzimi për qytetin e Elbasanit, sipas EKB, që është 39,154 lekë/m², sipas UKM nr. 3, datë 28.12.2016, llogaritet: 23,489,268 lekë. **Vlera e investimit prej 23,489,268 lekë, përbën efekt financiar negativ dhe të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit.**

- **Rekomandim:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, të marrë masa dhe të ndjekë të gjithë rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës prej **23,489,268 lekë**, e cila përfaqëson vlerën e llogaritur të sipërfaqes ndërtimore, për 7 rastet e objekteve pronë “Shtet”, në bashkëpunim me institucionet shtetërore pronare dhe administruese të objekteve të legalizuara në kundërshtim me ligjin.

I.C. Konkluzione dhe opinioni i auditimit

Nga auditimi i përputhshmërisë mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, i kryer në Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), rezultuan devijime nga kuadri ligjor rregullator në fuqi (kriteret) dhe konkretisht:

- Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan, në marrjen e vendimeve “Për kualifikimin për legalizim të objektit informal” ka vepruar pa marrë konfirmim mbi pagesën e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë për dalje me vendim kualifikimi duke krijuar një mungesë të ardhurash në buxhetin e shtetit në vlerën 42,986,822 lekë,

- Për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2017 deri 31.05.2019, janë lëshuar 6243 leje legalizimi për objektet informale të legalizuara. Nga 6243 leje legalizimi të lëshuara, 2130 leje legalizimi ose rreth 34 % e këtyre lejeve të legalizimit (6243) janë lëshuar vetëm për objektin me shënimin në lejen e legalizimit “Kalimi i pronësisë për parcelën ndërtimore do miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave, ndërsa sipas të dhënave konstatohet se periodikisht brenda periudhës objekt auditimi, kanë dalë nga arkiva e institucionit për tu punuar 11387 dosje të objekteve informale, për një pjesë të të cilave është kryer edhe kualifikimi i objekteve informale për të vazhduar procedurat deri në lëshimin e lejes së legalizimit, ndërkohë sipas pasqyrave të paraqitura konstatohet se janë kthyer 4,309 dosje pra me një diferencë 835 dosje të cilat kanë dalë dhe nuk janë bërë hyrje në arshivë dhe nuk ka asnjë të dhënë apo dokument për administrimin e tyre,



- Në 6 raste, janë legalizuar objekte social-ekonomikë, të kombinuara, banimi, të objekteve që ndodhen në Zonën e Mbrojtur të Parkut Kombëtar “Shebenik-Jabllanicë”, sipas VKM nr. 640, datë 21.05.2008, kategoria e dytë e zonave të mbrojtura.
- Në 5 raste, janë lëshuar leje legalizime për objekt social-ekonomik të ndodhur brenda pasurisë “Pyll” dhe “Shkëmb”, me status juridik “Shtet”.
- Në 2 raste, janë legalizuar objekte social-ekonomike dhe banimi, të cilat ndodhen pjesërisht në territore të institucioneve publike dhe shtetërore, brenda vijës kufizuese të Spitalit “Baki Kongoli” dhe brenda vijës kufizuese të objektit shtetëror të ujësjellësit “Pompë uji”.
- Në 2 raste, janë legalizuar objekte informalë, ku nga verifikimi në dokumentacionin hartografik të paraqitur, në gen-planin, në proces-verbalin e verifikimit në terren, në skicën fushore, si dhe nga matja e kryer në hartën vektoriale dhe në sistemin dixhital zyrtar “geoportal-albania”, u konstatua se legalizimi i këtyre objekteve ishte kryer në pozicionimin e pronës, në një distancë prej 69-94 m nga bregu i Lumit Devoll, me të cilin kufizohen objektet e legalizuara.
- Në 3 raste, janë legalizuar objekte informalë, në një distancë prej 12 m – 21 m nga bregu i përrrenjve, me të cilin kufizohen objektet e legalizuara, distancë brenda së cilës pasuria shtetërore është e patjetërsueshme dhe e paparashkrueshme, për rrjedhojë nuk duhej pranuar për legalizim objektet në fjalë.
- Në 3 raste, konstatohet se objektet e legalizuara ndodhen në distancë me të vogël se 10 m nga rrugët nacionale të kategorisë “C”, dhe më pak se 5 m prej rrugës rajonale të kategorisë “F”.
- Në 3 raste, janë legalizuar objekte informalë, në kushtet kur janë ndërtuar në një distancë shumë afër hekurudhës më pak 25 m dhe në dosje nuk ka asnjë dokumentacion që vërteton marrjen e konfirmimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave për legalizimin e objektit.
- Në 13 raste, janë legalizuar objekte informalë në kushtet kur parcelat ndërtimore janë në zërat kadastrale “Arë”, “Vreshtë”, “Pemishte”, “Ullishte”, “Ledh”, etj. dhe lejet e legalizimit janë lëshuar në mungesë të dokumentacionit: kërkesa për miratimin në Këshillin e Qarkut, të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Agjencisë Rajonale të Mjedisit. Pra, nuk ka asnjë dokumentacion nga këto organe, për t’i dhënë lejen dhe miratimi e këtyre lejeve të legalizimit sjell automatikisht ndryshimin e zërit kadastral gjatë regjistrimit në ZVRPP Elbasan.

Magësit dhe shkeljet e konstatuara më sipër nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur të KLSH, janë materiale për devijimet e konstatuara në disa raste por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar me rezervë dhe për përmirësimin e gjendjes i janë rekomanduar ish-Drejtorisë ALUIZNI Elbasan, sot Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, marrja e masave përkatëse.

I. HYRJA

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Elbasan, (aktualisht përfshirë në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan) duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me: vlerësimin e aktivitetit ekonomik e financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për legalizim për periudhën objekt i këtij auditimi etj.

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 206/1, datë 01.04.2019, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 05.06.2019 deri në datë 31.07.2019, në subjektin Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t



Qarku Elbasan, për periudhën nga 01.01.2017 deri në 31.05.2019u krye auditimi “Mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik e financiar dhe procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për legalizim”, nga Grupi i Auditimi me përbërje:

1. Besmir Pajaj, Përgjegjës Grupi
2. Aleksandër Papadhimitri, anëtar,
3. Xhovan Domi, anëtar,
3. Hysen Metko, anëtar,
4. Artan Mirashi, anëtar.

- Objektivat dhe qëllimi i auditimit Kontrolli i Lartë i Shtetit ka audituar vlerësimin e aktivitetit ekonomik e financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për legalizim për periudhën objekt i këtij auditimi, në përputhje me:

-ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";

-Rregullore e Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimit administrativ të KLSH-së”, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 85, datë 30.06.2015 e ndryshuar.

-Rregullore “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH-së, e ndryshuar. Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropianetë Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi “Auditimin e përputhshmërisë”, Manual i Auditimit Përputhshmërisë, të miratuar nga Kontrollit i Lartë i Shtetit.

-ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, ndryshuar me ligjin nr. 9786, datë 19.07.2007, ligjin nr. 9895, datë 09.06.2008, ligjin nr. 10099, datë 19.03.2009, ligjin nr. 10169, datë 22.10.2009 ligjin nr. 10219, datë 04.02.2010, ligjin nr. 141/2013, datë 02.05.2013 dhe ligjinnr. 50/2014, datë. 15.05.2014, ligjin 62/2015, datë 11.06.2015 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar;

-Vendimin e KM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” i ndryshuar edhe me VKM nr. 756, datë 26.10.2016;

-Vendimi i KM nr. 1180, datë 22.07.2014 “Për përcaktimin e çmimit favorizues të shitjes së parcelës ndërtimore për ndërtimet pa leje me funksion banimi dhe të përzier, të subjekteve që përfitojnë falje të pagesës, si dhe të mënyrës e afateve të pagesës”;

-Vendimi i KM nr. 1180, datë 5.8.2008 “Për përcaktimin e vlerës së tarifës së shërbimit për legalizim dhe mbledhjen e administrimin e të ardhurave të procesit të legalizimit” i ndryshuar;

-ligjin nr. 8379, datë 29.07.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave;

-ligjin nr. 10487, datë 05.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, i ndryshuar; ligjin nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, i ndryshuar; ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”;

-ligji nr. 7661, datë 19.01.1993 “Për kontabilitetin”; ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”;

-ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktive në njësitë e sektorit publik”; ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në ndryshim dhe zbatim të tyre.



Qëllimi i auditimit është vlerësimi objektiv, profesional e i pavarur i përputhjes së veprimeve procedurale, administrative, ekonomike e financiare të Drejtorisë Rajonale ALUIZNI-t Qarku Elbasan, mbi çështjet që lidhen me vlerësimin e procedurave të shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për legalizim e objekteve informale, si dhe veprimtarisë ekonomike financiare të Drejtorisë Rajonale ALUIZNI-t Qarku Elbasan.

Identifikimi i Çështjeve

Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan për periudhën objekt auditimi ka për objekt të veprimtarisë: administrimin e vetëdeklarimeve; procedurat e përditësimit në terren dhe hartimit të dokumentacionit; procesi i rregullimit ligjor të situatës, midis poseduesve të ndërtimeve pa leje dhe pronarëve truall i të cilëve është zënë nga ndërtime informale; lëshimin e lejeve të legalizimit si dhe bashkëpunimin me institucionet e përfshira në procesin e legalizimit.

Aktivitetet që vlerësohen sipas kriterëve të vlerësimit mbështetur në burimet e përdorura (Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan) janë:

-Të dhënat e aplikimeve për legalizim. Duhet patur parasysh se për shkak të disa fushatave të vetëdeklarimeve, ka një numër dublikimesh në vetëdeklarime i njëjti objekt i deklaruar disa herë. Gjithashtu, në vetëdeklarime janë përfshirë edhe një numër objektesh të cilat nuk mund të përfshihen në legalizim për shkak të kohës së ndërtimit të tyre. Si rezultat për të arritur në shifrën reale të ndërtimeve pa leje, nga numri i vetëdeklarimeve duhen zbritur dy kategoritë e mësipërme. Numri i ndërtimeve pa leje të futura në proces legalizimi, në periudhën 2006-31.05.2019, është 48000 objekte.

-Procedurat e përditësimit në terren dhe hartimit të dokumentacionit. Kjo procedurë, përfshin përditësimin në terren të gjendjes ndërtimore dhe plotësimin e hartimit e dokumentacionit tekniko-ligjor (proces verbal, genplan, planimetri, hartë e përditësuar e zonës kadastrale, etj).

-Procesi i rregullimit ligjor të situatës, midis poseduesve të ndërtimeve pa leje dhe pronarëve, truall i të cilëve është zënë nga ndërtime informale, sikurse është përcaktuar në ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar. Në periudhën objekt auditimi nga Drejtoria ALUIZNI-t Qarku Elbasan janë lëshuar 2513 leje legalizimi vetëm objektin në pritje te daljes ve VKM për të likuiduar parcelën ndërtimore.

-për periudhën objekt auditimi janë lëshuar 6243 leje legalizimi në total, më hollësisht sipas viteve për vitin 2017 të 3282 ndërtimeve informale, për vitin 2018 janë lëshuar 2364 leje legalizimidhe deri në 31 Maj të vitit 2019 janë lëshuar 597 leje legalizimi.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar:

Drejtoria e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimin e Zonave\Ndërtimeve Informale Qarku Elbasan, në zbatim të ligji nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, ka për objektiv:

-Legalizimin e objekteve pa leje dhe shtesave vertikale dhe horizontale në objektet me leje ndërtimi".

-Kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore, ku është ngritur ndërtimi pa leje, sipas përcaktimeve të këtij ligji në favor të zaptuesit të pronës.

-Urbanizimin e zonave, blloqeve informale e të ndërtimeve informale, si dhe integrimin e tyre në zhvillimin territorial dhe infrastrukturor të vendit, duke përmirësuar kushtet e jetesës.

-Procedurat për realizimin e legalizimit të ndërtimeve informale/objekteve dhe shtesa informale në objektet me leje ndërtimi si dhe ngritjen e funksionimit e strukturave përgjegjëse për realizimin e tyre.



Përgjegjësitë e audituesve:

Grupi i auditimit të KLSH^{së}, për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, ka zbatuar, Kodin e Parimet Etike të cilat drejtojnë përgjegjësitë profesionale të audituesit dhe Standardet e Miratuara të Auditimit duke patur në qendër të vëmendjes:

- Evidentimi i shmangieve në lidhje me përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë Rajonale ALUIZNI-t Qarku Elbasan me kërkesat e ligjshmërisë për periudhën objekt i auditimit.
- Evidentimi i të metave dhe mangësive në lidhje me rregullshmërinë e proceseve në përputhje me legjislacionit dhe rregullave të funksionimit të miratuara nga Drejtoria Rajonale ALUIZNI-t Qarku Elbasan.
- Vlerësimi ekonomik e financiar i veprimeve, zbulimi i veprimeve të kundërligjshme me pasojë dëm ekonomik, mungesë të ardhurash.
- Vlerësimi i realizimit të treguesve të të ardhurave, shpenzimeve, mënyrës dhe saktësisë në pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare dhe rakordimit me thesarin.
- Evidentimi i shkeljeve dhe parregullsive në zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik-financiar të Drejtorisë Rajonale ALUIZNI-t Qarku Elbasan.
- Vlerësimi i transparencës me publikun, krahasimi i rezultateve të veprimtarisë së institucionit midis viteve objekt i auditimit.
- Ballafaqimi dhe diskutimi i rezultateve të auditimit me personat përgjegjës.
- Përcaktimi i rekomandimeve në bazë të gjetjeve nga auditimi, për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen, shlyerjen e dëmeve të mundshme ekonomike dhe parandalimin e mospërputhjeve në të ardhmen.

Kriteret e vlerësimit:

Përcaktimet ligjore dhe rregullat e funksionimit të Drejtorisë Rajonale ALUIZNI-t Qarku Elbasan, normat dhe metodat e përcaktuara sipas kërkesave të ligjeve, akteve administrative, rregullores së institucionit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe pasqyrave të paraqitura, sistemit hartografik.

Në të gjitha fazat e auditimit sipas programit të detajuar, në përshtatje me Standardet e Auditimit, në referencë me problematikën është patur si kriter vlerësues në radhë të parë ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, -ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, ndryshuar me ligjin nr. 9786, datë 19.07.2007, ligjin nr. 9895, datë 09.06.2008, ligji nr. 10099, datë 19.03.2009, ligjin nr. 10169, datë 22.10.2009 ligjin nr. 10219, datë 04.02.2010, ligjin nr. 141/2013, datë 02.05.2013 dhe ligjin nr. 50/2014, datë 15.05.2014, ligjin 62/2015, datë 11.06.2015 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar; ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin standardeve dhe rregullave kontabël”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” etj.

Në vlerësimin e mekanizmave të auditimit, janë marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

- llojet e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve të cilat mund të ndodhin;
- procedurat e mekanizmave të auditimi, që i shërbejnë parandalimit dhe zbulimit të këtyre gabimeve, të metave, parregullsive dhe shkeljeve;
- nëse janë miratuar procedurat e duhura dhe nëse niveli i respektimit të tyre, është i kënaqshëm;
- anët e dobëta të mekanizmave ekzistuese të auditimi, që çojnë në mos zbulimin e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve prej tyre;
- ndikimi që këto anë të dobëta kanë, dhe:



-shpërndarjen në kohë dhe intensitetin e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve. Auditimi është kryer, në përputhje me Kodin Etik dhe Standardet duke përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë për zbatimin e ligjshmërisë së procesit të legalizimit dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare, konform me parimet, normat, rregullat dhe ligjet në fuqi.

Standardet e auditimit

Rregullorja e Brendshme “Mbi Organizimin dhe Funkcionimin Administrativ të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH, Nr. 85, datë 30.06.2015; Rregullorja e Brendshme “Për procedurat e auditimit të KLSH”; Udhëzimi i Kryetarit të KLSH nr. 1, datë 04.11.2016“ Mbi Procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës, në auditimin e verifikimit zbatimit rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t” (ISSAI), “Standardet e Kontrollit të KLSH”, “Manualeve” si dhe udhëzimeve dhe rregullave të nxjerra në zbatim të tyre.

III. PËRSHKRIMI I I AUDITIMIT

1. Zbatimi i procedurave ligjore në legalizimin e ndërtimeve informale.

1.1- Krijimi i bazës së të dhënave për ndërtimet pa leje dhe përpunimi i tyre. Evidentimi dhe diferencimi në subjektet përfitues ose jo nga procesi i legalizimit.

Mbi auditimin e ushtruar në ish/Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Elbasan “Agjensia Shtetërore e Kadastrës (Drejtoria Vendore Elbasan), në bazë të Programit të Auditimit nr. 380/1, datë 28.05.2019, mbajtur në datë 25.07.2019 “Mbi marrjen dhe përpunimin e të dhënave nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Elbasan, dokumentimi verifikimi e rakordimi dhe dhënia e lejeve të legalizimit në vitet dhe zbatimi i procedurave ligjore në pagesat e taksës në infrastrukturë në objektet e legalizuara në ndërtimet informale”.

Nga verifikimi rezultoi që:

Sipas dokumentacionit të kërkuar nga grupi i auditimit në ish/ Drejtorinë Rajonale të Aluizni-t Elbasan nga të dhënat e marra për objektet informale të ndërtuara në këtë qark, ku rezultoi se janë pajisur me leje legalizimit për ndërtimet informale nga Drejtoria e Aluizni-t Qarkut Elbasan si më poshte:

Nga viti 2006 deri në maj të vitit 2019 janë vetëdeklaruar **48,000 objekte** informale në vitin 2006 deri në vitin 2012 janë vetdeklaruar 18,859 objekte informale, në vitin 2013 janë vetëdeklaruar 3,756 objekte informale, në vitin 2014, kanë vetdeklaruar 22,286 objekte informale, në vitin 2015 janë vetdeklaruar 1202 objekte informale nga viti 2016 deri në vitit 2019 kane vet deklaruar 1897 objekte (shif tabelën e vetdeklarimeve sipas viteve).

Nr	Vedeklarimet sipas viteve	Objekte gjithsej
1	2006-2012	18,859
2	2013	3,756
3	2014	22,286
4	2015	1,202
5	2016-maj 2019	1,897



6	Totali	48,000
---	--------	---------------

Nga këto nga viti 2006 deri në maj 2019 janë dhënë gjithsej **12,785 legalizimi** ose 26 përqind e totalit janë paisur me leje legalizimi.

Pra ngelen për tu legalizuar dhe **35,215 (48,000-12,785)** objekte informale të cilat nuk janë futur akoma në proces legalizimi.

Nga viti 2007 deri në vitin 2015 janë dhënë **1,584** leje legalizimi dhe në vitin 2016 janë dhënë **4,958** leje legalizimi në vitin 2017 janë **3,282** leje legalizimi, në vitin 2018 janë **2,364** objekte për legalizim dhe në vitin 2019 janë **597** objekte për legalizim.

Pra legalizimi sipas këtij ritmi është me një performancë të ulët ku konstatohet se me këto ritëm në 12 vjet janë legalizuar 12,785 objekte afërsisht ose 1000 objekte në vit, pra duhen të reth 35 vjet që të mbarojë legalizimi i objekteve informale kur janë dhe 35,215 objekte të pa legalizuara (*shiko tabelen e legalizimeve si më poshtë*).

Nr	Lejet e Legalizimeve sipas Viteve.	Objekte te legalizuara gjithsej
1	2007-2015	1,584
2	2016	4,958
3	2017	3,282
4	2018	2,364
5	2018-maj 2019	597
6	Totali	12,785

Nga të dhenat nga protokollin në vitin 2017 deri në maj të vitit 2019 u kostatuan se dosjet e objekteve janë nxjerë nga arshiva dhe janë furur përsëri në arshive pa mbaruar procedurën ligjore, në dosje nuk ndodhet as një shënim mbi arsyen pse këto dosje janë rikthyer përsëri (*shiko tabelën si më poshtë*).

Nr.	Viti	Dosje të dala nga arshive për punë.	Dosje të kthyer përsëri në arshivë
1	2017	3013	1009
2	2018	5769	1304
3	Maj 2019	2605	1996
	Totali	11,387	4,309

Nga viti 2017 deri në maj të vitit 2019 rezulton se janë legalizuar **6,243 objekte** dhe nga arshiva janë nxjerë 11,387 dosje pra me një diferencë **5,144 (11,387- 6,243) dosje**. Sipas pasqyrave të paraqitura konstatohet se janë kthyer 4,309 dosje pra **me një diferencë 835 dosje** të cilat kanë dalë dhe **nuk janë bërë hyrje në arshivë**, ndërkohë që nuk ka asnjë të dhënë apo dokument për



administrimin e tyre, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet ligjore për administrimin dhe arshivimin e dokumentacionit.

Gjithashtu theksojmë se në dosjet e kthyer në plotë raste janë futur dhe dalë disa herë dosjet dhe pa as një motiv, **nuk** përshkruhet arsyeja e tyre e rikthimit në arshivë në sasinë **4,309** kur rezultojnë se për këto subjekte janë kryer matjet, gent planet, planimetritë dhe nuk kanë marrë vendime duke shkelur të gjitha afatet ligjore dhe deri tani nuk janë legalizuar duke e zgjatur këtë afat me vite. Nga auditimi me zgjedhje u verifikuan disa raste për respektimin e procedurave dhe afateve, nga ku rezultoi zgjatje të afatit të procedurave të legalizimit më shumë se një vit, më hollësisht sipas Aneksit nr. 1 “*Dosje të kthyer në Arshivë*”.

Sipas raportimeve mujore në ish/Drejtorinë e Aluiznit Elbasan rezultojnë se nga viti 2017 deri në maj të vitit 2019 janë raportuar gjithsej 8813 objekte të legalizuara dhe të dërguara në ish/zyrën e regjistrimit Elbasan (*shiko tabelen si më poshtë*).

Tabela e lejeve të dërguara për regjistrim

	2017	2018	2019	TOTAL
Janar	289	237	192	718
Shkurt	297	208	130	635
Mars	367	190	150	707
Prill	286	173	114	573
Maj	279	101	65	445
Qershor	232	311	77	620
Korrik	366	259		625
Gusht	355	60		415
Shtator	422	1679		2101
Tetor	353	583		936
Nentor	404	229		633
Dhjetor	251	154		405
<u>TOTAL</u>	3901	4184	728	8813

Por konstatohet se raportimet e bëra nuk korespondojnë me lejet e lëshuara sipas viteve dhe konkretisht nga pasqyrat e mara elektronikisht rezultojnë se janë dhënë leje legalizimi në vitin 2017 janë 3,282 leje legalizimi, në vitin 2018 janë 2,364 objekte për legalizim dhe në vitin 2019 janë 597 objekte për legalizim, pra në total janë 6,243 leje legalizimi dhe janë raportuar 8,813 leje legalizimi, me një diferencë **2570 leje** legalizimi, pra raportimet kanë qenë fiktive dhe **nuk** janë të sakta.

Nuk janë azhonuar të dhënat e subjekteve që kanë marrë lejet e legalizimit për vitin 2017-2018 deri në vitin maj të vitit 2019.

Në vitin 2011 në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Elbasan sipas të dhenave të paraqitura evidentohet se **52 objekte informale** janë ndërtuara në zonën Kalaja Elbasan (zonë e mbrojtur e monumenteve të kulturës). Për këto objekte nuk është dhënë asnjë leje legalizimi, por njëkohësisht as nuk janë ndjekur procedurat ligjore për përjashtimin nga procesi i legalizimit, veprim në



kundërshtim me nenin 38 dhe 39, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 me ndryshime (shiko Aneksin nr. 2- "Aplikimet për legalizim të ndodhura në lagjen Kala, (zonë arkeologjike)").

Nr.	Emer	Atesi	Mbiemer	Lagjia
1	A	N	Ç	Kala, Elbasan
2	D	D	Q	Kala, Elbasan
3	J	K	T	Kala, Elbasan

Konstatohet se janë 51 objekte të përjashtuara nga legalizimi, por nuk janë ndjekur procedurat ligjore sipas nenit 38 dhe 39, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, me ndryshime, për njoftimin e institucioneve përkatëse (shiko Aneksi nr. 4 "Përjashtimet nga legalizimi 2017 -2019").

-Objekte të cilat nuk kanë përfunduar dhe nuk u ka dalë Vendim të Këshillit të Ministrave, VKM nr.954, datë 25.11.2015" dhe VKM nr. 1095, datë 28.12.2015 që janë 2513 objekte në pritje të VKM, kanë marrë vetëm lejenë legalizimit të objektit (shiko pasqyrën si me poshtë).

MBI PROCEDURAT E DËRGIMIT TË DOSJEVE PËR KALIM PRONESIE

Viti	Leje të dhëna	Dosje të dërguara për VKM
2017	3282	1074
2018	2364	1174
Janar - Maj 2019	597	265
Shuma	6243 leje	2513 dosje

Tek lejet e dhëna kemi:

- 1600 dosje në pronë të vet
- 1500 dosje në pronë në b/pronësi me AMTP, të cilat nuk i kemi dërguar për VKM
- 2513 dosje të dërguara për Kalim Pronësie
- **Mbeten pa u dërguar 562 dosje, në proces.**

Pra konstatohet se për **2130 leje legalizimi** të dhëna vetëm objekti në vitin 2017 dhe 2018 deri në Maj të vitit 2019 janë pa arkëtuar parcelat ndërtimore e pajisur me leje legalizimi me nënshkrimin "Do miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.954, datë 25.11.2015 dhe VKM 1095, datë 28.12.2015"

Bazuar në ligjin 9482, datë 03.04.2006 me ndryshime në ligjin nr.50/2014 si dhe ligjin nr.62/2015, neni 17 (pika 5) ku shprehimisht thuhet "Vlera e parcelës ndërtimore që i shitet proceduesit të ndërtimit pa lejë paguhet menjëherë në momentin e njoftimit me shkrim nga ALUIZNI, duke përfituar reduktim të vlerës".

Pra sipas VKM aktet nënligjore kanë ndryshuar formën e pagesës së parcelave ndërtimore dhe mos përputhje me neni 17 (pika 5) të ligjit ligjin 9482, datë. 03.04.2006 me ndryshime si dhe VKM 280, datë 01.04.2015, pika 8.

Gjithashtu konstatohet se të dhënat e paraqitura në database e përgjithshëm të vetëdeklarimeve të hedhura nga NjQV dhe ALUIZNI, kryesisht mbi funksionin e objektit informal, këto të dhëna nuk



përputhen me të dhënat e evidentuara në formularin e vetëdeklarimit nga vetë poseduesi i objektit, ku nëse në regjistër është paraqitur funksioni shërbimi (biznes, magazina, hotele etj), sipas formularit të vetëdeklarimit, në formularin vetëdeklarimit depozituar në dosje evidentohet se objektit janë ose më funksion të kombinuar ose banimi, nuk kanë adresa të sakta të hedhura në database elektronik.

Në regjistrat elektronikë kostatohet se të dhënat e paraqitura në regjistër, nuk janë sipas manualit të hartimit dhe paraqitjes sipas urdhrit nr. 291 datë 01.09.2008 si dhe urdhrit nr. 846 datë 11.10.2012, ku konstatohet se nuk janë hedhur të dhënat specifike të zonës ku i përket vija e verdhë ose jashtë vijësverdhë, planet rregulluese, datat e miratimit nga KRTSH, kufijtë ndarës, nomenklatura, zona kadastrale, sipërfaqja deklaruar (etj, në kundërshtim me VKM nr. 437 datë 28.06.2006 (për përcaktimin e procedurave për mbledhjen, përpunimin e administrimit e të dhënave për ndërtimet pa lejë për ngritjen e bazës të dhënave) si dhe në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 767 datë 10.09.2014 e cila u është shpërndarë sektorëve në datën 17.09.2014.

Për kryerjen e veprimeve dhe krijimin e database e regjistrat të të dhënave **nuk** është konform ligjit Nr. 9482, datë 03.04.2006 me ndryshime, si dhe VKM e udhëzimeve të dala në zbatim të tij, nuk funksiononte sipas një Rregullore të Brendshme për të saktësuar përgjegjësinë dhe detyrat e secilit punonjës.

Sipas të dhënave nga Drejtoria e Aluizni-t Elbasan, Sektori i Financës, rezulton se nga lejet e legalizimit të dhëna në vitet 2017 – 2018 dhe të rakorduar nga thesari, të ardhurat për vitin 2017 janë në vlerën **96,638 mijë lekë** dhe në vlerën **134,220 mijë bono** privatizimi për 3,282 objekte të legalizuara, mesatarisht vlerë 29 mijë lek për një objekt të legalizuar, në vitin 2018 në vlerën **93,344 mijë lekë** dhe bono thesari në vlerën 120,862 mijë lekë për 2,364 objekte të legalizuara, mesatarisht 39 mijë lekë për një objekt të legalizuar, (shiko tabelën e mëposhtme).

Permbledhëse e të ardhurave

000/ leke, bono thesari

VITI	Parcela ndertimore 7116101		Tarifa Sherbimi 7110506	Penalite 7115417
	LEKE	BONO		
2017	96638	134220	9538	702
2018	93344	120862	3684	219
01-31.05.2019	32731	45459	2296	545
TOTALI	222713	300541	15518	1466

Sipas numrit të objekteve të legalizuara nga viti 2017 deri në vitin 2019 e llogaritur me numrin e lejeve të legalizimit të dhëna brenda një viti konstatohet se vlera e një objekti është me e lartë në vitin 2018 në krahasim me vitin 2017.

Pra kurba e të ardhurave nga legalizimi nga viti 2017 deri në vitin 2018 ka ardhur si rezultat i ndryshimeve të ligjit në vitin 2014 dhe 2015 dhe paisja e objekteve në pronën e vet e cila është 85 % e totalit dhe e përjashtuar nga tarifa e vlerës së parcelës, të cilët nuk kanë detyrim për pagesë të taksës së parcelës ndërtimore si rezultat i ndryshimeve ligjore “Vendim të Keshillit të Ministrave VKM nr.954, datë 25.11.2015” dhe VKM 1095, datë 28.12.2015” si dhe taksa e infrastrukturës i ka kaluar pushtetit vendor për tu arkëtuar, sipas ligjitnr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin,



urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar neni 3 pika (i), nenit 23, si dhe nenin 27 si dhe VKM 580 datë 10.12.2014.

Për mangësit e konstatuara më sipër ngarkohen me përgjegjësi z. M D me detyrë ish-Drejtor nga data 01.01.2017 deri 02.10.2017, z.F D me detyrë ish /Drejtor nga data 03.10.2017 deri më 12.02.2018, z.A G me detyrë ish/Drejtor nga data 12.02.2018 deri në 08.05.2018, me z.V H me detyrë ish/Përgjegjes i Legalizimit dhe Planifikimit Urban nga data 01.01.2017 deri në datën 04.09.2017, z.Sh K me detyrë Përgjegjës i Legalizimeve 01.01.2017 deri në datën 25.05.2019, zj. M S me detyrë Specialist i Çështjeve të Pronsisë, me z.Sh P me detyrë ish Përgjegjës i Hartografisë nga data 01.01.2017 deri në datën 17.05.2019, E K me detyrë Specialist i Sektorit të Legalizimit, z. I D me detyrë me detyrë Arshivist.

Për sa më sipër është mbajtur procesverbali nr. 7, datë 31.07.2019.

- Përsa i përket administrimit në dosje të vërtetimit të likuidimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë nuk pengon miratimin dhe lëshimin e lejeve të legalizimit pas hyrjes në fuqi të ligjit nr 50/2014. Referuar dispozitave ligjore të sipërcituara rezulton se arkëtimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë bëhet nga njësitë e qeverisjes vendore dhe kjo taksë shkon në favor të tyre. Gjithashtu edhe mënyra e përlogaritjes së kësaj takse është detyrë dhe kompetencë e këtyre organeve.

Për sa më sipër, është e qartë se, konstatimet dhe mangësitë për administrim dhe depozitim në dosjet e legalizimit nga ALUIZNI, të vërtetimit mbi pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, nuk qëndrojnë, pasi që ALUIZNI, në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, ka për detyrë që të bëjë njoftimin e objekteve të legalizuara pranë njërive vendore.

Qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH: Observacioni juaj nuk qëndron pasi në përcaktimet e bëra në ligjin për legalizimet, konkretisht Neni 23-Taksa e ndikimit në infrastrukturë, Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë llogaritet dhe arkëtohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me pikën 2/1, të nenit 27, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.”, ndërkohë në nenin 27, pika ç, thuhet se: Neni 27- Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit, Subjekti kërkues i interesuar për legalizimin e objektit pa leje duhet të paraqesë: ç) vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi, pra vërtetimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë duhet të jetë pjesë dosjes para lëshimit të lejes së legalizimit.

- Në lidhje me observimet e paraqitura nga znj. J S, për performacën e institucionit, lëvizjen e dosjeve nga arshiva nëpër sektor, azhornimin e lejeve të legalizimit, praktikat e pezulluara, dosjet e skualifikuara, objektet që nuk u ka dalë akoma VKM, mospërputhshmërinë e të dhënave të hedhura në sistemin qendror NjQV dhe ALUIZNI dhe formularëve të vetëdeklarimit.

Qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH: Në konstatimet e bëra në akt-konstatimin nr. 7, ju jeni përmendur në cilësinë e përfaqësuesit të institucionit si dhe personit që është marrë me nxjerrjen e të dhënave, pozicioni juaj do të merret në konsideratë në raport me mangësitë e konstatuara.

1.2- Procedurat e miratimit dhe dhënies së lejes së legalizimit nga Drejtoria Qendrore dhe Rajonale e Legalizimit (ALUIZNI) dhe regjistrimi në ZVRPP, sipas kategorive përkatëse (bazuar në risk).

Mbi auditimin e ushtruar në ish-ALUIZNI Elbasan, sot Agjensia Shtetërore e Kadastrës Elbasan në bazë të programit të auditimit nr. 380/1, datë 28/05/2019, mbajtur në datë 25/01/2019.



Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit “Nr. 380/1, datë 28.05.2019”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1) Dosjet e praktikave të legalizimit.
- 2) Dokumentacioni sipas inventarizimit bashkëlidhur dosjeve përkatëse, si dhe korespondencat shkresore me institucionet përkatëse, vendime gjykatash, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Nga ana e ish- ALUIZNI Elbasan, sot Agjensia Shtetërore e Kadastrës Elbasan nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore përsa i përket respektimit të kriterëve ligjore për pajisjen me leje legalizimi, referuar:

- 1) Neni 17 dhe 27 të Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.
- 2) Ligjin Nr. 8378, datë 22.07.1998 i ndryshuar “Kodi rrugor në Republikën e Shqipërisë”, neni 2 dhe neni 4.
- 3) VKM nr. 465, datë 22.06.2016”, pika 10.
- 4) VKM nr. 280, datë 01.04.2015, pika 8 dhe (i ndryshuar me VKM 756, datë 26.10.2016) kreu i I pika 1/4 dhe kreu 4, pika 8.
- 5) VKM nr. 153, datë 07.04.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor në Republikën e Shqipërisë” neni 27, pika 3.
- 6) VKM 1095, datë 28.12.2015 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet aluizni-t dhe zqrrp-së, dhe të procedurave apo kufizimeve që zbatohen për efekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara”, pika 2, 3 dhe 10.
- 7) VKM Nr. 954, datë 25.11.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të formularit të lejes së legalizimit”, pika 2 dhe 5,
- 8) Urdhrit nr. 37, datë 19.01.2016 “Për miratimin e planveprimit për shqyrtimin administrativ të praktikave të legalizimit të ndërtimeve pa leje”, pika 6, ku ndër të tjera citohet:

.....VKM Nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, pika 2 “*Ndërtimi informal i llojit “objekt”, i ngritur brenda vijës kufizuese të zonës informale të miratuar dhe i përfshirë në fushën e zbatimit të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, përjashtohet nga legalizimi në një nga rastet e mëposhtme, germa “gj” Preket nga zbatimi i një projekti konkret të infrastrukturës rrugore ose të linjës energjetike të interkonjeksionit, të miratuar në mënyrë të posaçme nga Këshilli Kombëtar i Territorit;* pika 8. *Drejtoritë e ALUIZNI-t, bazuar në gjendjen faktike në terren, kryejnë procedurat kualifikuese për ndërtimin informal, brenda 60 ditëve nga data e evidentimit faktik në terren (data e “Procesverbalit të evidentimit në terren”). Për kryerjen e këtyre procedurave drejtoritë mbështeten në cilësitë e territorit, të paraqitura grafikisht.* pika 8/1. *Në vlerësimin e kriterëve për rrugët ekzistuese, verifikimi i trupit të rrugës kryhet mbi bazën e dokumentacionit të gjendjes faktike dhe të klasifikimit të rrugës, të vënë në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar ose nga autoriteti vendor i zhvillimit të territorit. Nëse nuk disponohet dokumentacion, konstatimi i trupit të rrugës bëhet sipas evidentimit faktik në terren, të kryer nga vetë drejtoria e ALUIZNI-t. Në kuadër të këtij vendimi, “qendra të banuara” konsiderohen zonat e urbanizuara (zonat e ndërtushme), sipas vendimit nr. 5, datë 29.12.2014 të KKT-së.*



.....Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, nenin 27 “Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit”, pika “ç” – “vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi”

.....VKM nr. 411, datë 19.05.2010 i ndryshuar “Për kriteret procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit” Kreu I, pikën 1,c ku përcaktohet –“c) për objektin/shtesën pa leje në ndërtime me leje është plotësuar dokumentacioni tekniko-ligjor, i parashikuar në nenet 27 e 37 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, të ndryshuar; si dhe pika 2, ku përcaktohet se –“Drejtoritë e ALUIZNI-t pranë qarqeve, pas verifikimit të dokumentacionit dhe vlerësimit të përmbushjes ose jo të kushteve të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, për objektin informal/shtesën pa leje në ndërtime me leje, vendosin kualifikimin për legalizim ose përjashtimin nga legalizimi. Vendimi, i cili shoqërohet me aktin përkatës, të argumentuar, administrohet si pjesë përbërëse e dosjes së legalizimit”, etj....

Nga auditimi rezultoi që:

“Mbi zbatimin e procedurave ligjore për legalizimin e ndërtimeve informale” për periudhën 01.01.2017-31.05.2019.

- **Dosja nr. 21065, datë 03.08.2006**, Leje legalizimi nr. 2580608, datë 09.04.2019, ndërtim për Godinë banim 1 Kat + 1 kat nëntokë, pronar i ndërtimit pa leje: D D B, me adresë Bashkia Librazhd Dorëz, ZK- 2517, sipërfaqe e parcelës ndërtimore 186 m², sipërfaqe ndërtimi 62 m², nga të cilat për aktivitet 123.1 m², trualli në pritje të VKM-së, u konstatua:

- Në dosje administrohet dy procesverbale të verifikimit në terren një mban datën 12.12.2010, dhe i dyti është i datës 23.03.2018, nënshkruar nga specialistët e verifikimit në terren z. E B, z. B Gj, konfirmuar nga z. K T, z. R B, z. A S, z. F H, miratuar nga Përgjegjësi Sektorit të Hartografisë z. Sh P. Procesverbali i verifikimit në terren nuk është plotësuar me distancat përkatëse nga pasuritë kufitare dhe të dhënat e tjera për sipërfaqet sipas rubrikave përkatëse, është bërë plotësimi thjesht formal.

- Sipas vetë deklarimit nr. 21065, datë 03.08.2006, rezulton se sipërfaqja e zënë nga subjekti vetëdeklarues është 300 m², sipas lejes së legalizimit subjekti ka përfutur 186 m² ndërkohë që sipas imazheve dhe të dhënave të marra nga Geoportali asig.gov.al, sipërfaqja e parcelës së zënë rezulton 300 m², pra diferenca në sipërfaqe prej 114 m² është e pashfrytëzueshme, jo funksionale, dhe për këtë nuk është mbajtur asnjë evidencë, apo korespondencë shkresore me institucionet përkatëse. Referuar vlerës së truallit sipas çmimit të tregut bazuar në VKM nr. 89, datë 03.02.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, rezulton një vlerë e parkëtuar prej **32,946 lekë**(289 lekë*114 m²), e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 30, datë 15.01.2016 “Për mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së dokumentacionit teknik (gen-plan, planimetri)”, i ndryshuar, si dhe shkronja “f” dhe “g” e nenit 3 dhe pika 1 e nenit 17, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.

- Vendimi i kualifikimit nr. 24502 mban datën 18.02.2019, ndërkohë që procesverbali i konstatimit në terren mban datën 23.03.2018, duke mos u respektuar afati prej 60 ditësh në kundërshtim me VKM Nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, pika 8. *Drejtoritë e ALUIZNI-t, bazuar në gjendjen faktike në terren, kryejnë procedurat kualifikuese për ndërtimin informal, brenda 60 ditëve nga data e evidentimit faktik në terren (data*



e “Procesverbalit të evidentimit në terren”). Për kryerjen e këtyre procedurave drejtoritë mbështeten në cilësitë e territorit, të paraqitura grafikisht.

- Gjithashtu Vendimi për kualifikim nr. 24502 mban datën 18.02.2019, ndërkohë që leja e legalizimit është dhënë në datë 09.04.2019, duke mos respektuar afatin prej 30 ditë, në kundërshtim me përcaktimet Urdhrit nr. 37, datë 19.01.2016 “Për miratimin e planveprimit për shqyrtimin administrativ të praktikave të legalizimit të ndërtimeve pa leje”, pika 6- Miratimi i lejes së legalizimit përpara kalimit të pronësisë, germa “a” *Plotësimi dhe miratimi (nënshkrimi+vulosje) i lejes së legalizimit bëhet brenda 30 ditëve nga data e Vendimit të Kualifikimit.*

- Nga auditimi konstatohet se ka patur shkëmbim informacioni mes Drejtorisë së ALUIZNI-t Elbasan dhe strukturave përkatëse që përcaktojnë vendndodhjen e objektit të legalizuar, prej ku rezulton se ky objekt ndodhet në Zonën e Mbrojtur të Parkut Kombëtar “Shebenik-Jabllanicë”, sipas VKM nr. 640, datë 21.05.2008, kategoria e dytë e zonave të mbrojtura.

Sa më sipër konfirmohet nëpërmjet shkresave nr. 774/1, datë 03.07.2018; 362/1, datë 27.03.2018, të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura; shkresës nr. 55, datë 19.03.2018 të Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura Elbasan.

Sipas shkresës nr. 362/1, datë 27.03.2018 të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, citohet shprehimisht: “AKZM nuk mund të shprehet nëse lejohet apo jo ndërtimi i këtyre objekteve. Për sa i përket legalizimit të tyre nuk është në kompetencën tonë shqyrtimi dhe vlerësimi i këtij procesi”.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me vendimin e KM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar me vendimin e KM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dheshtesa në vendimin nr. 280, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, pika 2, germa “ë” ku citohet: Ndërtimi informal i llojit “objekt”, i ngritur brenda vijës kufizuese të zonës informale të miratuar dhe i përfshirë në fushën e zbatimit të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, përjashtohet nga legalizimi në një nga rastet e mëposhtme:

“Është ngritur brenda zonave dhe/ose nënzonave të mbrojtura, shkalla e mbrojtjes të cilave nuk lejon ndërtime, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 8906, datë 6.6.2002, “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij”.

Ligji nr. 8906, datë 6.6.2002 është shfuqizuar nga ligji nr. 81/2017, datë 04.05.2017 “Për zonat e mbrojtura”, në nenin 16 të të cilit, “Parku kombëtar” (kategoria II), pika 2, germa “a” përcaktohet se:

Në “Parkun kombëtar” zbatohet shkalla e mbrojtjes mjedisore të zonës që ka si objektiv të mbajë territorin në gjendje natyrore, ku të ruhen komunitetet biotike, të resurseve gjenetike dhe llojeve për të siguruar stabilitetin ekologjik dhe diversitetin dhe ku:

a) përjashtohet njeriu nga shfrytëzimi ose zënia me aktivitete intensive

-Në nenin 33, të ligjit nr. 81/2017, datë 04.05.2017, “Veprimtaritë që lejohen pasi të jenë pajisur me miratim paraprak” citohet:

“Veprimtaritë që lejohen të ushtrohen në zonat e mbrojtura mjedisore pasi të jenë pajisur me miratimin paraprak të organit, brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore të të cilit është veprimtaria e mëposhtme:

a) çdo veprimtari tjetër në përputhje me Planin e Menaxhimit;

b) monitorime të gjendjes mjedisore, të ekosistemit, të habitateve dhe të llojeve floristike e faunistike;

c) ndërhyrjet e nevojshme për rigjenerimin dhe shëndetësimin;



ç) *struktura në përputhje me përcaktimet e Planit të Menaxhimit në shërbim të aktiviteteve turistike;*

d) çdo veprimtari tjetër në përputhje me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit

-Sipas VKM nr. 640, datë 21.05.2018 “Për shpalljen “Park Kombëtar” të ekosistemit natyror Shebenik-Jabllanicë”, pika 4, germa “ç”, përcaktohet se:

Zonat e përdorimit tradicional, me sipërfaqe 12420 ha, e shënuar në hartë me “ZPT”, është zonë ku mundësohet vazhdimi i veprimtarive, tradicionale dhe ekonomike, e ku mund të ushtrohen veprimtari të reja, vetëm me lejet mjedisore dhe, për rastet e trashëgimisë kulturore me leje të Ministrisë të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe të shërbimit arkeologjik. Zona përfshihen territoret bujqësore, ujore e pyjore, rreth qendrave të banuara, kryesisht të përdorura nga banorët. Në zonën e përdorimit tradicional zbatohet shkalla e katërt e mbrojtjes.

-Meqenëse ky proces nuk është në kompetencën e AKZM, do të merren për referencë dispozitat e mësipërme, të cilat bëjnë të domosdoshme pajisjen me lejet mjedisore dhe miratimin paraprak nga Këshilli Kombëtar i Territorit, gjithashtu dhe ekzistencën Planit Urbanistik Vendor. Në kushtet kur kritere të tilla nuk gjenden të dokumentuara në praktikën e lejes së legalizimit, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Elbasan duhej të kishte refuzuar lëshimin e lejes së legalizimit dhe duhej të kishte kryer skualifikimin e objektit.

- Me shkresën nr. 6484 prot, datë 13.09.2018 ALUIZNI Elbasan drejtuar ZVRPP Elbasan ka kërkuar informacion për statusin juridik të pasurisë.

- ZVRPP Elbasan me shkresën nr. 288/1 prot, datë 24.09.2018, kthim përgjigje, sqaron se pasuria nr. 245/2, vol. 7, fq. 220, me sipërfaqe 433900 m² është pasuri e llojit **Shkëmb** në pronësi shtet.

Sa sipër, nga ana e ALUIZNI-t Elbasan, është miratuar leje legalizimi për godinë banimi në tokë “Shkëmb” dhe përveç kësaj është ndryshuar edhe zëri kadastral dhe regjimi i tokës në “Truall”, në një kohë që kompetenca për ndryshimin e zërit kadastral nga “Shkëmb” në “Truall”, për pyjet dhe tokat me bimësi pyjore, me sipërfaqe deri një 1 ha i takon Ministrisë të Mjedisit, vetëm në kushtet e një investimi afatgjatë për ndërtimin e strukturave turistike, etj.

Këto veprime janë një në kundërshtim, me nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, ku përcaktohet:

“Pjesë të fondit pyjor kombëtar, që kërkohen nga subjekte juridike ose fizike apo nga organet e qeverisjes vendore, për t’u kthyer në truall, për zgjerimin e vijës kufizuese të ndërtimit dhe të shtrirjes territoriale të periferisë së qytetit e të qendrave të banuara në zonat rurale, për ndërtimin e strukturave turistike, të qendrave të pushimit apo ato shëndetësore ose për qëllime të tjera publike, për rrugë automobilistike apo hekurudhore, për shpim dhe shfrytëzim të puseve të naftës e të gazit, për veprimtari minerare e gjeologjike, për aeroporte dhe struktura të telekomunikacionit, për qëllime të strukturave ushtarake, qendra industriale, hiqen nga fondi pyjor dhe nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve, si më poshtë:

a) pyjet dhe tokat me bimësi pyjore, me sipërfaqe deri në 1 ha, me miratimin e ministrit”

Në nenin 14, “Përbërja e fondit pyjor kombëtar”, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, përcaktohet:

Fondi pyjor kombëtar përbëhet nga këto formacione bimore e jobimore:

a) pyjet dhe drurët pyjorë;

b) shkurret;

c) sipërfaqet e zëna nga brezat pyjorë mbrojtës, grupet e veçuara të drurëve;

ç) bimësia barishtore, mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore;



d) tokat pyjore, bujqësore (të dhëna në përdorim ose në pronësi të organeve të shërbimit pyjor), liqenet natyrore, tokat e lagëta dhe lagunat (për mbarështimin dhe zhvillimin e faunës së egër, pasuri kombëtare, dhe që krijojnë një mjedis ekologjik të harmonizuar me fondin pyjor);

*dh) sipërfaqet e zhveshura si çeltrirat, **shkëmbinjte**, dunat e ranishtet, që ndodhen në sipërfaqen pyjore dhe pranë tyre (jo më larg se 500 m), por që krijojnë një mjedis ekologjik të harmonizuar me të;*

e) infrastruktura rrugore e komunikimit me të gjitha elementet bashkëshoqëruese, pritat e pendat, lerat, koritat, çezmat, rrethimet apo gardhimet në zonat e mbrojtura, në pyjet me funksion të veçantë, në rezervatet e gjuetisë, si dhe lehtësitë e krijuara e të ngritura për personelin e shërbimit pyjor dhe për pritjen e vizitorëve në to;

ë) ndërtesat, zyrat, magazinat, depot, stacionet pyjore, qendrat e informimit dhe të pritjes së vizitorëve, ujësjellësat, linjat elektrike e telefonike (të ndërtuara nga shërbimi pyjor apo të dhëna në pronësi të tyre), makinat, tabelat, shenjat e ndryshme treguese e sinjalizuese dhe ato të mbarështimit pyjor.

Sa më sipër, legalizimi i objektit informal “Godinë banimi 1 Kat + 1 kat nëntokë” dhe ndryshimi i destinacionit të 186 m² sipërfaqe të zërit kadastral “Shkëmb” në “Truall”, është i paligjshëm, pasi **nuk përfshihet në asnjërën nga veprimtaritë e përmendura** më sipër dhe nuk ka kërkesë për heqjen nga fondi pyjor apo urdhër Ministri që të ketë bërë miratim për këtë ndryshim destinacioni.

Për mangësit dhe shkeljet e konstatuara më sipër mbajnë përgjegjësi z. A H, me detyrë Specialist i Sektorit të Legalizimit, z. AG me detyrë ish-Drejtor, z. A M me detyrë Specialist i Sektorit të Hartografisë, z. Sh P me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, z. D B me detyrë Specialist i Sektorit të Pronësisë, zj. M S me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Kalimit të Pronësisë, z. K D me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. E B, me detyrë Specialist i Verifikimit në Terren, z. B Gj me detyrë Specialist i Verifikimit në Terren, z. K T, me detyrë Specialist i Verifikimit në Terren, z. R B, me detyrë Specialist i Verifikimit në Terren, z. A S, me detyrë Specialist i Verifikimit në Terren, z. F H, me detyrë Specialist i Verifikimit në Terren, z. Sh P me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë.

- Dosja me vetë deklaratimet nr. 127, datë 14.11.2006 dhe nr. 21063, datë 28.01.2015, Leje legalizimi nr. 2579621, datë 26.07.2018, ndërtim për Godinë banim 1 Kat, pronar i ndërtimit pa leje: D D B, me adresë Bashkia Librazhd Dorëz, ZK- 2517, sipërfaqe e parcelës ndërtimore 101.6 m², sipërfaqe ndërtimi 101.6 m², nga të cilat për banim 136.9 m², trualli regjistruar me certifikatë pronësie volum 4, faqe 58, u konstatua:

- Në dosje administrohen dy procesverbale të verifikimit në terren, të dyja pa datë, nënshkruar nga specialistët e verifikimit në terren z. F H, z. A S, z. R B dhe z. K T, miratuar nga Përgjegjësi Sektorit të Hartografisë z. Sh P. Procesverbali i verifikimit në terren nuk është plotësuar me distancat përkatëse nga pasuritë kufitare dhe të dhënat e tjera për sipërfaqet sipas rubrikave përkatëse, është bërë plotësimi thjesht formal.

- Sipas vetëdeklarimit nr. 127, datë 14.11.2006, rezulton se sipërfaqja e zënë nga subjekti vetëdeklarues është 300 m², ndërkohë që sipas lejes së legalizimit subjekti ka përfituar 101.6 m² ndërkohë që sipas imazheve dhe të dhënave të marra nga Geoportali asig.gov.al, sipërfaqja e parcelës së zënë rezulton 300 m², pra diferenca në sipërfaqe prej 198.4 m² është e pashfrytëzueshme, jo funksionale, dhe për këtë nuk është mbajtur asnjë evidencë, apo korespondencë shkresore me institucionet përkatëse. Referuar vlerës së truallit sipas cmimit të tregut bazuar në VKM nr. 89, datë 03.02.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, rezulton një vlerë e pa arkëtuar **prej 57,222 lekë** (289 lekë*198 m²), e



cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 30, datë 15.01.2016 “Për mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së dokumentacionit teknik (*gen-plan, planimetri*)”, i ndryshuar, si dhe shkronja “f” dhe “g” e nenit 3 dhe pika 1 e nenit 17, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.

- Në dosje mungon vërtetimi për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Për mangësit dhe shkeljet e konstatuara më sipër mbajnë përgjegjësi z. A H, me detyrë Specialist i Sektorit të Legalizimit, z. A G me detyrë ish-Drejtor, z. N Sme detyrë Specialist i Sektorit të Hartografisë, z. Sh P me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, z. D Bme detyrë Specialist i Sektorit të Pronësisë, zj. M S me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Kalimit të Pronësisë, z. A B me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. Sh P me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, z. F H, me detyrë Specialist i Verifikimit në Terren, z. A S, me detyrë Specialist i Verifikimit në Terren, z. R B, me detyrë Specialist i Verifikimit në Terren, z. K T, me detyrë Specialist i Verifikimit në Terren.

- **Dosja me vetë deklaratimet nr. 128, datë 23.08.2005, dhe nr. 2638, datë 30.09.2014**, Leje legalizimi nr. 2578256, datë 29.10.2018, ndërtim për Godinë banim 5 Kat, pronar i ndërtimit pa leje: **I Q S**, me adresë Bashkia Elbasan, Mengel, ZK- 2654, sipërfaqe e parcelës ndërtimore 420.3 m², sipërfaqe ndërtimi 141.3 m², nga të cilat për banim 365.4 m², dhe 282.6 m² për aktivitet, trualli në pritje të VKM, u konstatua:

- Në dosje administrohet procesverbali i verifikimit në terren pa datë, nënshkruar nga specialistët e verifikimit në terren z. A B, z. D A, miratuar nga Përgjegjësi Sektorit të Hartografisë z. Sh P. Procesverbali i verifikimit në terren nuk është plotësuar me distancat përkatëse nga pasuritë kufitare dhe të dhënat e tjera për sipërfaqet sipas rubrikave përkatëse, është bërë plotësimi thjesht formal.

- Sipas vetëdeklarimit nr. 128, datë 23.03.2005, rezulton se sipërfaqja e zënë nga subjekti vetëdeklarues është 1000 m², ndërkohë që sipas lejes së legalizimit subjekti ka përfituruar 420.3 m² ndërkohë që sipas imazheve dhe të dhënave të marra nga Geoportali asig.gov.al, sipërfaqja e parcelës së zënë rezulton 1000 m², pra diferenca në sipërfaqe prej 579.9 m² është e pashfrytëzueshme, jo funksionale, dhe për këtë nuk është mbajtur asnjë evidencë, apo korespondencë shkresore me institucionet përkatëse. Referuar vlerës së truallit sipas cmimit të tregut bazuar në VKM nr. 89, datë 03.02.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, rezulton një vlerë e pa arkëtuar **prej 167,591 lekë** (289 lekë*579.9 m²), e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 30, datë 15.01.2016 “Për mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së dokumentacionit teknik (*gen-plan, planimetri*)”, i ndryshuar, si dhe shkronja “f” dhe “g” e nenit 3 dhe pika 1 e nenit 17, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.

- Gjithashtu Vendimi për kualifikim nr. 23233 mban datën 10.09.2018, ndërkohë që leja e legalizimit është dhënë në datë 29.10.2019, duke mos respektuar afatin prej 30 ditë, në kundërshtim me përcaktimet Urdhrit nr. 37, datë 19.01.2016 “Për miratimin e planveprimit për shqyrtimin administrativ të praktikave të legalizimit të ndërtimeve pa leje”, pika 6- Miratimi i lejes së legalizimit përpara kalimit të pronësisë, germa “a” *Plotësimi dhe miratimi (nënshkrimi+ vulosje) i lejes së legalizimit bëhet brënda 30 ditëve nga data e Vendimit të Kualifikimit*.

- Me shkresën nr. 4529 prot, datë 25.06.2018, kërkesë për informacion, drejtuar OSHE Elbasan, ALUIZNI Elbasan ka kërkuar informacion nëse pranë objektit informal ka linjë të tensionit të lartë dhe nëse ky objekt është ndërtuar në kundërshtim me Rregulloren e Shfrytëzimit teknik të Nën Stacioneve dhe Linjave Elektrike të sistemit energjistik. Në dosje nuk administrohet kthimi



përgjigje për shkresën e sipërcituar. Nga verifikimi imazheve dixhitale dhe hartografike rezulton se objekti është ndërtuar në distancë shumë të afërt me linjën e tension të lartë dhe parcela ndërtimore shtrihet nën linjën e tensionit të lartë.

Sa sipër ALUIZNI Elbasan, sot ASHK Elbasan, nuk duhet të procedonte me miratimin e lejes së legalizimit në mungesë të konfirmimit nga OSHE nëse nga ndërtimi informal çenohet linja e tensionit të lartë ose jo, veprime këto që bien në kundërshtim me vendimin e KM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar me vendimin e KM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dheshtesa në vendimin nr. 280, datë 1.4.2015, të këshillit të ministrave, “për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, pika 2, germa “ç” dhe “g” dhe përcaktimet e Ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.

Punuar praktika nga z. A B, me detyrë ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. E K, me detyrë Specialist i Sektorit të Legalizimit, miratuar nga ish-Drejtori z. A G.

- **Dosja me vetë deklaram nr. 846, datë 15.07.2013**, Leje legalizimi nr. 2578443, datë 29.11.2018, ndërtim për Godinë banim 2 Kat, pronar i ndërtimit pa leje: **A Q D**, me adresë Bashkia Belsh-Qendër, Mengel, ZK-1147, pasuria 278/11/1, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 374.7 m², sipërfaqe ndërtimi 124.9 m², nga të cilat për banim 266.9 m², trualli në pritje të VKM, u konstatua:

- Procesverbali i verifikimit në terren datë 27.10.2018, nënshkruar nga specialistët e verifikimit në terren z. B Gj, z. A S, miratuar nga Përgjegjësi Sektorit të Hartografisë z. Sh P. Procesverbali i verifikimit në terren nuk është plotësuar me distancat përkatëse nga pasuritë kufitare, gjithashtu dhe emërtimin e tyre, plotësimi i procesverbalit është vetëm formalisht.

- Deklaratat personale dhe deklarata për zbatimin e planit rregullues nuk janë plotësuar në rubrikat që përmbajnë por vetëm janë firmosur nga deklaruesi, cka tregon plotësimin jo të rregullt të tyre.

- Procesverbali i vlerësimit të dosjes nuk është plotësuar me të gjitha rubrikat.

- Shkresa për taksën e ndikimit në infrastrukturë nr. 676 prot, datë 28.01.2019, është nisur një muaj më vonë nga data 20.11.2018, lëshimit të lejes së legalizimit.

- Sipas vetëdeklarimit nr. 128, datë 23.03.2005, rezulton se sipërfaqja e zënë nga subjekti vetëdeklarues është 650 m², ndërkohë që sipas lejes së legalizimit subjekti ka përfituar 374.7 m² ndërkohë që sipas imazheve dhe të dhënave të marra nga Geoportali asig.gov.al, sipërfaqja e parcelës së zënë rezulton 650 m², pra diferenca në sipërfaqe prej 275.30 m² është e pashfrytëzueshme, jo funksionale, dhe për këtë nuk është mbajtur asnjë evidencë, apo korespondencë shkresore me institucionet përkatëse. Referuar vlerës së truallit sipas cmimit të tregut bazuar në VKM nr. 89, datë 03.02.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, rezulton një vlerë e pa arkëtuar **prej 64,420 lekë** (234 lekë * 275.3 m²), e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit.

Nga verifikimi imazheve dixhitale dhe hartografike rezulton se objekti është ndërtuar në distancë 11 m nga kanali.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi z. A B, me detyrë ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. A H, me detyrë Specialist i Sektorit të Legalizimit, z. Sh P me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, z. Gj G me detyrë Specialist i Sektorit të Përpunimit të dhënave, miratuar nga ish-Drejtori z. A G.

- **Dosja me vetë deklaram nr. 20486, datë 27.01.2015**, Leje legalizimi nr. 2580637, datë 09.04.2019, ndërtim për Godinë Social Ekonomike 1 Kat, pronar i ndërtimit pa leje: **I XhH**, me



adresë Bashkia Belsh-Belsh Hysë, ZK-1146, pasuria 55/1, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 463.5 m², sipërfaqe ndërtimi 154.5 m², nga të cilat për aktivitet 154.5 m², trualli në pritje të VKM, u konstatua:

- Procesverbali i verifikimit në terren është pa datë, nënshkruar nga specialistët e verifikimit në terren z. Th D, z. A S, miratuar nga Përgjegjësi Sektorit të Hartografisë z. Sh P. Procesverbali i verifikimit në terren nuk është plotësuar me distancat përkatëse nga pasuritë kufitare.

- Procesverbali i vlerësimit të dosjes nuk është plotësuar me të gjitha rubrikat, Specialisti AH dhe z. A M Sektori i përpunimit të të dhënave.

- Shkresa për taksën e ndikimit në infrastrukturë nr. 3059 prot, datë 10.04.2019, është nisur më pas nga data e lëshimi i lejes së legalizimit.

- Në dosje administrohet shkresa e ZVRPP Elbasan nr. 3554/1 prot, datë 11.12.2018, për statusin juridik të pasurisë truall, ku pasuria nr. 55, vol. 7, fq. 68, e llojit shesh me sipërfaqe 1000 m², është në pronësi shtet.

- Me shkresën nr. 3003 prot, datë 09.04.2019, Kërkesë për informacion dhe miratim, drejtuar Bashkisë Belsh, ALUIZNI Elbasan ka kërkuar informacion nga Bashkia Belsh si autoriteti përgjegjës si dhe konfirmimin në lidhje me vazhdimin e procedurave administrative të legalizimit të objektit informal, dhe nëse ky objekt cënon hapsirat publike ose jo.

Theksojmë se në dosje nuk administrohet shkresa kthim përgjigje për këtë shkresë.

- Me shkresën pa numër prot, datë 10.04.2019, Bashkia Belsh ka lëshuar vërtetim, sipas të cilit vërtetohet se shtetasi I Xh H, posedon një objekt shërbimi të ndërtuar para vitit 2014.

Nga verifikimi i imazheve hartografike dhe digjitale rezulton se objekti nuk është ndërtuar para datës 27.06.2014, afati ligjor brenda të cilit duhet të jenë ndërtuar objektet e vetëdeklaruar, në kundërshtim me Nenin 2, pika 1, të Ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.

Gjithashtu vërtetimi i dhënë nga Bashkia në lidhje me periudhën e ndërtimit nuk është kompetencë e këtij autoriteti dhe nuk ka vlerë për procesin e legalizimit, pasi nuk prodhon pasoja juridike.

Sa sipër ALUIZNI Elbasan nuk duhet të procedonte me pajisjen me leje legalizimi të objektit të ndërtuar jashtë afatit ligjor si dhe pa marrë konfirmimin nga Bashkia Belsh nëse cënohet infrastruktura publike ose jo, veprime këto që bien në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar me vendimin e KM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dheshtesa në vendimin nr. 280, datë 1.4.2015, të këshillit të ministrave, “për përcaktimin ekriterëve, procedurave edokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesatanësore dhe/ose në lartësi, nëndërtime me leje”, si dhe Nenin 2, pika 1, përcaktimet e Ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.

Për sa më sipër për mangësit e konstatuara mbajnë përgjegjësi z. K D, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. A H, me detyrë Specialist i Sektorit të Legalizimit, miratuar nga ish-Drejtori z. A G, si dhe z. Th D, me detyrë Specialist i verifikimit në terren, z. Armand Sali me detyrë Specialist i verifikimit në terren, z. Shpëtim Pashollari me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, z. A M me detyrë Specialist i Sektorit të Përpunimit të të dhënave, zj. M S me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Kalimit të Pronësisë, z. D B Specialist i Sektorit të Kalimit të Pronësisë.

- **Dosja me vetë deklaram nr. 272, datë 28.07.2006**, Leje legalizimi nr. 2578479, datë 21.11.2018, ndërtim Godinë e Kombinuar 2 Kat, pronar i ndërtimit pa leje: **Sh dhe F D**, me adresë Bashkia Belsh-Shkozë, ZK-3393, pasuria 190/5/2/1, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore



99.3 m², sipërfaqe ndërtimi 99.3 m², nga të cilat për aktivitet 131.7 m², dhe 99.3 për banim, trualli në pritje të VKM, u konstatua:

- Në dosje administrohen dy procesverbale të verifikimit në terren njëri i mbajtur nga specialistët e verifikimit në terren z. E K dhe z. M R, pa datë, dhe i pa miratuar nga Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë, dhe një procesverbal i dytë i nënshkruar nga Specialistët e Verifikimit në terren z. B Gj dhe z. A S, miratuar nga Përgjegjësi Sektorit të Hartografisë z. Sh P datë 08.11.2018. Procesverbal i verifikimit në terren nuk është plotësuar me distancat përkatëse nga pasuritë kufitare. Gjithashtu konstatohet se distanca e objektit nga rruga është e ndryshme të në të dyja procesverbalet e verifikimit në terren.

- Shkresa për taksën e ndikimit në infrastrukturë nr. 9011 prot, datë 07.12.2019, është nisur më pas nga data e lëshimi i lejes së legalizimit 21.11.2018, në kundërshtim me Nenin 27, pika ç të Ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.

- Trualli mbi të cilën është ndërtuar objekti informal është me certifikatë pronësie, pasuria nr. 190/5/2, vol.7, fq. 176, zk. 3393- Shkozë, lloji i pasurisë arë, me sipërfaqe 4538 m². Ndërkohë që ALUIZNI Elbasan ka miratuar lejen e legalizimit për ndërtimin pa leje mbi këtë pasuri, edhe pse pa konfirmuar statusin e pasurisë, çka sjell ndryshimin automatikisht të zërit kadastral gjatë regjistrimit në ZVRPP, në mungesë të dokumentacionit; kërkesa për miratimin në Këshillin e Qarkut, të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Agjencisë Rajonale të Mjedisit. Pra, nuk ka asnjë dokumentacion nga këto organe, për t'i dhënë lejen, veprimet të kryer për legalizim në zonat “Territore të tjera”, veprime në kundërshtim me nenet 10, 11, 14, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar dhe VKM nr. 515, datë 13.5.2009 e VKM nr. 589, datë 10.9.2014, “Për përcaktimin e afateve, të mënyrës dhe kohës së ushtrimit nga ALUIZNI të përgjegjësive të zyrave të urbanistikës dhe të këshillave të qarqeve, gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale” si dhe Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit me nr. 5, datë 29.12.2014 “Për identifikimin e zonave të urbanizuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në miratimin e hartave ku mund të ndërhyhet në funksion të zhvillimit urban”. Pika 9 ku përcaktohet: “Konvertimi nga tokë “Arë” në tokë “Truall” për sipërfaqet brenda zonave të urbanizuara do të bëhet sipas procedurave përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi”.

- Nga verifikimi dokumentacionit disponibël në dosje, si genplani, harta dixhitale e paraqitur, dhe imazheve dixhitale, rezulton se objekti ndodhet **në një distancë më pak se 5 m prej rrugës rajonale të kategorisë “F”** Belsh-Rrasë-Pajovë. Zona ku është ndërtuar objekti është përfshirë në zonë urbane sipas VKKT me nr. 5, datë 29.12.2014. Në pikën 7 të këtij Vendimi cilësohet se: Deri në hartimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar dhe Planeve Vendore për njësit e reja territoriale, propozimi për ndërtim brenda zonave të identifikuar më sipër të miratohet vetëm pas konfirmimit nga AKPT dhe informimit të Këshillit Kombëtar të Territorit lidhur me konfirmimetin e zhvillimit të propozuar me instrumentet kombëtare dhe/ ose vendore të planifikimit të miratuara ose në proces, me vendimet e KKT-së, si dhe legjislacionin sektorial në fuqi.

- Sipas përcaktimeve të VKM Nr.153 datë 07.04.2000 “Për miratimin e Rregullores në zbatim të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, është miratuar në datën 07.04.2000, Neni 27. Hapësirat e detyrueshme për ndërtimet në qendrat e banuara (Neni 18 i Kodit Rrugor), pika 3- Në mungesë të veprimtarisë urbanistike në fuqi, largesite nga kufiri rrugor, që duhen respektuar në qendrat e banuara, nuk mund të jene me të vogla se: a) 30 m për rrugët e tipit A; b) 20 m për rrugët e tipit D dhe E; c) 10 m për rrugët e tipit F.

Ndërkohë referuar përcaktimeve të VKM nr. 280, datë 01.4.2015, ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016, Kreu III- Kriteret për lega lizimin e ndërtimeve jashtë zonave informale të miratuara, pika b) *shkel distancat ndaj rrugëve ekzistuese, sipas përcaktimeve të mëposhtme: i) 10 metra nga*



kufiri rrugor për rrugët e kategorisë C, brenda qendrave të banuara. Për rrugët e kategorive D dhe E, brenda qendrave të banuara, do të merret për bazë vetëm trupi i rrugës;

Sa sipër në kushtet kur Rruga Belsh-Rrasë-Pajovë është rrugë Rajonale e tipit F, dhe kur përcaktimet e VKM nr. 280, datë 01.4.2015, ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016, bien në kundërshtim me përcaktimet Kodit Rrugor, procesi i legalizimit duhej të ishte kushtëzuar nga miratimi paraprak i autoriteteve rrugore dhe autoriteteve të tjera kompetente sipas përcaktimeve ligjore të mësipërme.

Për mangësit e konstatuara mbajnë përgjegjësi z. A B, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. E K, me detyrë Specialist i Sektorit të Legalizimit, si dhe z. Sh P me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, zj. M S me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Kalimit të Pronësisë, z. D B Specialist i Sektorit të Kalimit të Pronësisë, miratuar nga ish-Drejtori z. A G.

- **Dosja me vetë deklaram nr. 2255, datë 27.01.2015**, Leje legalizimi nr. 2578217, datë 26.10.2018, ndërtim Godinë e Kombinuar 9 Kat + 1 Kat nëntokë, pronar i ndërtimit pa leje: **A Sh H**, me adresë Bashkia Elbasan, ZK-8525, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 1468.3 m², sipërfaqe ndërtimi për aktivitet 4837.3 m², sipërfaqe ndërtimi për banim 9517 m², u konstatua:

- Nuk është plotësuar inventari i dosjes sipas dokumentacionit të ndodhur në dosje, gjithashtu nuk është firmosur nga Specialisti i Arkivës që ka marrë në dorëzim dosjen në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, specialisti Arkivës I D.

- Aplikimi është bërë në emër të A Sh H, Shoqëria “I”, datë 11.11.2015, për shtesë anësore në ndërtim me leje, bashkangjitur janë dokumentet si ekstrakt i regjistrimit tregtar datë 13.09.2016, ku statusi i shoqërisë rezulton i pezulluar; vërtetimi hipotekor nr. 8525-76, datë 25.05.2005, në emër të Xh Sh H, për pasurinë nr. 31/41, zk. 8525, me sipërfaqe 2492 m², e llojit truall, HTR; Leje Ndërtimi nr. 8, datë 07.09.2005, për objektin Pallat 6-9 Kat + 1 kat bodrum, sipas formularit nr. 4, me sipërfaqe trualli 2492 m², sipërfaqe ndërtimi 1400 m²; Vërtetim nr. 23 prot, datë 16.11.2005, nga Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Elbasan, sipas të cilit vërtetohet se objekti ka përfunduar konform ligjit, projektit dhe kushteve urbanistike, vërtetimi është vetëm për fazën e karabinasë; vërtetimi hipotekor nr. 8525-213, datë 19.12.2006 për regjistrimin në fazën e karabinasë, në emër të A Sh H.

- Procesverbali i verifikimit në terren datë 25.05.2018, nënshkruar nga specialistët e verifikimit në terren z. Th D, z. A S, miratuar nga Përgjegjësi Sektorit të Hartografisë z. Sh P, nuk është plotësuar me distancat përkatëse nga pasuritë kufitare si dhe të dhënat e tjera për sipërfaqet sipas rubrikave përkatëse.

- Me deklaratë noteriale nr. 625 rep, nr. 486 kol, datë 19.06.2018, Xh H në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë “I” deklaron se ka hequr dorë nga legalizimi i objektit dhe do të vazhdoj në emër të investitorit A H.

- Procesverbali i vlerësimit të dosjes nuk është plotësuar me të gjitha rubrikat, Specialist znj. N S Sektori i përpunimit të të dhënave.

- Në dosje administrohet deklarata noteriale nr. 68 rep, nr. 24 kol, datë 04.07.2018, sipas së cilës shtetasi Xh H, deklaron se ndërtesa e vjetër me sipërfaqe 40 m² është prishur në datë 01.06.2005 dhe është ndërtuar objekti ri Pallat bodrum 6 plus 9 kate sipas lejes së ndërtimit të datës 07.09.2005, por në dosje nuk ka asnjë dokumentacion tjetër nga institucionet vendore si organet kompetente që japin lejen përkatëse për prishjen e objektit në kundërshtim me Ligjin nr. 8405 datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar, Neni 49.

- Në dosje administrohen shkresat nr. 1951/1 prot, datë 24.08.2017, nr. 1096/1 prot, datë 11.05.2018, nr. 2607/1 prot, datë 24.09.2018, për statusin juridik të pasurive, sipas të cilave saktësohet se Pasuria nr. 31/41, vol. 1, fq. 53, me sipërfaqe 2492 m², e llojit truall është në pronësi të Xh H, pasuria nr. 30/105, me sipërfaqe 1500 m², godinë e regjistruar në fazën e karabinasë, në



emër të A H, si dhe pasuria nr. 31/95-ND, vol. 2, fq. 203, me sipërfaqe 40 m², në pronësi të Xh H. Ndërkohë që nga ALUIZNI Elbasan është hartuar dhe regjistri i parcelës ndërtimore, për kalimin e parcelës ndërtimore me sipërfaqe 1468.3 m², nënshkruar nga znj. M S, miratuar nga z. A G me detyrë ish-Drejtor.

- Me Urdhër nr. 512, datë 24.10.2018, është anuluar leja e legalizimit nr. 2579832, datë 24.08.2018, pasi janë hedhur gabim të dhënat.

- Vendimi për kualifikim nr. 22835, mban datën 03.07.2018, ndërkohë që leja e legalizimit është dhënë në datë 26.10.2018, pra 3 muaj më vonë nga marrja e vendimit të kualifikimit, në kundërshtim me përcaktimet Urdhrit nr. 37, datë 19.01.2016 “Për miratimin e planveprimit për shqyrtimin administrativ të praktikave të legalizimit të ndërtimeve pa leje”, pika 6- Miratimi i lejes së legalizimit përpara kalimit të pronësisë, germa “a” *Plotësimi dhe miratimi (nënshkrimi+vulosje) i lejes së legalizimit bëhet brënda 30 ditëve nga data e Vendimit të Kualifikimit.*

- Në dosje nuk administrohet taksa i ndikimit në infrastrukturë për sipërfaqen shtesë, jashtë lejes së ndërtimit në vlerën **121,241 lekë** (125* 32,331 lekë* 3%).

- Gjithashtu nga mandat pagesat e administruara në dosje rezulton se është paguar tarifa e shërbimit 8000 lekë vetëm për një njësi, ndërkohë që objekti është legalizuar i gjithi, pra sipërfaqja ndërtimore me leje ndërtimi 1343.1 m² dhe sipërfaqja ndërtimore pa leje ndërtimi 125.2 m², godinë e kombinuar 9 Kat+1 Kat nëntokë, detyrimisht subjekti duhet të paguajë të plotë tarifën e shërbimit **80,000 lekë** (10 *8000 lekë), jo vetëm për shtesën.

- Sipas lejes së ndërtimit sipërfaqja sheshit të ndërtimit është 2492 m² dhe sipërfaqja e ndërtimit është 1500 m², ndërkohë që sipas lejes së legalizimit sipërfaqja e parcelës ndërtimore është 1468.3 m² dhe sipërfaqja e ndërtimit është po 1468.3 m², pra jemi në kushtet kur subjekti fillimisht sipas lejes së ndërtimit të miratuar, ka disponuar një sipërfaqe sheshi dhe sipërfaqje ndërtimit më të madhe, ndërkohë që pasi i është nënshtruar procesit të legalizimit për shkak të shmangies nga leja e ndërtimit, sipërfaqja e sheshit është zvogëluar në 1468.3 m² dhe sipërfaqja e ndërtimit është zvogëluar në 1468.3 m² (1343.1 m² + 125.2 m²), pra ka mospërputhje. Gjithashtu referuar Akt-Kolaudimi pa datë, të mbajtur nga Ing. Th D, sipërfaqja e sheshit të ndërtimit është 2492 m² dhe sipërfaqja e ndërtimit është 1400 m², ka mospërputhje me lejen e ndërtimit dhe vërtetimet e lëshuara nga Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Elbasan. Zvogëlimi i sipërfaqes së sheshit dhe të ndërtimit si rezultat i kalimit nga leja e ndërtimit drejt procesit të legalizimit, bie në kundërshtim me vet qëllimin dhe objektin e ligjit të legalizimeve nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, Neni 1, pika 1 dhe 2, Neni 15/1, pasi subjekti i nështrohet procesit të legalizimit për shtesat anësore osë në lartësi tej lejes së ndërtimit dhe jo zvogëlimit të sipërfaqes së truallit apo ndërtimit.

- Në dosje nuk administrohen planimetrit për të gjitha katet e ndërtimit si dhe përmbledhësja e sipërfaqeve për cdo njësi duke përfshirë dhe ambientet e përbashkëta.

Vendimi i kualifikimit nr. nr. 22835, mban datën 03.07.2018, është nënshkruar nga z. E K me detyrë Specialist i Sektorit të Legalizimit, z. A B, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, miratuar nga ish-Drejtori z. A G.

Leja e legalizimit është nënshkruar nga z. A B, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, miratuar nga ish-Drejtori z. A G.

Për mangësit e konstatuara mbajnë përgjegjësi z. A B, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. E K, me detyrë Specialist i Sektorit të Legalizimit, si dhe z. Th D, me detyrë Specialist i verifikimit në terren, z. A S, me detyrë Specialist i verifikimit në terren, z. Sh P me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, znj. N S Sektori i Përpunimit të dhënave, zj. M S me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Kalimit të Pronësisë, z. D B Specialist i Sektorit të Kalimit të Pronësisë, miratuar nga ish-Drejtori z. A G.



- **Dosja nr. 5020, leje legalizimi nr. 2578225**, datë 26.10.2018, për objektin: “Godinë banimi 2 Kat”, për A Dh B, me adresë Bashkia Elbasan, Gjinar, Zona Kadastrale 1742, nr. pasurisë 15/43/1, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 63 m², sipërfaqja e ndërtimit 63 m², sipërfaqja totale e ndërtimit: për banim 133.5 m², për aktivitet - m², numri i kateve mbi tokë 2, nën tokë -, titulli i pronësisë: “Me certifikatë pronësie”.

Dokumentacioni i dosjes së kësaj leje legalizimi është i pa plotësuar me inventarin përkatës të dokumentacionit dhe numrit të fletëve për çdo dokument, në kundërshtim me Ligjin Nr. 9154, date 06.11.2003, “Për Arkivat”, specialisti Arkivës I D.

- Në proces-verbalin e verifikimit në terren mungon data e mbajtjes së procesverbalit, për rrjedhje nuk mund të përcaktohet afati kohor proces-verbal verifikimi - vendimi i kualifikimit, në kundërshtim me vendimin e KM nr. 280, datë 1.4.2015 “ Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar, pika 8, ku përcaktohet se:

Drejtoritë e ALUIZNI-t, bazuar në gjendjen faktike në terren, kryejnë procedurat kualifikuese për ndërtimin informal, brenda 60 ditëve nga data e evidentimit faktik në terren (data e "Procesverbalit të evidentimit në terren"). Për kryerjen e këtyre procedurave drejtoritë mbështeten në cilësitë e territorit, të paraqitura grafikiisht.

Në dosje mungon:

-vërtetimi për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 27, germa “ç”, të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

-Proces-verbali i verifikimit në terren nuk është plotësuar me rubrikat për: datën e mbajtjes, sipërfaqet e parcelës ndërtimore, njolla e objektit, numri i kateve dhe destinacioni i sipërfaqeve. Përsa i përket pasurive kufitare (të saktësuara në përshkrim) nuk janë shënuar numrat e pasurive dhe distancat nga pasuritë kufitare.

Këto mungesa, vecanërisht mungesa e sipërfaqes së parcelës ndërtimore dhe distancave nga objektet kufitare e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale.

Sa sipër është në kundërshtim me rubrikat sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

Proces-Verbali i verifikimit në terren është nënshkruar nga specialistët e terrenit z. A B dhe z. S Q dhe nuk është nënshkruar nga Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë z. Sh P.

Me aktin e kualifikimit nr. 23472, datë 17.10.2018, objekti informal legalizohet, i nënshkruar nga z. E K Sektori i Çështjeve të Pronësisë, z.A B ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit dhe z. M D ish-Drejtor.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi z. A B, ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. E K, specialist, z. Sh P, ish-Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, znj. V Sh, specialist terreni dhe z. A B, specialist terreni, miratuar nga z. A G, ish-Drejtor i ALUIZNI-t Elbasan.

- **Dosja nr. 16474, leje legalizimi nr. 2578140, datë 22.10.2018**, për objektin: “Shtesë anësore 1 kat banimi në godinë ekzistuese 1 Kat”, për V Dh B, me adresë Bashkia Elbasan, Gjinar, Zona Kadastrale 1742, nr. pasurisë 120/161, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 300 m², sipërfaqja e ndërtimit 88+16.4 m², sipërfaqja totale e ndërtimit: për banim 16.4 m², për aktivitet - m², numri i kateve mbi tokë 1, nën tokë -, titulli i pronësisë: “Me certifikatë pronësie”.



Dokumentacioni i dosjes së kësaj leje legalizimi është i pa plotësuar me inventarin përkatës të dokumentacionit dhe numrit të fletëve për cdo dokument, në kundërshtim me Ligjin Nr. 9154, date 06.11.2003, “Për Arkivat”, specialisti Arkivës I D.

-Proces-verbali i verifikimit në terren është mbajtur më datën 05.05.2017 ndërkohë që vendimi i kualifikimit është mbajtur më datën 10.10.2018, **pra pas 17 muajsh**, në kundërshtim me vendimin e KM nr. 280, datë 1.4.2015 “ Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar, pika 8, ku përcaktohet se:

Drejtoritë e ALUIZNI-t, bazuar në gjendjen faktike në terren, kryejnë procedurat kualifikuese për ndërtimin informal, brenda 60 ditëve nga data e evidentimit faktik në terren (data e "Procesverbalit të evidentimit në terren"). Për kryerjen e këtyre procedurave drejtoritë mbështeten në cilësitë e territorit, të paraqitura grafikisht.

Në dosje mungon:

-vërtetimi për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 27, germa “ç”, të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

-Proces-verbali i verifikimit në terren nuk është plotësuar me rubrikat për: sipërfaqet e parcelës ndërtimore, njolla e objektit, numri i kateve dhe destinacioni i sipërfaqeve. Përsa i përket pasurive kufitare (të saktësuara në përshkrim) nuk janë shënuar numrat e pasurive dhe distancat nga pasuritë kufitare.

Këto mungesa, vecanërisht mungesa e sipërfaqes së parcelës ndërtimore dhe distancave nga objektet kufitare e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale.

Sa sipër është në kundërshtim me rubrikat sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

Proces-Verbali i verifikimit në terren është nënshkruar nga specialistët e terrenit V Sh dhe S Q dhe nuk është nënshkruar nga Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë z. Sh P.

Në dosje disponohen të panënshkruara nga deklaruesi:

-deklarata personale, që merr përsipër përgjegjësinë për çdo pasojë, që mund të rrjedhë nga shkaqe natyrore dhe/ose nga përdorimi i banesës. Sipas këtij ligji, shteti nuk është përgjegjës për kompensimin ose dëmshpërblim në raste fatkeqësish, për shkak faktorëve, që ndikojnë në qëndrueshmërinë e objektit.

-deklarata për zbatimin e planit rregullues, sipas së cilës deklaruesi pranon zbatimin e planit rregullues/studimit urbanistik pjesor, përfshirë këtu: respektimin e hapësirave publike, gjelbërimin, tipin e rrethimit, ngjyrat, ndriçimin, parkimin, etj.

Sa më sipër është në kundërshtim me nenin 27, germa “dh”, të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

Me aktin e kualifikimit nr. 23426, datë 10.10.2018, objekti informal legalizohet, i nënshkruar nga z. A H Sektori i Çështjeve të Pronësisë, z. A B ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit dhe z. A G ish-Drejtor.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi, z. A B, ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. A H, specialist, z. Sh P, ish-Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, znj. V Sh, specialist terreni, z. S Q, specialist terreni, miratuar nga z. A G, ish-Drejtor i ALUIZNI-t Elbasan.

- Dosja nr. 11234, leje legalizimi nr. 2579346, datë 19.06.2018, për objektin: “Godinë banimi 1 Kat”, për H Q D, me adresë Bashkia Elbasan, Gjinar, Zona Kadastrale 2481, nr. pasurisë 938/1,



sipërfaqja e parcelës ndërtimore 139.2 m², sipërfaqja e ndërtimit 46.4 m², sipërfaqja totale e ndërtimit: për banim 46.4 m², për aktivitet - m², numri i kateve mbi tokë 1, nën tokë -, titulli i pronësisë: “Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1”.

Dokumentacioni i dosjes së kësaj leje legalizimi është i pa plotësuar me inventarin përkatës të dokumentacionit dhe numrit të fletëve për cdo dokument, në kundërshtim me Ligjin Nr. 9154, date 06.11.2003, “Për Arkivat”, specialisti Arkivës I D.

-Proces-verbali i verifikimit në terren është pa datë, pra nuk mund të përcaktohet afati kohor proces-verbal i verifikimit – vendim për kualifikimin, në kundërshtim me vendimin e KM nr. 280, datë 1.4.2015 “ Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar, pika 8, ku përcaktohet se:

Drejtoritë e ALUIZNI-t, bazuar në gjendjen faktike në terren, kryejnë procedurat kualifikuese për ndërtimin informal, brenda 60 ditëve nga data e evidentimit faktik në terren (data e "Procesverbalit të evidentimit në terren"). Për kryerjen e këtyre procedurave drejtoritë mbështeten në cilësitë e territorit, të paraqitura grafikisht.

Në dosje mungon:

-vërtetimi për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 27, germa “ç”, të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

-Proces-verbali i verifikimit në terren nuk është plotësuar me rubrikat për: datën e mbajtjes, sipërfaqet e parcelës ndërtimore, njolla e objektit, numri i kateve dhe destinacioni i sipërfaqeve. Përsa i përket pasurive kufitare (të saktësuara në përshkrim) nuk janë shënuar numrat e pasurive dhe distancat nga pasuritë kufitare.

Këto mungesa, vecanërisht mungesa e sipërfaqes së parcelës ndërtimore dhe distancave nga objektet kufitare e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale.

Sa sipër është në kundërshtim me rubrikat sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

Proces-Verbali i verifikimit në terren është nënshkruar nga specialistët e terrenit B Gj dhe A S dhe nuk është nënshkruar nga Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë z. Sh P.

Me aktin e kualifikimit nr. 22490, datë 30.05.2018, objekti informal legalizohet, i nënshkruar nga z. E K Sektori i Legalizimit, z.A B ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit dhe z. A G ish-Drejtor.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi z. A B , ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. E K, specialist, z. Sh P, ish-Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, miratuar nga z. A G, ish-Drejtor i ALUIZNI-t Elbasan.

- Dosja nr. 8556, leje legalizimi nr. 2580585, datë 28.03.2019, për objektin: “Godinë banimi 2 Kat”, për B Z B, me adresë Bashkia Elbasan, Lleshan, Gjinar, Zona Kadastrale 2481, nr. pasurisë AB/1/3, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 260.7 m², sipërfaqja e ndërtimit 86.9 m², sipërfaqja totale e ndërtimit: për banim 189.9 m², për aktivitet - m², numri i kateve mbi tokë 2, nën tokë -, titulli i pronësisë: “Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1”.

Drejtori A G, Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit A B (firmosur z. K D).

Dokumentacioni i dosjes së kësaj leje legalizimi është i pa plotësuar me inventarin përkatës të dokumentacionit dhe numrit të fletëve për cdo dokument, në kundërshtim me Ligjin Nr. 9154, date 06.11.2003, “Për Arkivat”, specialisti Arkivës I D.



-Proces-verbali i verifikimit në terren është mbajtur më datë 24.06.2016, ndërkohë që vendimi për kualifikimin mban datën 05.02.2019, pra pas 2 vjetë e 7 muajsh, në kundërshtim me vendimin e KM nr. 280, datë 1.4.2015 “ Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar, pika 8, ku përcaktohet se:

Drejtoritë e ALUIZNI-t, bazuar në gjendjen faktike në terren, kryejnë procedurat kualifikuese për ndërtimin informal, brenda 60 ditëve nga data e evidentimit faktik në terren (data e "Procesverbalit të evidentimit në terren"). Për kryerjen e këtyre procedurave drejtoritë mbështeten në cilësitë e territorit, të paraqitura grafikisht.

Në dosje mungon:

-vërtetimi për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 27, germa “ç”, të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

-Proces-verbali i verifikimit në terren nuk është plotësuar me rubrikat për: sipërfaqet e parcelës ndërtimore, njolla e objektit, numri i kateve dhe destinacioni i sipërfaqeve. Përsa i përket pasurive kufitare (të saktësuara në përshkrim) nuk janë shënuar numrat e pasurive dhe distancat nga pasuritë kufitare.

Këto mungesa, vecanërisht mungesa e sipërfaqes së parcelës ndërtimore dhe distancave nga objektet kufitare e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale.

Sa sipër është në kundërshtim me rubrikat sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

Proces-Verbali i verifikimit në terren është nënshkruar nga specialistët e terrenit A B dhe S Q dhe është nënshkruar nga Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë z. Sh P.

Me aktin e kualifikimit nr. 24411, datë 05.02.2019, objekti informal legalizohet, i nënshkruar nga z. E K Sektori i Legalizimit, z.A B ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit dhe z. A G ish-Drejtor.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësisiz. A B , ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. E K, specialist, z. Sh P, ish-Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, z. A B, specialist terreni, z. S Q, specialist terreni, miratuar nga z. A G, ish-Drejtor i ALUIZNI-t Elbasan.

- Dosja nr. 8555, leje legalizimi nr. 2580586, datë 28.03.2019, për objektin: “Godinë banimi 1 Kat”, për Z S B, me adresë Bashkia Elbasan, Lleshan, Gjinar, Zona Kadastrale 2481, nr. pasurisë AB/1/2, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 341.1 m², sipërfaqja e ndërtimit 113.7 m², sipërfaqja totale e ndërtimit: për banim 113.7 m², për aktivitet - m², numri i kateve mbi tokë 1, nën tokë -, titulli i pronësisë: “Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1”.

Dokumentacioni i dosjes së kësaj leje legalizimi është i pa plotësuar me inventarin përkatës të dokumentacionit dhe numrit të fletëve për cdo dokument, në kundërshtim me Ligjin Nr. 9154, date 06.11.2003, “Për Arkivat”, specialisti Arkivës I D.

-Proces-verbali i verifikimit në terren është mbajtur më datë 24.06.2016, ndërkohë që vendimi për kualifikimin mban datën 05.02.2019, pra pas 2 vjetë e 7 muajsh, në kundërshtim me vendimin e KM nr. 280, datë 1.4.2015 “ Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar, pika 8, ku përcaktohet se:



Drejtoritë e ALUIZNI-t, bazuar në gjendjen faktike në terren, kryejnë procedurat kualifikuese për ndërtimin informal, brenda 60 ditëve nga data e evidentimit faktik në terren (data e "Procesverbalit të evidentimit në terren"). Për kryerjen e këtyre procedurave drejtoritë mbështeten në cilësitë e territorit, të paraqitura grafiksht.

Në dosje mungon:

-vërtetimi për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 27, germa “ç”, të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

-Proces-verbali i verifikimit në terren nuk është plotësuar me rubrikat për: sipërfaqet e parcelës ndërtimore, njolla e objektit, numri i kateve dhe destinacioni i sipërfaqeve. Përsa i përket pasurive kufitare (të saktësuara në përshkrim) nuk janë shënuar numrat e pasurive dhe distancat nga pasuritë kufitare.

Këto mungesa, vecanërisht mungesa e sipërfaqes së parcelës ndërtimore dhe distancave nga objektet kufitare e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale.

Sa sipër është në kundërshtim me rubrikat sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

Proces-Verbali i verifikimit në terren është nënshkruar nga specialistët e terrenit A B dhe S Q dhe është nënshkruar nga Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë z. Sh P.

Me aktin e kualifikimit nr. 24412, datë 05.02.2019, objekti informal legalizohet, i nënshkruar nga z. E K Sektori i Legalizimit, z.A B ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit dh z. A G ish-Drejtor.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi z. A B , ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. E K, specialist, z. Sh P, ish-Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, z. A B, specialist terreni, z. S Q specialist terreni, miratuar nga z. A G, ish-Drejtor i ALUIZNI-t Elbasan.

- Dosja nr. 607, leje legalizimi nr. 2578238, datë 26.10.2018, për objektin: “Godinë banimi 2 Kat”, për I F D, me adresë Bashkia Elbasan, Derstile, Zona Kadastrale 1477, nr. pasurisë AB/1, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 385.8 m², sipërfaqja e ndërtimit 128.6 m², sipërfaqja totale e ndërtimit: për banim 252.9 m², për aktivitet - m², numri i kateve mbi tokë 2, nën tokë -, titulli i pronësisë: “Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1”.

Drejtori A G, Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit A B.

-Proces-verbali i verifikimit në terren është mbajtur më datë 05.10.2018 (shënuar me laps plumbi ndërkohë që është kryer korrigjim në datën 16.06.2017 të punonjësit S Q), ndërkohë që vendimi për kualifikimin mban datën 16.10.2018, pra pas 1 viti e 4 muajsh, në kundërshtim me vendimin e KM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar, pika 8, ku përcaktohet se:

Drejtoritë e ALUIZNI-t, bazuar në gjendjen faktike në terren, kryejnë procedurat kualifikuese për ndërtimin informal, brenda 60 ditëve nga data e evidentimit faktik në terren (data e "Procesverbalit të evidentimit në terren"). Për kryerjen e këtyre procedurave drejtoritë mbështeten në cilësitë e territorit, të paraqitura grafiksht.

Në dosje mungon:

-vërtetimi për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 27, germa “ç”, të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.



-Proces-verbali i verifikimit në terren nuk është plotësuar me rubrikat për: sipërfaqet e parcelës ndërtimore, njolla e objektit, numri i kateve dhe destinacioni i sipërfaqeve. Përsa i përket pasurive kufitare (të saktësuara në përshkrim) nuk janë shënuar numrat e pasurive dhe distancat nga pasuritë kufitare.

Këto mungesa, vecanërisht mungesa e sipërfaqes së parcelës ndërtimore dhe distancave nga objektet kufitare e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale.

Sa sipër është në kundërshtim me rubrikat sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

Proces-Verbali i verifikimit në terren është nënshkruar nga specialistët e terrenit V Sh dhe S Q dhe është nënshkruar nga Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë z. Sh P.

Me aktin e kualifikimit nr. 23463, datë 16.10.2018, objekti informal legalizohet, i nënshkruar nga z. A H Sektori i Çështjeve të Pronësisë, z.A B ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit dhe z. A G ish-Drejtor.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësisë z. A B, ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. A H, specialist, z. Sh P, ish-Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, z. V Sh, specialist terreni, z. S Q, specialist terreni, miratuar nga z. A G, ish-Drejtor i ALUIZNI-t Elbasan.

- Dosja nr. 1959, leje legalizimi nr. 2579484, datë 18.07.2018, për objektin: “Godinë banimi 2 Kat”, për S Z P, me adresë Bashkia Elbasan, lleshan, Zona Kadastrale 2481, nr. pasurisë 822/1, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 275.7 m², sipërfaqja e ndërtimit 91.9 m², sipërfaqja totale e ndërtimit: për banim 230.49 m², për aktivitet - m², numri i kateve mbi tokë 2, nën tokë -, titulli i pronësisë: “Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1”.

Drejtori A G, Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit A B.

-Proces-verbali i verifikimit në terren nuk është plotësuar me rubrikat për: sipërfaqet e parcelës ndërtimore, njolla e objektit, numri i kateve dhe destinacioni i sipërfaqeve. Përsa i përket pasurive kufitare (të saktësuara në përshkrim) nuk janë shënuar numrat e pasurive dhe distancat nga pasuritë kufitare.

Këto mungesa, vecanërisht mungesa e sipërfaqes së parcelës ndërtimore dhe distancave nga objektet kufitare e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale.

Sa sipër është në kundërshtim me rubrikat sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

Proces-Verbali i verifikimit në terren është nënshkruar nga specialistët e terrenit V Sh dhe F H dhe është nënshkruar nga Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë z. Sh P.

Me aktin e kualifikimit nr. 22621, datë 18.06.2018, objekti informal legalizohet, i nënshkruar nga z. A H Sektori i Çështjeve të Pronësisë, z.A B ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit dhe z. A G ish-Drejtor.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A B, ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. A H, specialist, z. Sh P, ish-Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, z. V Sh, specialist terreni, z. A H, Specialist terreni (Sektorit Legalizimit), miratuar nga z. A G, ish-Drejtor i ALUIZNI-t Elbasan.

- Dosja nr. 3649, leje legalizimi nr. 2580120, datë 14.12.2018, për objektin: “Godinë banimi 2 Kat”, për A L D, V Xh D, me adresë Bashkia Elbasan, Gjinar, Zona Kadastrale 1477, nr. pasurisë



70/1, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 500 m², sipërfaqja e ndërtimit 170.6 m², sipërfaqja totale e ndërtimit: për banim 397.3 m², për aktivitet - m², numri i kateve mbi tokë 2, nën tokë - titulli i pronësisë: “Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1”.

-Proces-verbali i verifikimit në terren nuk ka datë kur është mbajtur, ndërkohë që vendimi për kualifikimin mban datën 04.12.2018, pra nuk mund të përcaktohet afati kohor: proces verbal verifikimi-vendim për kualifikimin, në kundërshtim me vendimin e KM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar, pika 8, ku përcaktohet se:

Drejtoritë e ALUIZNI-t, bazuar në gjendjen faktike në terren, kryejnë procedurat kualifikuese për ndërtimin informal, brenda 60 ditëve nga data e evidentimit faktik në terren (data e "Procesverbalit të evidentimit në terren"). Për kryerjen e këtyre procedurave drejtoritë mbështeten në cilësitë e territorit, të paraqitura grafikisht.

Në dosje mungon:

-vërtetimi për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 27, germa “ç”, të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

-Proces-verbali i verifikimit në terren nuk është plotësuar me rubrikat për: datën e mbajtjes, sipërfaqet e parcelës ndërtimore, njolla e objektit, numri i kateve dhe destinacioni i sipërfaqeve. Përsa i përket pasurive kufitare (të saktësuara në përkrahje) nuk janë shënuar numrat e pasurive dhe distancat nga pasuritë kufitare.

Këto mungesa, vecanërisht mungesa e sipërfaqes së parcelës ndërtimore dhe distancave nga objektet kufitare e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale.

Sa sipër është në kundërshtim me rubrikat sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

Proces-Verbali i verifikimit në terren është nënshkruar nga specialistët e terrenit V Sh dhe S Q dhe nuk është nënshkruar nga Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë z. Sh P.

Me aktin e kualifikimit nr. 23968, datë 04.12.2018, objekti informal legalizohet, i nënshkruar nga z. E K, Sektori i Legalizimit, z.A B ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit dhe z. A G ish-Drejtor.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi z. A B, ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. E K, specialist, z. Sh P, ish-Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, z. V Sh, specialist terreni, z. S Q, specialist terreni, miratuar nga z. A Gi, ish-Drejtor i ALUIZNI-t Elbasan.

Për sa më sipër është mbajtur procesverbali nr. 8, datë 31.07.2019.

- **Dosja nr. 8661 datë 3.12.2014**, Leje legalizimi nr. 8099042, datë 17.05.2017, ndërtim për banim 1 Kat, me pronar i ndërtimit pa leje: **F A G**, me adresë Fshati Copane, Komuna Përparim, sipërfaqe e parcelës ndërtimore 325.8 m², sipërfaqe e ndërtimit 108.6 m², trualli miratuar me VKM nr. 125, datë 17.02.2010.

Nga auditimi u konstatua:

- Në dosje nuk administrohet vërtetimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë cila përbën të ardhura të munguara për **fondin e kompensimit të pronarëve, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, neni 27 “Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit”, pika “ç” – “vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti**



nuk përjashtohet nga pagesa e taksës”, procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit” Kreu I, pika 1, “c” ku përcaktohet: –“për objektin/shtesën pa leje në ndërtime me leje është plotësuar dokumentacioni tekniko-ligjor, i parashikuar në nenet 27 e 37 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, të ndryshuar; si dhe pika 2, ku përcaktohet se –“Drejtoritë e ALUIZNI-t pranë qarqeve, pas verifikimit të dokumentacionit dhe vlerësimit të përmbushjes ose jo të kushteve të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, për objektin informal/shtesën pa leje në ndërtime me leje, vendosin kualifikimin për legalizim ose përjashtimin nga legalizimi. Vendimi, i cili shoqërohet me aktin përkatës, të argumentuar, administrohet si pjesë përbërëse e dosjes së legalizimit”.

-Meqenëse ky proces nuk është në kompetencën e AKZM, do të merren për referencë dispozitat e mësipërme, të cilat bëjnë të domosdoshme pajisjen me lejet mjedisore dhe miratimin paraprak nga Këshilli Kombëtar i Territorit. Në kushtet kur kritere të tilla nuk gjenden të dokumentuara në



praktikën e lejes së legalizimit, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Elbasan duhej të kishte refuzuar lëshimin e lejes së legalizimit dhe duhej të kishte kryer skualifikimin e objektit.

Për sa më sipër mbajunë përgjegjësi ish-Drejtori z. A G dhe Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit z. K D.

Në dosje mungon:

-vërtetimi për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 27, germa “ç”, të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

-Në proces-verbalin e verifikimit në terren datë 23.03.2018, nuk janë plotësuar rubrikat me sipërfaqet e parcelës ndërtimore, njollës së objektit, numrit të kateve, sipërfaqet për banim dhe aktivitet. Përsa i përket pasurive kufitare (të saktësuara në përkrahje) nuk janë shënuar distancat nga pasuritë kufitare, numrin e pasurisë.

Këto mungesa, vecanërisht mungesa e sipërfaqes së parcelës ndërtimore dhe mungesa e distancave nga objektet kufitare e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale.

Sa sipër është në kundërshtim me rubrikat sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

Proces-Verbalin e verifikimit në terren është nënshkruar nga specialistët e terrenit R B, K T, B Gj, F Zh dhe Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë z. Sh P.

Me aktin e kualifikimit nr. 24503, datë 18.02.2019, objekti informal legalizohet, i nënshkruar nga z. A H, Sektori i Çështjeve të Pronësisë, Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit z. K D Përgjegjës i Sektorit të legalizimit dhe Drejtori A G.

Sa më sipër konstatohet se ndërsa proces-verbal verifikimit është mbajtur datë 23.03.208, vendimi i kualifikimit është marrë më datë 18.02.2019, pas 11 muajsh, në kundërshtim me vendimin e KM nr. 280, datë 1.4.2015 “ Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar, pika 8, ku përcaktohet se:

Drejtoritë e ALUIZNI-t, bazuar në gjendjen faktike në terren, kryejnë procedurat kualifikuese për ndërtimin informal, brenda 60 ditëve nga data e evidentimit faktik në terren (data e "Procesverbalit të evidentimit në terren"). Për kryerjen e këtyre procedurave drejtoritë mbështeten në cilësitë e territorit, të paraqitura grafikisht.

Punuar praktika ngaz. A G, ish-Drejtor i ALUIZNI-t Elbasan, z. A B, ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z.K D, Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. A H, specialist në Sektorin e Kalimit të Pronësisë, z. Sh Pa, ish-Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, z. R B, specialist terreni, z. K T, specialist terreni, z. B Gj, specialist terreni, z. F Zh, specialist terreni.

Lidhur me konstatimet e grupit të KLSH, z. A H ka dërguar observacionin nr. 1065/62, datë 03.09.2019, ku ka paraqitur opsionin e tij se:

Shkresa konfirmimi:

-Shkresa nr. 3665/1, datë 25.07.2018, i Bashkisë Librazhd

-Shkresa nr. 55, datë 19.03.2018, ARZM Elbasan

“Sipas shkresës nr. 55, datë 19.03.2018 konfirmohet se ndërtimet ndodhen në ZPT (zonën e përdorimit tradicional) dhe nuk kanë ndikim në ekosistemin natyror të Parkut Kombëtar Shebenik-Jabllanicë. Nuk ka kuptim të merret leje mjedisore sepse deklarimi është bërë para se të hynte në fuqi VKM nr. 640, datë 21.05.2008 dhe se se këtu bëhet fjalë për leje ndërtimi”

Lidhur me këtë observacion, rikujtojmë se sipas shkresës nr. 362/1, datë 27.03.2018 të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, citohet shprehimisht: “AKZM nuk mund të shprehet nëse



lejohet apo jo ndërtimi i këtyre objekteve. Për sa i përket legalizimit të tyre nuk është në kompetencën tonë shqyrtimi dhe vlerësimi i këtij procesi”.

Përveç sa më sipër, sipas citimit të VKM nr. 640, datë 21.05.2008, në zonën në fjalë ZPT, zbatohet shkalla e katërt e mbrojtjes (pavarësisht konfirmimit të AKZM) dhe duhej të paraqitej leja mjedisore sipas vendimit të KM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar, pika 10, ku citohet:

“Për ndërtimet informale, të përcaktuara në kreun III, të këtij vendimi, të ngritura brenda zonave dhe nënzonave të mbrojtura, si dhe zonave të ruajtjes së veçantë, ku shkalla e mbrojtjes nuk ndalon ndërtimet me funksion banimi ose social/ekonomik, procedurat e kualifikimit kryhen pas depozitimit, nga poseduesi i ndërtimit, të aktit për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM), nga një ent apo subjekti i licencuar”

Shkresa nr. 3665/1, datë 25.07.2018 e Bashkisë Librazhd, nuk merret parasysh, sepse Bashkia Librazhd është jashtë kompetencës juridike, tagrit ligjor, për të marrë vendime lidhur me zonat e mbrojtura. Observacioni nuk qëndron.

Z. A G, ish-Drejtor i ALUIZNI-t, me observacionin nr. 1065/66, datë 04.09.2019, ka paraqitur pretendimin se ka patur komunikim me ARZM me shkresa konfirmuese:

- nr. 55, datë 19.03.2018.

- nr. 3665/1, datë 25.07.2018

-Lidhur me këtë observacion, rikujtojmë se sipas shkresës nr. 362/1, datë 27.03.2018 të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, citohet shprehimisht: **“AKZM nuk mund të shprehet nëse lejohet apo jo ndërtimi i këtyre objekteve. Për sa i përket legalizimit të tyre nuk është në kompetencën tonë shqyrtimi dhe vlerësimi i këtij procesi”.**

Përveç sa më sipër, sipas citimit të VKM nr. 640, datë 21.05.2008, në zonën në fjalë ZPT, zbatohet shkalla e katërt e mbrojtjes (pavarësisht konfirmimit të ARZM Elbasan) dhe duhej të paraqitej leja mjedisore sipas vendimit të KM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar, pika 10, ku citohet:

“Për ndërtimet informale, të përcaktuara në kreun III, të këtij vendimi, të ngritura brenda zonave dhe nënzonave të mbrojtura, si dhe zonave të ruajtjes së veçantë, ku shkalla e mbrojtjes nuk ndalon ndërtimet me funksion banimi ose social/ekonomik, procedurat e kualifikimit kryhen pas depozitimit, nga poseduesi i ndërtimit, të aktit për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM), nga një ent apo subjekti i licencuar”

-Në nenin 33, të ligjit nr. 81/2017, datë 04.05.2017, “Veprimtaritë që lejohen pasi të jenë pajisur me miratim paraprak” citohet:

“Veprimtaritë që lejohen të ushtrohen në zonat e mbrojtura mjedisore pasi të jenë pajisur me miratimin paraprak të organit, brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore të të cilit është veprimtaria e mëposhtme:

- a) çdo veprimtari tjetër në përputhje me Planin e Menaxhimit;
- b) monitorime të gjendjes mjedisore, të ekosistemit, të habitateve dhe të llojeve floristike e faunistike;
- c) ndërhyrjet e nevojshme për rigjenerimin dhe shëndetësimin;
- ç) struktura në përputhje me përcaktimet e Planit të Menaxhimit në shërbim të aktiviteteve turistike;
- d) çdo veprimtari tjetër në përputhje me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit”



Observacioni nuk qëndron, ndërkohë në lidhje me përgjegjësia tuaj si titullar do të merret në konsideratë gjatë trajtimit të përgjegjësive individuale rast pas rasti.

-Z. K D, Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, me observacionin nr. 1065/35, datë 13.08.2019, ka paraqitur pretendimin se ka patur komunikim me ARZM me shkresa konfirmuese:

- nr. 55, datë 19.03.2018.

- nr. 3665/1, datë 25.07.2018

-Lidhur me këtë observacion, rikujtojmë se sipas shkresës nr. 362/1, datë 27.03.2018 të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, citohet shprehimisht: “AKZM nuk mund të shprehet nëse lejohet apo jo ndërtimi i këtyre objekteve. Për sa i përket legalizimit të tyre nuk është ne kompetencën tonë shqyrtimi dhe vlerësimi i këtij procesi”.

Përveç sa më sipër, sipas citimit të VKM nr. 640, datë 21.05.2008, në zonën në fjalë ZPT, zbatohet shkalla e katërt e mbrojtjes (pavarësisht konfirmimit të ARZM Elbasan) dhe duhej të paraqitej leja mjedisore sipas vendimit të KM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar, pika 10, ku citohet:

“Për ndërtimet informale, të përcaktuara në kreun III, të këtij vendimi, të ngritura brenda zonave dhe nënzonave të mbrojtura, si dhe zonave të ruajtjes së veçantë, ku shkalla e mbrojtjes nuk ndalon ndërtimet me funksion banimi ose social/ekonomik, procedurat e kualifikimit kryhen pas depozitimit, nga poseduesi i ndërtimit, të aktit për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM), nga një ent apo subjekti i licencuar”

-Në nenin 33, të ligjit nr. 81/2017, datë 04.05.2017, “Veprimtaritë që lejohen pasi të jenë pajisur me miratim paraprak” citohet:

“Veprimtaritë që lejohen të ushtrohen në zonat e mbrojtura mjedisore pasi të jenë pajisur me miratimin paraprak të organit, brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore të të cilit është veprimtaria e mëposhtme:

- a) çdo veprimtari tjetër në përputhje me Planin e Menaxhimit;*
- b) monitorime të gjendjes mjedisore, të ekosistemit, të habitateve dhe të llojeve floristike e faunistike;*
- c) ndërhyrjet e nevojshme për rigjenerimin dhe shëndetësimin;*
- ç) struktura në përputhje me përcaktimet e Planit të Menaxhimit në shërbim të aktiviteteve turistike;*
- d) çdo veprimtari tjetër në përputhje me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit”***

Është observuar gjithashtu se objekti është deklaruar për legalizim përpara se të hynte në fuqi VKM nr. 640, datë 21.05.2008, por si bazë për auditivin e kryer grupi i KLSH-së ka marrë gjithnjë datën e lëshimit të lejes së legalizimit. Observacionet nuk qëndrojnë.

- Dosja nr. 79, leje legalizimi nr. 2578351, datë 31.10.2018, për objektin: “Godinë e Kombinuar 2 Kat”, për D O M, me adresë: Bashkia Librazhd, Zgosht, Zona Kadastrale 3913, nr.pasurisë 992/1, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 493 m², sipërfaqja e ndërtimit 493 m², sipërfaqja totale e ndërtimit: për banim 546, për aktivitet 539 m², numri i kateve mbi toke 2, nën tokë 1, titulli i pronësisë: “Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1”. Drejtori A G, Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit A B.

Dokumentacioni i dosjes së kësaj leje legalizimi është i pa plotësuar me inventarin e përkatës të rregullt të dokumentacionit dhe numrit të fletëve për cdo dokument, në kundërshtim me Ligjin Nr. 9154, date 06.11.2003, “Për Arkivat”.

Sa më sipër dhe sipas praktikës përkatëse, konstatohet se neni 30, pika 2/1, citon se:



*Përcaktimet e këtij neni zbatohen edhe në rastin kur subjekti apo njëri prej subjekteve që disponojnë ndërtimin **me funksion banimi** nuk shlyejnë detyrimet financiare të parashikuara në ligj për vlerën e parcelës ndërtimore të objektit pa leje. Në këtë rast, për pasurinë ose pjesën takuese të subjektit debitor, regjistrimi bëhet sipas shkronjës “a”, të nenit 54, “Regjistrimi i hipotekës ligjore”, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.*

Në dosje nuk rezulton të ketë dokument financiar për pagesën e parcelës ndërtimore, pra nuk është paguar vlera e parcelës ndërtimore, në një kohë që objekti është me funksion të Kombinuar dhe nuk duhej vendosur hipotekë ligjore si dhe nuk duhej lëshuar leja e legalizimit pa u paguar vlera e parcelës ndërtimore sipas vendimit të KM për këtë qëllim. Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1 dhe VKM nr. 1095, datë 28.12.2015 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet aluizni-t dhe zqrrp-së, dhe të procedurave apokufizimeve që zbatohen përfekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara”, Kreu III.

Nga auditimi konstatohet se ka patur shkëmbim informacioni mes Drejtorisë së ALUIZNI-t Elbasan dhe strukturave përkatëse që përcaktojnë vendndodhjen e objektit të legalizuar, prej ku rezulton se ky objekt ndodhet në Zonën e Mbrojtur të Parkut Kombëtar “Shebenik-Jabllanicë”, sipas VKM nr. 640, datë 21.05.2008, kategoria e dytë e zonave të mbrojtura .

Sa më sipër ALUIZNI i është drejtuar AKZM me shkresë nr. 2335/2, datë 14.06.2018, ku i kërkon shprehimisht: “*konfirmimin nëse objektet informale të ndodhura në këtë zonë mund të legalizohen ose jo*”.

Me shkresë nr. 774/1, datë 03.07.2018, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura ka konfirmuar faktin që *ndërtimi informal ndodhet në zonën e mbrojtur PK “Shebenik-Jabllanicë”, shpallur me VKM nr. 640, datë 21.05.208, kategoria e dytë e zonave të mbrojtura*”

Po me shkresë nr. 774/1, datë 03.07.2018, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura ka kthyer përgjigje, në të cilën nuk ka bërë konfirmim për legalizim të objekteve informale, duke deklaruar se : “*Përsa i përket legalizimit të tyre nuk është në kompetencën tonë shqyrtimi dhe vlerësimi i këtij procesi*”

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me vendimin e KM nr. 280, datë 1.4.2015 “ Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar me vendimin e KM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dheshtesa në vendimin nr. 280, datë 1.4.2015, të këshillit të ministrave, “për përcaktimin ekriterëve, procedurave edokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, pika 2, germa “ë” ku citohet: Ndërtimi informal i llojit “objekt”, i ngritur brenda vijës kufizuese të zonës informale të miratuar dhe i përfshirë në fushën e zbatimit të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, përjashtohet nga legalizimi në një nga rastet e mëposhtme:

“Është ngritur brenda zonave dhe/ose nënzonave të mbrojtura, shkalla e mbrojtjes të të cilave nuk lejon ndërtime, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 8906, datë 6.6.2002, “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij”.

Ligji nr. 8906, datë 6.6.2002 është shfuqizuar nga ligji nr. 81/2017, datë 04.05.2017 “Për zonat e mbrojtura”, në nenin 16 të të cilit, “Parku kombëtar” (kategoria II), pika 2, germa “a” përcaktohet se:

Në “Parkun kombëtar” zbatohet shkalla e mbrojtjes mjedisore të zonës që ka si objektiv të mbajë territorin në gjendje natyrore, ku të ruhen komunitetet biotike, të resurseve gjenetike dhe llojeve për të siguruar stabilitetin ekologjik dhe diversitetin dhe ku:

a) përjashtohet njeriu nga shfrytëzimi ose zënia me aktivitete intensive



-Në nenin 33, të ligjit nr. 81/2017, datë 04.05.2017, “Veprimtaritë që lejohen pasi të jenë pajisur me miratim paraprak” citohet:

“Veprimtaritë që lejohen të ushtrohen në zonat e mbrojtura mjedisore pasi të jenë pajisur me miratimin paraprak të organit, brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore të të cilit është veprimtaria e mëposhtme:

- a) çdo veprimtari tjetër në përputhje me Planin e Menaxhimit;
- b) monitorime të gjendjes mjedisore, të ekosistemit, të habitateve dhe të llojeve floristike e faunistike;
- c) ndërhyrjet e nevojshme për rigjenerimin dhe shëndetësimin;
- ç) struktura në përputhje me përcaktimet e Planit të Menaxhimit në shërbim të aktiviteteve turistike;
- d) çdo veprimtari tjetër në përputhje me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit”**

-Sipas VKM nr. 640, datë 21.05.2018 “Për shpalljen “Park Kombëtar” të ekosistemit natyror Shebenik-Jabllanicë”, pika 4, germa “ç”, përcaktohet se:

Zonat e përdorimit tradicional, me sipërfaqe 12 420 ha, e shënuar në hartë me “ZPT”, është zonë ku mundësohet vazhdimi i veprimtarive, tradicionale dhe ekonomike, e ku mund të ushtrohen veprimtari të reja, vetëm me lejet mjedisore dhe, për rastet e trashëgimisë kulturore me leje të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe të shërbimit arkeologjik. Zona përfshihen territoret bujqësore, ujore e pyjore, rreth qendrave të banuara, kryesisht të përdorura nga banorët. Në zonën e përdorimit tradicional zbatohet shkalla e katërt e mbrojtjes.

-Meqenëse ky proces nuk është në kompetencën e AKZM, do të merren për referencë dispozitat e mësipërme, të cilat bëjnë të domosdoshme pajisjen me lejet mjedisore dhe miratimin paraprak nga Këshilli Kombëtar i Territorit. Në kushtet kur kriteret të tilla nuk gjenden të dokumentuara në praktikën e lejes së legalizimit, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Elbasan duhej të kishte refuzuar lëshimin e lejes së legalizimit dhe duhej të kishte kryer skualifikimin e objektit.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ish-Drejtori z. A G dhe Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit z. A B.

Në dosje mungon:

-vërtetimi për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 27, germa “ç”, të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

-Në proces-verbalin e verifikimit në terren datë s`ka, nuk është plotësuar me sipërfaqet e parcelës ndërtimore, njollës së objektit, sipërfaqet për banim dhe aktivitet. Nuk mund të përcaktohet afati kohor proces-verbal verifikimi – vendim kualifikimi, në kundërshtim me vendimin e KM nr. 280, datë 1.4.2015 “ Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar, pika 8, ku përcaktohet se:

Drejtoritë e ALUIZNI-t, bazuar në gjendjen faktike në terren, kryejnë procedurat kualifikuese për ndërtimin informal, brenda 60 ditëve nga data e evidentimit faktik në terren (data e "Procesverbalit të evidentimit në terren"). Për kryerjen e këtyre procedurave drejtoritë mbështeten në cilësitë e territorit, të paraqitura grafikisht.

Përsa i përket pasurive kufitare (të saktësuara në përshkrim) nuk janë shënuar distancat nga pasuritë kufitare, numrin e pasurisë.

Këto mungesa, vecanërisht mungesa e sipërfaqes së parcelës ndërtimore dhe mungesa e distancave nga objektet kufitare e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument



formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale.

Sa sipër është në kundërshtim me rubrikat sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

Proces-Verbali i verifikimit në terren është nënshkruar nga specialistët e terrenit firmat e të cilëve janë të padeshifrueshme ku ngarkohet me përgjegjësi Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë z. Sh P.

Me aktin e kualifikimit nr. 23582, datë 29.10.2019, objekti informal legalizohet, i nënshkruar nga z. A H, Sektori i Çështjeve të Pronësisë, Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit z. A B Përgjegjës i Sektorit të legalizimit dhe Drejtori A G.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A G, ish-Drejtor i ALUIZNI-t Elbasan, z. A B, ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. A H, specialist në Sektorin e Kalimit të Pronësisë, z. Sh P, ish-Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, z. R B, specialist terreni.

Lidhur me konstatimet e grupit të KLSH, z. A H ka dërguar observacionin nr. 1065/62, datë 03.09.2019, ku ka paraqitur opsionin e tij se:

Shkresa konfirmimi:

-Shkresa nr. 3663/1, datë 18.07.2018, i Bashkisë Librazhd

-Shkresa nr. 183, datë 06.07.2018, ARZM Elbasan

-Shkresa nr.128, datë 06.06.2018, ARZM Elbasan

“Sipas shkresës nr. 183, datë 06.07.2018 konfirmohet se ndërtimet ndodhen në ZPT (zonën e përdorimit tradicional) dhe nuk kanë ndikim në ekosistemin natyror të Parkut Kombëtar Shebenik-Jabllanicë.

Sipas shkresës nr. 128, datë 06.06.2018 konfirmohet se ndërtimet ndodhen në ZPT (zonën e përdorimit tradicional) dhe nuk kanë ndikim në ekosistemin natyror të Parkut Kombëtar Shebenik-Jabllanicë dhe se nuk kemi kompetencë për interpretimin e VKM nr. 640, datë 21.05.2008

Nuk ka kuptim të merret leje mjedisore sepse deklarimi është bërë para se të hynte në fuqi VKM nr. 640, datë 21.05.2008 dhe se se këtu bëhet fjalë për leje ndërtimi”

Lidhur me këtë observacion, rikujtojmë se sipas shkresës nr. 362/1, datë 27.03.2018 të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, citohet shprehimisht: “AKZM nuk mund të shprehet nëse lejohet apo jo ndërtimi i këtyre objekteve. Për sa i përket legalizimit të tyre nuk është në kompetencën tonë shqyrtimi dhe vlerësimi i këtij procesi”.

Përveç sa më sipër, sipas citimit të VKM nr. 640, datë 21.05.2008, në zonën në fjalë ZPT, zbatohet shkalla e katërt e mbrojtjes (pavarësisht konfirmimit të AKZM) dhe duhej të paraqitej leja mjedisore sipas vendimit të KM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar, pika 10, ku citohet:

“Për ndërtimet informale, të përcaktuara në kreun III, të këtij vendimi, të ngritura brenda zonave dhe nënzonave të mbrojtura, si dhe zonave të ruajtjes së veçantë, ku shkalla e mbrojtjes nuk ndalon ndërtimet me funksion banimi ose social/ekonomik, procedurat e kualifikimit kryhen pas depozitimit, nga poseduesi i ndërtimit, të aktit për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM), nga një ent apo subjekti i licencuar”

Shkresa nr. 3663/1, datë 18.07.2018 e Bashkisë Librazhd, nuk merret parasysh, sepse Bashkia Librazhd është jashtë kompetencës juridike, tagrit ligjor, për të marrë vendime lidhur me zonat e mbrojtura. Observacioni nuk qëndron.

z. A G, ish-Drejtor i ALUIZNI-t, me observacionin nr. 1065/66, datë 04.09.2019, ka paraqitur pretendimin se ka patur komunikim me ARZM me shkresa konfirmuese:

-Shkresa nr. 3663/1, datë 18.07.2018, i Bashkisë Librazhd



-Shkresa nr. 183, datë 06.07.2018, ARZM Elbasan

-Shkresa nr.128, datë 06.06.2018, ARZM Elbasan

-Lidhur me këtë observacion, rikujtojmë se sipas shkresës nr. 362/1, datë 27.03.2018 të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, citohet shprehimisht: **“AKZM nuk mund të shprehet nëse lejohet apo jo ndërtimi i këtyre objekteve. Për sa i përket legalizimit të tyre nuk është në kompetencën tonë shqyrtimi dhe vlerësimi i këtij procesi”**.

Përveç sa më sipër, sipas citimit të VKM nr. 640, datë 21.05.2008, në zonën në fjalë ZPT, zbatohet shkalla e katërt e mbrojtjes (pavarësisht konfirmimit të ARZM Elbasan) dhe duhej të paraqitej leja mjedisore sipas vendimit të KM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar, pika 10, ku citohet:

“Për ndërtimet informale, të përcaktuara në kreun III, të këtij vendimi, të ngritura brenda zonave dhe nënzonave të mbrojtura, si dhe zonave të ruajtjes së veçantë, ku shkalla e mbrojtjes nuk ndalon ndërtimet me funksion banimi ose social/ekonomik, procedurat e kualifikimit kryhen pas depozitimit, nga poseduesi i ndërtimit, të aktit për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM), nga një ent apo subjekti i licencuar”

-Në nenin 33, të ligjit nr. 81/2017, datë 04.05.2017, “Veprimtaritë që lejohen pasi të jenë pajisur me miratim paraprak” citohet:

“Veprimtaritë që lejohen të ushtrohen në zonat e mbrojtura mjedisore pasi të jenë pajisur me miratimin paraprak të organit, brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore të të cilit është veprimtaria e mëposhtme:

- a) çdo veprimtari tjetër në përputhje me Planin e Menaxhimit;
- b) monitorime të gjendjes mjedisore, të ekosistemit, të habitateve dhe të llojeve floristike e faunistike;
- c) ndërhyrjet e nevojshme për rigjenerimin dhe shëndetësimin;
- ç) struktura në përputhje me përcaktimet e Planit të Menaxhimit në shërbim të aktiviteteve turistike;
- d) çdo veprimtari tjetër në përputhje me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit”**

Observacioni nuk qëndron, ndërkohë në lidhje me përgjegjësin tuaj si titullar do të merret në konsideratë gjatë trajtimit të përgjegjësive individuale rast pas rasti.

- **Dosja nr. 9420, leje legalizimi nr. 2578186, datë 24.10.2018**, për objektin: “Godinë Banimi 1 Kat”, për Ç R Z, me adresë Bashkia Librazhd, Llangë, Zona Kadastrale 2477, nr. pasurisë 196/1, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 225 m², sipërfaqja e ndërtimit 75 m², sipërfaqja totale e ndërtimit: për banim 75 m², për aktivitet - m², numri i kateve mbi tokë 1, nën tokë -, titulli i pronësisë: “Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1”.

Drejtori A G, Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit A B.

Dokumentacioni i dosjes së kësaj leje legalizimi është i pa plotësuar me inventarin përkatës të dokumentacionit dhe numrit të fletëve për cdo dokument, në kundërshtim me Ligjin Nr. 9154, date 06.11.2003, “Për Arkivat”.

Nga auditimi konstatohet se ka patur shkëmbim informacioni mes Drejtorisë së ALUIZNI-t Elbasan dhe strukturave përkatëse që përcaktojnë vendndodhjen e objektit të legalizuar, prej ku, sipas shkresës nr. 227, datë 18.09.2018, së AKZM Elbasan, rezulton se ky objekt ndodhet në Zonën e Mbrojtur të Parkut Kombëtar “Shebenik-Jabllanicë”, sipas VKM nr. 640, datë 21.05.2008, kategoria e dytë e zonave të mbrojtura .

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me vendimin e KM nr. 280, datë 1.4.2015 “ Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të



kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar me vendimin e KM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dheshtesa në vendimin nr. 280, datë 1.4.2015, të këshillit të ministrave, “për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, pika 2, germa “ë” ku citohet: Ndërtimi informal i llojit “objekt”, i ngritur brenda vijës kufizuese të zonës informale të miratuar dhe i përfshirë në fushën e zbatimit të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, përjashtohet nga legalizimi në një nga rastet e mëposhtme:

“Është ngritur brenda zonave dhe/ose nënzonave të mbrojtura, shkalla e mbrojtjes të të cilave nuk lejon ndërtime, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 8906, datë 6.6.2002, “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij”.

Ligji nr. 8906, datë 6.6.2002 është shfuqizuar nga ligji nr. 81/2017, datë 04.05.2017 “Për zonat e mbrojtura”, në nenin 16 të cilit, “Parku kombëtar” (kategoria II), pika 2, germa “a” përcaktohet se:

Në “Parkun kombëtar” zbatohet shkalla e mbrojtjes mjedisore të zonës që ka si objektiv të mbajë territorin në gjendje natyrore, ku të ruhen komunitetet biotike, të resurseve gjenetike dhe llojeve për të siguruar stabilitetin ekologjik dhe diversitetin dhe ku:

a) përjashtohet njeriu nga shfrytëzimi ose zënia me aktivitete intensive

-Në nenin 33, të ligjit nr. 81/2017, datë 04.05.2017, “Veprimtaritë që lejohen pasi të jenë pajisur me miratim paraprak” citohet:

“Veprimtaritë që lejohen të ushtrohen në zonat e mbrojtura mjedisore pasi të jenë pajisur me miratimin paraprak të organit, brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore të të cilit është veprimtaria e mëposhtme:

a) çdo veprimtari tjetër në përputhje me Planin e Menaxhimit;

b) monitorime të gjendjes mjedisore, të ekosistemit, të habitateve dhe të llojeve floristike e faunistike;

c) ndërhyrjet e nevojshme për rigjenerimin dhe shëndetësimin;

ç) struktura në përputhje me përcaktimet e Planit të Menaxhimit në shërbim të aktiviteteve turistike;

d) çdo veprimtari tjetër në përputhje me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit”

-Sipas VKM nr. 640, datë 21.05.2018 “Për shpalljen “Park Kombëtar” të ekosistemit natyror Shebenik-Jabllanicë”, pika 4, germa “ç”, përcaktohet se:

Zonat e përdorimit tradicional, me sipërfaqe 12 420 ha, e shënuar në hartë me “ZPT”, është zonë ku mundësohet vazhdimi i veprimtarive, tradicionale dhe ekonomike, e ku mund të ushtrohen veprimtari të reja, vetëm me lejet mjedisore dhe, për rastet e trashëgimisë kulturore me leje të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe të shërbimit arkeologjik. Zona përfshihen territoret bujqësore, ujore e pyjore, rreth qendrave të banuara, kryesisht të përdorura nga banorët. Në zonën e përdorimit tradicional zbatohet shkalla e katërt e mbrojtjes.

-Meqenëse procesi i legalizimit nuk është në kompetencën e AKZM, do të merren për referencë dispozitat e mësipërme, të cilat bëjnë të domosdoshme pajisjen me lejet mjedisore dhe miratimin paraprak nga Këshilli Kombëtar i Territorit. Në kushtet kur kritere të tilla nuk gjenden të dokumentuara në praktikën e lejes së legalizimit, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Elbasan duhej të kishte refuzuar lëshimin e lejes së legalizimit dhe duhej të kishte kryer skualifikimin e objektit.

-Sipas shkresës së ZVRPP Elbasan nr. 255/1, datë 04.09.2018, “Kthim përgjigje”, informacion për gjendjen juridike të pasurive, konstatohet se pasuria nr. 196, është e llojit “Ledh”, sipërfaqe 2217 m², regjistruar në vol.3, faqe 55, ZK 2477, pronë “Shtet”.



Ndërkohë që ALUIZNI Elbasan ka miratuar lejen e legalizimit për ndërtimin pa leje mbi këtë pasuri, çka sjell ndryshimin automatikisht të zërit kadastral gjatë regjistrimit në ZVRPP, në mungesë të dokumentacionit: kërkesa për miratimin në Këshillin e Qarkut, të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Agjencisë Rajonale të Mjedisit. Pra, nuk ka asnjë dokumentacion nga këto organe, për t'i dhënë lejen, veprimet të kryer për legalizim në zonat “Territore të tjera”, veprime në kundërshtim me nenet 10, 11, 14, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar dhe VKM nr. 515, datë 13.5.2009 e VKM nr. 589, datë 10.9.2014, “Për përcaktimin e afateve, të mënyrës dhe kohës së ushtrimit nga ALUIZNI të përgjegjësive të zyrave të urbanistikës dhe të këshillave të qarqeve, gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale” si dhe Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit me nr. 5, datë 29.12.2014 “Për identifikimin e zonave të urbanizuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në miratimin e hartave ku mund të ndërhyhet në funksion të zhvillimit urban”, pika 9 ku përcaktohet: “Konvertimi nga tokë “Ledh” në tokë “Truall” për sipërfaqet brenda zonave të urbanizuara do të bëhet sipas procedurave përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi”.

Regjistri i Parcelës Ndërtimore është përgatitur nga Përgjegjësi i Sektorit të Çështjeve të Pronësisë znj. M S dhe konfirmuar nga Drejtori z. A G.

Në dosje mungon:

-vërtetimi për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 27, germa “ç”, të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

-Proces-verbali i verifikimit në terren nuk është plotësuar me rubrikat për: sipërfaqet e parcelës ndërtimore, njolla e objektit, dhe destinacioni i sipërfaqeve. Përsa i përket pasurive kufitare (të saktësuara në përshkrim) nuk janë shënuar numrat e pasurive dhe distancat nga pasuritë kufitare. Këto mungesa, vecanërisht mungesa e sipërfaqes së parcelës ndërtimore dhe distancave nga objektet kufitare e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale.

Sa sipër është në kundërshtim me rubrikat sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

Proces-Verbali i verifikimit në terren është nënshkruar nga specialisti i terrenit K T dhe është miratuar nga Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë z. Sh P dhe është nënshkruar vetëm nga një specialist, në një kohë që duhen jo më pak se 2 specialistë.

Me aktin e kualifikimit nr. 23477, datë 17.10.2018, objekti informal legalizohet, i nënshkruar nga z. A H, z. A B dhe Drejtori z. A G.

Proces-verbali i vlerësimit të dosjes së legalizimit është nënshkruar nga z. A H për Sektorin e Legalizimit dhe z. F Sh, Sektori i Përpunimit të të Dhënave.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A G, ish-Drejtor i ALUIZNI-t Elbasan, z. A B, ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. A H, specialist, znj. M S Përgjegjësi i Sektorit të Çështjeve të Pronësisë, z. F Sh, Sektori i Përpunimit të të Dhënave, z. Sh P, ish-Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, z. K T, specialist terreni.

Lidhur me konstatimet e grupit të KLSH, z. A H ka dërguar observacionin nr. 1065/62, datë 03.09.2019, ku ka paraqitur opsionin e tij se:

Shkresa konfirmimi:

-Shkresa nr. 227, datë 18.09.2018, e ARZM Elbasan

“Sipas shkresës nr. 227, datë 18.09.2018 konfirmohet se ndërtimet ndodhen në ZPT (zonën e përdorimit tradicional) dhe nuk kanë ndikim në ekosistemin natyror të Parkut Kombëtar Shebenik-Jabllanicë.



Nuk ka kuptim të merret leje mjedisore sepse deklarimi është bërë para se të hynte në fuqi VKM nr. 640, datë 21.05.2008 dhe se se këtu bëhet fjalë për leje ndërtimi”

Lidhur me këtë observacion, rikujtojmë se sipas shkresës nr. 362/1, datë 27.03.2018 të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, citohet shprehimisht: **“AKZM nuk mund të shprehet nëse lejohet apo jo ndërtimi i këtyre objekteve. Për sa i përket legalizimit të tyre nuk është në kompetencën tonë shqyrtimi dhe vlerësimi i këtij procesi”**. Shkresanr. 227, datë 18.09.2018, e ARZM Elbasan nuk është shprehur për legalizimin e objektit.

Përveç sa më sipër, sipas citimit të VKM nr. 640, datë 21.05.2008, në zonën në fjalë ZPT, zbatohet shkalla e katërt e mbrojtjes (pavarësisht konfirmimit të AKZM) dhe duhej të paraqitej leja mjedisore sipas vendimit të KM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar, pika 10, ku citohet:

“Për ndërtimet informale, të përcaktuara në kreun III, të këtij vendimi, të ngritura brenda zonave dhe nënzonave të mbrojtura, si dhe zonave të ruajtjes së veçantë, ku shkalla e mbrojtjes nuk ndalon ndërtimet me funksion banimi ose social/ekonomik, procedurat e kualifikimit kryhen pas depozitimit, nga poseduesi i ndërtimit, të aktit për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM), nga një ent apo subjekti i licencuar”

Observacioni nuk qëndron.

Z. A G, ish-Drejtor i ALUIZNI-t, me observacionin nr. 1065/66, datë 04.09.2019, ka paraqitur pretendimin se ka patur komunikim me ARZM me shkresa konfirmuese:

-Shkresa nr. 227, datë 18.09.2018, e ARZM Elbasan

-Lidhur me këtë observacion, rikujtojmë se sipas shkresës nr. 362/1, datë 27.03.2018 të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, citohet shprehimisht: **“AKZM nuk mund të shprehet nëse lejohet apo jo ndërtimi i këtyre objekteve. Për sa i përket legalizimit të tyre nuk është në kompetencën tonë shqyrtimi dhe vlerësimi i këtij procesi”**.

Përveç sa më sipër, sipas citimit të VKM nr. 640, datë 21.05.2008, në zonën në fjalë ZPT, zbatohet shkalla e katërt e mbrojtjes (pavarësisht konfirmimit të ARZM Elbasan) dhe duhej të paraqitej leja mjedisore sipas vendimit të KM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar, pika 10, ku citohet:

“Për ndërtimet informale, të përcaktuara në kreun III, të këtij vendimi, të ngritura brenda zonave dhe nënzonave të mbrojtura, si dhe zonave të ruajtjes së veçantë, ku shkalla e mbrojtjes nuk ndalon ndërtimet me funksion banimi ose social/ekonomik, procedurat e kualifikimit kryhen pas depozitimit, nga poseduesi i ndërtimit, të aktit për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM), nga një ent apo subjekti i licencuar”

-Në nenin 33, të ligjit nr. 81/2017, datë 04.05.2017, “Veprimtaritë që lejohen pasi të jenë pajisur me miratim paraprak” citohet:

“Veprimtaritë që lejohen të ushtrohen në zonat e mbrojtura mjedisore pasi të jenë pajisur me miratimin paraprak të organit, brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore të të cilit është veprimtaria e mëposhtme:

- a) çdo veprimtari tjetër në përputhje me Planin e Menaxhimit;
- b) monitorime të gjendjes mjedisore, të ekosistemit, të habitateve dhe të llojeve floristike e faunistike;
- c) ndërhyrjet e nevojshme për rigjenerimin dhe shëndetësimin;
- ç) struktura në përputhje me përcaktimet e Planit të Menaxhimit në shërbim të aktiviteteve turistike;
- d) çdo veprimtari tjetër në përputhje me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit”



Observacioni nuk qëndron, ndërkohë në lidhje me përgjegjësia tuaj si titullar do të merret në konsideratë gjatë trajtimit të përgjegjësive individuale rast pas rasti.

- Dosja nr. 13030, leje legalizimi nr. 2578530, datë 22.11.2018, për objektin: “Godinë Banimi 2 Kat”, për S F B, me adresë Bashkia Prrenjas, Bardhaj, Zona Kadastrale 1108, nr. pasurisë 44/7/1, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 200 m², sipërfaqja e ndërtimit 73.9 m², sipërfaqja totale e ndërtimit: për banim 165 m², për aktivitet - m², numri i kateve mbi tokë 1, nën tokë -, titulli i pronësisë: “Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1”.

Dokumentacioni i dosjes së kësaj leje legalizimi është i pa plotësuar me inventarin përkatës të dokumentacionit dhe numrit të fletëve për cdo dokument, në kundërshtim me Ligjin Nr. 9154, date 06.11.2003, “Për Arkivat”.

Nga verifikimi i kryer për vendndodhjen e objektit të legalizuar, me anën e sistemit dixhital geoportal-albania, rezulton se e tërë zona kadastrale 1108 si dhe objekti i legalizuar ndodhet në Zonën e Mbrojtur të Parkut Kombëtar “Shebenik-Jabllanicë”, sipas VKM nr. 640, datë 21.05.2008, kategoria e dytë e zonave të mbrojtura.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me vendimin e KM nr. 280, datë 1.4.2015 “ Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar me vendimin e KM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dhështesa në vendimin nr. 280, datë 1.4.2015, të këshillit të ministrave, “për përcaktimin ekriterëve, procedurave edokumentacionit tëzbatueshëm për të kualifikuarndërtimet pa leje, shtesatanësore dhe/ose në lartësi, nëndërtime me leje”, pika 2, germa “ë” ku citohet: Ndërtimi informal i llojit “objekt”, i ngritur brenda vijës kufizuese të zonës informale të miratuar dhe i përfshirë në fushën e zbatimit të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, përjashtohet nga legalizimi në një nga rastet e mëposhtme:

“Është ngritur brenda zonave dhe/ose nënzonave të mbrojtura, shkalla e mbrojtjes të të cilave nuk lejon ndërtime, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 8906, datë 6.6.2002, “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij”.

Ligji nr. 8906, datë 06.06.2002 është shfuqizuar nga ligji nr. 81/2017, datë 04.05.2017 “Për zonat e mbrojtura”, në nenin 16 të cilit, “Parku kombëtar” (kategoria II), pika 2, germa “a” përcaktohet se:

Në “Parkun kombëtar” zbatohet shkalla e mbrojtjes mjedisore të zonës që ka si objektiv të mbajë territorin në gjendje natyrore, ku të ruhen komunitetet biotike, të resurseve gjenetike dhe llojeve për të siguruar stabilitetin ekologjik dhe diversitetin dhe ku:

a) përjashtohet njeriu nga shfrytëzimi ose zënia me aktivitete intensive

-Në nenin 33, të ligjit nr. 81/2017, datë 04.05.2017, “Veprimtaritë që lejohen pasi të jenë pajisur me miratim paraprak” citohet:

“Veprimtaritë që lejohen të ushtrohen në zonat e mbrojtura mjedisore pasi të jenë pajisur me miratimin paraprak të organit, brenda fushës së përgjegjësive shtetërore të të cilit është veprimtaria e mëposhtme:

- a) çdo veprimtari tjetër në përputhje me Planin e Menaxhimit;*
- b) monitorime të gjendjes mjedisore, të ekosistemit, të habitateve dhe të llojeve floristike e faunistike;*
- c) ndërhyrjet e nevojshme për rigjenerimin dhe shëndetësimin;*
- ç) struktura në përputhje me përcaktimet e Planit të Menaxhimit në shërbim të aktiviteteve turistike;*
- d) çdo veprimtari tjetër në përputhje me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit”**



-Sipas VKM nr. 640, datë 21.05.2018 “Për shpalljen “Park Kombëtar” të ekosistemit natyror Shebenik-Jabllanicë”, pika 4, germa “ç”, përcaktohet se:

Zonat e përdorimit tradicional, me sipërfaqe 12 420 ha, e shënuar në hartë me “ZPT”, është zonë ku mundësohet vazhdimi i veprimtarive, tradicionale dhe ekonomike, e ku mund të ushtrohen veprimtari të reja, vetëm me lejet mjedisore dhe, për rastet e trashëgimisë kulturore me leje të Ministrisë të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe të shërbimit arkeologjik. Zona përfshihen territoret bujqësore, ujore e pyjore, rreth qendrave të banuara, kryesisht të përdorura nga banorët. Në zonën e përdorimit tradicional zbatohet shkalla e katërt e mbrojtjes.

-Megjithëse në rastin e mësipërm nuk është prononcuar AKZM dhe nuk është vepruar nga ana e ALUIZNI-t Elbasan për të njoftuar pozicionimin e objektit, sipas vetë AKZM procesi i legalizimit nuk është në kompetencën e saj, për rrjedhojë do të merren për referencë dispozitat e akteve ligjore e nënligjore të trajtuara mësipër, të cilat bëjnë të domosdoshme pajisjen me lejet mjedisore dhe miratimin paraprak nga Këshilli Kombëtar i Territorit. Në kushtet kur kriteret të tilla nuk gjenden të dokumentuara në praktikën e lejes së legalizimit, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Elbasan duhet të kishte refuzuar lëshimin e lejes së legalizimit dhe duhet të kishte kryer s`kualifikimin e objektit.

-Sipas shkresës së ZVRPP Elbasan nr. 242/1, datë 27.08.2018, “Kthim përgjigje”, informacion për gjendjen juridike të pasurive, konstatohet se për pasuritë 44/7, 44/8, 566, 662, 521, nuk ka informacion në ZVRPP Elbasan.

-Proces-verbali i verifikimit në terren nuk ka datën e mbajtjes për rrjedhojë nuk mund të përcaktohet afati kohor proces-verbal verifikimi – vendim kualifikimi, në kundërshtim me vendimin e KM nr. 280, datë 1.4.2015 “ Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar, pika 8, ku përcaktohet se:

Drejtoritë e ALUIZNI-t, bazuar në gjendjen faktike në terren, kryejnë procedurat kualifikuese për ndërtimin informal, brenda 60 ditëve nga data e evidentimit faktik në terren (data e "Procesverbalit të evidentimit në terren"). Për kryerjen e këtyre procedurave drejtoritë mbështeten në cilësitë e territorit, të paraqitura grafikiisht.

Në dosje mungon:

-vërtetimi për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 27, germa “ç”, të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

-Proces-verbali i verifikimit në terren nuk është plotësuar me rubrikat për: datën e mbajtjes, sipërfaqet e parcelës ndërtimore, njolla e objektit, numri i kateve dhe destinacioni i sipërfaqeve. Përsa i përket pasurive kufitare (të saktësuara në përshkrim) nuk janë shënuar numrat e pasurive dhe distancat nga pasuritë kufitare.

Këto mungesa, vecanërisht mungesa e sipërfaqes së parcelës ndërtimore dhe distancave nga objektet kufitare e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale.

Sa sipër është në kundërshtim me rubrikat sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

Proces-Verbali i verifikimit në terren është nënshkruar nga specialistët e terrenit R B dhe A K e është miratuar nga Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë z. Sh P.

Me aktin e kualifikimit nr. 23629, datë 01.11.2018, objekti informal legalizohet, i nënshkruar nga z. A H, z. A B dhe Drejtori z. A G.



Proces-verbali i vlerësimit të dosjes së legalizimit është nënshkruar nga z. A H për Sektorin e Legalizimit dhe z. K D, Sektori i Përpunimit të të Dhënave.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A G, ish-Drejtor i ALUIZNI-t Elbasan, z. A B, ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, znj. A H, specialist, z. K D, Sektori i Përpunimit të të Dhënave, z. Sh P, ish-Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, z. R B, specialist terreni, znj. A K, specialist terreni.

DV e ASHK-së Elbasan, më shkresë nr.1065/56, datë 16.08.2019, ka “Relacion observues”, të nënshkruar nga të gjithë punonjësit e prekur në auditim.

Lidhur me problematikat e trajtuara më sipër, në relacion observohet se:

-Ligji i legalizimeve prevalon mbi të gjithë ligjet e tjera.

-Interpretimi i ligjit kryhet nga institucioni zbatues.

Sa sipër qëndron, megjithëse hierarkia e akteve ligjore është: Kushtetuta, Kodet, ligjet, aktet nënligjore. Ndërmjet ligjit dhe VKM nr. 280/2016, prevalencë ka ligji.

Interpretimi i ligjeve është tagër i Gjykatës Kushtetuese, ndërsa KLSH, sipas standarteve ndërkombëtare të auditimit jep mendim të pavarur.

DV e ASHK-së Elbasan, më shkresë nr.1065/56, datë 16.08.2019, ka “RELACION OBSERVES”, të nënshkruar nga të gjithë punonjësit e prekur në auditim, ku përse i përket legalizimeve në zonën e mbrojtur Shebenik-Jabllanicë, në thelb observimi qëndron në faktin se ARZM Elbasan ka dhënë konfirmimin për vazhdimin e procedurave të legalizimit, gjë që nuk qëndron.

AKZM dhe ARZM, kanë dhënë mendime mbi zonën ku janë kryer legalizimet, ZPT(zonë e përdorimit tradicional), ku sic citojnë edhe vetë observuesit, cdo veprimtari ndërtuese kërkon miratimin e Këshillit Kombëtar të Territorit.

Observacioni nuk qëndron.

Lidhur me konstatimet e grupit të KLSH, z. A H ka dërguar observacionin nr. 1065/62, datë 03.09.2019, ku ka paraqitur opsionin e tij se:

“Nuk ka kuptim të merret leje mjedisore sepse deklarimi është bërë para se të hynte në fuqi VKM nr. 640, datë 21.05.2008 dhe se se këtu bëhet fjalë për leje ndërtimi”

Lidhur me këtë observacion, rikujtojmë se sipas citimit të VKM nr. 640, datë 21.05.2008, në zonën në fjalë ZPT, zbatohet shkalla e katërt e mbrojtjes (pavarësisht konfirmimit të AKZM) dhe duhej të paraqitej leja mjedisore sipas vendimit të KM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar, pika 10, ku citohet:

“Për ndërtimet informale, të përcaktuara në kreun III, të këtij vendimi, të ngritura brenda zonave dhe nënzonave të mbrojtura, si dhe zonave të ruajtjes së veçantë, ku shkalla e mbrojtjes nuk ndalon ndërtimet me funksion banimi ose social/ekonomik, procedurat e kualifikimit kryhen pas depozitimit, nga poseduesi i ndërtimit, të aktit për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM), nga një ent apo subjekti i licencuar”

Observacioni nuk qëndron.

Lidhur me konstatimet e grupit të KLSH, z. K D, Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, ka dërguar observacionin nr. 1065/35, datë 13.08.2019, ku ka paraqitur pretendimin se:

“Nuk ka kuptim të merret leje mjedisore sepse këtu nuk bëhet fjalë për leje ndërtimi”

Lidhur me këtë observacion, rikujtojmë se sipas citimit të VKM nr. 640, datë 21.05.2008, në zonën në fjalë ZPT, zbatohet shkalla e katërt e mbrojtjes (pavarësisht konfirmimit të AKZM) dhe duhej të paraqitej leja mjedisore sipas vendimit të KM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar, pika 10, ku citohet:



“Për ndërtimet informale, të përcaktuara në kreun III, të këtij vendimi, të ngritura brenda zonave dhe nënzonave të mbrojtura, si dhe zonave të ruajtjes së veçantë, ku shkalla e mbrojtjes nuk ndalon ndërtimet me funksion banimi ose social/ekonomik, procedurat e kualifikimit kryhen pas depozitimit, nga poseduesi i ndërtimit, të aktit për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM), nga një ent apo subjekti i licencuar”

Observacioni nuk qëndron.

-Lejet e legalizimit sipas listës së paraqitur nga ASHK Elbasan, të lëshuara nga DR e ALUIZNI-t Elbasan, në zona pyjore, ose në zëra kadastrale të këtyre llojeve (shkëmb, TPF, etj.). Mangësi dokumentare, etj.

- Dosja nr. 2539, leje legalizimi nr. 2580387, datë 31.01.2019, për objektin: “Godinë Social-Ekonomike 1 Kat”, për A K M, me adresë Bashkia Elbasan, Gjinar, Zona Kadastrale 1742, nr. pasurisë 151/1/7, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 53.6 m², sipërfaqja e ndërtimit 20.4 m², sipërfaqja totale e ndërtimit:për banim -, për aktivitet 20.4 m², numri i kateve mbi tokë 1, nën tokë -, titulli i pronësisë: “Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1”. Drejtori A G, Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit A B (firmosur me porosi K D).

Dokumentacioni i dosjes së kësaj leje legalizimi është i pa plotësuar me inventarin përkatës të dokumentacionit dhe numrit të fletëve për cdo dokument, në kundërshtim me Ligjin Nr. 9154, date 06.11.2003, “Për Arkivat”.

Sa më sipër dhe sipas praktikës përkatëse, konstatohet se neni 30, pika 2/1, citon se:

*Përcaktimet e këtij neni zbatohen edhe në rastin kur subjekti apo njëri prej subjekteve që disponojnë ndërtimin **me funksion banimi** nuk shlyejnë detyrimet financiare të parashikuara në ligj për vlerën e parcelës ndërtimore të objektit pa leje. Në këtë rast, për pasurinë ose pjesën takuese të subjektit debitor, regjistrimi bëhet sipas shkronjës “a”, të nenit 54, “Regjistrimi i hipotekës ligjore”, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.*

Në dosje nuk rezulton të ketë dokument financiar për pagesën e parcelës ndërtimore, pra nuk është paguar vlera e parcelës ndërtimore, në një kohë që objekti është me funksion Social-Ekonomik dhe nuk duhej vendosur hipotekë ligjore si dhe nuk duhej lëshuar leja e legalizimit pa u paguar vlera e parcelës ndërtimore sipas vendimit të KM për këtë qëllim. Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1 dhe VKM nr. 1095, datë 28.12.2015 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet aluizni-t dhe zqrrp-së, dhe të procedurave apokufizimeve që zbatohen përfekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara”, Kreu III.

Nga auditimi konstatohet se sipas shkresës nr. 156/1, datë 23.01.2011 të ZVRPP Elbasan, pasuria në fjalë ndodhet brenda pasurisë mëmë nr. 151/1, “Pyll”, me status juridik “Shtet”.

Sa sipër, nga ana e ALUIZNI-t Elbasan, është miratuar leje legalizimi për godinë social-ekonomike në tokë “Pyll” dhe përveç kësaj është ndryshuar edhe zërin kadastral dhe regjimi i e tokës në “Truall”, në një kohë që kompetenca për ndryshimin e zërit kadastral nga “Pyll” në “Truall”, për pyjet dhe tokat me bimësi pyjore, me sipërfaqe deri një 1 ha i takon Ministrin të Mjedisit, vetëm në kushtet e një investimi afatgjatë për ndërtimin e strukturave turistike, etj.

Këto veprime janë një në kundërshtim, me nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, ku përcaktohet:

“Pjesë të fondit pyjor kombëtar, që kërkohen nga subjekte juridike ose fizike apo nga organet e qeverisjes vendore, për t’u kthyer në truall, për zgjerimin e vijës kufizuese të ndërtimit dhe të shtrirjes territoriale të periferisë së qytetit e të qendrave të banuara në zonat rurale, për ndërtimin e strukturave turistike, të qendrave të pushimit apo ato shëndetësore ose për qëllime të tjera publike, për rrugë automobilistike apo hekurudhore, për shpim dhe shfrytëzim të puseve të



naftës e të gazit, për veprimtari minerare e gjeologjike, për aeroporte dhe struktura të telekomunikacionit, për qëllime të strukturave ushtarake, qendra industriale, hiqen nga fondi pyjor dhe nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve, si më poshtë:

a) pyjet dhe tokat me bimësi pyjore, me sipërfaqe deri në 1 ha, me miratimin e ministrit”

Siç shihet sa më sipër, legalizimi i objektit informal “Godinë Social-Ekonomike I Kat” dhe ndryshimi i destinacionit të 53.6 m² sipërfaqe të zërit kadstral “Pyll” në “Truall”, është i paligjshëm, pasi **nuk përfshihet në asnjërën nga veprimtaritë e përmendura** më sipër dhe nuk ka kërkesë për heqjen nga fondi pyjor apo urdhër Ministri që të ketë bërë miratim për këtë ndryshim destinacioni.

Regjistri i Parcelës Ndërtimore është përgatitur nga Përgjegjësi i Sektorit të Çështjeve të Pronësisë znj. M S dhe konfirmuar nga Drejtori z. A G.

-Proces-verbali i verifikimit në terren mban datën 07.07.2017 ndërkohë që vendimi për kualifikim është më datën 30.01.2019, pra pas 1 viti e gjysëm, në kundërshtim me vendimin e KM nr. 280, datë 1.4.2015 “ Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar, pika 8, ku përcaktohet se:

Drejtoritë e ALUIZNI-t, bazuar në gjendjen faktike në terren, kryejnë procedurat kualifikuese për ndërtimin informal, brenda 60 ditëve nga data e evidentimit faktik në terren (data e "Procesverbalit të evidentimit në terren"). Për kryerjen e këtyre procedurave drejtoritë mbështeten në cilësitë e territorit, të paraqitura grafiksht.

-Në proces-verbalin e verifikimit në terren datë 07.07.2017, nuk janë plotësuar rubrikat me sipërfaqet e parcelës ndërtimore, njollës së objektit, sipërfaqet për banim dhe aktivitet. Përsa i përket pasurive kufitare (të saktësuara në përshkrim) nuk janë shënuar distancat nga pasuritë kufitare, numrat e pasurive.

Këto mungesa, vecanërisht mungesa e sipërfaqes së parcelës ndërtimore dhe distancave nga objektet kufitare e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale.

Sa sipër është në kundërshtim me rubrikat sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

Proces-Verbali i verifikimit në terren është nënshkruar nga specialistët e terrenit V Sh dhe S. Q dhe nuk është nënshkruar nga Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë z. Sh P.

Me aktin e kualifikimit nr. 24368, datë 30.01.2019, objekti informal legalizohet, i nënshkruar nga z. A H, Sektori i Çështjeve të Pronësisë, Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit z. A B dhe Drejtori A G

Punuar praktika ngaz. A G, ish-Drejtor i ALUIZNI-t Elbasan, z. A B, ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. K D, Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. A H, specialist në Sektorin e Kalimit të Pronësisë, znj.M S, Sektori i Çështjeve të Pronësisë.

z. A H me shkresë nr. 1065/62, datë 03.09.2019, ka observuar se:

“Përgjegjësia ime qëndron në plotësimet dhe verifikimet, shkresë konfirmuese nr. 03, datë 07.01.2019”. Theksojmë së për sa më lart përgjegjësia mbetet. Shkresa nr. 03, datë 07.01.2019, nuk u gjet në dosje. Observacioni nuk qëndron.

Z.A G, me shkresë nr. 1065/66, datë 04.09.2019, ka paraqitur observacionin me pretendimin se ka shkresë konfirmuese nr. 03, datë 07.01.2019, por kjo shkresë nuk disponohet. Përveç sa më sipër pretendohet se nuk është shkelur VKM nr. 280/2016.



Z. A H me shkresë nr. 1065/35, datë 03.08.2019, ka paraqitur se nuk mban përgjegjësi sepse ka nënshkruar vetëm lejen e legalizimit. Observimi nuk qëndron sepse mjafton firma në leje për përgjegjësim.

- **Dosja nr. 21220, leje legalizimi nr. 2580609, datë 09.04.2019**, për objektin: “Godinë Social-Ekonomike 2 Kate”, për B D Xh, me adresë Bashkia Librazhd, Dorëz, Zona Kadastrale 1715, nr.pasurisë 245/2/2, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 297.5 m², sipërfaqja e ndërtimit 168 m², sipërfaqja totale e ndërtimit: për banim -, për aktivitet 414.5 m², numri i kateve mbi toke 2, nën tokë -, titulli i pronësisë: “Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1”. Drejtori A G, Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit K D.

Sa më sipër dhe sipas praktikës përkatëse, konstatohet se neni 30, pika 2/1, citon se:

*Përcaktimet e këtij neni zbatohen edhe në rastin kur subjekti apo njëri prej subjekteve që disponojnë ndërtimin **me funksion banimi** nuk shlyejnë detyrimet financiare të parashikuara në ligj për vlerën e parcelës ndërtimore të objektit pa leje. Në këtë rast, për pasurinë ose pjesën takuese të subjektit debitor, regjistrimi bëhet sipas shkronjës “a”, të nenit 54, “Regjistrimi i hipotekës ligjore”, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.*

Në dosje nuk rezulton të ketë dokument financiar për pagesën e parcelës ndërtimore, pra nuk është paguar vlera e parcelës ndërtimore, në një kohë që objekti është me funksion Social-Ekonomik dhe nuk duhej vendosur hipotekë ligjore si dhe nuk duhej lëshuar leja e legalizimit pa u paguar vlera e parcelës ndërtimore sipas vendimit të KM për këtë qëllim. Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1 dhe VKM nr. 1095, datë 28.12.2015 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet aluizni-t dhe zqrrp-së, dhe të procedurave apokufizimeve që zbatohen përfekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara”, Kreu III.

Nga auditimi konstatohet se sipas shkresës nr. 288/1, datë 24.09.2018 të ZVRPP Elbasan, pasuria në fjalë ndodhet brenda pasurisë mëmë nr. 245/2, “**Shkëmb**”, me status juridik “Shtet”, regjistruar në vol.7, faqe 220, sipërfaqe 433900 m².

Sa sipër, nga ana e ALUIZNI-t Elbasan, është miratuar leje legalizimi për godinë social-ekonomike në tokë “Shkëmb” dhe përveç kësaj është ndryshuar edhe zërin kadastral dhe regjimi i e tokës në “Truall”, në një kohë që kompetenca për ndryshimin e zërit kadastral nga “Shkëmb” në “Truall”, për pyjet dhe tokat me bimësi pyjore, me sipërfaqe deri një 1 ha i takon Ministrin të Mjedisit, vetëm në kushtet e një investimi afatgjatë për ndërtimin e strukturave turistike, etj.

Këto veprime janë një në kundërshtim, me nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, ku përcaktohet:

“Pjesë të fondit pyjor kombëtar, që kërkohen nga subjekte juridike ose fizike apo nga organet e qeverisjes vendore, për t’u kthyer në truall, për zgjerimin e vijës kufizuese të ndërtimit dhe të shtrirjes territoriale të periferisë së qytetit e të qendrave të banuara në zonat rurale, për ndërtimin e strukturave turistike, të qendrave të pushimit apo ato shëndetësore ose për qëllime të tjera publike, për rrugë automobilistike apo hekurudhore, për shpim dhe shfrytëzim të puseve të naftës e të gazit, për veprimtari minerare e gjeologjike, për aeroporte dhe struktura të telekomunikacionit, për qëllime të strukturave ushtarake, qendra industriale, hiqen nga fondi pyjor dhe nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve, si më poshtë:

a) pyjet dhe tokat me bimësi pyjore, me sipërfaqe deri në 1 ha, me miratimin e ministrit”

Në nenin 14, “Përbërja e fondit pyjor kombëtar”, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, përcaktohet:



Fondi pyjor kombëtar përbëhet nga këto formacione bimore e jobimore:

- a) pyjet dhe drurët pyjorë;
- b) shkurret;
- c) sipërfaqet e zëna nga brezat pyjorë mbrojtës, grupet e veçuara të drurëve;
- ç) bimësia barishtore, mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore;
- d) tokat pyjore, bujqësore (të dhëna në përdorim ose në pronësi të organeve të shërbimit pyjor), liqenet natyrore, tokat e lagëta dhe lagunat (për mbarështimin dhe zhvillimin e faunës së egër, pasuri kombëtare, dhe që krijojnë një mjedis ekologjik të harmonizuar me fondin pyjor);
- dh)** sipërfaqet e zhveshura si çeltirat, **shkëmbinjtë**, dunat e ranishtet, që ndodhen në sipërfaqen pyjore dhe pranë tyre (jo më larg se 500 m), por që krijojnë një mjedis ekologjik të harmonizuar me të;
- e) infrastruktura rrugore e komunikimit me të gjitha elementet bashkëshoqëruese, pritat e pendat, lerat, koritat, çezmat, rrethimet apo gardhimet në zonat e mbrojtura, në pyjet me funksion të veçantë, në rezervatet e gjuetisë, si dhe lehtësitë e krijuara e të ngritura për personelin e shërbimit pyjor dhe për pritjen e vizitorëve në to;
- ë) ndërtesat, zyrat, magazinat, depot, stacionet pyjore, qendrat e informimit dhe të pritjes së vizitorëve, ujësjellësat, linjat elektrike e telefonike (të ndërtuara nga shërbimi pyjor apo të dhëna në pronësi të tyre), makinat, tabelat, shenjat e ndryshme treguese e sinjalizuese dhe ato të mbarështimit pyjor.

Siç shihet sa më sipër, legalizimi i objektit informal “Godinë Social-Ekonomike 2 Kat” dhe ndryshimi i destinacionit të 297.5 m² sipërfaqe të zërit kadastral “Shkëmb” në “Truall”, është i paligjshëm, pasi **nuk përfshihet në asnjërën nga veprimtaritë e përmendura** më sipër dhe nuk ka kërkesë për heqjen nga fondi pyjor apo urdhër Ministri që të ketë bërë miratim për këtë ndryshim destinacioni.

Gen-Plani është nënshkruar nga Përgjegjësi i Sektorit të Çështjeve të Pronësisë znj. M S, specialisti z. B B dhe konfirmuar nga Drejtori z. A G.

Me aktin e kualifikimit nr. 24503, datë 18.02.2019, objekti informal legalizohet, i nënshkruar nga z. A H, Sektori i Çështjeve të Pronësisë, Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit z. K D Përgjegjës i Sektorit të legalizimit dhe Drejtori A G.

Proces-Verbali i vlerësimit të dosjes për legalizim është nënshkruar nga z. G G, Sektori i Përpunimit të të Dhënave.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. K D, Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. A H, specialist në Sektorin e Kalimit të Pronësisë, znj. M S, Përgjegjës i Sektorit të Çështjeve të Pronësisë, z. B B, specialist i Sektorit të Çështjeve të Pronësisë, z. Gj G, Sektori i Përpunimit të të Dhënave, miratuar nga z. A G, ish-Drejtor i ALUIZNI-t Elbasan.

Z. A H në këtë rast i është referuar VKM nr. 640, datë 21.05.2008, kur në fakt bëhet fjalë për zërin kadastral “Shkëmb” dhe ligjit për Pyjet. Observacioni nuk qëndron.

Z. A G, me shkresë nr. 1065/66, datë 04.09.2019, ka paraqitur observacionin me pretendimin se kanë zbatuar procedurat ligjore, por në këtë rast ligji për pyjet ka prevalencë mbi VKM nr. 280/2016.

Znj. K D, sipas observimit nr. 1065/35, datë 13.08.2019, ka ngritur pretendimin se nuk mban përgjegjësi për ndryshimin e zërit kadastral nga “Shkëmb” në “Truall” dhe ligjit për Pyjet, etj. Observacioni nuk qëndron, me përjashtim të problematikave të hartografisë.

- Dosja nr. 5756, leje legalizimi nr. 74854213, datë 28.06.2018, për objektin: “Godinë Shërbimi 1 Kat”, për O I D, me adresë Bashkia Librazhd, Dorëz, Zona Kadastrale 1745, nr.pasurisë 245/1, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 81.4 m², sipërfaqja e ndërtimit 81.4 m², sipërfaqja totale e



ndërtimit: për banim -, për aktivitet 81.4 m², numri i kateve mbi tokë 1, nën tokë -, titulli i pronësisë: “Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1”. Drejtori A G, Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit A B.

Sa më sipër dhe sipas praktikës përkatëse, konstatohet se neni 30, pika 2/1, citon se:

*Përcaktimet e këtij neni zbatohen edhe në rastin kur subjekti apo njëri prej subjekteve që disponojnë ndërtimin **me funksion banimi** nuk shlyejnë detyrimet financiare të parashikuara në ligj për vlerën e parcelës ndërtimore të objektit pa leje. Në këtë rast, për pasurinë ose pjesën takuese të subjektit debitor, regjistrimi bëhet sipas shkronjës “a”, të nenit 54, “Regjistrimi i hipotekës ligjore”, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.*

Në dosje nuk rezulton të ketë dokument financiar për pagesën e parcelës ndërtimore, pra nuk është paguar vlera e parcelës ndërtimore, në një kohë që objekti është me funksion Social-Ekonomik dhe nuk duhej vendosur hipotekë ligjore si dhe nuk duhej lëshuar leja e legalizimit pa u paguar vlera e parcelës ndërtimore sipas vendimit të KM për këtë qëllim. Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1 dhe VKM nr. 1095, datë 28.12.2015 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet aluizni-t dhe zqrrp-së, dhe të procedurave apokufizimeve që zbatohen përfekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara”, Kreu III.

Nga auditimi konstatohet se sipas shkresës nr. 167/1, datë 11.06.2018 të ZVRPP Elbasan, pasuria në fjalë ndodhet brenda pasurisë mëmë nr. 245/2, “Shkëmb”, me status juridik “Shtet”, regjistruar me sipërfaqe 433900 m².

Sa sipër, nga ana e ALUIZNI-t Elbasan, është miratuar leje legalizimi për godinë social-ekonomike (shërbimi) në tokë “Shkëmb” dhe përveç kësaj është ndryshuar edhe zërin kadastral dhe regjimi i e tokës në “Truall”, në një kohë që kompetenca për ndryshimin e zërit kadastral nga “Shkëmb” në “Truall”, për pyjet dhe tokat me bimësi pyjore, me sipërfaqe deri një 1 ha i takon Ministrin të Mjedisit, vetëm në kushtet e një investimi afatgjatë për ndërtimin e strukturave turistike, etj.

Këto veprime janë një në kundërshtim, me nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, ku përcaktohet:

“Pjesë të fondit pyjor kombëtar, që kërkohen nga subjekte juridike ose fizike apo nga organet e qeverisjes vendore, për t’u kthyer në truall, për zgjerimin e vijës kufizuese të ndërtimit dhe të shtrirjes territoriale të periferisë së qytetit e të qendrave të banuara në zonat rurale, për ndërtimin e strukturave turistike, të qendrave të pushimit apo ato shëndetësore ose për qëllime të tjera publike, për rrugë automobilistike apo hekurudhore, për shpim dhe shfrytëzim të puseve të naftës e të gazit, për veprimtari minerare e gjeologjike, për aeroporte dhe struktura të telekomunikacionit, për qëllime të strukturave ushtarake, qendra industriale, hiqen nga fondi pyjor dhe nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve, si më poshtë:

a) pyjet dhe tokat me bimësi pyjore, me sipërfaqe deri në 1 ha, me miratimin e ministrit”

Në nenin 14, “Përbërja e fondit pyjor kombëtar”, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, përcaktohet:

Fondi pyjor kombëtar përbëhet nga këto formacione bimore e jobimore:

a) pyjet dhe drurët pyjorë;

b) shkurret;

c) sipërfaqet e zëna nga brezat pyjorë mbrojtës, grupet e veçuara të drurëve;

ç) bimësia barishtore, mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore;



d) tokat pyjore, bujqësore (të dhëna në përdorim ose në pronësi të organeve të shërbimit pyjor), liqenet natyrore, tokat e lagëta dhe lagunat (për mbarështimin dhe zhvillimin e faunës së egër, pasuri kombëtare, dhe që krijojnë një mjedis ekologjik të harmonizuar me fondin pyjor);

*dh) sipërfaqet e zhveshura si çeltirat, **shkëmbinjë**, dunat e ranishtet, që ndodhen në sipërfaqen pyjore dhe pranë tyre (jo më larg se 500 m), por që krijojnë një mjedis ekologjik të harmonizuar me të;*

e) infrastruktura rrugore e komunikimit me të gjitha elementet bashkëshoqëruese, pritat e pendat, lerat, koritat, çezmat, rrethimet apo gardhimet në zonat e mbrojtura, në pyjet me funksion të veçantë, në rezervatet e gjuetisë, si dhe lehtësitë e krijuara e të ngritura për personelin e shërbimit pyjor dhe për pritjen e vizitorëve në to;

ë) ndërtesat, zyrat, magazinat, depot, stacionet pyjore, qendrat e informimit dhe të pritjes së vizitorëve, ujësjellësat, linjat elektrike e telefonike (të ndërtuara nga shërbimi pyjor apo të dhëna në pronësi të tyre), makinat, tabelat, shenjat e ndryshme treguese e sinjalizuese dhe ato të mbarështimit pyjor.

Siç shihet sa më sipër, legalizimi i objektit informal “Godinë Social-Ekonomike (Shërbimi) 1 Kat” dhe ndryshimi i destinacionit të 81.4 m² sipërfaqe të zërit kadastral “Shkëmb” në “Truall”, është i paligjshëm, pasi **nuk përfshihet në asnjërën nga veprimtaritë e përmendura** më sipër dhe nuk ka kërkesë për heqjen nga fondi pyjor apo urdhër Ministri që të ketë bërë miratim për këtë ndryshim destinacioni.

Regjistri i Parcelës Ndërtimore është nënshkruar nga Përgjegjësi i Sektorit të Çështjeve të Pronësisë znj. M S dhe konfirmuar nga Drejtori z. A G.

-Proces-verbali i verifikimit në terren nuk ka datë, pra nuk mund të përcaktohet afati kohor proces-verbal verifikimi – vendim kualifikimi, në kundërshtim me vendimin e KM nr. 280, datë 1.4.2015 “ Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar, pika 8, ku përcaktohet se:

Drejtoritë e ALUIZNI-t, bazuar në gjendjen faktike në terren, kryejnë procedurat kualifikuese për ndërtimin informal, brenda 60 ditëve nga data e evidentimit faktik në terren (data e "Procesverbalit të evidentimit në terren"). Për kryerjen e këtyre procedurave drejtoritë mbështeten në cilësitë e territorit, të paraqitura grafikisht.

-Vendimi për kualifikim është marrë më datë 06.09.2017, ndërsa leja e legalizimit është lëshuar më datë 28.06.2018 pra pas 9 muajsh, në kundërshtim me Urdhrin nr. 37, datë 19.01.2016 “Për miratimin e planveprimit për shqyrtimin administrativ të praktikave të legalizimit të ndërtimeve pa leje”, pika 6- Miratimi i lejes së legalizimit përpara kalimit të pronësisë, germa “a”, ku citohet:

Plotësimi dhe miratimi (nënshkrimi+ vulosje) i lejes së legalizimit bëhet brenda 30 ditëve nga data e Vendimit të Kualifikimit.

Në dosje mungon:

-vërtetimi për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 27, germa “ç”, të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

-Në proces-verbalin e verifikimit në terren, nuk janë plotësuar rubrikat për: datën e mbajtjes, sipërfaqet e parcelës ndërtimore, njollës së objektit, numrit të kateve, sipërfaqet për banim dhe aktivitet. Përsa i përket pasurive kufitare (të saktësuara në përshkrim) nuk janë shënuar distancat nga pasuritë kufitare, numrin e pasurisë.

Këto mungesa, vecanërisht mungesa e sipërfaqes së parcelës ndërtimore dhe mungesa e distancave nga objektet kufitare e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument



formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale.

Sa sipër është në kundërshtim me rubrikat sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

Proces-Verbali i verifikimit në terren është nënshkruar nga specialistët e terrenit E B dhe O H dhe Përgjegjësi i Sektorit të hartografisë z. Sh P.

Proces-Verbali i vlerësimit të dosjes për legalizim është nënshkruar për Sektorin e Legalizimit nga znj. E T, znj. E Ç, për sektorin e Përpunimit të të Dhënave z. E T.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A G, ish-Drejtor i ALUIZNI-t Elbasan, z. A B, Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, znj. M S, Përgjegjësi i Sektorit të Çështjeve të Pronësisë, z. V H, specialist, z. Shp i, Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, z. E B, specialist terreni, z. O H, specialist terreni.

z. A G, ish-Drejtor, me shkresë nr. 1065/66, datë 04.09.2019, ka paraqitur observacionin me pretendimin se kanë zbatuar procedurat ligjore, por në këtë rast ligji për pyjet ka prevalencë mbi VKM nr.280/2016.

- Dosja nr. 2539, leje legalizimi nr. 2580387, datë 31.01.2019, për objektin: “Godinë Social-Ekonomike 1 Kat”, për A K M, me adresë Bashkia Elbasan, Gjinar, Zona Kadastrale 1742, nr. pasurisë 151/1/7, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 53.6 m², sipërfaqja e ndërtimit 20.4 m², sipërfaqja totale e ndërtimit: për banim -, për aktivitet 20.4 m², numri i kateve mbi tokë 1, nën tokë -, titulli i pronësisë: “Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1”. *Drejtori A G, Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit A B (firmosur me porosi K D).*

Dokumentacioni i dosjes së kësaj leje legalizimi është i pa plotësuar me inventarin përkatës të dokumentacionit dhe numrit të fletëve për cdo dokument, në kundërshtim me Ligjin Nr. 9154, date 06.11.2003, “Për Arkivat”.

Sa më sipër dhe sipas praktikës përkatëse, konstatohet se neni 30, pika 2/1, citon se:

Përcaktimet e këtij neni zbatohen edhe në rastin kur subjekti apo njëri prej subjekteve që disponojnë ndërtimin me funksion banimi nuk shlyejnë detyrimet financiare të parashikuara në ligj për vlerën e parcelës ndërtimore të objektit pa leje. Në këtë rast, për pasurinë ose pjesën takuese të subjektit debitor, regjistrimi bëhet sipas shkronjës “a”, të nenit 54, “Regjistrimi i hipotekës ligjore”, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.

Në dosje nuk rezulton të ketë dokument financiar për pagesën e parcelës ndërtimore, pra nuk është paguar vlera e parcelës ndërtimore, në një kohë që objekti është me funksion Social-Ekonomik dhe nuk duhej vendosur hipotekë ligjore si dhe nuk duhej lëshuar leja e legalizimit pa u paguar vlera e parcelës ndërtimore sipas vendimit të KM për këtë qëllim. Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1 dhe VKM nr. 1095, datë 28.12.2015 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet aluizni-t dhe zqrrp-së, dhe të procedurave apokufizimeve që zbatohen përfekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara”, Kreu III.

Nga auditimi konstatohet se sipas shkresës nr. 156/1, datë 23.01.2011 të ZVRPP Elbasan, pasuria në fjalë ndodhet brenda pasurisë mëmë nr. 151/1, “Pyll”, me status juridik “Shtet”.

Sa sipër, nga ana e ALUIZNI-t Elbasan, është miratuar leje legalizimi për godinë social-ekonomike në tokë “Pyll” dhe përveç kësaj është ndryshuar edhe zërin kadastral dhe regjimi i e tokës në “Truall”, në një kohë që kompetenca për ndryshimin e zërit kadastral nga “Pyll” në “Truall”, për pyjet dhe tokat me bimësi pyjore, me sipërfaqe deri një 1 ha i takon Ministrisë të Mjedisit, vetëm në kushtet e një investimi afatgjatë për ndërtimin e strukturave turistike, etj.

Këto veprime janë një në kundërshtim, me nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, ku përcaktohet:



“Pjesë të fondit pyjor kombëtar, që kërkohen nga subjekte juridike ose fizike apo nga organet e qeverisjes vendore, për t’u kthyer në truall, për zgjerimin e vijës kufizuese të ndërtimit dhe të shtrirjes territoriale të periferisë së qytetit e të qendrave të banuara në zonat rurale, për ndërtimin e strukturave turistike, të qendrave të pushimit apo ato shëndetësore ose për qëllime të tjera publike, për rrugë automobilistike apo hekurudhore, për shpim dhe shfrytëzim të puseve të naftës e të gazit, për veprimtari minerare e gjeologjike, për aeroporte dhe struktura të telekomunikacionit, për qëllime të strukturave ushtarake, qendra industriale, hiqen nga fondi pyjor dhe nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve, si më poshtë:

a) pyjet dhe tokat me bimësi pyjore, me sipërfaqe deri në 1 ha, me miratimin e ministrit”

Siç shihet sa më sipër, legalizimi i objektit informal “Godinë Social-Ekonomike 1 Kat” dhe ndryshimi i destinacionit të 53.6 m² sipërfaqe të zërit kadstral “Pyll” në “Truall”, është i paligjshëm, pasi **nuk përfshihet në asnjërën nga veprimtaritë e përmendura** më sipër dhe nuk ka kërkesë për heqjen nga fondi pyjor apo urdhër Ministri që të ketë bërë miratim për këtë ndryshim destinacioni.

Regjistri i Parcelës Ndërtimore është përgatitur nga Përgjegjësi i Sektorit të Çështjeve të Pronësisë znj. M S dhe konfirmuar nga Drejtori z. A G.

-Proces-verbali i verifikimit në terren mban datën 07.07.2017 ndërkohë që vendimi për kualifikim është më datën 30.01.2019, pra pas 1 viti e gjysëm, në kundërshtim me vendimin e KM nr. 280, datë 1.4.2015 “ Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar, pika 8, ku përcaktohet se:

Drejtoritë e ALUIZNI-t, bazuar në gjendjen faktike në terren, kryejnë procedurat kualifikuese për ndërtimin informal, brenda 60 ditëve nga data e evidentimit faktik në terren (data e "Procesverbalit të evidentimit në terren"). Për kryerjen e këtyre procedurave drejtoritë mbështeten në cilësitë e territorit, të paraqitura grafiksht.

-Në proces-verbalin e verifikimit në terren datë 07.07.2017, nuk janë plotësuar rubrikat me sipërfaqet e parcelës ndërtimore, njollës së objektit, sipërfaqet për banim dhe aktivitet. Përsa i përket pasurive kufitare (të saktësuara në përshkrim) nuk janë shënuar distancat nga pasuritë kufitare, numrat e pasurive.

Këto mungesa, vecanërisht mungesa e sipërfaqes së parcelës ndërtimore dhe distancave nga objektet kufitare e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale.

Sa sipër është në kundërshtim me rubrikat sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

Proces-Verbali i verifikimit në terren është nënshkruar nga specialistët e terrenit VSh dhe S. Q dhe nuk është nënshkruar nga Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë z. Sh P.

Me aktin e kualifikimit nr. 24368, datë 30.01.2019, objekti informal legalizohet, i nënshkruar nga z. A H, Sektori i Çështjeve të Pronësisë, Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit z. A B dhe Drejtori A G

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A B, ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. K D, Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. A H, specialist në Sektorin e Kalimit të Pronësisë, znj. M S, Sektori i Çështjeve të Pronësisë, z. Sh P, ish-Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, z. V Sh, specialist terreni, z. S Q, specialist terreni, miratuar nga z. A G, me detyrë ish-Drejtor i ALUIZNI-t Elbasan.



- Lejet e legalizimit sipas listës së paraqitur nga ASHK Elbasan, të lëshuara nga DR e ALUIZNI-t Elbasan, në brendësi të territorit të institucioneve publike. Mangësi dokumentare, etj.

- **Dosja nr. 5372, leje legalizimi nr. 2579709, datë 31.07.2018**, për objektin: “Godinë Social-Ekonomike 2 kat”, për A A K, me adresë Bashkia Elbasan, Lagjia “Haxhias”, Zona Kadastrale 8525, nr.pasurisë 7/123/1, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 14.9+64.5 m², sipërfaqja e ndërtimit 79.4 m², sipërfaqja totale e ndërtimit: për banim - m², për aktivitet 79.4, numri i kateve mbi tokë 1, nën tokë -, titulli i pronësisë: Regj. Me certifikat pronësie +ligji 9482, datë 03.04.2006, neni 30, pika 2/1.

Dokumentacioni i dosjes së kësaj leje legalizimi është i pa plotësuar me inventarin përkatës të dokumentacionit dhe numrit të fletëve për cdo dokument, në kundërshtim me Ligjin Nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”.

Sa më sipër dhe sipas praktikës përkatëse, konstatohet se neni 30, pika 2/1, citon se:

*Përcaktimet e këtij neni zbatohen edhe në rastin kur subjekti apo njëri prej subjekteve që disponojnë ndërtimin **me funksion banimi** nuk shlyejnë detyrimet financiare të parashikuara në ligj për vlerën e parcelës ndërtimore të objektit pa leje. Në këtë rast, për pasurinë ose pjesën takuese të subjektit debitor, regjistrimi bëhet sipas shkronjës “a”, të nenit 54, “Regjistrimi i hipotekës ligjore”, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.*

Në dosje nuk rezulton të ketë dokument financiar për pagesën e parcelës ndërtimore, pra nuk është paguar vlera e parcelës ndërtimore, në një kohë që objekti është me funksion Social-Ekonomik dhe nuk duhej vendosur hipotekë ligjore si dhe nuk duhej lëshuar leja e legalizimit pa u paguar vlera e parcelës ndërtimore sipas vendimit të KM për këtë qëllim. Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1 dhe VKM nr. 1095, datë 28.12.2015 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet aluizni-t dhe zqrrp-së, dhe të procedurave apokufizimeve që zbatohen përfekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara”, Kreu III.

Nga auditimi dhe konsultimi me hartat dixhitale që na u vubë në dispozicion nga DSHK Elbasan, konkretisht hartë me emërtimin: “LEJE 2018-2019 TOTALE.dëg”, konstatohet se objekti social ekonomik me sipërfaqe ndërtimi dhe parcele prej 79.4 m² ndodhet pjesërisht për sipërfaqen 39 m², brenda vijës kufizuese të Spitalit “Baki Kongoli”, duke vepruar në kundërshtim me vendimin e KM nr. 280, datë 1.4.2015 “ Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar me vendimin e KM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dheshtesa në vendimin nr. 280, datë 1.4.2015, të këshillit të ministrave, ...”, pika 2, germa “c”, ku citohet se:

“Ndërtimi informal i llojit “objekt”, i ngritur brenda vijës kufizuese të zonës informale të miratuar dhe i përfshirë në fushën e zbatimit të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, përjashtohet nga legalizimi në një nga rastet e mëposhtme:

Është ngritur brenda “territorit të institucioneve publike”, sipas neneve 39 dhe 42, pika 2, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me përjashtim të rasteve kur është ndërtuar nga vetë këto institucione. Në kuptim të këtyre neneve, “territori i institucionit publik” është sipërfaqja e truallit funksional të ndërtesës publike apo që rezulton të jetë pjesë e inventarit për këtë ndërtesë, si: godinat e institucioneve shtetërore, të shkollave e kopshteve publike, spitaleve, qendrave shëndetësore, kampuseve studentore e të tjera të ngjashme”

Regjistri i Parcelës Ndërtimore është përgatitur nga Përgjegjësi i Sektorit të Çështjeve të Pronësisë znj. M S dhe konfirmuar nga Drejtori z. A G.



Përsa më sipër Drejtoria e ALUIZNIT Elbasan duhej të kishte proceduar me refuzimin e kërkesës, mos lëshimin e lejes së legalizimit dhe duhej të kishte kryer skualifikimin e objektit.

Përsa i përket certifikatës së pronësisë të evidentuar në lejen e lejen e legalizimit, në dosje nuk ndodhet asnjë dokument pronësie nga ZVRPP Elbasan për të vërtetuar këtë pronësi.

Në proces-verbalin e verifikimit nuk janë plotësuar rubrikat me distancat nga pasuritë kufitare (të saktësuara në përshkrim), numrat e pasurive dhe gjithashtu rubrikat për sipërfaqen e parcelës ndërtimore, njollës së objektit, destinacionit të sipërfaqeve, kateve mbi e nën tokë.

Këto mungesa, vecanërisht mungesa e sipërfaqes së parcelës ndërtimore dhe distancës nga pasuritë kufitare e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale.

Sa sipër është në kundërshtim me rubrikat sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

Proces-Verbali i verifikimit në terren është nënshkruar nga specialistët e terrenit Th D, A B dhe Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë z. Sh P.

Me aktin e kualifikimit nr. 22945, datë 16.07.2018, objekti informal legalizohet, i nënshkruar nga znj. A B, Sektori i Çështjeve të Pronësisë, ish-Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit z. A B, Përgjegjës i Sektorit të legalizimit dhe Drejtori z.A G.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A B, Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, znj. M S, Përgjegjëse e Sektorit të Pronësisë, znj. A B, Sektori i Çështjeve të Pronësisë, z. Sh P, ish-Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë, z. D A, specialist terreni, z. Sh C, specialist terreni, miratuar nga z. A G, me detyrë ish-Drejtor i ALUIZNI-t Elbasan.

Znj.A B, ish-specialiste e legalizimit (sot në hartografi), paraqet observacionin nr.1065/59, datë 04.09.2019, me pretendimin se: “Nuk kam përgjegjësi për të gjitha çështjet dhe për mbivendosjen me oborrin e spitalit kemi kërkuar konfirmim nga ZVRPP”

Kundërgargumenti i grupit të auditimit: Cdo firme përmban në vetvete përgjegjësinë për nënshkruesin. Lidhur me 39 m2 mbivendosje me Spitalin “Xhaferr Kongoli” del qartë nga harta dixhitale që na u vu në dispozicion. Sic dihet institucionet shtetërore në një pjesë ta madhe nuk i kanë regjistruar pasuritë e tyre në ZVRPP

Observacioni nuk qëndron

Z.A G, ish-Drejtor, me shkresë nr. 1065/66, datë 04.09.2019, ka paraqitur observacionin me pretendimin se “objekti ndodhet jashtë konturit të vijës kufizuese”, gjë që nuk qëndron nga harta dixhitale që na u vu në dispozicion.

Z. A H me shkresë nr. 1065/62, datë 03.09.2019, ka observuar se:

“Përgjegjësia ime qëndron në plotësimet dhe verifikimet, dhe në dosje prezumohet pozitiv qëndrimi i Bordit pasi kalojnë afatet sipas procedurave administrative”

Theksojmë së për sa më lart përgjegjësia mbetet. Nuk duhej bazuar vetëm në qëndrimin e bordit por edhe në verifikimin në vend dhe në hartat e disponuara në DR të ALUIZNI-t Elbasan, etj.

Observacioni nuk qëndron.

Lidhur me observimin për legalizimin brenda territorit të parkut “Rinia”, nga punonjësit e ASHK-së Elbasan janë paraqitur argumente për vendosjen e objektit jashtë vijës kufizuese të Parkut Rinia, argumente të cilat qëndrojnë dhe reflektohen në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- Dosja nr. 1847, leje legalizimi nr. 2579037, datë 21.09.2018, për objektin: “Shtëpi banimi 2 kat”, për H M H, me adresë Bashkia Elbasan, Lagjia “Emin Matraxhiu”, Zona Kadastrale 8527, nr.pasurisë 307/17, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 168.4 m², sipërfaqja e ndërtimit 94.2 m²,



sipërfaqja totale e ndërtimit: për banim 175.6 m², për aktivitet -, numri i kateve mbi tokë 2, nën tokë -, titulli i pronësisë: “Sipas VKM-së nr. 100, datë 27.01.2009”.

Nga auditimi dhe konsultimi me hartat dixhitale që na u vubë në dispozicion nga DSHK Elbasan, konkretisht harta me emërtimin: “LEJE 2018-2019 TOTALE.dëg”, konstatohet se objekti i banimit me sipërfaqe ndërtimi 94.2 dhe parcele prej 168.4 m² ndodhet pjesërisht për sipërfaqen 16 m², brenda vijës kufizuese të objektit shtetëror të ujësjes së “Pompë uji”, duke vepruar në kundërshtim me vendimin e KM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar me vendimin e KM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dhështesa në vendimin nr. 280, datë 1.4.2015, të këshillit të ministrave, ...”, pika 2, germa “c”, ku citohet se:

“Ndërtimi informal i llojit “objekt”, i ngritur brenda vijës kufizuese të zonës informale të miratuar dhe i përfshirë në fushën e zbatimit të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, përjashtohet nga legalizimi në një nga rastet e mëposhtme:

Është ngritur brenda “territorit të institucioneve publike”, sipas neneve 39 dhe 42, pika 2, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me përjashtim të rasteve kur është ndërtuar nga vetë këto institucione. Në kuptim të këtyre neneve, “territori i institucionit publik” është sipërfaqja e truallit funksional të ndërtesës publike apo që rezulton të jetë pjesë e inventarit për këtë ndërtesë, si: godinat e institucioneve shtetërore, të shkollave e kopshteve publike, spitaleve, qendrave shëndetësore, kampuseve studentore e të tjera të ngjashme”

Për këtë situatë legalizimi Drejtoria e ALUIZNI-t Elbasan, me shkresë nr. 13231, datë 15.11.2017, i është drejtuar Bordit të Kullimit Korçë, ku i kërkon atij Bordi, prononcimin, si autoritet përgjegjës, në lidhje me vazhdimin e procedurave të legalizimit, nëse objekti në fjalë, cënon sistemin e pompave të kullimit. Meqenëse Bordi i Kullimit Korçë nuk ka kthyer përgjigje, ALUIZNI Elbasan, i është referuar procedurave administrative duke prezumuar se qëndrimi i Bordit është pozitiv.

Regjistri i Parcelës Ndërtimore është përgatitur nga Përgjegjësi i Sektorit të Çështjeve të Pronësisë znj. M S dhe konfirmuar nga Drejtori z. A G.

Por, përsa më sipër Drejtoria e ALUIZNI-t Elbasan duhej të kishte proceduar vetë me refuzimin e kërkesës, mos lëshimin e lejes së legalizimit dhe duhej të kishte kryer skualifikimin e objektit.

Në dosje mungon:

-vërtetimi për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 27, germa “ç”, të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

-Në proces-verbalin e verifikimit në terren datë s`ka, pra mund të përcaktohet afati kohor proces-verbal verifikimi – vendim kualifikimi, në kundërshtim me vendimin e KM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar, pika 8, ku përcaktohet se:

Drejtoritë e ALUIZNI-t, bazuar në gjendjen faktike në terren, kryejnë procedurat kualifikuese për ndërtimin informal, brenda 60 ditëve nga data e evidentimit faktik në terren (data e "Procesverbalit të evidentimit në terren"). Për kryerjen e këtyre procedurave drejtoritë mbështeten në cilësitë e territorit, të paraqitura grafikisht.



-Vendimi për kualifikim është marrë më datë 14.11.2017 ndërsa leja e legalizimit është lëshuar më datë 21.09.2018 pra pas 10 muajsh, në kundërshtim me Urdhrin nr. 37, datë 19.01.2016 “Për miratimin e planveprimet për shqyrtimin administrativ të praktikave të legalizimit të ndërtimeve pa leje”, pika 6- Miratimi i lejes së legalizimit përpara kalimit të pronësisë, germa “a”, ku citohet:

Plotësimi dhe miratimi (nënshkrimi+ vulosje) i lejes së legalizimit bëhet brënda 30 ditëve nga data e Vendimit të Kualifikimit.

Në proces-verbalin e verifikimit (datë s`ka), nuk janë plotësuar rubrikat me destinacionin e sipërfaqeve të legalizuara (banim ose aktivitet), me emërtimet e objekteve kufitare, numrat e pasurive, distancat nga pasuritë kufitare (të saktësuara në përshkrim).

Këto mungesa, vecanërisht mungesa e distancave nga pasuritë kufitare e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale.

Sa sipër është në kundërshtim me rubrikat sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

Proces-Verbali i verifikimit në terren është nënshkruar nga specialistët e terrenit D A, A B dhe Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë z. Sh P.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A B, Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, znj. M S, Përgjegjëse e Sektorit të Pronësisë, z. A H, Sektori i Çështjeve të Pronësisë, z. Sh P, ish-Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë, z. D A, specialist terreni, z. A B, specialist terreni, miratuar nga z. A G, me detyrë ish-Drejtor i ALUIZNI-t Elbasan.

z. A H me shkresë nr. 1065/62, datë 03.09.2019, ka observuar se:

“Përgjegjësia ime qëndron në plotësimet dhe verifikimet, dhe në dosje prezumohet pozitiv qëndrimi i Bordit pasi kalojnë afatet sipas procedurave administrative”

Theksojmë së për sa më lart përgjegjësia mbetet. Nuk duhej bazuar vetëm në qëndrimin e bordit por edhe në verifikimin në vend dhe në hartat e disponuara në DR të ALUIZNI-t Elbasan, etj.

Observacioni nuk qëndron.

Lidhur me observimin për legalizimin nr. 2580523, datë 25.03.2019, për objektin: “Godinë Social-Ekonomike 1 kat”, për F S Ç, brenda territorit të parkut “Rinia”, nga punonjësit e ASHK-së Elbasan janë paraqitur argumente për vendosjen e objektit jashtë vijës kufizuese të Parkut Rinia, argumente të cilat qëndrojnë dhe reflektohen në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- Lejet e legalizimit sipas listës së paraqitur nga ASHK Elbasan, të lëshuara nga DR e ALUIZNI-t Elbasan, objekte pronë “shtet”. mangësi dokumentare, etj.

- Dosja nr. 14853, leje legalizimi nr. 2578776, datë 16.04.2018, për objektin: “Godinë Social-Ekonomike 1 kat”, për R Sh A, me adresë Bashkia Elbasan, Lagjia “Luigj Gurakuqi”, Zona Kadastrale 8521, nr.pasurisë 7/122/1, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 51.2 m², sipërfaqja e ndërtimit 51.2 m², sipërfaqja totale e ndërtimit: për banim - m², për aktivitet 51.2, numri i kateve mbi tokë 1, nën tokë -, titulli i pronësisë: : “Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1”.

Dokumentacioni i dosjes së kësaj leje legalizimi është i pa plotësuar me inventarin përkatës të dokumentacionit dhe numrit të fletëve për cdo dokument, në kundërshtim me Ligjin Nr. 9154, date 06.11.2003, “Për Arkivat”.

Nga auditimi konstatohet se sipas shkresës së ZVRPP Elbasan nr. 671/1, datë 19.03.2018, në përgjigje të shkresës së DR ALUIZNI-t Elbasan nr. 2254, datë 16.03.2018, rezulton se pasuria nr. 7/121 është e llojit “Garazh”, me sipërfaqe 59.56 m², ndodhur në lagjen “Luigj Gurakuqi”, Zona Kadastrale 8521, Elbasan, figuron e regjistruar në vol. 19, faqe 14, në pronësi “Shtet”, të pa plotësuar seksionet D dhe E. Shkresa nuk ka bashkëlidhur fragmentin e HTR.



Pra, pasuria në fjalë, “Garazh” 59.56 m² nuk rezulton të jetë ndërtim i paligjshëm, por pronë “Shtet”, rast për të cilin qytetari ka lëshuar deklaratë noteriale “per prishje të objektit “Shtet”, i cili pasi është prishur është ndërtuar objekt i ri.

Por, konstatohet se në dosje nuk ndodhen dokumente që të provojnë faktin se institucioni përgjegjës (administrues) ka kryer procedurat për pasqyrimin e gjendjes ekzistuese në inventarin e pronave të paluajtshme të shtetit.

Përveç kësaj, në dosje nuk ndodhet shkresë drejtuar institucioneve përgjegjëse të administrimit të institucioneve shtetërore, gjë që duhej bërë duke njoftuar paraprakisht këto institucione.

Sa sipër është në kundërshtim me vendimin e KM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar me vendimin e KM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dheshitesa në vendimin nr. 280, datë 1.4.2015, të këshillit të ministrave, “për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, pika 13, ku përcaktohet se:

Nëse poseduesi ka ngritur ndërtim informal mbi truallin e një objekti të shembur, që ka qenë në pronësi të tij, ai duhet të dorëzojë pranë drejtorisë së ALUIZNI-t deklaratën noteriale në të cilën pranon faktin e shembjes. Kjo deklaratë dorëzohet përpara miratimit të lejes së legalizimit dhe një kopje e saj përcillet pranë ALUIZNI-së.

*Kur objekti i shembur rezulton në pronësi të të tretëve ose në pronësi shtetërore, sipas regjistrit të pasurive të paluajtshme ose çdo dokumenti ligjor pronësie, në deklaratën noteriale poseduesi duhet të deklarojë se nuk është subjekt i veprave penale të parashikuara në seksionin III, të kreut III, të pjesës së posaçme, të Kodit Penal. **Për ndërtimet shtetërore të shembura, institucioni përgjegjës (administrues) detyrohet të kryejë procedurat për pasqyrimin e gjendjes ekzistuese në inventarin e pronave të paluajtshme të shtetit.***

Përveç sa sipër veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 13/1, ku përcaktohet se:

Përlegalizimin e ndërtimeve informale, të ngritura mbi territoret e objekteve ish-ushtarake, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8743, datë 22.1.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, ALUIZNI zbaton procedurat e përcaktuara në këtë vendim, duke bashkëpunuar me Ministrinë e Mbrotjtjes, në përputhje me pikën 17, të vendimit nr. 465, datë 22.6.2016, të Këshillit të Ministrave.

Për territoret ose për sipërfaqe të tjera në përgjegjësi administrimit të institucioneve shtetërore, procedurat e legalizimit kryhen duke njoftuar paraprakisht këto institucione.”

Sikurse evidentohet në dosje rezulton se legalizimi është bërë duke shëmbur ndërtesën “Shtet”, për sipërfaqen prej 59.56 m² ndërtesë pasuri “Shtet” dhe nuk disponohet asnjë lloj dokumentacioni në lidhje me këtë sipërfaqe.

Sa më sipër konstatohet se nga DR ALUIZNI Elbasan, është vepruar në kundërshtim me ligjin për legalizimin e ndërtimeve pa leje, pra kemi të bëjmë me ligjërimit të prishjes së pronës shtetërore, pa njoftuar institucionet përkatëse dhe pa u kryer veprimet prej këtyre të fundit, dokumentacione këto që duhej të ishin pjesë e dosjes, para se të lëshohej leja e legalizimit.

Regjistri i Parcelës Ndërtimore është përgatitur nga Përgjegjësi i Sektorit të Çështjeve të Pronësisë znj. M S dhe konfirmuar nga Drejtori z. A G.

Sipërfaqja ndërtimore 59.56 m², pronë “Shtet”, e vlerësuar me koston mesatare të të banesave për sipërfaqe shfrytëzimi për qytetin e Elbasanit, sipas EKB, që është 39,154 lekë/m², sipas UKM nr. 3, datë 28.12.2016, llogaritet:



Vlera e investimit: 2,332,012 lekë (59.56 m² x 39,154 lekë/m²).

Vlera e investimit prej 2,332,012 lekë, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit.

Sipas sistemit geoportal-albania, pasuritë “Garazh” pronë “Shtet” 7/121 dhe 7/122 janë brenda konturit të territorit të Kopshtit nr. 7 dhe gjithashtu duke bërë ballafaqimin me fotografitë (4 copë) të paraqitura, konstatohet se objekti social ekonomik me sipërfaqe ndertimi dhe parcele prej 59.56 m² ndodhet brenda vijës kufizuese të Kopshtit Nr. 7. Nga fotografitë kjo duket sepse në pamjen veriore të objektit, paraqitet porta e jashtme e këtij kopshti.

Sa sipër është vepruar në kundërshtim me vendimin e KM nr. 280, datë 1.4.2015 “ Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar me vendimin e KM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dheshtesa në vendimin nr. 280, datë 1.4.2015, të këshillit të ministrave, ...”, pika 2, germa “c”, ku citohet se:

“Ndërtimi informal i llojit “objekt”, i ngritur brenda vijës kufizuese të zonës informale të miratuar dhe i përfshirë në fushën e zbatimit të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, përjashtohet nga legalizimi në një nga rastet e mëposhtme:

Është ngritur brenda “territorit të institucioneve publike”, sipas neneve 39 dhe 42, pika 2, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me përjashtim të rasteve kur është ndërtuar nga vetë këto institucione. Në kuptim të këtyre neneve, “territori i institucionit publik” është sipërfaqja e truallit funksional të ndërtesës publike apo që rezulton të jetë pjesë e inventarit për këtë ndërtesë, si: godinat e institucioneve shtetërore, të shkollave e kopshteve publike, spitaleve, qendrave shëndetësore, kampuseve studentore e të tjera të ngjashme”

Drejtoria e ALUIZNI-t Elbasan duhej të kishte proceduar me refuzimin e kërkesës, mos lëshimin e lejes së legalizimit dhe duhej të kishte kryer skualifikimin e objektit.

Sipas shënimeve në lejën e legalizimit, titulli i pronësisë, jepet si referencë ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1, sipas të cilit citojmë:

-Proces-verbali i verifikimit në terren nuk është plotësuar me rubrikat për: data e mbajtjes, sipërfaqet e parcelës ndërtimore, njolla e objektit, nmri i kateve dhe destinacioni i sipërfaqeve. Përsa i përket pasurive kufitare (të saktësuara në përshkrim) nuk janë shënuar numrat e pasurive dhe distancat nga pasuritë kufitare.

Këto mungesa, vecanërisht mungesa e sipërfaqes së parcelës ndërtimore dhe distancave nga objektet kufitare e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale.

Sa sipër është në kundërshtim me rubrikat sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

Proces-Verbali i verifikimit në terren është nënshkruar nga specialistët e terrenit D A dhe A B dhe është miratuar nga Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë z. Sh P.

Proces-Verbali i vlerësimit të dosjes është nënshkruar nga znj. A T për Sektorin e Legalizimit, znj. N S për Sektorin e Hartografisë dhe Përpunimit të Informacionit dhe Sektorin e Përpunimit të të Dhënave, ku rezulton se *subjekti ka më shumë se 1 (një) ndërtim informal.*

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A G, ish-Drejtor i ALUIZNI-t Elbasan, z. A B, Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, znj.M S, Përgjegjëse e Sektorit të pronësisë, znj. A T, specialist, znj. V H, specialist, znj. N S, për Sektorin Hartografisë dhe Sektorin e Përpunimit të të Dhënave, z. Sh P, Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë, z. A B, specialist terreni, z. D A, specialist terreni.

(Problematikat e mësipërme janë trajtuar në Akt-Konstatimin nr. 3, datë 30.07.2019, dorëzuar zyrtarisht në Zyrën e Protokollit të DR të ASHK-së Elbasan).

Lejet e legalizimit sipas listës së paraqitur nga ASHK Elbasan, të lëshuara nga DR e ALUIZNI-t Elbasan, mbi distancat nga ujërat sipërfaqësore. Mangësi dokumentare, etj. Afër përrenjve

- Dosja nr. 19436, leje legalizimi nr. 8555516, datë 25.10.2017, për objektin: “Godinë Banimi 1 Kat”, për E Xh Sh, me adresë Bashkia Elbasan, Mengel, Zona Kadastrale 2654, nr. pasurisë 1274/1, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 346.5 m², sipërfaqja e ndërtimit 115.5 m², sipërfaqja totale e ndërtimit: për banim 115.5 m², për aktivitet - m², numri i kateve mbi tokë 1, nën tokë -, titulli i pronësisë: “Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1”. Drejtori F D, Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit A B.

Objekti i legalizuar gjendet brenda zonës informale.

Nga verifikimi në dokumentacionin hartografik të paraqitur, në Gen-Planin me shkallë zvogëlimi 1:500, në proces-verbalin e verifikimit në terren, në skicën fushore, si dhe nga matja e kryer në hartën vektoriale dhe në sistemin dixhital zyrtar “geoportal-albania”, u konstatua se legalizimi i objektit “Godinë Banimi 1 Kat”, ishte kryer në pozicionimin e pronës, në një distancë prej **12 m** nga bregu i përroit, me të cilin kufizohet në perëndim, distancë brenda së cilës pasuria shtetërore është e patjetërsueshme dhe e paparashkrueshme, për rrjedhojë nuk duhej pranuar për legalizim objekti në 346.5 m² truall dhe 115.5 m² ndërtesë.

Veprimet e kryera më sipër, janë kryer në kundërshtim me ligjin nr. 111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 1, pika 2, germa “a”; neni 4, pika 8; neni 5 dhe neni 84, si dhe me vendimin e KM nr. 280, datë 1.4.2015 “ Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar me vendimin e KM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dhështesa në vendimin nr. 280, datë 1.4.2015, të këshillit të ministrave, “për



Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ish-Drejtorinë e Aluizni Qarku Elbasan, (sot Agjensia Shtetërore e Kadastrës Elbasan)

përcaktimin ekritereve, procedurave edokumentacionit tëzbatueshëm për të kualifikuarndërtimet pa leje, shtesatanësore dhe/ose në lartësi, nëndërtime me leje”, Kreu II, pika 2, germa “h”.

-Proces-verbali i verifikimit në terren nuk ka datë kur është mbajtur, ndërkohë që vendimi për kualifikimin mban datën 05.07.2017, pra nuk mund të përcaktohet afati kohor: proces verbal verifikimi-vendim për kualifikimin, në kundërshtim me vendimin e KM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar, pika 8, ku përcaktohet se:

Drejtoritë e ALUIZNI-t, bazuar në gjendjen faktike në terren, kryejnë procedurat kualifikuese për ndërtimin informal, brenda 60 ditëve nga data e evidentimit faktik në terren (data e "Procesverbalit të evidentimit në terren"). Për kryerjen e këtyre procedurave drejtoritë mbështeten në cilësitë e territorit, të paraqitura grafikisht.

Në dosje mungon:

-vërtetimi për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 27, germa “ç”, të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

-Në proces-verbalin e verifikimit në terren, nuk janë plotësuar rubrikat me: datën e mbajtjes, funksionin e sipërfaqeve për banim dhe aktivitet. Përsa i përket pasurive kufitare (të saktësuara në përshkrim) nuk janë shënuar distancat nga pasuritë kufitare dhe numrat e pasurive.

Këto mungesa, vecanërisht mungesa e distancave nga objektet kufitare e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale. Efekti në këtë rast është më i rëndë, sepse nuk është përcaktuar distanca nga përroi në përfundim të objektit.

Sa sipër është në kundërshtim me rubrikat sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

Proces-Verbali i verifikimit në terren është nënshkruar nga specialistët e terrenit V Sh dhe R Xh dhe nga Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë z. Sh P.

Proces-verbali i vlerësimit të dosjes është firmosur nga z.E K, znj DD, për Sektorin e legalizimit dhe znj. N S, për Sektorin e përpunimit të të Dhënave.

Punuar praktika nga specialistët z. A B, ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. E K, specialist, znj D D, specialist, znj. N S, specialiste, z. Sh P, Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, znj.V Sh, specialist terreni, z. R Xh, specialist terreni, miratuar ngaz. F D, ish-Drejtor i ALUIZNI-t Elbasan. Z. F D, ish-Drejtor, ka paraqitur observacionin me pretendimin se:

-Lidhur me largësinë nga përroi është observuar duke ju referuar 2 dispozitave ligjore: VKM nr. 589, datë 10.09.2014, i ndryshuar me VKM nr. 634, datë 07.09.2016 ku cilësohet se ..ndërtimi në zona informale nuk u nënshtrohet kushteve të dokumenteve të planifikimit të territorit dhe VKM nr. 280, datë 01.04.2015, i ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016 ku thuhet se në këtë zonë lejohen ndërtime siç përcakton dokumenti i planifikimit të territorit, i miratuar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Sa sipër, kujtojmë që kemi pretendime bazuar në 2 dispozita kontradiktore (siç na janë paraqitur nga z. D). Përsa i përket VKM nr. 280, datë 01.04.2015, i ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016, duhet të citojmë edhe pjesën e dispozitës ku thuhet i miratuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, legjislacioni i cili parashikon në rradhë të parë ligjin për ujrat nr. 111/2012, në nenin 84, të të cilit përcaktohet që:

Në tokat, pronë private dhe shtetërore, përbri brigjeve të lumenjve, përrenjve, kanaleve, liqeneve, pellgjeve, rezervuarëve, lagunave bregdetare dhe deteve duhet, detyrimisht, të lihet:

-një sipërfaqe toke e lirë për përdorim publik, me gjerësi nga 5 deri në 100 metra nga këto brigje,



sipas përkufizimit të bërë në këtë ligj. Gjerësia e saj mund të shtrihet më tej në afërsi të grykës së lumenjve, në rrethinat e ngushta të rezervuarëve ose kur kushtet topografike dhe hidrologjike të lumenjve, liqeneve ose rezervuarëve e bëjnë të nevojshme për sigurimin e njerëzve dhe të pasurisë. Veprimtaritë në këto zona përcaktohen me akte të Këshillit Kombëtar të Ujit; -një sipërfaqe toke e lirë për zhvillimin e veprimtarive që përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Ujit, me gjerësi nga 100 m deri në 200 m.

Observacioni nuk qëndron.

-Për taksën e infrastrukturës është njoftuar Bashkia Elbasan.

Sa sipër kujtojmë se paraqitja e vërtetimit për pagesën e taksës së infrastrukturës është detyrimi sipas nenit 27, të ligjit për legalizimin.

Observacioni nuk qëndron.

-Për proces-verbalin e verifikimit në terren, pretendohet se të dhënat mbi largësië nga objektet kufitare, etj., janë pasqyruar në skicën fushore.

Sa sipër kujtojmë se skica fushore nuk është dokument i njohur për vërtetimin e kryerjes së matjeve, pasi është një skicë e përgatitur me laps plumbi, po kështu edhe firmat e specialistëve. Dokument i njohur ligjërisht është vetëm Akti i Verifikimit në Terren.

Observacioni nuk qëndron.

- Dosja nr. 10808, leje legalizimi nr. 306028, datë 20.11.2017, për objektin: “Godinë Banimi 2 Kat”, për R F Sh, me adresë Bashkia Elbasan, Mengel, Zona Kadastrale 2654, nr. pasurisë 1186/1, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 391.5 m², sipërfaqja e ndërtimit 130.5 m², sipërfaqja totale e ndërtimit: për banim 282.5 m², për aktivitet - m², numri i kateve mbi tokë 2, nën tokë -, titulli i pronësisë: “Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1”. Drejtori F D, Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit A B.

Dokumentacioni i dosjes së kësaj leje legalizimi është i pa plotësuar me inventarin përkatës të dokumentacionit dhe numrit të fletëve për cdo dokument, në kundërshtim me Ligjin Nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”.

Objekti i legalizuar gjendet brenda zonës informale.

Nga verifikimi në dokumentacionin hartografik të paraqitur, në gen-planet me shkallë zvogëlimi 1:500 dhe 1:2500, në proces-verbalin e verifikimit në terren, në skicën fushore, si dhe nga matja e kryer në hartën vektoriale dhe në sistemin dixhital zyrtar “geoportal-albania”, u konstatua se legalizimi i objektit “Godinë Banimi 2 Kat”, ishte kryer në pozicionimin e pronës, në një distancë prej 13 m nga bregu i përroit, me të cilin kufizohet në përfundim, distancë brenda së cilës pasuria shtetërore është e patjetërsueshme dhe e paparashkrueshme, për rrjedhojë nuk duhej pranuar për legalizim objekti në 391.5 m² truall dhe 130.5 m² ndërtesë.

Veprimet e kryera më sipër, janë kryer në kundërshtim me ligjin nr. 111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 1, pika 2, germa “a”; neni 4, pika 8; neni 5 dhe neni 84, si dhe me vendimin e KM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar me vendimin e KM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dheshtesa në vendimin nr. 280, datë 1.4.2015, të këshillit të ministrave, “për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, Kreu II, pika 2, germa “h”.

-Proces-verbali i verifikimit në terren nuk ka datë kur është mbajtur, ndërkohë që vendimi për kualifikimin mban datën 13.11.2017, pra nuk mund të përcaktohet afati kohor: proces verbal verifikimi-vendim për kualifikimin, në kundërshtim me vendimin e KM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar



ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar, pika 8, ku përcaktohet se:

Drejtoritë e ALUIZNI-t, bazuar në gjendjen faktike në terren, kryejnë procedurat kualifikuese për ndërtimin informal, brenda 60 ditëve nga data e evidentimit faktik në terren (data e "Procesverbalit të evidentimit në terren"). Për kryerjen e këtyre procedurave drejtoritë mbështeten në cilësitë e territorit, të paraqitura grafikisht.

Në dosje mungon:

-vërtetimi për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 27, germa “ç”, të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

-Në proces-verbalin e verifikimit në terren, nuk janë plotësuar rubrikat me: datën e mbajtjes, funksionin e sipërfaqeve për banim dhe aktivitet. Përsa i përket pasurive kufitare (të saktësuara në përshkrim) nuk janë shënuar distancat nga pasuritë kufitare dhe numrat e pasurive. Nuk është shënuar objekti në lindje.

Këto mungesa, vecanërisht mungesa e distancave nga objektet kufitare e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale. Efekti në këtë rast është më i rëndë, sepse nuk është përcaktuar distanca nga përroi në përfundim të objektit.

Sa sipër është në kundërshtim me rubrikat sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

Proces-Verbali i verifikimit në terren është nënshkruar nga specialistët e terrenit V Sh dhe R Xh dhe nga Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë z. Sh P.

Me aktin e kualifikimit nr. 21441, datë 13.11.2017, objekti informal legalizohet, i nënshkruar nga znj. A T, z. AB dhe Drejtori z. F D.

Proces-verbali i vlerësimit të dosjes është firmosur nga znj. A T, znj. E T, për Sektorin e legalizimit dhe znj. J S, për Sektorin e përpunimit të të Dhënave.

Punuar praktika nga specialistët z. A B, ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. E K, specialist, znj A T, specialist, znj. E T, specialiste, znj. J S, për Sektorin e përpunimit të të Dhënave, z. Sh P, Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, znj.V Sh, specialist terreni, z. R Xh, specialist terreni, miratuar nga z. F D, ish-Drejtor i ALUIZNI-t Elbasan.

Znj.J S me observacionin nr. 1065/58, datë 03.09.2019, ka paraqitur observacionin sipas të cilit përjashton veten nga përgjegjësia për sa i takon hartimit të proces-verbalit të verifikimit në terren, në një kohë që ka firmosur proces-verbalin e vlerësimit të dosjes.

Observimi nuk qëndron

Z. F D, ish-Drejtor, ka paraqitur observacionin me pretendimin se:

*-Lidhur me largësinë nga përroi është observuar duke ju referuar 2 dispozitave ligjore: VKM nr. 589, datë 10.09.2014, i ndryshuar me VKM nr. 634, datë 07.09.2016 ku cilësohet se ..ndërtimi në zona informale **nuk u nënshtrohet kushteve të dokumenteve të planifikimit të territorit dhe VKM nr. 280, datë 01.04.2015, i ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016 ku thuhet se në këtë zonë lejohen ndërtime siç përcakton dokumenti i planifikimit të territorit, i miratuar në përputhje më legjislacionin në fuqi.***

Sa sipër, kujtojmë që kemi pretendime bazuar në 2 dispozita kontradiktore (siç na janë paraqitur nga z. D).

*Përsa i përket VKM nr. 280, datë 01.04.2015, i ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016, duhet të citojmë edhe pjesën e dispozitës ku thuhet **i miratuar në përputhje më legjislacionin në fuqi**, legjislacion i cili parashikon në rradhë të parë ligjin për ujrat nr. 111/2012, në nenin 84, të të cilit përcaktohet që:*



Në tokat, pronë private dhe shtetërore, përbri brigjeve të lumenjve, përrenjve, kanaleve, liqeneve, pellgjeve, rezervuarëve, lagunave bregdetare dhe deteve duhet, detyrimisht, të lihet:

-një sipërfaqe toke e lirë për përdorim publik, me gjerësi nga 5 deri në 100 metra nga këto brigje, sipas përkufizimit të bërë në këtë ligj. Gjerësia e saj mund të shtrihet më tej në afërsi të grykës së lumenjve, në rrethinat e ngushta të rezervuarëve ose kur kushtet topografike dhe hidrologjike të lumenjve, liqeneve ose rezervuarëve e bëjnë të nevojshme për sigurimin e njerëzve dhe të pasurisë. Veprimtaritë në këto zona përcaktohen me akte të Këshillit Kombëtar të Ujit;

-një sipërfaqe toke e lirë për zhvillimin e veprimtarive që përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Ujit, me gjerësi nga 100 m deri në 200 m.

Observacioni nuk qëndron.

-Për taksën e infrastrukturës është njoftuar Bashkia Elbasan.

Sa sipër kujtojmë se paraqitja e vërtetimit për pagesën e taksës së infrastrukturës është detyrimi sipas nenit 27, të ligjit për legalizimin.

Observacioni nuk qëndron.

-Për proces-verbalin e verifikimit në terren, pretendohet se të dhënat mbi largësië nga objektet kufitare, etj., janë pasqyruar në skicën fushore.

Sa sipër kujtojmë se skica fushore nuk është dokument i njohur për vërtetimin e kryerjes së matjeve, pasi është një skicë e përgatitur me laps plumbi, po kështu edhe firmat e specialistëve.

Dokument i njohur ligjrisht është vetëm Akti i Verifikimit në Terren.

Observacioni nuk qëndron.

- Dosja nr. 20361, leje legalizimi nr. 85585968, datë 21.10.2017, për objektin: “Godinë Banimi 1 Kat”, për H A B, me adresë Bashkia Elbasan, Labinot Fushë, Zona Kadastrale 2355, nr. pasurisë 228/1, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 332.7 m², sipërfaqja e ndërtimit 110.9 m², sipërfaqja totale e ndërtimit: për banim 110.9 m², për aktivitet - m², numri i kateve mbi tokë 1, nën tokë -, titulli i pronësisë: “Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1”. *Drejtori F D, Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit A B.*

Dokumentacioni i dosjes së kësaj leje legalizimi është i pa plotësuar me inventarin përkatës të dokumentacionit dhe numrit të fletëve për cdo dokument, në kundërshtim me Ligjin Nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”.

Objekti i legalizuar gjendet jashtë zonës informale.

Nga verifikimi në dokumentacionin hartografik të paraqitur, në gen-planin me shkallë zvogëlimi 1:500, në proces-verbalin e verifikimit në terren, në skicën fushore, si dhe nga matja e kryer në hartën vektoriale dhe në sistemin dixhital zyrtar “geoportal-albania”, u konstatua se legalizimi i objektit “Godinë Banimi 1 Kat”, ishte kryer në pozicionimin e pronës, në një distancë prej 21 m nga bregu i përroit, me të cilin kufizohet në lindje, distancë brenda së cilës pasuria shtetërore është e patjetërsueshme dhe e paparashkrueshme, për rrjedhojë nuk duhej pranuar për legalizim objekti në 332.7 m² truall dhe 110.9 m² ndërtesë.

Veprimet e kryera më sipër, janë kryer në kundërshtim me ligjin nr. 111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 1, pika 2, germa “a”; neni 4, pika 8; neni 5 dhe neni 84, si dhe me vendimin e KM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar me vendimin e KM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dheshtesa në vendimin nr. 280, datë 1.4.2015, të këshillit të ministrave, “për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, Kreu III, pika 4, germa “dh”.

-Proces-verbali i verifikimit në terren nuk ka datë kur është mbajtur, ndërkohë që vendimi për kualifikimin mban datën 19.07.2017, pra nuk mund të përcaktohet afati kohor: proces verbal



verifikimi-vendim për kualifikimin, në kundërshtim me vendimin e KM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar, pika 8, ku përcaktohet se:

Drejtoritë e ALUIZNI-t, bazuar në gjendjen faktike në terren, kryejnë procedurat kualifikuese për ndërtimin informal, brenda 60 ditëve nga data e evidentimit faktik në terren (data e "Procesverbalit të evidentimit në terren"). Për kryerjen e këtyre procedurave drejtoritë mbështeten në cilësitë e territorit, të paraqitura grafikisht.

-Vendimi për kualifikim është marrë më datë 19.07.2017, ndërsa leja e legalizimit është lëshuar më datë 21.10.2017, pra pas 3 muaj e 2 ditë, në kundërshtim me Urdhrin nr. 37, datë 19.01.2016 “Për miratimin e planveprimit për shqyrtimin administrativ të praktikave të legalizimit të ndërtimeve pa leje”, pika 6- Miratimi i lejes së legalizimit përpara kalimit të pronësisë, germa “a”, ku citohjet:

Plotësimi dhe miratimi (nënshkrimi+ vulosje) i lejes së legalizimit bëhet brenda 30 ditëve nga data e Vendimit të Kualifikimit.

Në dosje mungon:

-vërtetimi për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 27, germa “ç”, të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

-Në proces-verbalin e verifikimit në terren, nuk janë plotësuar rubrikat me: datën e mbajtjes, sipërfaqen e parcelës ndërtimore, sipërfaqen e bazës (njollës) së ndërtimit, funksionin e sipërfaqeve për banim dhe aktivitet. Përsa i përket pasurive kufitare (të saktësuara në përshkrim) nuk janë shënuar distancat nga pasuritë kufitare dhe numrat e pasurive. Këto mungesa, vecanërisht mungesa e distancave nga objektet kufitare e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale. Efekti në këtë rast është më i rëndë, sepse nuk është përcaktuar distanca nga përroi në përcaktim të objektit.

Sa sipër është në kundërshtim me rubrikat sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

Proces-Verbali i verifikimit në terren është nënshkruar nga specialistët e terrenit V Sh dhe R Xh dhe nga Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë z. Sh P.

Proces-verbali i vlerësimit të dosjes është firmosur nga znj. A B, znj. E A, për Sektorin e legalizimit dhe znj. N S, për Sektorin e përpunimit të të Dhënave.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A B, ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, znj. A B, specialist, znj. E A, specialist, znj. N S, specialiste, z. Sh P, Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, znj. V Sh, specialist terreni, z. R Xh, specialist terreni, miratuar nga z. F D, ish-Drejtor i ALUIZNI-t Elbasan,

Znj. A B, ish-specialiste e legalizimit, me observacionin 1056/59, datë 04.09.2019, pa paraqitur pretendimin se: “Objekti ndodhet në zonë urbane 21 m nga përroi”

Ky pretendim nuk hedh poshtë vlerësimin tonë për ruajtjen e distancave nga brigjet e përrenjve, lumenjve, etj.

Observacioni nuk qendron.

Z. F D, ish-Drejtor, ka paraqitur observacionin me pretendimin se:

-Lidhur me largësinë nga përroi është observuar duke ju referuar 2 dispozitive ligjore: VKM nr. 589, datë 10.09.2014, i ndryshuar me VKM nr. 634, datë 07.09.2016 ku cilësohet se ..ndërtimi në zona informale nuk u nënshtrohet kushteve të dokumenteve të planifikimit të territorit dhe VKM nr. 280, datë 01.04.2015, i ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016 ku thuhet se në këtë zonë



lejohen ndërtime siç përcakton dokumenti i planifikimit të territorit, i miratuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Sa sipër, kujtojmë që kemi pretendime bazuar në 2 dispozita kontradiktore (siç na janë paraqitur nga z. D).

Përsa i përket VKM nr. 280, datë 01.04.2015, i ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016, duhet të citojmë edhe pjesën e dispozitës ku thuhet i miratuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, legjislacioni i cili parashikon në rradhë të parë ligjin për ujrat nr. 111/2012, në nenin 84, të të cilit përcaktohet që:

Në tokat, pronë private dhe shtetërore, përbri brigjeve të lumenjve, përrenjve, kanaleve, liqeneve, pëllgjeve, rezervuarëve, lagunave bregdetare dhe deteve duhet, detyrimisht, të lihet:

-një sipërfaqe toke e lirë për përdorim publik, me gjerësi nga 5 deri në 100 metra nga këto brigje, sipas përkufizimit të bërë në këtë ligj. Gjerësia e saj mund të shtrihet më tej në afërsi të grykës së lumenjve, në rrethinat e ngushta të rezervuarëve ose kur kushtet topografike dhe hidrologjike të lumenjve, liqeneve ose rezervuarëve e bëjnë të nevojshme për sigurimin e njerëzve dhe të pasurisë. Veprimtaritë në këto zona përcaktohen me akte të Këshillit Kombëtar të Ujit;

-një sipërfaqe toke e lirë për zhvillimin e veprimtarive që përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Ujit, me gjerësi nga 100 m deri në 200 m.

Observacioni nuk qëndron.

-Për taksën e infrastrukturës është njoftuar Bashkia Elbasan.

Sa sipër kujtojmë se paraqitja e vërtetimit për pagesën e taksës së infrastrukturës është detyrimi sipas nenit 27, të ligjit për legalizimin.

Observacioni nuk qëndron.

-Për proces-verbalin e verifikimit në terren, pretendohet se të dhënat mbi largësië nga objektet kufitare, etj., janë pasqyruar në skicën fushore.

Sa sipër kujtojmë se skica fushore nuk është dokument i njohur për vërtetimin e kryerjes së matjeve, pasi është një skicë e përgatitur me laps plumbi, po kështu edhe firmat e specialistëve.

Dokument i njohur ligjërish është vetëm Akti i Verifikimit në Terren.

Observacioni nuk qëndron.

Afër Lumenjve

- Dosja nr. 1375, leje legalizimi nr. 2570569, datë 23.07.2018, për objektin: “ Shtesë Anësore 1 kat në Godinë Ekzistuese 1 Kat”, për Q R S, me adresë Bashkia Gramsh, Zona Kadastrale 1842, nr. pasurisë 8/58/1, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 31.2 m², sipërfaqja e ndërtimit 11.37 m², sipërfaqja totale e ndërtimit: për banim 11.37 m², për aktivitet - m², numri i kateve mbi tokë 1, nën tokë -, titulli i pronësisë: “Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1”. Drejtori A G, Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit A B.

Nga verifikimi në dokumentacionin hartografik të paraqitur, në gen-planin me shkallë zvogëlimi 1:500, në proces-verbalin e verifikimit në terren, në skicën fushore, si dhe nga matja e kryer në hartën vektoriale dhe në sistemin dixhital zyrtar “geoportal-albania”, u konstatua se legalizimi i objektit “Godinë Banimi 1 Kat”, ishte kryer në pozicionimin e pronës, në një distancë prej **69 m nga bregu i Lumit Devoll**, me të cilin kufizohet në Perëndim, distancë brenda së cilës pasuria shtetërore është e patjetërsueshme dhe e paparashkrueshme.

Në dosje nuk u gjetën plane ose studime të planifikimit dhe rregullimit të territorit, ose dokumente të miratuara në Këshillin Kombëtar të Ujit, për rrjedhojë nuk duhej pranuar për legalizim objekti në 31.2 m² truall dhe 11.37 m² ndërtesë.

Objekti i legalizuar gjendet jashtë zonës informale.



Veprimet e kryera më sipër, janë kryer në kundërshtim me ligjin nr. 111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, neni 2; neni 4, pika 8; neni 5 dhe neni 84, ku përcaktohet se:

“Veprimtaritë përbri brigjeve përcaktohen në planet dhe studimet e planifikimit dhe rregullimit të territorit. Këto dokumente miratohen paraprisht në Këshillin Kombëtar të Ujit.”

-Vendimi për kualifikim është marrë më datë 17.05.2018, ndërsa leja e legalizimit është lëshuar më datë 23.07.2018, pra pas **2 muaj e 6 ditë**, në kundërshtim me Urdhrin nr. 37, datë 19.01.2016 “Për miratimin e planveprimit për shqyrtimin administrativ të praktikave të legalizimit të ndërtimeve pa leje”, pika 6- Miratimi i lejes së legalizimit përpara kalimit të pronësisë, germa “a”, ku citohjet:

Plotësimi dhe miratimi (nënshkrimi+ vulosje) i lejes së legalizimit bëhet brenda 30 ditëve nga data e Vendimit të Kualifikimit.

Në dosje mungon:

-vërtetimi për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 27, germa “ç”, të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

-Në proces-verbalin e verifikimit në terren, nuk janë plotësuar rubrikat me: funksionin e sipërfaqeve për banim dhe aktivitetet. Përsa i përket pasurive kufitare (të saktësuara në përshkrim) nuk janë shënuar distancat nga pasuritë kufitare dhe numrat e pasurive. Këto mungesa, vecanërisht mungesa e distancave nga objektet kufitare e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale.

Sa sipër është në kundërshtim me rubrikat sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

Proces-Verbali i verifikimit në terren është nënshkruar nga specialistët e terrenit E H dhe K T dhe nga Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë z. Sh P.

Me aktin e kualifikimit nr. 22384, datë 17.05.2018, objekti informal legalizohet, i nënshkruar nga znj. A H, z. A B dhe Drejtori z. A G.

Proces-verbali i vlerësimit të dosjes është firmosur nga z. A H, z. K T, për Sektorin e legalizimit dhe z. K D, për Sektorin e përpunimit të të Dhënave.

Punuar praktika nga specialistët z. A B, ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. A H, specialist, z. K T, specialist, z. K D, për Sektorin e përpunimit të të Dhënave, z. Sh P, Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, z.E H, specialist terreni, z. K T, specialist terreni, miratuar nga z. A G, ish-Drejtor i ALUIZNI-t Elbasan.

Z. A H, ka paraqitur observimin nr. 1065/62, datë 03.09.2019, sipas të cilit “në rastin e shtesave si brenda dhe jashtë zonave informale zbatohen kriteret e pikës 2, të VKM 280, datë 01.04.2015, i ndryshuar”

Sipas germës “h” të VKM 756, datë 26.10.2016, duhen respektuar distancat sipas ligjit në brigjet e lumenjve. Observacioni nuk qëndron.

Z. A G, ish-Drejtor, ka paraqitur observimin nr. 1065/66, datë 03.09.2019, sipas të cilit “në rastin e shtesave si brenda dhe jashtë zonave informale zbatohen kriteret e pikës 2, të VKM 280, datë 01.04.2015, i ndryshuar”

Por, sipas germës “h” të VKM 756, datë 26.10.2016, duhen respektuar distancat sipas ligjit në brigjet e lumenjve. Observacioni nuk qëndron.



- **Dosja nr. 5255, leje legalizimi nr. 2570316, datë 31.05.2018**, për objektin: “ Godinë Banimi 2 Kat”, për Ç H K, me adresë Bashkia Cërrik, Gostimë, Zona Kadastrale 1820, nr. pasurisë 48/12/1, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 270 m², sipërfaqja e ndërtimit 90 m², sipërfaqja totale e ndërtimit: për banim 220.9 m², për aktivitet - m², numri i kateve mbi tokë 2, nën tokë -, titulli i pronësisë: “Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1”. *Drejtori A G, Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit A B.*

Dokumentacioni i dosjes së kësaj leje legalizimi është i pa plotësuar me inventarin përkatës të dokumentacionit dhe numrit të fletëve për cdo dokument, në kundërshtim me Ligjin Nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”.

Objekti i legalizuar gjendet jashtë zonës informale.

Nga verifikimi në dokumentacionin hartografik të paraqitur, në gen-planet me shkallë zvogëlimi 1:500 dhe 1:2500, në proces-verbalin e verifikimit në terren, në skicën fushore, si dhe nga matja e kryer në hartën vektoriale dhe në sistemin dixhital zyrtar “geoportal-albania”, u konstatua se legalizimi i objektit “Godinë Banimi 2 Kat”, ishte kryer në pozicionimin e pronës, në një distancë prej **94 m nga bregu i Lumit Devoll**, me të cilin kufizohet në Lindje, distancë brenda së cilës pasuria shtetërore është e **patjetërsueshme dhe e paparashkrueshme**.

Në dosje nuk u gjetën plane ose studime të planifikimit dhe rregullimit të territorit, ose dokumente të miratuara në Këshillin Kombëtar të Ujit, për rrjedhojë nuk duhej pranuar për legalizim objekti në 270m² truall dhe 90 m² ndërtesë.

Veprimet e kryera më sipër, janë kryer në kundërshtim me ligjin nr. 111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, neni 2; neni 4, pika 8; neni 5 dhe neni 84, ku përcaktohet se:

“Veprimtaritë përbri brigjeve përcaktohen në planet dhe studimet e planifikimit dhe rregullimit të territorit. Këto dokumente miratohen paraprakisht në Këshillin Kombëtar të Ujit.”

-Nga auditimi konstatohet se sipas shkresës së ZVRPP Elbasan nr. 1046/1, datë 08.05.2018, “Kthim përgjigje DR ALUIZNI-t Elbasan”, informacion për gjendjen juridike të pasurive, pasuria nr. 48/12, është “Arë”, me sipërfaqe 1600m², pronë “Demir Qamil Roçi”, regjistruar vol. 5, faqe 110.

-Ndërkohë që ALUIZNI Elbasan ka miratuar lejen e legalizimit për ndërtimin pa leje mbi këtë pasuri, çka sjell ndryshimin automatikisht të zërit kadastral gjatë regjistrimit në ZVRPP, në mungesë të dokumentacionit: kërkesa për miratimin në Këshillin e Qarkut, të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Agjencisë Rajonale të Mjedisit. Pra, nuk ka asnjë dokumentacion nga këto organe, për t'i dhënë lejen, veprimit të kryer për legalizim në zonat “Territore të tjera”, veprime në kundërshtim me nenet 10, 11, 14, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar dhe VKM nr. 515, datë 13.5.2009 e VKM nr. 589, datë 10.9.2014, “Për përcaktimin e afateve, të mënyrës dhe kohës së ushtrimit nga ALUIZNI të përgjegjësisve të zyrave të urbanistikës dhe të këshillave të qarqeve, gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale” si dhe Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit me nr. 5, datë 29.12.2014 “Për identifikimin e zonave të urbanizuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në miratimin e hartave ku mund të ndërhyhet në funksion të zhvillimit urban”, pika 9 ku përcaktohet: “Konvertimi nga tokë “Arë” në tokë “Truall” për sipërfaqet brenda zonave të urbanizuara do të bëhet sipas procedurave përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi”.

Regjistri i Parcelës Ndërtimore është përgatitur nga Përgjegjësi i Sektorit të Çështjeve të Pronësisë znj. M S dhe konfirmuar nga Drejtori z. A G.

-Proces-verbali i verifikimit në terren nuk ka datë kur është mbajtur, ndërkohë që vendimi për kualifikimin mban datën 10.05.2018, pra nuk mund të përcaktohet afati kohor: proces verbal



verifikimi-vendim për kualifikimin, në kundërshtim me vendimin e KM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar, pika 8, ku përcaktohet se:

Drejtoritë e ALUIZNI-t, bazuar në gjendjen faktike në terren, kryejnë procedurat kualifikuese për ndërtimin informal, brenda 60 ditëve nga data e evidentimit faktik në terren (data e "Procesverbalit të evidentimit në terren"). Për kryerjen e këtyre procedurave drejtoritë mbështeten në cilësitë e territorit, të paraqitura grafikisht.

Në dosje mungon:

-vërtetimi për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 27, germa “ç”, të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

-Në proces-verbalin e verifikimit në terren, nuk janë plotësuar rubrikat me: datën e mbajtjes, sipërfaqen e parcelës ndërtimore, sipërfaqen e bazës (njollës) së ndërtimit, funksionin e sipërfaqeve për banim dhe aktivitet. Përsa i përket pasurive kufitare këto mungojnë së bashku me numrat e pasurive të këtyre pasurive. Këto mungesa, vecanërisht mungesa e objekteve kufitare e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale.

Sa sipër është në kundërshtim me rubrikat sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

Proces-Verbali i verifikimit në terren është nënshkruar nga specialistët e terrenit B Gj dhe A S dhe nga Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë z. Sh P.

Me aktin e kualifikimit nr. 22333, datë 10.05.2018, objekti informal legalizohet, i nënshkruar nga znj. A B, z. A B dhe Drejtori z. A G.

Proces-verbali i vlerësimit të dosjes është firmosur nga znj. A B.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A G, ish-Drejtor i ALUIZNI-t Elbasan, z. A B, ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, znj. A B, specialist, z. Sh Pa.

Znj. A B, ish-specialiste e legalizimit, me observacionin 1056/59, datë 04.09.2019, pa paraqitur pretendimin se: “Objekti ndodhet në zonë urbane 94 m nga Lumi Devoll”

Ky pretendim nuk hedh poshtë vlerësimin tonë për ruajtjen e distancave nga brigjet e lumenjve.

Observacioni nuk qendron.

DV e ASHK-së Elbasan, më shkresë nr.1065/56, datë 16.08.2019, “RELACION OBSERVES”, të nënshkruar nga të gjithë punonjësit e prekur në auditim, dhe znj. Juliana Sinani sipas observacionit nr. 1065/58, datë 03.09.2019, lidhur me problematikat e trajtuara ka cituar pikën 2/h, të VKM 280, të ndryshuar, ku është nënvizuar shprehja sic përcakton dokumenti i planifikimit të territorit dhe është lënë jashtë vëmendjes shprehja vijuese i miratuar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Përmendet gjithashtu statusi i zonave informale.

Kujtojmë se pjesë e këtij legjislacioni është edhe ligji nr. 111/2012, i cili duhet të ishte mbajtur parasysh në cdo rast, qoftë edhe për objekte jashtë zonave informale ashtu edhe për ato brenda këtyre zonave. Observacioni nuk qendron.

- Lejet e legalizimit sipas listës së paraqitur nga ASHK Elbasan, të lëshuara nga DR e ALUIZNI-t Elbasan, mbi distancat nga rrugët automobilistike dhe hekurudhore. Mangësi dokumentare, etj.

Distanca nga rrugët nacionale

- **Dosja nr. 647, leje legalizimi nr. 3040868, datë 19.06.2017**, për objektin: “ Godinë e Kombinuar 2 kat+ 1 kat nën tokë”, për G H Xh, me adresë Bashkia Cërrik, Shtëpanjë, Zona



Kadastrale 3420, nr.pasurisë 16/8/5, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 152 m², sipërfaqja e ndërtimit 152 m², sipërfaqja totale e ndërtimit: për banim 343.6 m², për aktivitet 152, numri i kateve mbi tokë 2, nën tokë 1, titulli i pronësisë: “E regjistruar me certifikatë pronësie”. *Drejtori A T, Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit V H (ka nënshkruar A B).*

Nga auditimi konstatohet se sipas azhornimit me sistemin zyrtar geoportal-albania, proces-verbalit të verifikimit në terren dhe skicën fushore, objekti i legalizuar kufizohet në perëndim nga Rruga Nacionale “Cërrik-Gramsh”, rrugë Automobilistike kategorisë C, Rrugë Interurbane kryesore. Nga matja e kryer në 2 harta vektoriale Gen-planet me shkallë 1:500 dhe 1:2500, konstatohet se objekti i legalizuar “Godinë e Kombinuar 2 kat+ 1 kat nën tokë”, ndodhet në distancat nga **6.5 m** në **9 m** nga rruga nacionale.

Sa sipër që bie në kundërshtim me vendimin e KM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriteve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar me vendimin e KM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dhështesa në vendimin nr. 280, datë 1.4.2015, të këshillit të ministrave, ...”, pika 4, germa “b”/i, ku distanca nga kufiri rrugor për rrugët e kategorisë C, **është 10 m.**

Dokumenti i mësipërm është dokumenti i saktë, ndërkaq sipas matjeve në hartën dixhitale të përditësuar dhe nga skica fushore distancat nga rruga të objektit janë më të mëdha.

-Nga auditimi konstatohet se sipas shkresës së ZVRPP Elbasan, “Kthim përgjigje”, informacion për gjendjen juridike të pasurisë, rezulton se pasuria nr. 16/8/5, “Arë”, sipërfaqe 1633.34, pronësi Genci Xhika, regjistruar vol. 13, faqe 195.

Ndërkohë që ALUIZNI Elbasan ka miratuar lejen e legalizimit për ndërtimin pa leje mbi këtë pasuri, çka sjell ndryshimin automatikisht të zërit kadastral gjatë regjistrimit në ZVRPP, në mungesë të dokumentacionit: kërkesa për miratimin në Këshillin e Qarkut, të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Agjencisë Rajonale të Mjedisit. Pra, nuk ka asnjë dokumentacion nga këto organe, për t'i dhënë lejen, veprimet të kryer për legalizim në zonat “Territore të tjera”, veprime në kundërshtim me nenet 10, 11, 14, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar dhe VKM nr. 515, datë 13.5.2009 e VKM nr. 589, datë 10.9.2014, “Për përcaktimin e afateve, të mënyrës dhe kohës së ushtrimit nga ALUIZNI të përgjegjësive të zyrave të urbanistikës dhe të këshillave të qarqeve, gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale” si dhe Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit me nr. 5, datë 29.12.2014 “Për identifikimin e zonave të urbanizuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në miratimin e hartave ku mund të ndërhyhet në funksion të zhvillimit urban”, pika 9 ku përcaktohet: “Konvertimi nga tokë “Arë” në tokë “Truall” për sipërfaqet brenda zonave të urbanizuara do të bëhet sipas procedurave përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi”.

Regjistri i Parcelës Ndërtimore është nënshkruar për Sektorin e Çështjeve të Pronësisë nga Përgjegjësi znj. M S, dhe nga Drejtori z. A T. Gen-Plani është nënshkruar nga z. D B.

Proces-Verbali i verifikimit në terren, nuk është plotësuar në rubrikat për objektet kufitar dhe distancat nga këto objekte, mungesa të cilat e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale. Në këtë rast shkelja e konstatuar ka ndikuar në legalizimin e kryer në një distancë më të vogël se 10 m nga rruga.

Sa sipër është në kundërshtim me rubrikat sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

Proces-verbali i verifikimit në terren është nënshkruar nga specialistët e terrenit: z. J D dhe z. E H dhe për Sektorin e Hartografisë nga Përgjegjësi z. Sh P.



Me aktin e kualifikimit nr. 20527, datë 15.06.2017, objekti informal legalizohet, i nënshkruar nga specialisti z. A H, ish-Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit znj. V H dhe ish-Drejtori znj. A T. Proces-verbali i vlerësimit të dosjes së legalizimit është nënshkruar nga z. A H për Sektorin e Legalizimit, znj. J S, për Sektorin e Përpunimit të të Dhënave.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. A T, ish-Drejtor i ALUIZNI-t Elbasan, z. A B, ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. A H, specialist, znj. M S, Përgjegjës i Sektorit të Çështjeve të Pronësisë, z. D B, specialist Sektori i Çështjeve të Pronësisë, z. J D, specialist dhe specialist terreni, znj. J S, për Sektorin e Përpunimit të të Dhënave, z. Sh P, Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, z. E H, specialist terreni.

Me observacionin nr.1065/61, datë 03.09.2019, specialisti z. D B ka paraqitur opsionin e tij, ku thuhet se ndryshimi i zërit kadastral është kryer bazuar në rregulloren e brendshme, në një kohë që ligji për legalizimet nuk e lejon një gjë të tillë, përveçse me konfirmim nga Këshilli i Qarkut, Drejtoria Rajonale e Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Agjencia Rajonale e Mjedisit. Grupi i auditimit bazohet në hierarkinë ligjore.

Lidhur me vendosjen e hipotekës ligjore, kjo nuk është trajtuar në këtë dosje.

Observacioni nuk qëndron.

-Me observacionin nr.1065/61, datë 03.09.2019, specialisti z. A H ka paraqitur opsionin: “nga matjet faktike objekti ndodhet 12.3 m nga të 2 anët në një zonë të urbanizuar”.

Ritheksojmë faktin se distanca nga ruga nacionale Cërrrik-Gramsh është më e vogël se 10 m. Pretendimi se janë kryer matje nuk qëndron, sic kemi theksuar në mangësitë e hartimit të proces-verbalit të konstatimit. Observacioni nuk qëndron.

-Me observacionin nr.1065/66, datë 04.09.2019, ish-Drejtori z.A G ka paraqitur opsionin: “nga matjet faktike objekti ndodhet 12.3 m nga të 2 anët në një zonë të urbanizuar”.

Ritheksojmë faktin se distanca nga ruga nacionale Cërrrik-Gramsh është më e vogël se 10 m. Pretendimi se janë kryer matje nuk qëndron, sic kemi theksuar në mangësitë e hartimit të proces-verbalit të konstatimit. Observacioni nuk qëndron.

- Dosja nr. 12920, leje legalizimi nr. 988658, datë 30.06.2017, për objektin: “Godinë Shërbimi 1 kat”, për A B L, me adresë Bashkia Elbasan, Lagja Emin Matraxhiu, Zona Kadastrale 8521, nr.pasurisë 13/47/1, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 89.8 m², sipërfaqja e ndërtimit 89.8 m², sipërfaqja totale e ndërtimit: për banim - , për aktivitet 89.8 m², numri i kateve mbi tokë 1, nën tokë -, titulli i pronësisë: “Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1”. *Drejtori A T, Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit A B.*

Dokumentacioni i dosjes së kësaj leje legalizimi është i pa plotësuar me inventarin përkatës të dokumentacionit dhe numrit të fletëve për cdo dokument, në kundërshtim me Ligjin Nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”.

Sa më sipër dhe sipas praktikës përkatëse, konstatohet se neni 30, pika 2/1, citon se:

*Përcaktimet e këtij neni zbatohen edhe në rastin kur subjekti apo njëri prej subjekteve që disponojnë ndërtimin **me funksion banimi** nuk shlyejnë detyrimet financiare të parashikuara në ligj për vlerën e parcelës ndërtimore të objektit pa leje. Në këtë rast, për pasurinë ose pjesën takuese të subjektit debitor, regjistrimi bëhet sipas shkronjës “a”, të nenit 54, “Regjistrimi i hipotekës ligjore”, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.*

Në dosje nuk rezulton të ketë dokument financiar për pagesën e parcelës ndërtimore, pra nuk është paguar vlera e parcelës ndërtimore, në një kohë që objekti është me **funksion Social-Ekonomik** dhe nuk duhej vendosur hipotekë ligjore si dhe nuk duhej lëshuar leja e legalizimit pa u paguar vlera e parcelës ndërtimore sipas vendimit të KM për këtë qëllim. Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1 dhe VKM nr. 1095, datë 28.12.2015 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet aluizni-t dhe



zqrrp-së, dhe të procedurave apokufizimeve që zbatohen përefekt të regjistrimit të pasurivetë legalizuara”, Kreu III.

Nga auditimi konstatohet se sipas azhornimit me sistemin zyrtar geoportal-albania, skicën fushore, hartën tregues të dërdur nga ZVRPP Elbasan dhe sidomos nga matja e kryer në hartën sipas sistemit AUTOCAD që na u vu në dispozicion, “Hartat për KLSH”, përditësimi, NjA Elbasan, objekti i legalizuar kufizohet në perëndim nga Rruga Nacionale, rrugë Automobilistike kategorisë C, Rrugë Interurbane kryesore. Nga matjet e kryera, konstatohet se objekti i legalizuar “Godinë Shërbimi 1 kat”, ndodhet në distancat nga **6.4 m** në **7.1m** nga rruga nacionale.

Sa sipër që bie në kundërshtim me vendimin e KM nr. 280, datë 1.4.2015 “ Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar me vendimin e KM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dheshitesa në vendimin nr. 280, datë 1.4.2015, të këshillit të ministrave, ...”, pika 4, germa “b”/i, ku distanca nga kufiri rrugor për rrugët e kategorisë C, **është 10 m.**

-Proces-verbali i verifikimit në terren nuk ka datë kur është mbajtur, ndërkohë që vendimi për kualifikimin mban datën 22.06.2017, pra nuk mund të përcaktohet afati kohor: proces verbal verifikimi-vendim për kualifikimin, në kundërshtim me vendimin e KM nr. 280, datë 1.4.2015 “ Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar, pika 8, ku përcaktohet se:

Drejtoritë e ALUIZNI-t, bazuar në gjendjen faktike në terren, kryejnë procedurat kualifikuese për ndërtimin informal, brenda 60 ditëve nga data e evidentimit faktik në terren (data e "Procesverbalit të evidentimit në terren"). Për kryerjen e këtyre procedurave drejtoritë mbështeten në cilësitë e territorit, të paraqitura grafikisht.

Në dosje mungon:

-vërtetimi për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 27, germa “ç”, të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

Proces-Verbali i verifikimit në terren, nuk është plotësuar në rubrikat për: datën e mbajtjes, sipërfaqet e parcelës ndërtimore dhe sipërfaqes (njollës) së ndërtimit, numri i kateve, funksionet e hapësirave dhe distancat nga objektet kufitarë, numrat e pasurive, mungesa të cilat e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale. Në këtë rast shkelja e konstatuar ka ndikuar në legalizimin e kryer në një distancë më të vogël se 10 m nga rruga.

Sa sipër është në kundërshtim me rubrikat sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

Proces-verbali i verifikimit në terren është nënshkruar nga specialistët e terrenit: z. J D dhe z. A K dhe për Sektorin e Hartografisë nga Përgjegjësi z. Sh P.

Me aktin e kualifikimit nr. 20566, datë 22.06.2017, objekti informal legalizohet, i nënshkruar nga specialisti z. A H, ish-Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit z. A B dhe ish-Drejtori znj. A T.

Proces-verbali i vlerësimit të dosjes së legalizimit është nënshkruar nga z. A H për Sektorin e Legalizimit, z. Gj G, për Sektorin e Përpunimit të të Dhënave.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. A T, ish-Drejtor i ALUIZNI-t Elbasan, z. A B, ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. A H, specialist, znj. Gj G, për Sektorin e Përpunimit të të Dhënave, z. Sh P, Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, z. J D, specialist terreni, z. A K, specialist terreni.



DSHK (ish –ALUIZNI, punonjësit) Elbasan me observacionin nr. 1065/56, datë 16.08.2019 dhe znj. J S me observacionin nr. 1065/58, datë 03.09.2019, kanë paraqitur opsionet e tyre lidhur me problematikat e mësipërme, ku pretendojnë së 2 rastet janë në zonat informale gjë që nuk qëndron. Në asnjërin rast nuk kanë paraqitur vendimin e KKT përkatës, që nuk është gjetur. Observacioni nuk merret parasysh.

Me observacionin nr.1065/61, datë 03.09.2019, specialisti z.A H ka paraqitur opsionin: “Objekti i legalizuar gjendet në zonën informale 4”.

Pretendimi i mësipërm është i mangët, sepse nuk tregon numrin dhe datën e vendimit të KKT për shpallje zonë informale. Observimi nuk qëndron.

Distanca nga Hekurudha

- **Dosja nr. 138, leje legalizimi nr. 3040589, datë 20.06.2017**, për objektin: “ Godinë Shërbimi 1 kat”, për R H S, me adresë Bashkia Elbasan, Mengel, Zona Kadastrale 2654, nr.pasurisë 1070, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 339.6 m², sipërfaqja e ndërtimit 113.2 m², sipërfaqja totale e ndërtimit: për banim - m², për aktivitet 113.2, numri i kateve mbi tokë 1, nën tokë -, titulli i pronësisë: “Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1”. Drejtori A T, Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit V H (firmosur A B).

Sa më sipër dhe sipas praktikës përkatëse, konstatohet se neni 30, pika 2/1, citon se:

*Përcaktimet e këtij neni zbatohen edhe në rastin kur subjekti apo njëri prej subjekteve që disponojnë ndërtimin **me funksion banimi** nuk shlyejnë detyrimet financiare të parashikuara në ligj për vlerën e parcelës ndërtimore të objektit pa leje. Në këtë rast, për pasurinë ose pjesën takuese të subjektit debitor, regjistrimi bëhet sipas shkronjës “a”, të nenit 54, “Regjistrimi i hipotekës ligjore”, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.*

Në dosje nuk rezulton të ketë dokument financiar për pagesën e parcelës ndërtimore, pra nuk është paguar vlera e parcelës ndërtimore, në një kohë që objekti është me **funksion Social-Ekonomik** dhe nuk duhej vendosur hipotekë ligjore si dhe nuk duhej lëshuar leja e legalizimit pa u paguar vlera e parcelës ndërtimore sipas vendimit të KM për këtë qëllim. Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1 dhe VKM nr. 1095, datë 28.12.2015 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet aluizni-t dhe zqrrp-së, dhe të procedurave apokufizimeve që zbatohen përfekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara”, Kreu III.

Nga auditimi konstatohet se në dosje ndodhet **dokumenti fotokopje**, nr. 789/1, datë 14.06.2017, “Kthim përgjigje shkresës nr. 5431, datë 01.06.2017”, dërguar nga Hekurudha Shqiptare SHA, sipas së cilës objekti i legalizuar ndodhet 12 m nga fundi i skarpatës, ku konfirmohet që të vazhdojë procedura e legalizimit, sepse nuk çenohet brezi hekurudhor”.

(Dokumenti origjinal është në protokoll dhe nuk gjendet në inventarin e dosjes)

Proces-Verbali i verifikimit në terren, nuk është plotësuar në rubrikat për numrat e objekteve kufitare dhe distancat nga këto objekte, mungesa të cilat e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale.

Sa sipër është në kundërshtim me rubrikat sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

Proces-verbali i verifikimit në terren është nënshkruar nga specialistët e terrenit: z. Th D dhe z. A B dhe për Sektorin e Hartografisë nga Përgjegjësi z. Sh P.

Me aktin e kualifikimit nr. 20524, datë 15.06.2017, objekti informal legalizohet, i nënshkruar nga specialisti z. A H, ish-Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit znj. V H (firmosur z. A G) dhe ish-Drejtori znj. A T.



Proces-verbali i vlerësimit të dosjes së legalizimit është nënshkruar nga z. A H dhe znj. E A për Sektorin e Legalizimit, znj. N S, për Sektorin e Përpunimit të të Dhënave.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. A T, ish-Drejtor i ALUIZNI-t Elbasan, z. A B, ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. A H, specialist, znj. N S, për Sektorin e Përpunimit të të Dhënave, z. Sh Pa, Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, z. Th D, specialist terreni, z. A B, specialist terreni.

- Dosja nr. 8444, 1360, leje legalizimi nr. 3054852, datë 21.06.2017, për objektin: “Godinë e kombinuar 2 kat”, për S M Zh, K M Zh, me adresë Bashkia Elbasan, Labinot Fushë, Zona Kadastrale 2355, nr.pasurisë 241/1, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 500 m², sipërfaqja e ndërtimit 192 m², sipërfaqja totale e ndërtimit: për banim 241.6 m², për aktivitet 192, numri i kateve mbi tokë 2, nën tokë -, titulli i pronësisë: “Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1”. Drejtori A T, Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit V H (firmosur A B).

Sa më sipër dhe sipas praktikës përkatëse, konstatohet se neni 30, pika 2/1, citon se:

*Përcaktimet e këtij neni zbatohen edhe në rastin kur subjekti apo njëri prej subjekteve që disponojnë ndërtimin **me funksion banimi** nuk shlyejnë detyrimet financiare të parashikuara në ligj për vlerën e parcelës ndërtimore të objektit pa leje. Në këtë rast, për pasurinë ose pjesën takuese të subjektit debitor, regjistrimi bëhet sipas shkronjës “a”, të nenit 54, “Regjistrimi i hipotekës ligjore”, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.*

Në dosje nuk rezulton të ketë dokument financiar për pagesën e parcelës ndërtimore, pra nuk është paguar vlera e parcelës ndërtimore, në një kohë që objekti është me **funksion të Kombinuar** dhe nuk duhej vendosur hipotekë ligjore si dhe nuk duhej lëshuar leja e legalizimit pa u paguar vlera e parcelës ndërtimore sipas vendimit të KM për këtë qëllim. Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1 dhe VKM nr. 1095, datë 28.12.2015 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet aluizni-t dhe zqrrp-së, dhe të procedurave apokufizimeve që zbatohen përfekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara”, Kreu III.

Nga auditimi konstatohet se sipas materialit hartografik dhe pozicionimit të pronës, të paraqitur në 2 gen-planet me shkallë zvogëlimi 1:500 dhe 1:2500, nga matjet që u bënë në këto gen-plane, konstatohet se objekti informal “Godinë e kombinuar 2 kat”, **është ndërtuar në një distancë shumë afër hekurudhës më pak 25 m** dhe në dosje nuk ka asnjë dokumentacion që vërteton marrjen e konfirmimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave për legalizimin e objektit, veprime këto që bien në kundërshtim me nenin 45, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, pika 5 e Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrat të regjistruarit”, Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, të ndryshuar dhe pika 2, gërma “b”, pika 3, pika 4, gërma “a”, pika 5 të VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”.

Proces-Verbali i verifikimit në terren, nuk është plotësuar në rubrikat për: destinacionin e sipërfaqeve, numrat e pasurive të objekteve kufitarë dhe distancat nga këto objekte, mungesa të cilat e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale.

Sa sipër është në kundërshtim me rubrikat sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t dhe shkalla e shkeljes rëndohet për faktin e përmendur më sipër që ndodhet brenda distancës nga hekurudha, ku nuk lejohen ndërtime.

Proces-verbali i verifikimit në terren është nënshkruar nga specialistët e terrenit: z. E H dhe z. A D dhe për Sektorin e Hartografisë nga Përgjegjësi z. Sh P.



Me aktin e kualifikimit nr. 20507, datë 12.06.2017, objekti informal legalizohet, i nënshkruar nga specialisti z. A H, ish-Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit znj. V H (firmosur z. A B) dhe ish-Drejtori znj. A T.

Proces-verbali i vlerësimit të dosjes së legalizimit është nënshkruar nga z. A H dhe znj. E A dhe J D për Sektorin e Legalizimit, znj. J S, për Sektorin e Përpunimit të të Dhënave.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. Aurora Terziu, ish-Drejtor i ALUIZNI-t Elbasan, z. A B, ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. A H, specialist, znj. J S, për Sektorin e Përpunimit të të Dhënave, znj. E A, specialist, z. J D, specialist, z. Sh P, Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, z. E H, specialist terreni, z. A D, specialist terreni.

Me observacionin nr. 1065/61, datë 03.09.2019, specialisti z. A H ka paraqitur opsionin: "Objekti ndodhet 25.38 m nga hekurudha"

Matja është bërë bazuar në materialin hartografik, në 2 harta vektoriale 1:500 dhe 1:2500 dhe rezulton më pak se 25 m nga hekurudha. Observimi nuk qëndron.

Znj. J S me observacionin nr. 1065/58, datë 03.09.2019, ka shmangur përgjegjësinë e saj si Përgjegjëse e Hartografisë, kur në fakt ka firmosur proces-verbalin e vlerësimit të dosjes ka përgjegjësi për hartimin e proces-verbalit në terren. Observacioni nuk qëndron

- Dosja nr. 12208, leje legalizimi nr. 2526985, datë 10.11.2017, për objektin: "Godinë Shërbimi 1 kat", për A I B, me adresë Bashkia Elbasan, Mengel, Zona Kadastrale 2654, nr. pasurisë 1559/4, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 299.7 m², sipërfaqja e ndërtimit 130.5 m², sipërfaqja totale e ndërtimit: për banim - m², për aktivitet 130.5 m², numri i kateve mbi tokë 1, nën tokë -, titulli i pronësisë: "Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1". Drejtori F D, Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit A B.

-Dokumentacioni i dosjes së kësaj leje legalizimi është i pa plotësuar me inventarin përkatës të dokumentacionit dhe numrit të fletëve për cdo dokument, në kundërshtim me Ligjin Nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat".

Sa më sipër dhe sipas praktikës përkatëse, konstatohet se neni 30, pika 2/1, citon se:

Përcaktimet e këtij neni zbatohen edhe në rastin kur subjekti apo njëri prej subjekteve që disponojnë ndërtimin me funksion banimi nuk shlyejnë detyrimet financiare të parashikuara në ligj për vlerën e parcelës ndërtimore të objektit pa leje. Në këtë rast, për pasurinë ose pjesën takuese të subjektit debitor, regjistrimi bëhet sipas shkronjës "a", të nenit 54, "Regjistrimi i hipotekës ligjore", të ligjit nr. 33/2012, "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.

Në dosje nuk rezulton të ketë dokument financiar për pagesën e parcelës ndërtimore, pra nuk është paguar vlera e parcelës ndërtimore, në një kohë që objekti është me **funksion Social-Ekonomik** dhe nuk duhej vendosur hipotekë ligjore si dhe nuk duhej lëshuar leja e legalizimit pa u paguar vlera e parcelës ndërtimore sipas vendimit të KM për këtë qëllim. Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1 dhe VKM nr. 1095, datë 28.12.2015 "Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet aluizni-t dhe zqrrp-së, dhe të procedurave apokufizimeve që zbatohen përfekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara", Kreu III.

Nga auditimi konstatohet se sipas materialit hartografik dhe pozicionimit të pronës, të paraqitur në gen-planin me shkallë zvogëlimi 1:500, nga matja që u bënë në këtë gen-plan, konstatohet se objekti informal "Godinë Shërbimi 1 kat", **është ndërtuar në një distancë shumë afër hekurudhës më pak 25 m** dhe në dosje nuk ka asnjë dokumentacion që vërteton marrjen e konfirmimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave për legalizimin e objektit, veprime këto që bien në kundërshtim me nenin 45, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", pika 5 e Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrin të regjistruesit", Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, të ndryshuar



dhe pika 2, gërma “b”, pika 3, pika 4, germë “a”, pika 5 të VKM nr. 280, date 01.04.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”.

-Proces-verbali i verifikimit në terren nuk ka datë pra nuk mund të përcaktohet afati kohor proces verbal verifikimi - vendimi për kualifikim datë 09.11.2017, në kundërshtim me vendimin e KM nr. 280, datë 1.4.2015 “ Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar, pika 8, ku përcaktohet se:

Drejtoritë e ALUIZNI-t, bazuar në gjendjen faktike në terren, kryejnë procedurat kualifikuese për ndërtimin informal, brenda 60 ditëve nga data e evidentimit faktik në terren (data e "Procesverbalit të evidentimit në terren"). Për kryerjen e këtyre procedurave drejtoritë mbështeten në cilësitë e territorit, të paraqitura grafikisht.

Në dosje mungojnë:

-vërtetimi për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 27, germa “ç”, të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

Proces-Verbali i verifikimit në terren, nuk është plotësuar në rubrikat për: datën e mbajtjes, sipërfaqen e parcelës ndërtimore, sipërfaqen e bazës (njollës së ndërtimit), destinacionin e sipërfaqeve, numrat e pasurive të objekteve kufitarë dhe distancat nga këto objekte, mungesa të cilat e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale.

Sa sipër është në kundërshtim me rubrikat sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t dhe shkalla e shkeljes rëndohet për faktin e përmendur më sipër që ndodhet brenda distancës nga hekurudha, ku nuk lejohen ndërtime.

Proces-verbali i verifikimit në terren është nënshkruar nga specialistët e terrenit: z. B Gj dhe z. E K dhe për Sektorin e Hartografisë nga Përgjegjësi z. Sh P.

Me aktin e kualifikimit nr. 21404, datë 09.11.2017, objekti informal legalizohet, i nënshkruar nga specialisti znj. A T, z. A B dhe ish-Drejtori z. F D.

Punuar praktika ngaz. F D, ish-Drejtor i ALUIZNI-t Elbasan, z. A B, ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, znj. A T, specialiste, z. Sh P, Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë.

Z. F D, ish-Drejtor, ka paraqitur observacionin me pretendimin se:

-Lidhur me largësinë nga hekurudha observohet se objekti ndodhet në zonë informale, por kujtojmë s qënja në këtë zonë nuk do të thotë:të mos paraqitet dokumentacion që vërteton marrjen e konfirmimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave për legalizimin e objektit, të mos merren parasysh neni 45, i ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, pika 5 e Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrat të regjistruarit”, Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, të ndryshuar dhe pika 2, gërma “b”, pika 3, pika 4, germë “a”, pika 5 të VKM nr. 280, date 01.04.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”. Observacioni nuk qëndron.

-Lidhur me vendosjen e hipotekës ligjore është përmendur mungesa e VKM për parcelën ndërtimore, kur kjo është detyrim vetëm për ndërtesat e banimit. Për rastin konkret nuk duhej të ishte lëshuar leja e legalizimit, kjo sipas nenit 30, pika 2/1, të ligjit për legalizimin Observacioni nuk qëndron.



-Përproces-verbalin e verifikimit në terren, pretendohet se të dhënat mbi largësië nga objektet kufitare, etj., janë pasqyruar në skicën fushore.

Sa sipër kujtojmë se skica fushore nuk është dokument i njohur për vërtetimin e kryerjes së matjeve, pasi është një skicë e përgatitur me laps plumbi, po kështu edhe firmat e specialistëve. Dokument i njohur ligjërish është vetëm Akti i Verifikimit në Terren. Observacioni nuk qëndron.

-Pretendohet se janë zbatuar procedurat për inventarizimin r dosjes, në një kohë që nuk ka inventar. Observacioni nuk qëndron.

- Dosja nr. 446, leje legalizimi nr. 2580684, datë 15.04.2019, për objektin: “Godinë banimi 1 kat+ 1 kat nën tokë”, për L D Ll, me adresë Bashkia Elbasan, Bradashesh, Zona Kadastrale 1258, nr.pasurisë 120/18/1, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 499.8 m², sipërfaqja e ndërtimit 166.6 m², sipërfaqja totale e ndërtimit: për banim 232.2 m², për aktivitet - m², numri i kateve mbi tokë 1, nën tokë 1, titulli i pronësisë: “Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1”. Drejtori A G, Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit K D.

-Dokumentacioni i dosjes së kësaj leje legalizimi është i pa plotësuar me inventarin përkatës të dokumentacionit dhe numrit të fletëve për cdo dokument, në kundërshtim me Ligjin Nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”.

Nga auditimi konstatohet se sipas materialit hartografik dhe pozicionimit të pronës, të paraqitur në gen-planin me shkallë zvogëlimi 1:2500 nga matja që u bënë në këtë gen-plan, si dhe nga matja e kryer në Harten sipas AUTOCAD-it që na u vu në dispozicion, “Hartat për KLSH”, përditësimi, NjA Bradashesh, konstatohet se objekti informal “Godinë banimi 1 kat+ 1 kat nën tokë”, është ndërtuar në një distancë shumë afër hekurudhës më pak 25 m nga brezi hekurudhor dhe në dosje nuk ka asnjë dokumentacion që vërteton marrjen e konfirmimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave për legalizimin e objektit, veprime këto që bien në kundërshtim me nenin 45, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, pika 5 e Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrat të regjistruesit”, Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, të ndryshuar dhe pika 2, gërma “b”, pika 3, pika 4, gërma “a”, pika 5 të VKM nr. 280, date 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”.

Proces-Verbali i verifikimit në terren, nuk është plotësuar në rubrikat për: sipërfaqen e parcelës ndërtimore, sipërfaqen e bazës (njollës së ndërtimit), destinacionin e sipërfaqeve, numrat e pasurive të objekteve kufitare dhe distancat nga këto objekte, mungesa të cilat e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale.

Sa sipër është në kundërshtim me rubrikat sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t dhe shkalla e shkeljes rëndohet për faktin e përmendur më sipër që ndodhet brenda distancës nga hekurudha, ku nuk lejohen ndërtime.

Proces-verbali i verifikimit në terren është nënshkruar nga specialistët e terrenit: z. Th D dhe z. A B dhe për Sektorin e Hartografisë nga Përgjegjësi z. Sh P.

Me aktin e kualifikimit nr. 24572, datë 27.02.2019, objekti informal legalizohet, i nënshkruar nga specialisti z. A H, z. K D dhe ish-Drejtori z. A G.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A G, ish-Drejtor i ALUIZNI-t Elbasan, z. K D, Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. A H, specialist, z. Sh P, Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, z. Th D, specialist terreni, z. A B, specialist terreni.



Me observacionin nr.1065/61, datë 03.09.2019, specialisti z.A H ka paraqitur opsionin: “Ka patur gabime në harta”

Theksojmë se kjo nuk është çeshtje e grupit të auditimit i cili bazohet ne dokumentacionin shkresor dhe hartografik.

Observimi nuk qëndron.

Me observacionin nr. 1065/66, datë 04.09.2019, ish-Drejtori z. A G, pretendon se objekti ndodhet në zonë urbane, gjë që nuk ka lidhje me largësinë e objektit nga hekurudha.

Observimi nuk qëndron.

- Dosja, datë 12.06.2017, për objektin: “Shtesë anësore 1 kat+ngritje 1 kat shërbimi në Godinë Ekz. 3 kat”, me adresë Bashkia Cërrik, Zona Kadastrale 2559, nr.pasurisë 6/29/22, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 363+555.14 m², sipërfaqja e ndërtimit 8.3+8.3+478.38 m², sipërfaqja totale e ndërtimit: për banim - m², për aktivitet 286.6, numri i kateve mbi tokë 2, nën tokë -, titulli i pronësisë: “E regjistruar me certifikatë pronësie”.Drejtori A T, Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit V H (firmosur A B).

Nga auditimi konstatohet se Proces-Verbali i verifikimit në terren mban datën 15.09.2017,ndërkohë që leja e legalizimit është lëshuar më datë 12.06.2017, pra ka mospërputhje, i nënshkruar nga specialistët e terrenit z. F H dhe z. E H, si dhe nga Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë z. Sh P.

Në dosje mungojnë:

-vërtetimi për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 27, germa “ç”, të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

Proces-verbali i vlerësimit të dosjes së legalizimit është nënshkruar nga z. A H për Sektorin e Legalizimit, znj. J S, për Sektorin e Përpunimit të të Dhënave.

Punuar praktika nga specialiteti A T, ish-Drejtor i ALUIZNI-t Elbasan, z. A B, ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. A H, specialist, znj. J S, për Sektorin e Përpunimit të të Dhënave, z. Sh P, Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, z. F H, specialist terreni, z. E H, specialist terreni.

- Dosja nr. 2081, leje legalizimi nr. 2580815, datë 26.04.2019, për objektin: “Godinë e Kombinuar 6 Kat+ 1 kat nëntokë”, për A E N, M E N, I E N, K E N, me adresë Bashkia Prrenjas, Lagja Domosdova, Zona Kadastrale 2924, nr. pasurisë 2/658/2, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 100+1001 m², sipërfaqja e ndërtimit 170.7 m², sipërfaqja totale e ndërtimit: për banim 372.2, për aktivitet 525.7 m², numri i kateve mbi tokë 6, nën tokë 1, titulli i pronësisë: “Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1”.

Drejtori A G, Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit K D.

Dokumentacioni i dosjes së kësaj leje legalizimi është i pa plotësuar me inventarin përkatës të dokumentacionit dhe numrit të fletëve për cdo dokument, në kundërshtim me Ligjin Nr. 9154, date 06.11.2003, “Për Arkivat”.

Nga auditimi konstatohet se Proces-Verbali i verifikimit në terren mban datën 17.04.2017, ndërkohë që vendimi për kualifikim është marrë më datë 26.01.2019, pra verifikimi i terrenit është kryer pas kualifikimit, ka mospërputhje, i nënshkruar nga specialistët e terrenit z. R B dhe z. K T, si dhe nga Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë z. Sh P.

Sipas dokumentacionit të disponuar në dosje, objekti në fjalë i legalizuar është trajtuar së bashku me lejet e ndërtimit të dhëna gjatë viteve, e konkretisht: Extra vendim i KRRT-së, Bashkia Prrenjas nr. 06, datë 29.09.2011, për rikondicionim të sheshit dhe lejes së ndërtimit nr. 03, datë 31.03.2006.

Sipas shkresës së ZVRPP Librazhd nr. 111/1, datë 19.04.2019, “Kthim përgjigje”, informacion për gjendjen juridike të pasurive, konstatohet se pasuria nr. 2/658/2, është e llojit “Truall”, sipërfaqe 8223.6 m², regjistruar në vol.14, faqe 246, ZK 2924, pronë “Shtet”.



Sipas shënimeve në lejen e legalizimit, titulli i pronësisë, jepet si referencë ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1, sipas të cilit citojmë:

*Përcaktimet e këtij neni zbatohen edhe në rastin kur subjekti apo njëri prej subjekteve që disponojnë ndërtimin **me funksion banimi** nuk shlyejnë detyrimet financiare të parashikuara në ligj për vlerën e parcelës ndërtimore të objektit pa leje. Në këtë rast, për pasurinë ose pjesën takuese të subjektit debitor, regjistrimi bëhet sipas shkronjës “a”, të nenit 54, “Regjistrimi i hipotekës ligjore”, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.*

Në dosje nuk rezulton të ketë dokument financiar për pagesën e parcelës ndërtimore, pra nuk është paguar vlera e parcelës ndërtimore, në një kohë që objekti është me **funksion të Kombinuar** dhe nuk duhej vendosur hipotekë ligjore si dhe nuk duhej lëshuar leja e legalizimit pa u paguar vlera e parcelës ndërtimore sipas vendimit të KM për këtë qëllim. Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1 dhe VKM nr. 1095, datë 28.12.2015 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet aluizni-t dhe zqrrp-së, dhe të procedurave apokufizimeve që zbatohen përfekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara”, Kreu III.

-Vendimi për kualifikim është marrë më datë 26.01.2019 ndërsa leja e legalizimit është lëshuar më datë 26.04.2019, pra pas 90 ditësh, në kundërshtim me Urdhrin nr. 37, datë 19.01.2016 “Për miratimin e planveprimit për shqyrtimin administrativ të praktikave të legalizimit të ndërtimeve pa leje”, pika 6- Miratimi i lejes së legalizimit përpara kalimit të pronësisë, germa “a”, ku citohet:

Plotësimi dhe miratimi (nënshkrimi+ vulosje) i lejes së legalizimit bëhet brënda 30 ditëve nga data e Vendimit të Kualifikimit.

-Proces-verbali i verifikimit në terren nuk është plotësuar me rubrikat për: sipërfaqet e parcelës ndërtimore, njolla e objektit, numri i kateve dhe destinacioni i sipërfaqeve. Përsa i përket pasurive kufitare (të saktësuara në përshkrim) nuk janë shënuar numrat e pasurive dhe distancat nga pasuritë kufitare.

Këto mungesa, vecanërisht mungesa e sipërfaqes së parcelës ndërtimore dhe distancave nga objektet kufitare e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale.

Sa sipër është në kundërshtim me rubrikat sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

Proces-verbali i vlerësimit të dosjes është nënshkruar nga z. A H dhe nga znj. N S për Sektorin e Përpunimit të të Dhënave.

Me aktin e kualifikimit nr. 24348, datë 26.01.2019, objekti informal legalizohet, i nënshkruar nga z. A H, z. K D dhe Drejtori z. A G.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A G, ish-Drejtor i ALUIZNI-t Elbasan, z. K D, ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. A H, specialist, znj. N S, për Sektorin e Përpunimit të të Dhënave, z. Sh P, ish-Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, z. R B, specialist terreni, z. K T, specialist terreni.

Me observacionin nr.1065/61, datë 03.09.2019, specialisti z.A H ka paraqitur opsionin: “data e kualifikimit është lapsus dhe e saktë është 26.04.2019”

Ritheksojmë se në vlerësimet e kryera grupi i KLSH bazohet në dokumentacionin shkresor dhe hartografik të vënë në dispozicion. Observimi nuk qëndron.

Me observacionin nr.1065/66, datë 04.09.2019, ish-Drejtori z.A G ka paraqitur opsionin: “data e kualifikimit është plotësuar gabimisht dhe data e saktë e saktë është 26.04.2019. Lidhur me hipotekën ligjore zbatuar udhëzimi 1095/2015”.

Ritheksojmë se në vlerësimet e kryera grupi i KLSH bazohet në dokumentacionin shkresor dhe hartografik të vënë në dispozicion. Përsa i takon hipotekës ligjore, në rradhën hierarkike është



ligji i pari, neni 30, pika 2/1, që përjashton nga ky proces objektet social-ekonomike. Observimi nuk qëndron.

-Lejet e legalizimit sipas listës së paraqitur nga ASHK Elbasan, të lëshuara nga DR e ALUIZNI-t Elbasan, në kushte të ndryshimit të objektit të lejes së ndërtimit, sipas nenit 1, pika 1, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

- Dosja nr. s`ka, (M M M, H A K, L I H, E E L, A L Sh, V L R), leje legalizimi nr. 9898592, datë 22.06.2017, për objektin: “Godinë e kombinuar 9 Kat+1 kat nën tokë”, për Pronarët e Apartamenteve, me adresë Bashkia Elbasan, Lagjja “Aqif Pasha”, Zona Kadastrale 8524, nr.pasurisë 7/412, sipërfaqja e parcelës ndërtimore - m², sipërfaqja e ndërtimit 390 m², sipërfaqja totale e ndërtimit: për banim 2470 m², për aktivitet 518 m², numri i kateve mbi tokë 9, nën tokë 1, titulli i pronësisë: “Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1”. Drejtori A T, Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit A G.

Dokumentacioni i dosjes së kësaj leje legalizimi është i pa plotësuar me inventarin përkatës të dokumentacionit dhe numrit të fletëve për cdo dokument, në kundërshtim me Ligjin Nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”.

Sa më sipër dhe sipas praktikës përkatëse, konstatohet se neni 30, pika 2/1, citon se:

*Përcaktimet e këtij neni zbatohen edhe në rastin kur subjekti apo njëri prej subjekteve që disponojnë ndërtimin **me funksion banimi** nuk shlyejnë detyrimet financiare të parashikuara në ligj për vlerën e parcelës ndërtimore të objektit pa leje. Në këtë rast, për pasurinë ose pjesën takuese të subjektit debitor, regjistrimi bëhet sipas shkronjës “a”, të nenit 54, “Regjistrimi i hipotekës ligjore”, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.*

Në dosje nuk rezulton të ketë dokument financiar për pagesën e parcelës ndërtimore, pra nuk është paguar vlera e parcelës ndërtimore, në një kohë që objekti është me **funksion të Kombinuar** dhe nuk duhej vendosur hipotekë ligjore si dhe nuk duhej lëshuar leja e legalizimit pa u paguar vlera e parcelës ndërtimore sipas vendimit të KM për këtë qëllim. Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1 dhe VKM nr. 1095, datë 28.12.2015 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet aluizni-t dhe zqrrp-së, dhe të procedurave apokufizimeve që zbatohen përfekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara”, Kreu III.

Sipas lejes së legalizimit nr. nr. 9898592, datë 22.06.2017, kemi të bëjmë me godinë të kombinuar 9 kate, në një kohë që sipas akt-marrëveshjeve të lidhura në vitet 2004, 2005, 2006, ndërmjet investitorit z. L Gj dhe qytetarëve blerës:

-Akt-Marrëveshje me A S, lidhur datë 16.06.2004.

-Akt-Marrëveshje me M M, lidhur datë 07.07.2005 dhe 19.09.2006.

-Akt-Marrëveshje me H K, lidhur datë 22.09.2006.

Në rubrikën “Legjitimiteti i shitësit”, konstatohet se objekti i legalizuar ka qenë nisur për ndërtim sipas lejeve të ndërtimit nr.5, datë 26.04.2002 dhe nr. 07, datë 16.05.2003, për objektin “Pallat 7 kat+podrum”.

Nga auditimi i dosjes plotësuese, rezulton leja e sheshit dhe e ndërtimit, të njësuara me origjinalin nr. 07, datë 16.05.2003, lëshuar nga KRRT Bashkia Elbasan, objekti: “7 kat +podrum (2 katet e para lokale). Sipërfaqja e sheshit 538.75; sipërfaqja e ndërtimit në bazë 370 m². Leja është lëshuar në favor të subjektit “N”, me investitorë A S dhe L Gj, në truallin e z. I Z, z. S P, z. R M.

Sa sipër, rezulton se kemi të bëjmë me shtesa (anësore apo në lartësi) tej lejes së ndërtimit, me qëllim kalimin e së drejtës së pronësisë apo qiradhënien dhe jo objekt informal, siç del nga leja e legalizimit, për rrjedhojë duhej që investitori të paguante për efekt të legalizimit, 2 përqind të çmimit minimal fiskal, për çdo m² sipërfaqe banimi dhe 5 përqind për veprimtari social ekonomike.



Sa sipër është në kundërshtim me ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, neni 43.

Sipas Aktit të Kolauditimit të disponuar në dosje dhe të firmosur vetëm nga kolaudatori dhe sipas projektit të zbatimit të disponuar gjithashtu në dosje, rezulton se sipas lejes së ndërtimit janë parashikuar sipërfaqe lokale shërbimi 789 m², ndërsa sipërfaqe banimi janë parashikuar 1769 m². Sipas lejes së legalizimit janë legalizuar 2470 m² sipërfaqe banimi me një shtesë prej 701 m² (2470-1769), krahasuar me sipërfaqen sipas lejes së ndërtimit.

Çmimi minimal fiskal për qytetin e Elbasanit, sipas VKM nr. 132, datë 07.03.2018, është 50,300 lekë/m².

Rrjedhimisht për shtesën e mësipërme investitori duhej të paguante një penalitet prej 705,206 (701x50,300x2%).

Lidhur me sipërfaqen e lokaleve të shërbimit këto janë pakësuar nga 789 m² në 518 m², pra është pakësuar me 271 m² (789-518), duke u ndryshuar destinacionin dhe duke i kaluar në sipërfaqe banimi.

Për këtë rast investitori duhej të paguante një penalitet prej 1,363,130 (271x50,300x10%).

Gjithsej investitori duhej të paguante 2,068,336 lekë (705,206+1,363,130).

Vlefia 2,068,336 lekë përbën të ardhur të munguar për buxhetin e shtetit.

Në dosje mungon: -Proces-Verbali i verifikimit në terren; -Skica fushore; -Fotografite e 4 pamjeve të objektit; -Vendimi për kualifikimin e objektit informal; -Planimetritë e ndërtimit informal për çdo kat.

Sa sipër bie në kundërshtim me:

- VKM nr.437, datë 28.6.2006 ”Për përcaktimin e procedurave për mbledhjen, përpunimin dhe administrimin e të dhënave për ndërtimet pa leje, për ngritjen e bazës së të dhënave”, pika 1/ii, pika 2, VKM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, pika 8, VKM nr. 1095, datë 28.12.2015 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet aluizni-t dhe zqrrp-së, dhe të procedurave apokufizimeve që zbatohen përfekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara”, pika 10, -urdrin e Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t nr.8, datë 30.10.2006 “Për miratimin e manualit të hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike”, pika 1.2, -vërtetimi për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 27, germa “ç”, të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. A T, ish-Drejtor i ALUIZNI-t Elbasan, z. A B, ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. Sh P, ish-Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë

- Lejet e legalizimit sipas listës së paraqitur nga ASHK Elbasan, të lëshuara nga DR e ALUIZNI-t Elbasan, në kushte të plotësimit të dosjes memangësi dokumentare: mosinventarizim të dosjes, në proces-verbalin e verifikimit të terren, dokumentin e vërtetues për pagesën e taksës së infrastrukturës, moszbatim të afateve të plotësimit të dokumentave, etj.

- **Dosja nr. s'ka, leje legalizimi nr. 2580635, datë 09.04.2019**, për objektin: “Godinë Banimi 3 Kat”, për A G H, me adresë Bashkia Elbasan, Lagjia “Aqif Pasha”, Zona Kadastrale 8524, nr.pasurisë 7/694/2, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 85.6 m², sipërfaqja e ndërtimit 85.6 m², sipërfaqja totale e ndërtimit: për banim 323.9, për aktivitet -, numri i kateve mbi toke 3, nën tokë -, titulli i pronësisë: Me certifikatë pronësie “Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1”. Drejtori A G, Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit K D.



Dokumentacioni i dosjes së kësaj leje legalizimi është i pa plotësuar me inventarin përkatës të dokumentacionit dhe numrit të fletëve për cdo dokument, në kundërshtim me Ligjin Nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”.

Në dosje mungon:

-vërtetimi për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 27, germa “ç”, të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

-Në proces-verbalin e verifikimit në terren datë s`ka, nuk është plotësuar me sipërfaqet e parcelës ndërtimore, njollës së objektit, sipërfaqet për banim dhe aktivitet. Nuk mund të përcaktohet afati kohor proces-verbal verifikimi – vendim kualifikimi, në kundërshtim me vendimin e KM nr. 280, datë 1.4.2015 “ Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar, pika 8, ku përcaktohet se:

Drejtoritë e ALUIZNI-t, bazuar në gjendjen faktike në terren, kryejnë procedurat kualifikuese për ndërtimin informal, brenda 60 ditëve nga data e evidentimit faktik në terren (data e "Procesverbalit të evidentimit në terren"). Për kryerjen e këtyre procedurave drejtoritë mbështeten në cilësitë e territorit, të paraqitura grafikiisht.

Përsa i përket pasurive kufitare (të saktësuara në përshkrim) nuk janë shënuar distancat nga këto pasuri, me numrin e pasurisë.

Këto mungesa, vecanërisht mungesa e sipërfaqes së parcelës ndërtimore dhe mungesa e distancave nga objektet kufitare e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale.

Sa sipër është në kundërshtim me rubrikat sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

Proces-Verbali i verifikimit në terren është nënshkruar nga specialistët e terrenit F H, V Sh dhe Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë z. Sh P.

Me aktin e kualifikimit nr. 24799, datë 09.04.2019, objekti informal legalizohet, i nënshkruar nga z. A H, Sektori i Çështjeve të Pronësisë, Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit z. K D Përgjegjësi i Sektorit të legalizimit dhe Drejtori Artur Guni.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. Artur Guni, ish-Drejtor i ALUIZNI-t Elbasan, z. Klajdi Dyrmishi, Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. A H, specialist në Sektorin e Kalimit të Pronësisë, z. Shpëtim Pashollari, ish-Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë, z. F H, specialist terreni, z. V Sh, specialist terreni.

Me observacionin nr.1065/61, datë 03.09.2019, specialisti z.A H ka paraqitur opsionin: "Për mirëfunksionimin e Drejtorise janë nxjerrë urdhra të brendshëm prandaj nuk mund të ngarkohem me përgjegjësi". Ritheksojmë se grupi i auditimit bazohet në auditimin sipas hierarkisë së akteve ligjore. Cdo firmë e vendosur përmban në vetvete mbajtje përgjegjësie.

Observimi nuk qëndron.

- Dosja nr. 2587, leje legalizimi nr. 2580523, datë 25.03.2019, për objektin: “Godinë Social-Ekonomike 1 kat”, për F S Ç, me adresë Bashkia Elbasan, Lagjia “5 Maj”, Zona Kadastrale 8525, nr.pasurisë 28/148/1, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 57.6 m², sipërfaqja e ndërtimit 28 m², sipërfaqja totale e ndërtimit: për banim - m², për aktivitet 28 m², numri i kateve mbi tokë 1, nën tokë -, titulli i pronësisë: “Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1”.

Dokumentacioni i dosjes së kësaj leje legalizimi është i pa plotësuar me inventarin përkatës të dokumentacionit dhe numrit të fletëve për cdo dokument, në kundërshtim me Ligjin Nr. 9154, date 06.11.2003, “Për Arkivat”.



Në dosje nuk rezulton të ketë dokument financiar për pagesën e parcelës ndërtimore, pra nuk është paguar vlera e parcelës ndërtimore, në një kohë që objekti është me funksion Social-Ekonomik dhe nuk duhej vendosur hipotekë ligjore si dhe nuk duhej lëshuar leja e legalizimit pa u paguar vlera e parcelës ndërtimore sipas vendimit të KM për këtë qëllim. Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1 dhe VKM nr. 1095, datë 28.12.2015 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet aluizni-t dhe zqrrp-së, dhe të procedurave apokufizimeve që zbatohen përfekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara”, Kreu III.

-Proces-verbali i verifikimit në terren nuk është plotësuar me rubrikat për: sipërfaqet e parcelës ndërtimore, njolla e objektit, numri i kateve dhe destinacioni i sipërfaqeve. Përsa i përket pasurive kufitare (të saktësuara në përshkrim) nuk janë shënuar numrat e pasurive dhe distancat nga pasuritë kufitare.

Këto mungesa, veçanërisht mungesa e sipërfaqes së parcelës ndërtimore dhe distancave nga objektet kufitare e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale.

Sa sipër është në kundërshtim me rubrikat sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

Proces-Verbali i verifikimit në terren është nënshkruar nga specialistët e terrenit B Gj dhe E K dhe nga Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë z. Sh P.

Me aktin e kualifikimit nr. 24728, datë 21.03.2019, objekti informal legalizohet, i nënshkruar nga z. A H, Sektori i Legalizimit, z.A B (firmosur K D) ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit dhe z. A G ish-Drejtor.

Punuar praktika ngaz. A G, ish-Drejtor i ALUIZNI-t Elbasan, z. A B, Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. K D, Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, znj. M S, Përgjegjëse e Sektorit të pronësisë, z. A H, specialist në Sektorin e Kalimit të Pronësisë, z. Sh P, ish-Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë, z. B Gj, specialist terreni, z. E K, specialist terreni.

- Dosja nr. 1365, leje legalizimi nr. 2579268, datë 29.05.2018, për objektin: “Ngritje 1 Kat për banim në godinë ekzistuese 1 kat”, për L M H, me adresë Bashkia Elbasan, Lagjja “Aqif Pasha”, Zona Kadastrale 8524, nr.pasurisë 7/151, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 165 m², sipërfaqja e ndërtimit 73 m², sipërfaqja totale e ndërtimit: për banim 75.9, për aktivitet -, numri i kateve mbi tokë 1, nën tokë -, titulli i pronësisë: Regjistruar me certifikatë pronësie. *Drejtori A G, Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit A B.*

Në dosje mungon:

-vërtetimi për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 27, germa “ç”, të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

-Në proces-verbalin e verifikimit në terren datë s`ka, nuk mund të përcaktohet afati kohor proces-verbal verifikimi – vendim kualifikimi, në kundërshtim me vendimin e KM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar, pika 8, ku përcaktohet se:

Drejtoritë e ALUIZNI-t, bazuar në gjendjen faktike në terren, kryejnë procedurat kualifikuese për ndërtimin informal, brenda 60 ditëve nga data e evidentimit faktik në terren (data e "Procesverbalit të evidentimit në terren"). Për kryerjen e këtyre procedurave drejtoritë mbështeten në cilësitë e territorit, të paraqitura grafikisht.

Në proces-verbalin e verifikimit nuk janë plotësuar rubrikat për: pasurive kufitare (të saktësuara në përshkrim) me numrin e pasurisë.



Këto mungesa, vecanërisht mungesa e sipërfaqes së parcelës ndërtimore dhe mungesa e distancave nga pasuritë kufitare e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale.

Sa sipër është në kundërshtim me rubrikat sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

Proces-Verbali i verifikimit në terren është nënshkruar nga specialistët e terrenit F H, V Sh dhe Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë z. Sh P.

Me aktin e kualifikimit nr. 22201, datë 24.04.2018, objekti informal legalizohet, i nënshkruar nga z. A H, Sektori i Çështjeve të Pronësisë, ish-Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit z. A B, Përgjegjës i Sektorit të legalizimit dhe Drejtori A G.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A G, ish-Drejtor i ALUIZNI-t Elbasan, z. A B, Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. A H, specialist në Sektorin e Kalimit të Pronësisë, z. Sh P, ish-Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë, z. F H, specialist terreni, z. V Sh, specialist terreni.

Me observacionin nr.1065/61, datë 03.09.2019, specialisti z.A H ka paraqitur opsionin: "Për mirëfunksionimin e Drejtorisë janë nxjerrë urdhra të brendëshëm prandaj nuk mund të ngarkohem me përgjegjësi".

Ritheksojmë se grupi i auditimit bazohet në auditimin sipas hierarkisë së akteve ligjore. Cdo firmë e vendosur përmban në vetvete mbajtje përgjegjësie për personin nënshkrues. Observimi nuk qëndron.

- Dosja nr. 6851, leje legalizimi nr. 2580285, datë 26.12.2018, për objektin: "Godinë Banimi 1 kat", për N S D, me adresë Bashkia Elbasan, Lagjja "Partizani", Zona Kadastrale 8524, nr.pasurisë 3/332/1, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 108.7 m², sipërfaqja e ndërtimit 108.7 m², sipërfaqja totale e ndërtimit: për banim 115.9, për aktivitet -, numri i kateve mbi tokë 1, nën tokë -, titulli i pronësisë: Regjistruar me certifikatë pronësie. *Drejtori A G, Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit A B.*

Dokumentacioni i dosjes së kësaj leje legalizimi është i pa plotësuar me inventarin përkatës të dokumentacionit dhe numrit të fletëve për cdo dokument, në kundërshtim me Ligjin Nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat".

Në dosje mungon:

-vërtetimi për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 27, germa "ç", të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar.

-Në proces-verbalin e verifikimit në terren datë s`ka, nuk mund të përcaktohet afati kohor proces-verbal verifikimi – vendim kualifikimi, në kundërshtim me vendimin e KM nr. 280, datë 1.4.2015 " Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje", të ndryshuar, pika 8, ku përcaktohet se:

Drejtoritë e ALUIZNI-t, bazuar në gjendjen faktike në terren, kryejnë procedurat kualifikuese për ndërtimin informal, brenda 60 ditëve nga data e evidentimit faktik në terren (data e "Procesverbalit të evidentimit në terren"). Për kryerjen e këtyre procedurave drejtoritë mbështeten në cilësitë e territorit, të paraqitura grafikisht.

Në proces-verbalin e verifikimit nuk janë plotësuar rubrikat për sa u përket pasurive kufitare (të saktësuara në përshkrim), me numrin e pasurisë.

Këto mungesa, vecanërisht mungesa e sipërfaqes së parcelës ndërtimore dhe mungesa e distancave nga pasuritë kufitare e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument



formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale.

Sa sipër është në kundërshtim me rubrikat sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

Proces-Verbali i verifikimit në terren është nënshkruar nga specialistët e terrenit F H, V Sh dhe Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë z. Sh P.

Me aktin e kualifikimit nr. 22201, datë 24.04.2018, objekti informal legalizohet, i nënshkruar nga z. A H, Sektori i Çështjeve të Pronësisë, ish-Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit z. A B, Përgjegjës i Sektorit të legalizimit dhe Drejtori A G.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A G, ish-Drejtor i ALUIZNI-t Elbasan, z. A B, Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. A H, specialist në Sektorin e Kalimit të Pronësisë, z. Sh P, ish-Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë, z. F H, specialist terreni, z. V Sh, specialist terreni.

Me observacionin nr.1065/61, datë 03.09.2019, specialisti z.A H ka paraqitur opsionin: "Për mirëfunksionimin e Drejtorise janë nxjerrë urdhra të brendëshëm prandaj nuk mund të ngarkohem me përgjegjësi"

Ritheksojmë se grupi i auditimit bazohet në auditimin sipas hierarkisë së akteve ligjore. Cdo firmë e vendosur përmban në vetvete mbajtje përgjegjësie për personin nënshkruar.

Observimi nuk qëndron.

- Dosja nr. 24761, leje legalizimi nr. 2578625, datë 26.11.2018, për objektin: "Godinë Banimi 1 kat", për D A, Z H, me adresë Bashkia Elbasan, Lagjia "Aqif Pasha", Zona Kadastrale 8524, nr.pasurisë 7/86/1, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 500 m², sipërfaqja e ndërtimit 188.2 m², sipërfaqja totale e ndërtimit: për banim 188.2, për aktivitet -, numri i kateve mbi tokë 1, nën tokë -, titulli i pronësisë: Ligji 9482, datë 03.04.2006, neni 30, pika 2/1. *Drejtori A G, Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit A B.*

Në dosje mungon:

Këto mungesa, vecanërisht mungesa e sipërfaqes së parcelës ndërtimore dhe distancave nga objektet kufitare e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale.

Sa sipër është në kundërshtim me rubrikat sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

Proces-Verbali i verifikimit në terren është nënshkruar nga specialistët e terrenit Th D dhe A B dhe është miratuar nga Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë z. Sh P.

Proces-verbali i vlerësimit të dosjes është nënshkruar nga z. A H dhe nga z. F Sh për Sektorin e Përpunimit të të Dhënave.



Me aktin e kualifikimit nr. 23324, datë 27.09.2018, objekti informal legalizohet, i nënshkruar nga z. A H, z. A B dhe Drejtori z. A G.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A B, ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. A H, specialist, znj. M S Përgjegjësi i Sektorit të Çështjeve të Pronësisë, z. F Sh për Sektorin e Përpunimit të të Dhënave, z. Sh P, ish-Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë, z. Th D, specialist terreni, z. A B, specialist terreni, miratuar nga z. A G, me detyrëish-Drejtor i ALUIZNI-t Elbasan,

Me observacionin nr.1065/62, datë 03.09.2019, specialisti z.A H ka paraqitur opsionin: "Për mirëfunksionimin e Drejtorisë janë nxjerrë urdhra të brendëshëm prandaj nuk mund të ngarkohem me përgjegjësi"

Ritheksojmë se grupi i auditimit bazohet në auditimin sipas hierarkisë së akteve ligjore. Cdo firmë e vendosur përmban në vetvete mbajtje përgjegjësie për personin nënshkruar. Observimi nuk qëndron.

- Dosja nr. 2510, leje legalizimi nr. 2578553, datë 22.11.2018, për objektin: "Godinë Social-Ekonomike 1 Kat", për I M O, me adresë Bashkia Elbasan, Gjinar, Zona Kadastrale 1742, nr. pasurisë 150/90/1, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 87 m², sipërfaqja e ndërtimit 29 m², sipërfaqja totale e ndërtimit: për banim -, për aktivitet 29 m², numri i kateve mbi tokë 1, nën tokë -, titulli i pronësisë: "Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1".

Drejtori A G, Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit A B.

Dokumentacioni i dosjes së kësaj leje legalizimi është i pa plotësuar me inventarin përkatës të dokumentacionit dhe numrit të fletëve për cdo dokument, në kundërshtim me Ligjin Nr. 9154, date 06.11.2003, "Për Arkivat".

Sipas shënimeve në lejen e legalizimit, titulli i pronësisë, jepet si referencë ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1, sipas të cilit citojmë:

*Përcaktimet e këtij neni zbatohen edhe në rastin kur subjekti apo njëri prej subjekteve që disponojnë ndërtimin **me funksion banimi** nuk shlyejnë detyrimet financiare të parashikuara në ligj për vlerën e parcelës ndërtimore të objektit pa leje. Në këtë rast, për pasurinë ose pjesën takuese të subjektit debitor, regjistrimi bëhet sipas shkronjës "a", të nenit 54, "Regjistrimi i hipotekës ligjore", të ligjit nr. 33/2012, "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.*

Në dosje nuk rezulton të ketë dokument financiar për pagesën e parcelës ndërtimore, pra nuk është paguar vlera e parcelës ndërtimore, në një kohë që objekti është me **funksion Social-Ekonomik** dhe nuk duhej vendosur hipotekë ligjore si dhe nuk duhej lëshuar leja e legalizimit pa u paguar vlera e parcelës ndërtimore sipas vendimit të KM për këtë qëllim. Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1 dhe VKM nr. 1095, datë 28.12.2015 "Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet ALUIZNI-t dhe ZQRPP-së, dhe të procedurave apokufizimeve që zbatohen përfekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara", Kreu III.

-Në proces-verbalin e verifikimit në terren nuk janë plotësuar rubrikat me: nr. e vetëdeklarimit/kërkesës/deklaratës, sipërfaqet e parcelës ndërtimore, njollës së objektit, numrit të kateve, sipërfaqet për banim dhe aktivitet. Përsa i përket pasurive kufitare (të saktësuara në përshkrim) nuk janë shënuar distancat nga pasuritë kufitare si dhe numrat e pasurive.

Këto mungesa, vecanërisht mungesa e sipërfaqes së parcelës ndërtimore dhe mungesa e distancave nga objektet kufitare e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale. Proces-verbali i verifikimit është nënshkruar vetëm nga 1 punonjës terreni.



Sa sipër është në kundërshtim me rubrikat sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

Proces-Verbali i verifikimit në terren është nënshkruar nga specialisti i terrenit A B e është miratuar nga Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë z. Sh P.

Proces-verbali i Vlerësimit të Dosjes së Legalizimit është nënshkruar nga z. A M.

Me vendimin e kualifikimit nr. 23755, datë 13.11.2018, objekti informal legalizohet, i nënshkruar nga z. A H, z. A B dhe ish-Drejtori z. A G.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A B, ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. A H, specialist, z.A M, për Sektorin e përpunimit të të Dhënave, z. Sh P, ish-Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, z. A B, specialist terreni, miratuar nga z. A G, ish-Drejtor i ALUIZNI-t Elbasan.

Me observacionin nr.1065/62, datë 03.09.2019, specialisti z.A H ka paraqitur opsionin: "Për mirëfunksionimin e Drejtorise janë nxjerrë urdhra të brendëshëm prandaj nuk mund të ngarkohem me përgjegjësi". Ritheksojmë se grupi i auditimit bazohet në auditimin sipas hierarkisë së akteve ligjore. Cdo firmë e vendosur përmban në vetvete mbajtje përgjegjësie për personin nënshkrues. Observimi nuk qëndron.

Përveç sa u trajtua më sipër, konstatohet se **në 47 raste**, sipas lejeve të legalizimit nr. 2580635, datë 09.04.2019; nr. 2580285, datë 26.12.2018; nr. 2580387, datë 31.01.2019; nr. 2570644, datë 26.07.2018; nr. 2578501, datë 21.11.2018; nr. 2578729, datë 28.03.2018; nr. 2578225, datë 26.10.2018; nr. 2579709, datë 31.07.2018; nr. 2578009, datë 28.09.2018; nr.2580609, datë 09.04.2019; nr.2578351, datë 31.10.2018; nr. 2578186, datë 24.10.2018; nr. 2578530, datë 22.11.2018; nr. 2580609, datë 09.04.2019; nr. 74854213, datë 28.06.2018; nr. 2580523, datë 25.03.2019; nr. 2578776, datë 16.04.2018; nr. 2578564, datë 23.11.2018; nr. 2578574, datë 23.11.2018; nr. 2580104, datë 13.12.2018; nr. 8962354, datë 31.12.2018; nr. 306028, datë 20.11.2017; nr. 85585968, datë 21.10.2017; nr. 2570316, datë 31.05.2018; nr. 988658, datë 30.06.2017; nr. 2526985, datë 10.11.2017; nr. 2580684, datë 15.04.2019; nr. 2580815, datë 26.04.2019; nr. 9898592, datë 22.06.2017; nr. 2580644, datë 09.04.2019; nr. 402604, datë 24.04.2017; nr. 8558968, datë 25.10.2007; nr. 85884, datë 18.10.2017; nr. 89859688, datë 22.10.2017; nr. 85805030, datë 30.10.2017; nr. 858540, datë 02.11.2017; nr. 2578140, datë 22.10.2018; nr. 2579346, datë 19.06.2018; nr. 2580585, datë 28.03.2019; nr. 2580586, datë 28.03.2019; nr. 2578687, datë 20.03.2018; nr. 2580216, datë 20.12.2018; nr. 2578427, datë 20.11.2018; nr. 2579793, datë 20.08.2018; nr. 2578775, datë 16.04.2018; nr. 2578197, datë 25.10.2018; nr. 2578553, datë 22.11.2018, janë kryer legalizime dhe dokumentacioni i dosjeve së këtyre lejeve legalizimi është i pa plotësuar me inventarin e përkatës të rregullt të dokumentacionit dhe numrit të fletëve për cdo dokument, në kundërshtim me Ligjin Nr. 9154, date 06.11.2003, "Për Arkivat", veprim për të cilin mban përgjegjësi specialisti i Arkivit z. Ildri Doçi, si dhe specialistët të cilët kanë përgatitur dosjet të trajtuara për çdo rast në akt-konstatimet e mbajtura.

(Problematikat e mësipërme janë trajtuar në Akt-Konstatimin nr. 5, datë 30.07.2019, dorëzuar zyrtarisht në Zyrën e Protokollit të DR të ASHK-së Elbasan).

DV e ASHK-së Elbasan, më shkresë nr.1065/56, datë 16.08.2019, ka "RELACION OBSERVUES", të nënshkruar nga të gjithë punonjësit e prekur në auditim.

Lidhur me problematikat e trajtuara më sipër, në relacion observohet se:

Lidhur me inventarizimin e dosjeve, në relacion, është konsideruar e mjaftueshme vetëm firmosja nga specialisti dorëzues dhe jo nga arkivisti. Observimi nuk qëndron.

Sipas relacionit dhe observacionit nr. 1065/58, datë 03.09.2019 nga Përgjegjësja e Hartografisë znj. J S, lidhur me hartimin e proces-verbaleve të verifikimit në terren, pretendojnë se objektet



kufitarë dhe distancat nga këto objekte përshkruhen në skicën fushore. Mosplotësimi i rregullt i proces-verbaleve të konstatimit ka ardhur nga ngarkesa në punë dhe nuk është pasojë e neglizhencës.

Kujtojmë që grupi i KLSH, në vlerësimet e tij, bazohet në dokumentacionin shkresor dhe hartografik, duke mos qenë në target të tij shkaqet e ngjarjeve negative. Rikujtojmë që skica fushore është një dokument ndihmës, i hartuar me laps plumbi (pra i pasigurtë) dhe në asnjë rast nuk mund të konsiderohet dokument i mirëfilltë konstatimi.

Lidhur me vërtetimin për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, në Relacion dhe nga znj. J S sipas observacionit nr. 1065/58, datë 03.09.2019, observohet duke paraqitur pretendimin se, detyrimi për këtë rast i takon pushtetit vendor, por nuk është mbajtur parasysh neni 27, i ligjit të legalizimit i cili e paraqet këtë dokument si pjesë të dosjes për lëshimin e lejes së legalizimit. Observacioni nuk qëndron.

Lidhur me moszbatimin e afateve 60 ditore dhe 30 ditore, observacioni paraqet vetëm justifikime. Lidhur me vendosjen e hipotekës ligjore nuk është patur parasysh neni 30, i ligjit, ku kjo hipotekë vendoset për objektet me destinacion “Banim” dhe jo për ato “Social-Ekonomike”. Observacioni nuk qëndron.

-Z.O H dhe z.B Gj, specialistë terreni, kanë përcjellë observacionin nr. 1065/60, datë 03.09.2019, mbi hartimin e proces-verbaleve të verifikimit në terren, ku pretendojnë se: “Objektet kufitarë dhe distancat nga këto objekte përshkruhen në skicën fushore. Mosplotësimi i rregullt i proces-verbaleve të konstatimit ka ardhur nga ngarkesa në punë dhe nuk është pasojë e neglizhencës” Kujtojmë që grupi i KLSH, në vlerësimet e tij, bazohet në dokumentacionin shkresor dhe hartografik, duke mos qenë në target të tij shkaqet e ngjarjeve negative. Rikujtojmë që skica fushore është një dokument ndihmës, i hartuar me laps plumbi (pra i pasigurtë) dhe në asnjë rast nuk mund të konsiderohet dokument i mirëfilltë konstatimi. Observacionet nuk qëndrojnë.

Z. A G, ish-Drejtor, ka paraqitur observacion për objektet e subjekteve informale: A G H, N S D, D A Z, Xh S B, R B M, O P N, A O G, S H T, ku pretendohet se janë zbatuar urdhrat e brendshëm dhe baza ligjore dhe proces-verbale të verifikimit në terren janë përgjegjësi personale e atyre që nënshkruajnë, ndërkohë që për subjektet Z. L Q T, D K Q, P M Q, P J B, P K M, B N A, A P Q, Dh Xh D, G V M, M M P, G A M, B B M, F S Sh, A N M, N F A, R S D, L V M, N H J, R S D, B J B, Sh B B, A S S, E A K, I M O, duke pretenduar në disa praktika lelesh jam ngarkuar padrejtësisht me përgjegjësi pasi janë para periudhës sime si ish-Drejtor në ish-ALUIZNI Elbasan. Sqarojmë se përgjegjësia është lënë për lejet e legalizimit të lëshuara për subjektet e mësipërmedhe që janë nënshkruar nga Drejtori z. A G dhe jo për të gjitha lejet.

Përsa i përket observacioneve të znj. N S, sqarojmë se përgjegjësia e saj si Përgjegjëse e Sektorit të Hartografisë, ish-Hartografe që ka nënshkruar proces-verbale të vlerësimit të dosjeve, qëndron në magësitë e konstatuara në hartimin e proces-verbaleve të verifikimit në terren, për të cilat raste duheshin vendosur opsionet e duhura për këto mangësi në vlerësim.

-Lidhur me vonesat në kualifikim dhe legalizim, pretendohet se urdhri nr. 37, datë 19.01.2016, është urdhër vetëm me qellim nxitjen e punës dhe jo taksativ. Kujtojmë se çdo urdhër i nxjerrë është taksativ dhe nuk ka urdhër nxitjeje, përndryshe duhej të ishte theksuar shprehimisht.

Për tërheqjen nga Arkiva të dosjeve të legalizimit, etj.

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit “Nr.380/1, datë 28.05.2019”, u kërkua nga Arkiva dokumentacioni: lejet e legalizimit sipas listës së paraqitur nga ASHK Elbasan për vitet 2018, 2019, të lëshuara nga ish-DR e ALUIZNI-t Elbasan.

Sipas dokumentacionit që na u vu në dispozicion, përkatësisht shkresa e Drejtorit të Përgjithshëm z. A L nr. 2178, datë 28.02.2019, lënda: “Dërgohet Akt-Konstatimi”, është dërguar në DR të ALUIZNI-t Elbasan, Akt-Konstatimi datë 25.02.2019 i mbajtur nga specialistët e Auditit të



Brendshëm z. E Z (P/Spektori) dhe z.K Ç, specialist, me objektiv trajtimin e dosjes së qytetarit D S Q, lëshuar leje legalizimi nr.2580334, datë 21.01.2019, dosje problematike sipas trajtimit të bërë nga ky Audit.

Leja në fjalë ishte futur në sistemin e brendshëm dixhital dhe mbi këtë u kërkua nga Arkiva paraqitja e saj grupit të KLSH për auditim. Bazuar në kërkesën tonë specialisti i Arkivit z. I D, na u përgjigj se dosja nuk gjendej në arkivin e ASHK-së dhe nuk është sjellë ndonjëherë për arkivim nga personat përkatës dhe në sistemin dixhital mungonte kodi i lejes së legalizimit.

Përveç kesaj, brenda periudhës së auditimit më datë 30.07.2019, është mbajtur proces verbal i grupit të punës së ngritur me këtë rast, sipas të cilit u konstatua se dosja në emër të D S Q nuk administrohet në arkivën e sektorit të legalizimit dhe nuk rezulton të jetë depozituar kërkesa/dosja për përfshirje në procesin e legalizimeve të ndërtimeve informale e shtetasit D S Q. Përveç sa më sipër grupi i punë ka mbajtur Akt-konstatimin datë 30.07.2019, protokolluar nr. 3932/1, datë 30.07.2019, pasi mbi bazën e materialit të auditit të brendshëm, ka nxjerrë si konkluzion se duhet të anulohet/shfuqizohet leja e legalizimit nr. 2580334, datë 21.01.2019, vënien e kufizimit të pasurisë nr. 5/271/1, ZK 8523, për të parandaluar një veprim të padrejtë, që ka për qëllim kalimin e pronësisë në mënyrë të paligjshme.

(Problematikat e mësipërme janë trajtuar në Akt-Verifikimin nr. 3, datë 31.07.2019, dorëzuar zyrtarisht në Zyrën e Protokollit të DR të ASHK-së Elbasan).

Në lidhje me procesverbalet nr. 7, 8,9 dhe 10 si dhe pjesën takuese në Projekt Raport janë paraqitur observacionet përkatëse me shkresën nr. 1065/17-1065/46 prot, datë 15.08.2018, për procesverbalet si dhe shkresën nr. 1065/56-65, datë 04.09.2019, administruar në KLSH me nr. 380/3 prot, datë 06.09.2019 si vijon:

- Përsa i përket konstatimit se formularët e inventarit nuk janë firmosur nga përgjegjësi i sektorit përkatës, sqarojmë se sipas përcaktimeve të mësipërme, ato janë firmosur në çdo rast, siç është e nevojshme, nga specialisti i cili ka inventarizuar dosjen.

Qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH: Observacioni juaj nuk qëndron pasi nuk është i mbështetur në argumente dhe dokumentacion shoqërues, gjithashtu nga auditimi janë konstatuar një numër i konsiderushëm dosjesh të cilat kanë mangësi në inventarizim, trajtuar hollësisht në pjesën takuese të materialit.

-Përsa i përket vendosjes së emërtimeve të objekteve dhe distancave nga kufitarët në procesverbalin e terrenit sqarojmë si më poshtë:

Proces-Verbali i verifikimit në terren, përbëhet jo vetëm nga faqja e parë me të dhënat teknike, por edhe nga fletët shoqëruese, ku objekti dhe të gjitha të dhënat faktike të gjendjes ndërtimore paraqiten grafikisht. Sqarojmë së gjatë verifikimit në terren, specialistët e terrenit verifikojmë poseduesit faktikë të ndërtimit informal në proces legalizimi si edhe kufitarët faktikë me këtë pasuri dhe që në shumë raste nuk përputhen me kufitarët juridikë. Për këtë arsye, me përshkrim në proces verbal janë shënuar kufitarët faktikë, ku bashkëlidhur Proces Verbalit janë edhe skicat fushore (materiali i terrenit) me të dhënat përkatëse dhe te sakta, të paraqitura aq sa lejon mundësia fizike dhe kondicionet e parcelës ndërtimore. Kjo pasi, për shkak të terrenit të vështirë, dhe zhvillimeve informale në zonë, jo gjithmonë është e mundur matja e të gjithë distancave nga kufitarët. P.sh. në një rast terreni (e dukshme në foto) është tejte i pjerrët, duke e bërë të pamundur matjen e njëres distancë nga kufiri i parcelës.

Qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH: Observacioni juaj nuk qëndron pasi nga auditimi janë konstatuar raste të konsiderushme ku procesverbalet e verifikimit në terren janë të parregullta, të paplotësuara me të dhënat përkatëse, apo janë kryer thjesht formalisht si dokument për të qenë pjesë e dosjes.



- Përsa i përket administrimit në dosje të vërtetimit të likuidimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë nuk pengon miratimin dhe lëshimin e lejeve të legalizimit pas hyrjes në fuqi të ligjit nr 50/2014. Referuar dispozitave ligjore të sipërcituara rezulton se arkëtimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë bëhet nga njësitë e qeverisjes vendore dhe kjo taksë shkon në favor të tyre.

Gjithashtu edhe mënyra e përlogaritjes së kësaj takse është detyrë dhe kompetencë e këtyre organeve.

Për sa më sipër, është e qartë se, konstatimet dhe mangësitë për administrim dhe depozitim në dosjet e legalizimit nga ALUIZNI, të vërtetimit mbi pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, nuk qëndrojnë, pasi ALUIZNI, në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, ka për detyrë që të bëjë njoftimin e objekteve të legalizuara pranë njësite vendore.

Qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH: Observacioni juaj nuk qëndron pasi në përcaktimet e bëra në ligjin për legalizimet, konkretisht Neni 23-Taksa e ndikimit në infrastrukturë, Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë llogaritet dhe arkëtohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me pikën 2/1, të nenit 27, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.”, ndërkohë në nenin 27, pika ç, thuhet se: Neni 27- Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit, Subjekti kërkues i interesuar për legalizimin e objektit pa leje duhet të paraqesë: ç) vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi, pra vërtetimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë duhet të jetë pjesë dosjes para lëshimit të lejes së legalizimit.

-Në lidhje me legalizimin e këtyre objekteve informale të cilat ndodhen në zonën e mbrojtur të parkut kombëtar “Shebenik- Jabllanicë”, nga ana jonë është verifikuar që këto objekte ndodhen në Zonën e Përdorimit Tradicional, e cila është zonë ku mundësohet vazhdimi i veprimtarive, tradicionale dhe ekonomike, e ku mund të ushtrohen veprimtari të reja, zona përfshin territoret buqësore, ujore e pyjore, rreth qëndrave të banuara, kryesisht të përdorura nga banorët. Në zonën e përdorimit tradicional zbatohet shkalla e katër e mbrojtjes, ku sipas pikës 2 (ë), ku citohet;

“Ndërtimi informal i llojit “objekt”, i ngritur brenda vijës kufizuese të zonës informale të miratuar dhe i përfshirë në fushën e zbatimit të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, përjashtohet nga legalizimi në një nga rastet e mëposhtme:

Është ngritur brenda zonave dhe/ose nënzonave të mbrojtura, shkalla e mbrojtjes të të cilave nuk lejon ndërtime, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 8906, datë 6.6.2002, “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij.

Ligji 8906/2002 shfuqizuar me Ligjin Nr. 81/2017 datë 04.05.2017, Neni 33, “Veprimtaritë që lejohen, pasi të jenë pajisur me miratim paraprak” citohet;

Veprimtaritë që lejohen të ushtrohen në zonat e mbrojtura mjedisore pasi të jenë pajisur me miratimin paraprak të organit, brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore të të cilit është veprimtaria e mëposhtme: a) çdo veprimtari tjetër në përputhje me Planin e Menaxhimit; b) monitorime të gjendjes mjedisore, të ekosistemit, të habitateve dhe të llojeve floristike e faunistike; c) ndërhyrjet e nevojshme për rigjenerimin dhe shëndetësimin; ç) struktura në përputhje me përcaktimet e Planit të Menaxhimit në shërbim të aktiviteteve turistike; d) çdo veprimtari tjetër në përputhje me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit.

Sipas VKM 640, datë 21.05.2018 “Për Shpalljen Park Kombëtar” të ekosistemit natyror “Shebenik Jabllanicë” pika 4, përcaktohet se;



Zonat e përdorimit tradicional, me sipërfaqe 12420 ha, e shënuar në hartë me “ZPT” Zonë e Përdorimit Tradicional, vetëm me lejet mjedisore dhe për rastet e trashëgimisë kulturore me leje të Ministrisë të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe të shërbimit arkeologjik. Zona përfshin territoret buqësore, ujore e pyjore, rreth qëndrave të banuara, kryesisht të përdorura nga banorët. Në zonën e përdorimit tradicional zbatohet shkalla e katër e mbrojtjes.

Në rastin konkret, Drejtoria Vendore e ASHK-së Elbasan, është investuar në korespondencë zyrtare me Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura si dhe me ARZM Elbasan, ku nga kjo e fundit kemi konfirmim për vazhdim të procedurave të legalizimit.

Në rast se do ndodheshe në kushtet që nuk lejohet legalizimi, atëherë ky institucion, si autoritet përgjigjës nuk do të konfirmonte vijimin e procedurave të legalizimit.

Qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH: Observacioni juaj nuk qëndron pasinuk është paraqitur dokumentacion shtesë si dhe nga auditimi ka rezultuar se nuk janë respektuar procedurat ligjore në dhënien e lejevetë legalizimit, si dhe nuk janë marrë konfirmimet përkatëse nga organet kompetente, trajtuar hollësisht në pjesën takuese të materialit

- Në lidhje me mosrespektimin e afatit 60 ditor sipas Urdhërit të Drejtorit të Përgjithsëm Nr. 37, datë 19.01.2016 “Për miratimin e planveprimit për shqyrtimin administrative të praktikave të legalizimit të ndërtimeve pa leje”, të konstatuara në Projekt Raport, duke i marrë të mirëqena, sqarojmë se ato nuk janë në thelb i mosfunksionimit i rregullt i Drejtorisë së Aluizni-t Elbasan.

Mosrespektimi i afatit vjen si rezultat i ngarkesës së konsiderueshme të punës, në raport me burimet njerëzore efektive të Drejtorisë së Aluizni-t Elbasan, e cila provohet nga evidencat e objekteve të legalizuara nga ana e drejtorisë sonë.

Përsa i përket mosrespektimi i afatit 60 ditor sipas Urdhërit të Drejtorit të Përgjithsëm Nr. 37, datë 19.01.2016 dhe të zgjatjeve të proceduarve administrative të legalizimit, mendoj se është e nevojshme t’ju paraqes rrethanat dhe renditjen e shkurtër që ndiqet nga secili sektor.

Qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH: Observacioni juaj do të merret pjesërisht në konsideratë dhe rast pas rasti në adresimin e përgjegjësive individuale në raport me shkeljet e konstatuara, pasi përveç rrethanave që kanë sjelle ngarkesën në punë, të paraqitura hollësisht në observacion, janë të pajustificueshme vonesat deri në 1 vit për miratimin e lejes së legalizimit nga data e procesverbalit të verifikimit në terren.

- Në lidhje me mos respektimin e distancës nga rruga sqarojmë se ndërtimi informal i llojit “objekt”, i ngritur brenda vijës kufizuese të zonës informale të miratuar dhe i përfshirë në fushën e zbatimit të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, përjashtohet nga legalizimi në rast se; a) Shkel distancat nga kufiri rrugor i rrugëve ekzistuese të kategorive A e B ose trupi i rrugëve ekzistuese të kategorive C, D dhe E. Për rrugët e kategorive A dhe B, distancat nga kufiri rrugor nuk mund të jenë më pak se: (30 metra për rrugët e kategorisë A; 20 metra për rrugët e kategorisë B). Pra, për Qarkun Elbasan, lloji i kategorive të rrugëve është C, D dhe E, dhe në këto kushte, në përputhje me përcaktimet e VKM-së së sipërcituar, objekti informal përjashtohet nga legalizimi vetëm në rastet se do të cënonte trupin e rrugëve C, D dhe E.

Qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH: Oservacioni juaj është i natyrës sqaruese për referencat ligjore në lidhje me zbatimin e kriterit për distancën nga rrugët, pa referuar rastet konkrete të cilat janë trajtuar si shkelje në Projekt Raportin e Adutimit.

- Në lidhje me pretendimin se legalizimi i objekteve në pyll dhe në brendësi të territoreve të institucioneve publike është bërë në përputhje me ligjin dhe se ka pasur korespondencë shkresore me institucionet përkatëse. **Qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH:** Konstatimet e Grupit të Auditimit janë bërë mbi bazën e informacionit të vënë në dispozicion nga Ish-Drejtoria e ALUIZNI Elbasan, ku janë konstatuar mangësi në procedurat e legalizimit të objekteve trajtuar



hollësisht në pjesën takuese të materialit, gjithashtu nuk është paraqitur dokumentacion i ri shtesë për pasojë nuk merret në konsideratë.

- Në lidhje me shqyrtimin dhe zgjidhjen e ankesave të pa trajtuara nga ana e ALUIZNI Elbasan, të konstatuara në Projekt Raport, duke i marrë të mirëqena, sqarojmë se ato nuk janë në thelb i mosfunksionimi i rregullt i Drejtorisë së Aluizni-t Elbasan. Mosshqyrtimi i kërkesave, ankesave vjen si rezultat i ngarkesës së konsiderueshme të punës, në raport me burimet njerëzore efektive të Drejtorisë së Aluizni-t Elbasan, e cila provohet edhe nga evidencat e drejtorisë sonë, kjo për shkak se për shqyrtim të kërkesave dhe ankesave kanë qenë 3 veta gjithsej për trajtimin e tyre.

Qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH: Konstatimet e Grupit të Auditimit janë bërë mbi bazën e informacionit të vënë në dispozicion nga Ish-Drejtoria e ALUIZNI Elbasan, ku janë konstatuar mangësi në administrimin e ankesave në vazhdimësi, mungon data base, një pjesë e tyre janë pa përgjigje. Në lidhje me argumentet tuaja për ngarkesën në punë dhe mungesën e stafit në trajtimin e numrit të lartë të ankesave, do të mbahen parasysht në adresimin e përgjegjësi individuale në raport me shkeljet e konstatuara për secilin nga specialistët.

Në lidhje me pretendimin e znj. M S, me detyrë Përgjegjës e Sektorit të Cështjeve të Pronësisë, se ky sektor merret me përgatitjen e statusit juridik, procedurat e kalimit të pronësisë, shpronësimet dhe nuk mund të merret me plotësimin ose jo të kriterëve për kualifikim pasi kjo është përgjegjësi e Sektorit të Legalizimeve.

- Në lidhje me sqarimet e z. F D, për inventarizimin e dosjeve duhet të mbahet parasysht formulari tip i dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme, si dhe përcaktimet për ruajtjen e dokumentacionit.

Qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH: Observacioni juaj është i natyrës sqaruese dhe informuese, ALUIZNI Elbasan duhet të marrë masa për inventarimin e dosjeve në përputhje me përcaktimet ligjore për arkivimin e dokumentacionit.

- Në lidhje me ndryshimin e zërit kadastral nuk është përgjegjësi e ALUIZNI por e zyrave të regjistrimit. Gjithashtu ndryshimi i zërit kadastral është bërë bazuar në përcaktimet ligjore VKM nr. 465, datë 22.06.2016, Udhëzimin nr. 1095/2015, Urdhrin nr. 309, datë 15.09.2008 dhe Rregulloren nr. 189/1999.

Qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH: Observacioni juaj nuk qëndron pasi nuk është mbështetur në argumente dhe dokumente shoqërues, mos zbatimi i procedurave për ndryshimin e zërit kadastral është trajtuar hollësisht në pjesën takuese të materialit. Në procesverbale dhe në Projekt Raportin e Auditimit, përveç mangësive të konstatuara rast pas rasti në dosjet e legalizimit të objekteve, ju jeni ngarkuar me përgjegjësi në raport me kompetencat dhe detyrat që ju mbulonin, për sa i përket mangësive të konstatuara në procedurat e kalimit të pronësisë për objektet e legalizuara.

- Në lidhje me sqarimet e z. F D për legalizimet e objekteve në afërsi të lumenjve dhe përrejtëve, i cili sqaron se ligji i legalizimit është një ligj i posaçëm dhe prevalon mbi ligjet e tjera, në zonat informale nuk zbatohen kushtet e dokumenteve të planifikimit të territorit, ndërkohë kur ndërtimet informale ndodhen në territore pranë brigjeve për të cilat nuk ka dokumente të miratuara të planifikimit të territorit, zbatohen drejtëpërsëdrejti përcaktimet e nenit 84 të Ligjit Nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore".

Qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH: Observacioni juaj është i natyrës sqaruese në lidhje me bazën ligjore dhe kriteret e përcaktuara për legalizimin e objekteve, sqarimet tuaja do mbahen parasysht në shqyrtimin e rasteve të konstatuara.

- Në lidhje me pretendimin e z. I D, i cili sqaron se nuk është përgjegjësi e tij për magnësitë e konstatuara në akt-konstatimin nr. 8, për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, zgjidhjen e ankesave, respektimin e afateve për kthim përgjigje të ankesave apo për procedurat e legalizimit.

Qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH: Observacioni juaj qëndron pjesërisht për sa i përket procedurave të zbatimit të kriterëve për legalizim, apo zgjidhjes së ankesave, por kjo nuk ju



përfundon nga përgjegjësia për mangësit dhe shkeljet e konstatuara për daljen dhe hyrjen e dosjeve të legalizimit në arshivë apo inventarizimin e dosjeve.

- Në lidhje me pretendimin e z. D B dhe znj. N S, të cili sqarojnë se mungesa e deklaratës së prishjes për objektin e vjetër, dhe vazhdimi i procedurave të legalizimit është bazuar në VKM nr. 280, datë 01.04.2015, ndërsa përse i përket gjurmës së ndërtimit që ka dalë më e vogël se leja e ndërtimit sqaron se janë marrë për bazë matjet faktike në terren.

Qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH: Observacioni juaj nuk qëndron pasi nuk është i mbështetur në dokumentacion shoqërues, gjithashtu në dosje mungon vërtetimi nga organet kompetente vendore për prishjen e objektit të vjetër, në kundërshtim me përcaktimet ligjore. Në lidhje me njollën e objektit që rezulton më e vogël nga procesi i legalizimit se ajo e përcaktuar në lejen e ndërtimit, sic është trajtuar dhe në pjesën takuese të materialit, argumentat tuaja nuk qëndrojnë pasi bie në kundërshtim me vete objektin e ligjit të legalizimeve për shtesat anësore dhe në lartësi.

-Z. F D, ish-Drejtor, ka paraqitur observacionin, me pretendimin se:

-Vërejtja për vonesat nuk qëndron sepse z.D ka nënshkruar lejen e legalizimit.

-Për proces-verbalin e verifikimit në terren, pretendohet se të dhënat mbi largësië nga objektet kufitare, etj., janë pasqyruar në skicën fushore.

Sa sipër kujtojmë se skica fushore nuk është dokument i njohur për vërtetimin e kryerjes së matjeve, pasi është një skicë e përgatitur me laps plumbi, po kështu edhe firmat e specialistëve. Dokumenti i njohur ligjërish është vetëm Akti i Verifikimit në Terren. Observimi nuk qëndron.

- Në lidhje me pretendimin e z. E K, se janë zbatuar procedurat ligjore në dosjet e lejeve të legalizimit I S, F D, A H, si dhe për dosjet A B, H D, B B, Z B, A D për mosplotësimin e rubrikave të procesverbalit të konstatimit si dhe mungesën e vërtetimit të takës së ndikimit në infrastrukturë sqaron se në periudhën kur janë lëshuar këto dosje ka mbajtur rolin e Specialistit të Sektorit të Legalizimit dhe nuk është detyrë e tij mbajtja e procesverbalit të verifikimit në terren apo administrimi i vërtetimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH: Observacioni juaj nuk qëndron pasi procedurat e legalizimit për dosjet e cituara nuk janë bërë në përputhje me përcaktimet ligjore, gjithashtu administrimi i vërtetimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë është një kriter ligjor i detyrueshëm për tu plotësuar sipas Nenit 27, pika ç të ligjit të legalizimeve e për pasojë ky argument nuk ju përjashton nga përgjegjësia.

- Në lidhje me pretendimin e z. A H, se objekti sipas vetëdeklarimit nr. 127, datë 14.11.2006 dhe nr. 21063, datë 28.01.2015, leje legalizimi nr. 2579621, datë 26.07.2018, ndodhet jashtë zonës Shebllenikë-Jabllanicë, bazuar në shkresën nr. 55 prot, datë 19.03.2018, si dhe imazhet nga Geoportali Asig dhe google earth kordinatat gjeografike, bashkangjitur observacionit.

Qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH: Observacioni juaj qëndron pas verifikimit të shkresës dhe imazheve bashkangjitur observacionit dhe do të pasqyrohet në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

- Në lidhje me pretendimin e z. Artur Hasani dhe z. Klajdi Dyrmishi, se janë zbatuar procedurat ligjore në dosjet e lejeve të legalizimit Dashamir Brazhda, Agim Dervishi, Ilirjan Hysa, Vasil Bezhani, Fetah Dërstila, dhe Selim Preci, **Qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH:** Observacioni juaj nuk qëndron pasi procedurat e legalizimit për dosjet e cituara nuk janë bërë në përputhje me përcaktimet ligjore, trajtuar hollësisht në material.

Qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH: Observacioni juaj qëndron pas verifikimit të shkresës dhe imazheve bashkangjitur observacionit dhe do të pasqyrohet në Raportin Përfundimtar të Auditimit.



- Me observacionin nr.1065/62, datë 03.09.2019, specialisti z.Artur Hasani ka paraqitur opsionin: "Për mirëfunksionimin e Drejtorise janë nxjerrë urdhra të brendëshëm prandaj nuk mund të ngarkohem me përgjegjësi"

Ritheksojmë se grupi i auditimit bazohet në auditimin sipas hierarkisë së akteve ligjore. Cdo firmë e vendosur përmban në vetvete mbajtje përgjegjësie për personin nënshkrues. Observimi nuk qëndron.

Z. F D, ish-Drejtor, ka paraqitur observacionin me pretendimin se:

-Për taksën e infrastrukturës është njoftuar Bashkia Elbasan.

- Përproces-verbalin e verifikimit në terren, pretendohet se të dhënat mbi largësië nga objektet kufitare, etj., janë pasqyruar në skicën fushore.

- Sa sipër kujtojmë se paraqitja e vërtetimit për pagesën e taksës së infrastrukturës është detyrimi sipas nenit 27, të ligjit për legalizimin. Skica fushore nuk është dokument i njohur për vërtetimin e kryerjes së matjeve, pasi është një skicë e përgatitur me laps plumbi, po kështu edhe firmat e specialistëve. Dokument i njohur ligjërisht është vetëm Akti i Verifikimit në Terren. Observacionet nuk qëndrojnë.

- Në lidhje me pretendimin e zj. M S, se nuk është përgjegjësi e saj zbatimi i afateve për arkëtimin e të ardhurave nga parcela ndërtimore si dhe taksës së ndikimit në infrastrukturë, **Qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH:** Observacioni juaj nuk qëndron pasi nga auditimi janë konstatuar mangësi dhe vonesa deri në 1 vit në dërgimin e VKM-ve për parcelat ndërtimore, trajtuar në pjesën takuese të materialit.

1.3- Auditim mbi bazueshmërinë ligjore të shqyrtimit dhe zgjidhjes së ankesave dhe respektimi i afateve ligjor për kthim përgjigje.

Mbi auditimin e ushtruar në ALUIZNI Elbasan në bazë të programit të auditimit nr. 380/1, datë 28/05/2019, mbajtur në datë 31/07/2019.

Në zbatim të pikës 1 dhe 5 të programit të auditimit "Nr. 380/1, datë 28.05.2019", u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

3) Evidencat e ankesave të administruara

4) Ankesat e ardhura në KLSH.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Nga ana e ALUIZNI Elbasan nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore në çdo rast përse i përket trajtimit të ankesave, referuar:

1) Ligjinr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar,

2) Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"

3) Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

4) VKM nr.465, datë 22.06.2016" pika 10.

5) VKM nr. 280, datë 01.04.2015, pika 8 dhe (i ndryshuar me VKM 756, datë 26.10.2016), kreu i I pika 1/4 dhe kreu i 4, pika 8.

Nga auditimi rezultoi që:

I- Mbi bazueshmërinë ligjore të shqyrtimit dhe zgjidhjes së ankesave dhe respektimi i afatit ligjor për kthim përgjigje.



Nga ana e ALUIZNI Elbasan nukështë administruar në mënyrë të rregullt dhe periodike një regjistër i veçantë në lidhje me ankesat e qytetarëve ndër vite, ku të jenë trajtuar ankesat e bëra, problematikat e ngritura, afatet e shqyrtimit të tyre si dhe zgjidhjen e problemit.

Në lidhje me periudhën objekt auditimi 01.01.2017-01.05.2019, janë paraqitur 5023 kërkesa-ankesa, nga institucionet dhe qytetarët me problematika të ndryshme, më hollësisht të dhënat sipas viteve janë trajtuar në si më poshtë:

Tabela nr. 1 “Përmbledhëse e ankesave periudha 01.01.2017-31.05.2019”

Periudha	Kërkesa+Ankesat hyrëse	Kthyer Përgjigje	Pa përgjigje
Dt. 12.07.2017 - 29.12.2017	1992	1640	352
Dt. 03.01.2018 – 31.12.2018	2152	1936	216
Dt. 03.01.2019 – 08.05.2019	879	668	211
TOTAL	5023	4244	779

Sqarojmë se ky informacion është përgatitur nga verifikimi i të gjithë kërkesave dhe ankesave hyrëse nëpërmjet regjistrit të protokollit të institucionit.

Informacionin për kërkesat dhe ankesat nga periudha datë 03.01.2017 deri në datën 12.07.2017, nuk na u vunë dispozicion, për shkak se regjistrat e korespodencës për këtë periudhë, nuk administrohen pranë institucionit sepse janë sekuestruar me Vendimin e Sekuestrimit të Dokumentave të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan datë 02.05.2018 dhe datë 29.05.2018.

Ndërkohë që evidenca e paraqitur për trajtimin e ankesave, përfshin vetem 243 ankesa në total të trajtuara nga platforma e bashkëqeverisjes, ndërkohë që sipas regjistrit të protokollit figurojnë 5023 për të cilat nuk u paraqit asnjë evidencë për trajtimin e tyre, pra nuk pasqyrohet informacioni i plotë për mënyrën e trajtimit të ankesave si dhe zbatimin e afateve procedurale për trajtimin e tyre.

Praktikat e bashkëqeverisjes janë administruar nga nëpunësit znj. M B, me detyrë Specialiste e Sektorit të Legalizimit znj. E T me detyrë Specialiste e Sektorit të Legalizimit dhe znj. E I me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimeve të Sportelit dhe Kadastrës.

Nga një sondazh i kryer vetëm për 243 ankesa të evidentuara, rezulton se përgjithësisht janë zbatuar afatet e kthimit të përgjigjeve, por kjo nuk mund ta përgjithësojë rezultatin krahasuar me kampionin e ankesave që u morë për bazë në raport me numrin total të ankesave të administruara në protokoll 5023 në total. Theksojmë se përveç përgjigjeve të kthyer zyrtarisht brenda afateve ligjore është e domosdoshme bashkëpunimi dhe rakordimi ndërmjet sektorëve, bashkëpunim i cili realisht mungon, për dhënien e zgjidhjeve ligjore të problemeve në zbatim të kërkesave të Ligjit Nr. 9482 dt. 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizmin, integrimin e ndërtimeve pa leje” të ndryshuar dhe akteve nën ligjore në zbatim të tij, Kodit të Procedurës Administrative, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, dhe jo thjesht kthimi i përgjigjeve zyrtare brenda afateve por pa zgjidhur problemin në thelb dhe pa adresuar problematikat e ngritura nga ankesat e qytetarëve.

Gjithashtu nga 5023 ankesa të administruara, **në 779 raste rezulton se nuk është kthyer përgjigje nga ALUIZNI Elbasan.**



Për mos administrimin, regjistrimin dhe ndjekjen e ecurisë së zgjidhjes së ankesave ngarkohet me përgjegjësi z. M D me detyrë ish-Drejtor nga data 01.01.2017- 22.05.2017, dhe 22.06.2017- 03.10.2017, znj. A T, me detyrë ish-Drejtor, nga data 22.05.2017-22.06.2017, z. F D me detyrë ish-Drejtor, nga data 03.10.2017- 12.02.2018, dhe z. A G me detyrë ish-Drejtor nga data 12.02.2018-08.05.2019, znj. V H me detyrë ish-Përgjegjëse e Sektorit të Legalizimit, z. A B me detyrë ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. K D me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit.

Për sa më sipër është mbajtur procesverbali nr.9, datë 31.07.2019.

1.4-Auditim në lidhje me regjistrimet e lejeve të legalizimit dhe pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë (për periudhën objekt auditimi)

Sipas informacioneve të dhëna në Drejtorinë e Aluiznit Elbasan rezulton se nga viti 2017 deri në maj të vitit 2019 janë dhënë gjithsej **5427 leje legalizimi** të objekteve informale nga këto në vitin 2017 janë dhënë 2,423, në vitin 2018 janë dhënë 2,399 leje legalizimi dhe në Maj të vitit 2019 janë dhënë 605 leje legalizimi .

Sipas shkresave të nisur Bashkive Elbasan, Librazhd, Prenjas, Gramsh dhe Cerik kostatohet se shkresat janë nisur me vonesë nga Drejtoria e Aluiznit Elbasan dhe nuk kanë kthyer përgjigje për pagesat e taksës në infrastrukturë.

Nuk kanë marrë vërtetimet mbi pagesat e taksës së infrastrukturës nga secili subjekt ku të vertetojë se kjo taksë është e likuaduar.

Pra konstatohet se në vitin 2018 deri në maj të vitit 2019 janë legalizuar gjithsej 3004 dhe janë nisur shkresa në pushtetin vendor për 2266 objekte me një diferencë 738 objekte që **nuk** kanë dërguar akoma shkresat bashkive përkatëse për likuadimin e taksës në infrastrukturë.

Pra nga viti 2017 deri në maj të vitit 2019 janë gjithsej **1616 objekte** (878 objekte në vitin 2017+ 738 objekte në vitin 2018 deri në maj të vitit 2019) të padërguar shkresat Bashkive Elbasan, Librazhd, Prenjas, Gramsh, Peqin, Belsh dhe Cerik.

Sipas rakordimeve të datave që janë dhënë lejet e legalizimit në vitin 2017 kanë nisur shkresat me vonesë 6 muaj deri në një vit shkresat pranë bashkive, nuk ka një regjistër të saktë me të gjitha modalitetet e duhura ku të jenë shënuar data e dhenies së lejes së legalizimit dhe data e nisjes së shkresës Bashkive përkatëse, e cila ka ndikuar në mos arkëtimin e taksës së infrastrukturës në masën **30 %** e objekteve të legalizuar, pa dërguar shkresat përkatëse.

Sipas pasqyrës rezulton se janë dërguar shkresat vetëm për 1545 objekte kur në vitin 2017 janë legalizuar gjithsej 2423 objekte me një diferencë të pa dërguar **878 objekte** të legalizuara ose 36 përqint e tyre nuk janë dërguar shkresat përkatëse pushtetit vendor.

Pra dërgimi i shkresave nuk ka qenë i saktë, shkresat janë dërguar me selektim **“për objekte të legalizuara”** duke mos mbajtur pasqyra të regullta dhe kronologjike dhe duke mos i rakorduar ato dhe mos marrë e vërtetimet të objekteve të legalizuar dhe të likuaduar taksën e infrastrukturës.

Nga auditimi i dosjeve të legalizimit për objektet informale të pajisur me leje legalizimi konstatohet se mungojnë vërtetimet e likuidimit të taksës së infrastrukturës në dosje veprime në kundërshtim me nenet 27 dhe 37 të ligjit 9482, datë 03.04.2006 i ndryshuar, si dhe VKM 411, datë 19.05.2010 i ndryshuar.



- Në **vitin 2017** janë 2423 objekte të legalizuara me sipërfaqe totale **424,985 m²** (77,481m² aktivitete ekonomike dhe 347,504 m² sipërfaqe ndërtimore).
- Për **vitin 2018** janë legalizuar 2399 objekte për banim dhe social ekonomike e garazhe e veranda e cila rezulton se sipërfaqja ndërtimore është **424,374 m²** të legalizuara (53,689 m² aktivitete ekonomike dhe 370,705 m² sipërfaqe ndërtimore).
- Për **vitin 2019** janë legalizuar 605 objekte për banim dhe social ekonomike e garazhe e veranda e cila rezulton se pasqyra nuk është e regullt, nuk janë hedhur saktë të dhënat në pasqyrat përkatëse sipërfaqja ndërtimore është **107,085 m²** të legalizuara.

Pra rezulton se taksa e ndikimit në infrastrukturë në Bashkinë Elbasan, Prenjas, Librazhd, Gramsh, Cerik, Peqin, Belsh për vitin **2017** deri në maj të vitit 2019 për **5427 objekte** për banim dhe social ekonomike e garazhe e veranda e cila rezulton se sipërfaqja totale e ndërtimit është 956,444 m² e legalizuar që duhej të likujdonte taksën e infrastrukturës për m², marrë me mesataren duhej të likujdohej taksa në infrastrukturë në vlerën në total **149,956,073 lekë** (956,444 m² x 31,357 lekë për m² x 0.5%).

Pra rezulton se nga shuma totale që duhej likujdohej taksa në infrastrukturë në vlerën në total 149,956,073 lekë për sipërfaqen ndërtimore 956,444 m², 30 % e tyre nuk janë nisur shkresat përkatëse pra për vlerën **44,986,822 lekë** për 286,933 m² të pa dërguara shkresat përkatëse bashkive në vitin 2017 deri në maj të vitit 2019.

Më hollësisht të dhënat janë paraqitur në *Aneksin nr. 5 "Pasqyra e objekteve që janë legalizuar dërguar shkresat bashkive viti 2017"* dhe *Aneksin nr. 6 "Pasqyra e objekteve që janë legalizuar dërguar shkresat bashkive viti 2018 deri në 31 Maj 2019"*.

Pra sa më sipër me veprime e mos veprime bien në kundërshtim me ligji nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" i ndryshuar nenin 3 pika (i), nenin 23, si dhe nenin 27 "Dokumentacioni tekniko- ligjor për legalizimin e objektit" pika (ç) ku përcaktohet se mugon vertetimi i likujdimit te taksës se infrastrukturës nga viti 2017 e në vazhdim: "*Vërtetim për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa sipas legjislacionit në fuqi dhe legjislacionit në fuqi*", si dhe VKM 580 datë 10.12.2014 pika (5), mbajnë përgjegjësi përfaqësuesve të subjektit të auditimit, në Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, "Agjensia Shtetërore e Kadastrës (Drejtoria Vendore Elbasan)" me ish/Drejtorin Mariglen Disha nga data 01.01.2017 deri 02.10.2017, z. F D ish /Drejtor i Aluiznit nga data 03.10.2017 deri më 12.02.2018, me z.A G me detyrë ish/Drejtor nga data 12.02.2018 deri në 08.05.2018, me z.V H me detyrë ish/Përgjegjës i Legalizimit dhe Planifikimit Urban nga data 01.01.2017 deri në datën 04.09.2017, me z. Sh K me detyrë Përgjegjës i Legalizimeve 01.01.2017 deri në datën 25.05.2019, z. K D me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Legalizimeve, zj. M S me detyrë Specialist i çështjeve të pronsisë, me z. Sh P me detyrë ish Përgjegjës i Hortografisë nga data 01.01.2017 deri në datën 17.05.2019.

Për sa më sipër është mbajtur procesverbali nr.10, datë 31.07.2019.

III.2. Auditimi mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.

Nga auditimi i dokumentacionit i vendosur në dispozicion në lidhje me hartimin dhe miratimin e buxhetit të njësisë shpenzuese DSHK Elbasan (Drejtoria Shtetërore e Kadastrës) për periudhën e vitit 2017 rezultoi sa më poshtë:

Projektbuxheti për periudhën raportuese të vitit 2017, është hartuar mbi bazën e kërkesave të dërguara nga ish Drejtoria e Aluiznit Elbasan, të cilat janë miratuar nga Drejtoria e Manaxhimit të Buxhetit në Ministrinë e Zhvillimit Urban, Agjencia e Legalizimit Urbanizimit dhe Integritimit të

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT



Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ish-Drejtorinë e Aluizni Qarku Elbasan,(sot Agjensia Shtetërore e Kadastrës Elbasan)

Zonave Informale me shkresën nr. 549/1 prot. datë 07.02.2017, brenda afateve dhe kriterëve të përcaktuara në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimeve përkatëse të Ministrisë së Financave.

Ndarja e plan buxheteve dhe detajimet e tij janë kryer në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën/artikulli duke respektuar disiplinën buxhetore sipas strukturës buxhetore dhe burimeve të financimit.

Programi i shpenzimeve është bërë në nivel, titulli, kapitulli dhe artikulli e nën artikulli, ndërsa realizimi i tyre paraqitet sa më poshtë: **000/lekë**

Nr	Emërtimi	Viti 2017				
		Plan Fillestar	Shtesa pakesime të brendshme	Plani gjithsej	Fakt	%
1	Llog.(600) “Paga e shperblime”	13,000	15,701	28,702	28,657	99.8
2	Llog.(601) “Kontribute Sig.Shoq shendetsores”	2,500	2,214	5,115	4,972	97.2
3	Llog.(602) “Shp.operative”	2,800	0	2,800	2,788	99.6
4	Llog. (231) “Investime ”	0	1440	1,440	1,372	95.3
	Totali	18,300	19,355	38,057	37,789	99.2

Për periudhën raportuese bazuar në PBA të vitit 2017, ish Drejtoria e Aluiznit Elbasan me shkresë nr. 1593/4 datë 24.04.2017 ka miratuar buxhetin për vitin 2017 vlerën e investimeve në shumën 1440 milion lekë për nevojat e paisjeve kompiuterike

- Rregullshmëria e plotësimit dhe përpunimit të dokumentacionit për shpenzimet e të ardhurat nga kryerja e legalizimeve.

Nga sa më sipër, ish Aluizni Elbasan ka ndjekur në dinamikë të ardhurat e brendshme dhe mbi këtë bazë ka përcaktuar nevojat për shpenzime si diferencë nga fondet e akorduara nga buxheti, i cili në fillim të vitit është çelur për 18.300 milion lekë për zërat paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative. Situacionet mujore janë të rakorduara me thesarin sipas pasqyrave përkatëse për çdo muaj të firmosura nga specialisti dhe drejtori i thesarit. Diferenca tepriçë mbi nevojat e krijimit të ardhurave të brendshme nga tarifa e shërbimit dhe nga parcela ndërtimore është derdhur në buxhet dhe nuk janë trashëguar nga institucioni.

në 000/lekë

Periudha raportuese 2017	Llogarit e analizuara		Totali		
	7116100	7110506	Plan	Fakt	%
Të ardhurat e brendëshme					
Nga shërbimet		9,538	10,000	9,538	95
Nga parcela	96,638		120,000	96,638	80
Të tjera nga rivlersimi dhe gjoba penalitete	701	0	0	701	100
Totali	97,339	9,538	130,000	106,877	82

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelë rezulton se, realizimi i fondeve të alokuara është në masën 82 %, me realizim me të ulët paraqitet fondi i parcelës ndërtimore i realizuar në masën 80 %, në të cilën ka ndikuar mos paraqitja e personave për pagesë si dhe ndryshimi i dispozitave ligjore që favorizon me tej legalizimet deri tek regjistrimi pa pagesë i objekteve ndërtimore.

Lidhur me mbulimin e shpenzimeve të zërit “paga të punonjësve me kontratë” janë mbuluar nga të ardhurat e brendëshme, ku rezulton se 98 % e pagave të punonjësve me kontratë janë përballuar



nga 30 % i përdorimit të të ardhurave nga parcela ndërtimore dhe diefrenca nga tarifa e shërbimeve.

Mbështetur në shkresën nr. 6121 prot. datë 10.09.2015, nga Ministria e Zhvillimit Urban janë dërguar treguesit e krijimit të ardhurave nga tarifa e shërbimit dhe të ardhurat për pagesën dhe transferimin e vlerës së parcelës ndërtimore. Konkretisht këto tregues janë 10 milion lekë nga e cila 70 % ose 7 milion lekë përdoret për kompesimin e ish pronarëve dhe 3 milion përdoret nga vetë institucioni (Aluizni Elbasan) për mbulimin e zërit paga dhe shpenzime të tjera operative.

Nga analiza sipas zërave të shpenzimeve rezulton se realizimi shpenzimeve operative është dokumentuar sipas nën/artikuj llogaria. (602) “Shpenzime operative” sa më poshtë:

000/lekë

Nr	Emërtimi	Të ardhe brendsh	Nga buxheti	Gjith Plan	Fakt	%
1	Kancelari	880	56	936	935	100
2	Shpenzime telefonike dhe internet	0	108	108	108	100
3	Posta dhe shërbime korrieri	0	350	350	348	99
4	Shpenzime për taksa të institucioni	40	0	40	40	40
5	Shpenzime udhëtimi brenda vendit	0	0	0	0	
6	Energji elektrike	70	580	650	634	97.5
7	Ujë	0	30	30	24	80
8	Komisione bankare	0	0	0	0	
9	Investime	0	1440	1440	1372	95.3
10	Shenzime për ruajtjen	0	700	700	654	93.4
11	Materiale për funksionimin e zyrës	600	350	950	920	96.9
12	Mirëmbajtje e paisjeve zyrave dhe objekte	60	180	240	220	91.6
13	Karburanti	660	300	960	956	99.6
14	Të tjera	1000	300	1300	1287	99
	Totali	3310	4394	7704	7498	97.3

Realizimi i shpenzimeve për çdo zë në kufijtë limit të fondeve të parashikuara tregon se në përgjithësi nga subjekti është zbatuar disiplina buxhetore por konstatohet se në realcionet e paraqitura për analizën e veprimtarsë ekonomiko financiare, nuk vihen në dukje në se këto fonde janë të mjaftueshme për vazhdimësinë funksionale të institucionit, apo nevojat për rritjen e tyre për të realizuar objektivat e përcaktuara nga Qeveria.

-Miratimi i plan buxhetit për periudhën raportuese të vitit 2018.

Për periudhën raportuese të vitit 2018 bazuar në PBA afat mesëm, ish Drejtoria e Aluiznit Elbasan me shkresën nr. 19433 ka miratuar detajimin e shpenzimeve koherente të buxhetit për vitin 2018 dhe detajimin limit mujor në zbatim të ligjit të buxhetit të miratuar nga Drejtoria e Manaxhimit të Buxhetit në Ministrinë e Financave.

Plani i buxhetit është detajuar në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën/artikulli duke respektuar disiplinën buxhetore sipas strukturës buxhetore dhe burimeve të financimit.

Plani dhe realizimi i buxhetit sipas fondeve dhe natyrës së shpenzimeve pasqyrohet sa më poshtë

Nr	Emërtimi	Viti 2018					
		Plan Fillestar	Shtesa gjatë vitit	Shtesa pakësime	Plani gjithsej	Fakt	%

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT



Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ish-Drejtorinë e Aluizni Qarku Elbasan, (sot Agjensia Shtetërore e Kadastrës Elbasan)

		nga buxheti	nga buxheti	të ardhura të brendshme			
1	Llog.(600) "Paga e shperblime"	17,200	8,010	11,800	37,010	30,340	81
2	Llog.(601) "Kontribute Sig.Shoq shendetsore"	2,400	1,510	1,200	4,940	4,922	99
3	Llog.(602) "Shp.operative"	2,800	0	3,240	6,040	5,807	96
	Vendim gjykate	0	1,396	0	1,396	1,396	100
	LLog (466) Kthim vlere	0	0	1,446	1,446	1,446	100
4	Llog. (231) "Investime "	0	0	0	0	0	0
	Totali	22,400	22,400	22,400	22,400	22,400	87

Realizimi i të ardhurave të brendëshme.

Periudha raportuese 2018	Llogarit e analizuara		Totali		
	7116100	7110506	Plan	Fakt	%
Të ardhurat e brendëshme					
Nga shërbimet		3,683	4,000	3,683	92
Nga parcela	93,344	0	120,000	93,344	77
Të tjera nga rivlersimi dhe gjoba penalitete		245		245	100
Totali	93,344	3,928	124,000	97,272	78

Nga auditimi rezulton se ish Aluizni Elbasan, ka ndjekur në dinamikë të ardhurat e brendshme dhe mbi këtë bazë ka përcaktuar nevojat për shpenzime, si diferencë nga fondet e akorduara nga buxheti, i cili në fillim të vitit është çelur për shumën 22,400 milion lekë për zërin paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative. Situacionet mujore janë të rakorduara me thesarin ku pasqyra është e firmosur për cdo muaj nga specialisti dhe drejtori i thesarit. Diferenca e krijimit të ardhurave të brendëshme nga arkëtimi tarifës së shërbimit dhe nga parcela ndërtimore është derdhur totalisht në buxhet dhe nuk ka mbartje të trashëguara nga institucioni.

Realizimi shpenzimeve operative i ndarë në nën/artikuj llogaria. (602) "Shpenzime operative" sa më poshtë:

Nr	Emërtimi	Të ardhë brendsh	Nga buxheti	Gjith Plan	Fakt	%
1	Kancelari	450	450	900	860	95.5
2	Shpenzime telefonike dhe internet	60	86	146	143	97.9
3	Posta dhe shërbime korrieri	60	200	260	242	93
4	Shpenzime për taksa të instirucioni	53	0	53	53	100
5	Shpenzime udhëtimi brenda vendit	0	0	0	0	0
6	Energji elektrike	200	320	520	512	98.4
7	Ujë	0	16	16	16	100
8	Shpenzime gjyqi	0	1396	1396	1396	100
9	Investime	0	0	0	0	0
10	Shenzime për ruajtjen	0	840	840	837	99.6
11	Materiele për funksionimin e zyrës	300	650	950	943	99.2



12	Mirëmbajtje e paisjeve zyra dhe objekte	480	120	600	590	98.3
13	Karburanti	960	0	960	959	100
14	Të tjera	447	114	561	651	116
15	Kthim vlere për skualifikim të objektit	1,446	0	1446	1446	100
	Totali	4,456	4192	8648	8648	100

Nga krahasimi i të dhënave të pasqyruara në tabelë për dy vitet rezultojnë se realizimi i fondeve në llogaria (602) “Shpenzime operative” në nivel artikulli dhe në nivel nënartikujsh kanë ruajtur të njëjtin nivel realizimi. U bë krahasimi i pasqyrave financiare për të ardhurat dhe shpenzimet me aktraktordimet nuk u konstatuan deviacione.

-Përdorimi efektiv i fondeve të buxhetit. Shkaqet e tejkalimeve dhe mos realizimeve. Rakordimet që janë kryer me Degën e Thesarit për arketimet nga legalizimet.

Sa më sipër për periudhat raportuese objekt auditimi arrihet në konkluzionin se;

-Aluizni Elbasan si pjesë e programit PBA-n ka hartuar projektbuxhet vjetore për periudhën afatmesme 3 vjeçare për të ardhurat dhe shpenzimet të cilat janë dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Aluiznit Tiranë. Hartimi dhe zbatimi i buxheteve vjetore është bërë në përputhje me ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, UMF nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, si dhe udhëzimet vjetore përkatëse”.

Nga auditimi dhe analiza e fondeve buxhetore rezultojnë se veprimtaria financiare e Institucionit është rregulluar në zbatim të nenit 32 të ligjit nr. 9482 datë 3.04.2006 “Për Legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” të ndryshuar, udhëzimit nr. 2 datë 13.07.2017 të Ministrit të Financave “ Për zbatimin e buxhetit të shtetit”. Shpenzimet janë mbuluar nga vlera në masën 30 % e të ardhurave nga transferimi i pronës së parcelës ndërtimore dhe tarifave të shërbimit, e derdhur dhe e rishpërndarë sipas nevojave të Drejtorive Rajonale nga Drejtoria e Përgjithshme e Aluiznit. Kjo praktikë e përqëndruar nuk ka bërë të mundur avancimin e procesit të legalizimit sipas kuotave të kërkuara pasi nga mungesa e herëpashershme e fondeve nuk është siguruar numri i nevojshëm i punonjësve me kontratë të domosdoshëm për ndjekjen e procesit të legalizimit.

Nga auditimi i veprimeve të shpenzimeve të kaluara me bankë deri në fund të periudhës që auditohet rezultojnë se, natyra e shpenzimeve është e njëjtë, janë zbatuar po të njëjtat kritere dhe konstatohet se transaksionet e pagesave për procedurat e prokurimeve për blerjet me vlerë të vogël janë të shoqëruar me dokumentacion të saktë autorizues e vertetues për kalimin e shumave në bankë dhe të kuadruara me thesarin. Nga sa verifikuam mendojmë se është e mjaftueshëm gjetja mangësive nuk është nevojta të bëjme përkrahime të përsëritura për të njëjtat veprime.

III.3.Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës (Pagat dhe Shpërblimet etj).

Në zbatim të pikës 3 të programit të auditimit “**380/1, datë 28/05/2019**”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Urdhër - Shpenzimet e bankës në lekë për vitet 2017, 2018, 5-muori I-viti 2019, me praktikat bashkëlidhur dokumentacionin për pagat (dokumentacionin autorizues, vërtetues, e mbështetës).

Objekti i këtij akt verifikimi është: Auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave. Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me faktin. Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve. Respektimi i kufirit të fondeve të planifikuara me destinacion shpenzimet e pagave të punonjësve. Zbatimi i vendimit të komisionit



të shërbimit civil dhe të gjykatave me qëllim evidentimin e rasteve kur nga entet e publike për një pozicion pune paguhen njëkohësisht dy persona.

Nga verifikimi rezultoi që:

Mbi organizimin dhe funksionimin Drejtorisë së ALUIZNI-t Elbasan

Në bazë të ligjit të Shërbimit Civil, MFK dhe të dispozitave të ligjore për pagat e punonjësve, Titullari i institucionit në bashkëpunim me Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, realizojnë hartimin dhe ndjekin zbatimin e Buxhetit, organizimin e procedurave të rekrutimit të stafit të ri, përgatitjen e procedurave të punësimit, për plotësimin e organikës dhe strukturave të miratuara. Sigurojnë zbatimin e dispozitave ligjore të pagave, kontabilizimin e transaksioneve financiare, si dhe menaxhimin e trajnimeve etj.

Në mbështetje të Urdhrit nr. 58, datë 05.04.2016 të Kryeministrit “*Miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë së Legalizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) dhe Drejtoritë në varësi të saj*” Dërgohet VKM nr. 63, datë 12.02.2014 për ndryshimin e VKM nr. 545, datë 11.08.2011 “*Miratimi i strukturës dhe nivelit të pagave sipas lidhjes 2/2 që sipas së cilës përcaktohet kategoria III-a/1 me grupin 1 Drejtor, IV-a –grupi 1 Përgjegjës sektori dhe IV-b grupi 1, ose 2 ose 3 specilaist*, duke përcaktuar dhe kushtet e punës.

Me shkresën nr. 6974/3, datë 23.01.2017 është dërguar nr. punonjësve në strukturë për vitin 2017, që ishte 19 punonjës dhe bazuar në shkresën nr.1063/1, datë 17.02.2017, shkresës nr. 2807/1, datë 24.05.2017 është dërguar nr. i punonjësve me kontratë për vitin 2017.

STRUKTURA e miratuar përbëhet nga: Drejtori, Sektori i Legalizimit e Planifikimit Urban, Sektori i Legalizimit Librazhd, Sektori i Hartografisë e Përpunimit të Informacionit, Sektori i Çështjeve të Pronësisë, Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse .

ORGANIKA për periudhën **01.01.2017 deri 31.12.2017** përbëhet nga 19 punonjës sipas emërtimeve:

- | | |
|---|---|
| • Drejtor | 1 |
| • Specialistë ne zyrën e legalizimeve | 4 |
| • Specialistë ne zyrën e legalizimeve Librazhd | 3 |
| • Specialistë në zyrën e hartografisë | 4 |
| • Specialistë ne zyrën e çështjeve të pronësisë | 3 |
| • Specialist i Sektorit të Financës | 4 |

Për nëpunësit e Drejtorisë së ALUIZNI-t Elbasan marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet Ligjit nr.7961 datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*” i ndryshuar. Punonjësit me kontratë të përkohshme janë marë mbështetur në VKM nr.7 datë 11.01.2017 të Këshillit të ministrave “*Për përcaktimin e punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2017*”, i ndryshuar me VKM nr.251 datë 29.03.2017, ndërsa planifikimi i fondeve dhe shpenzimet për kosto personeli kryhen në bazë të ligjit të Buxhetit “*Për buxhetin e vitit 2017*”, dhe nje pjese e konsiderushme mbulohet nga te ardhurat e krijuara nga vetë institucioni si Tarifa e Shërbimit dhe 30% i pagesës së Parcelës Ndërtimore të objekteve informale në proces legalizimi.

Ndërsa 63 punonjësit me kontratë të përkohshme janë rekrutuar dhe janë kontraktuar në bazë të VKM nr. 7, datë 11.01.2017, i ndryshuar. Bazuar në Urdhrit nr. 58, datë 05.04.2016 të Kryeministrit “*Miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë së Legalizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) dhe Drejtoritë në varësi të saj*”, sipas skemës 2/6.



Me shkresën nr.19108, datë 05.01.2018 është dërguar nr. punonjësve në strukturë për vitin 2018, që ishte 19 punonjës, shkresën nr. 19551/27 Prot., datë 05.02.2018 është dërguar detajimi i punonjësve me kontratë për vitin 2018, mbështetur në VKM nr. 60, datë 31.01.2018, “Për përcaktimin e punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2018” i ndryshuar me VKM nr. 463, datë 26.07.2018, ku janë përcaktuar nr. i punonjësve me kontratë për vitin 2018.

STRUKTURA: nuk ka ndryshuar dhe është, Drejtor, Sektori i Legalizimit Planifikimit Urban, Sektori i Hartografisë Përpunimit Informacionit, Sektori i Çështjeve të Pronësisë, Sektori i Legalizimit Librazhd, Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

ORGANIKA për periudhën **01.01.2018 deri 31.12.2018** për vitin 2018 përbëhet nga 19 punonjës në strukturë nga të cilët:

- Drejtor 1
- Specialistë në zyrën e legalizimeve 4
- Specialistë në zyrën e legalizimeve Librazhd 3
- Specialistë në zyrën e hartografisë 4
- Specialistë në zyrën e çështjeve të pronësisë 3
- Specialist i Sektorit të Financës 4

Për vitin 2017 janë miratuar punonjës të përhershëm 19 dhe të përkohshëm 65, nga të cilët 58 (specialistë), 7 teknik, sipas VKM nr. 7, datë 11.01.2018 të ndryshuar me VKM nr. 251, datë 29.03.2017.

Për vitin 2018 janë miratuar punonjës të përhershëm 19 dhe të përkohshëm 35, nga të cilët 32 (specialistë), 3 teknik, sipas VKM nr. 60, datë 31.01.2018 të ndryshuar me VKM nr. 463, datë 26.07.2018.

Për 5- mujorin e vitit 2019 janë miratuar punonjës të përhershëm 19 dhe të përkohshëm 26, nga të cilët 23 (specialistë), 3 teknik, sipas VKM nr. 16, datë 16.01.2019.

Krahasimi i përmbledhësës së listëpagesave me shumat e urdhër shpenzimeve dhe pagesat e kryera.

Nga krahasimi që ju bë përmbledhësës së listë-pagesave me likuidimet, nuk u konstatuan pasaktësi në shpenzimet për paga për periudhën e audituar.

Realizimi i fondit të pagave për punonjësit e përhershëm në strukturën organike dhe punonjësit me kontratë paraqiten në tabelën e mëposhtme:

000/lekë

Nr	Emërtimi	Viti 2017			Viti 2018			5 mujori viti 2019		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
1	Paga	47,752	47,672	0.99	37,010	30,340	0.82	25,138	10,606	0.42
2	Sig. shoq	8,315	8,090	0.97	4,940	4,922	0.99	4,199	1,778	0.42
3	Nr.Punonj	84	82	0.98	54	54	1	45	45	1

Pagesat janë shoqëruar me dokumentacionin mbështetës si listë-prezencat si dhe urdhrat e veçantë të titullarit. Janë nënshkruar nga drejtuesi kryesor të gjithë listë-prezencat dhe urdhër-shpenzimet për paga. Urdhër shpenzimet janë nënshkruar edhe nga Dega e Thesarit Elbasan.

U bë krahasimi i librit të pagave me regjistrin themeltar sipas viteve, për rakordimin e numrit të nëpunësve të paguar me atë të përfshirë në regjistër dhe nuk pati parregullsi.



U kryen verifikime me zgjedhje për regjistrimin e nëpunësve me kontratë dhe rezultoi se janë të regjistruar në regjistrin themeltar dhe në librin e pagave, veprime të rakorduar me të dhënat e listë - pagesave.

Niveli i pagave është përcaktuar në zbatim të VKM nr. 589, datë 17.7.2013 “Për disa shtesa e ndryshime në Vendimin nr. 545, datë 11.08.2011 të Këshillit Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të nëpunësve civil, zv/ministrit dhe nëpunësit të kabineteve në Kryeministri, aparatit e ministrive të linjës, administratës të presidentit, komisionit qendror të zgjedhjeve, Prokurorisë së Përgjithshme, disa institucioneve të pavarura, institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit, institucione në varësi të ministrive të linjës dhe administratën e prefektit” lidhja 1. Struktura e pagave për nëpunësit civilë/nëpunësit në të gjitha institucionet pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi” dhe lidhja nr. 9/4 “Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat "specialist" deri në "titullar institucioni" në drejtoritë e agjencisë së legalizimit, urbanizimit dhe integritit të zonave/ndërtimeve informale”. Si dhe nga muaji Mars 2017 sipas VKM nr 187 date 8.03.2017. “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri aparatet e ministrive të linjës, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit.

Nga auditimi me zgjedhje i listëpagesave për vitit 2017, 2018 dhe 5-mujorin e vitit 2019 në lidhje me verifikimin e nivelit të pagave për çdo punonjës dhe arsimimin sipas diplomës, vjetërsinë e punës të përcaktuar në librezat e punës të secilit nuk u konstatuan mospërputhje të nivelit të diplomës me kategorinë e vendit të punës dhe funksionit sipas emërimit. Për rrjedhojë rezultoi se ato janë në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara në VKM nr. 545, datë 11.08.2011 të Këshillit Ministrave.

Në përlllogaritjet e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësorë të përballuara nga punëmarrësi dhe ato të përballuara nga punëdhënësi, deklarimet, ndalesat si dhe derdhjet e tyre janë bërë në përputhje me ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7770, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar.

Regjistri i nëpunësve është mbajtur dhe azhurnuar periodikisht sipas nëpunësve. Janë mbajtur dosjet e punonjësve ku janë të kompletuar me dokumentacionin e duhur.

Niveli pagave për punonjësit me kontratë të përkohshme është përcaktuar në kategorinë IV-b sipas VKM nr. 589, datë 17.7.2013 “Për disa shtesa e ndryshime në Vendimin nr. 545, datë 11.08.2011 të Këshillit Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të nëpunësve civil, zv/ministrit dhe nëpunësit të kabineteve në Kryeministri, aparatit e ministrive të linjës, administratës të presidentit, komisionit qendror të zgjedhjeve, prokurime së përgjithshme, disa institucioneve të pavarura, institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit, institucione në varësi të ministrive të linjës dhe administratën e prefektit”, ndërsa për specialistët e mesëm niveli i pagës është përcaktuar ,sipas kategorisë VI të Lidhjes II të VKM nr. 610 datë 24.07.2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 717, datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore” pika 1/b. Si dhe VKM nr 187 date 8.03.2017. “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri aparatet e ministrive të linjës, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”.

Për gjithë punonjësit me kontratë janë hapur dosje me të dhënat e domosdoshme për arsimin, kualifikimet, CV, certifikatat personale, librezat e punës, kontratat e lidhura me punëdhënësin e shkresat e emërimit sipas periudhave si dhe dokumentet e tjera plotësuese të dosjes sipas VKM nr. 355, datë 07.07.2000 ” Për organizimin e dosjes së personeli”.



Kontratat janë lidhur në bazë të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Me urdhër nr. 117, datë 14.7.2015 të Ministrit të Zhvillimit Urban është bërë miratimi i Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e ALUIZNI-t”, e cila ka shfuqizuar rregulloren e Brendshme me nr. 61, datë 16.01.2008.

Marrja në punë dhe përcaktimi i pozicionit dhe nivelit të pagës të punonjësve si me kontratë më kohë të pacaktuar dhe me kontratë të përkohshme është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i ALUIZNI-t.

(Problematikat e mësipërme janë trajtuar në Akt-Verifikimin nr. 2, datë 30.07.2019, dorëzuar zyrtarisht në Zyrën e Protokollit të DR të ASHK-së Elbasan).

Mbi zbatimin e vendimeve të Gjykatave, me qëllim evidentimin e rasteve kur nga entet publike paguhen për një pozicion pune njëkohësisht dy persona.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

-Me urdhër-shpenzimin nr. 38, datë 27.03.2018, janë kryer shpenzime në shumën 1,395,520 lekë, me objekt “Ekzekutim Vendim Gjyqi”: 1,246,000 lekë dhe “Tarifë shërbimi përmbarimor”: 149,520 lekë, në kredi të përfituesit: shoqërisë përmbarimore ”S” shpk, me xhirim datë 27.03.2018, sipas faturës nr. 144, nr. Serie 58125174, dt. 23.03.2018, vendim gjyqi nr.(82-2016-1084) 706, dt.14.07.2016 të Gj.A. të Sh. Së P. Durrës, v.gj. nr.4443, datë 26.10.2017 të Gjykatës Ad. Të Apelit Tiranë, Urdhër 94, datë 23.03.2018.

Sipas shkresës së shoqërisë përmbarimore ”Strati Bailiffs Service” shpk nr. 2850, datë 23.03.2018 i është përcjellë Drejtorisë së ALUIZNI-t Elbasan fatura tatimore e shitjes nr. 144, nr. Serie 58125174, dt. 23.03.2018, “Tarifë shërbimi përmbarimor” për shumën 149,520 lekë për punonjësën e ALUIZNI-t Elbasan znj. E K.

Sipas shkresës së shoqërisë përmbarimore ”Strati Bailiffs Service” shpk nr. 2864, datë 26.03.2018 i është përcjellë Drejtorisë së ALUIZNI-t Elbasan vendim gjyqi nr.(82-2016-1084) 706, dt.14.07.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Durrës, dokument i noterizuar, sipas të cilit është vendosur detyrimi i Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë dhe ALUIZNI-t Elbasan, për të dëmshpërblyer paditësen znj. E K me:

-3 muaj pagë sipas nenit 143 të Kodit të Punës.

-2 muaj pagë sipas nenit 144 të Kodit të Punës.

-12 muaj pagë për shkak të zgjidhjes së menjëhershme të kontratës së punës pa shkaqe të arsyeshme sipas nenit 155 të Kodit të Punës.

- Një 15 ditësh mbi çdo vit punë të plotë (paga mujore në përfundim të marrëdhënieve të punës), për periudhën 01.04.2010-01.04.2016, sipas nenit 145 të Kodit të Punës.

- Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

Vendimi i mësipërm është ankimuar dhe me vendimin nr.4443, datë 26.10.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr.(82-2016-1084) 706, dt.14.07.2016, të gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

Me shkresën nr. 475, datë 12.01.2018, shoqëria përmbarimore ”Strati Bailiffs Service” ka urdheruar vendosjen e masës së sekuestros konservative në llogarinë e palës debitore Drejtorisë së ALUIZNI-t Elbasan, për ekzekutimin e vendimeve të gjykatave, në masën 1,395,520 lekë.

Vendimi për dëmshpërblym është marrë nga Gjykata Administrative, me arësyetimin e një largimi të padrejtë nga puna të punonjësës së ALUIZNI-t Elbasan znj. E K.

-Në pjesën vërejtëse dhe arësyetimit ligjor dhe analizës së fakteve të vendimit nr.(82-2016-1084) 706, dt.14.07.2016, të gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, si indice për fillimin e procedurës gjyqësore është marrë urdheri nr. 477, datë 25.04.2016 i Titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, sipas të cilit punonjësja E.K lirohet nga detyra si specialiste



në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe emërohet si specialiste në Sektorin e legalizimit Librazhd, pranë Drejtorisë së ALUIZNI-t Elbasan. Gjykata e ka çmuar të arësyeshme duke e marrë këtë shkresë de fakto, si masë largimi nga puna, kjo e arësytuar proceduralisht nga rrethanat objektive dhe subjektive të çështjes, mosndjekjen e procedurave administrativo-ligjore sipas kontratës së punës së lidhur me punëdhënësit dhe punëmarrësit dhe mosrespektimin e dispozitave të Kodit të Punës, lidhur me këtë.

-Në pjesët vërejtëse të vendimit nr.(82-2016-1084) 706, dt.14.07.2016, të gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, përmendet veç të tjerave edhe pretendimi i znj. E K, ish-Punonjëse në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, se *“lirimi nga detyra është kryer me qëllim zëvendësimit e saj me një punonjëse tjetër”*.

-Në pjesën *“Arësytimi ligjor dhe analiza e fakteve”*, gjykata parashton se *“Shkaku për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës jo vetëm që nuk argumentohet nga pala e paditur (ALUIZNI Elbasan), por është edhe një interpretim abuziv me dispozitat e Kodit të Punës, duke mos argumentuar shkurtimin e vendeve të punës”*.

Me këto indicie, u kërkua nga Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, materialet dokumentare lidhur me këtë çështje si dhe u krye konstatimi i strukturës dhe organikës për periudhën 01.01.2017-31.05.2019. Kjo sepse: janë 17 muaj shpërblime gjithsej dhe këtyre u shtohen edhe shpërblimet ½ pagë mujore për çdo vit pune dhe shpenzimet gjyqësore dhe përmbartimore.

Nga verifikimi rezulton se për vitet 2017, 2018, deri në kohën e ristrukturimit në 2019, Drejtoria e ALUIZNI-t Elbasan ka patur në strukturë 19 punonjës, strukturë e cila është plotësuar faktikisht për këtë periudhë dhe nuk ka patur vende bosh të paplotësuara, pjesë e së cilës ka qenë edhe paditësja znj. E.K. Kësaj të fundit i është ndërprerë kontrata e punës me urdhrin nr. 1478, datë 27.09.2016 të Drejtorit të përgjithshëm z. A L, me motivacionin *“për shkak të mosparaqitjes në punë pa shkaqe të arsyeshme prej datës 20.05.2016”*, urdher i dalë ndërkohë që vazhdonte procedura gjyqësore në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Pas daljes së këtij urdhëri punonjësja e larguar është zëvendësuar me specialisten E T.

Urdhri i mësipërm është nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm, bazuar në shkresës nr. 3626/3, datë 23.05.2016, të Drejtorit të ALIZNIT z. M D, kërkesë për fillimin e procedurave disiplinore administrative dhe largimin nga puna (Zgjidhje e kontratës së punës) dhe shkresës nr. 7046, datë 27.09.2016, ku rikonfirmohet kërkesa për largim nga puna të znj. E.K dhe kërkohet informacioni si të veprohet pas vendimit të Gjykatës, duke qene se punonjësja vazhdonte të ishte në punë.

Sa sipër duke kryer mesatarizimin e pagesës kemi për 17 muaj një pagesë prej 1,395,520 lekë, perudhë në të cilën janë paguar de fakto në Sektorin e ALUIZNI-t Librazhd, për një pozicion pune njëkohësisht dy persona, për një periudhë 17 muaj, siç ka përcaktuar gjykata, duke u shpenzuar shuma 1,395,520 lekë, veprim i cili ka efekte financiare negative, me shkak mosndjekjen e procedurave të rregullta ligjore sipas Kodit të Punës dhe kontratës së lidhur, nga strukturat e Drejtorisë së ALUIZNI-t Elbasan.

(Problematikat e mësipërme janë trajtuar në Akt-Konstatimin nr. 6, datë 30.07.2019, dorëzuar zyrtarisht në Zyrën e Protokollit të DR të ASHK-së Elbasan).

III.4. Mbi administrimi, ruajtja, dokumentimi dhe qarkullimi i asetëve dhe aktiveve



Në zbatim të pikës 4 të programit të auditimit “**380/1, datë 28/05/2019**”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Urdhër-Shpenzimet e bankës në lekë dhe valutë për vitet 2017, 2018, 5-muori I-viti 2019, me praktikat bashkëlidhur (dokumentacionin autorizues, vërtetues, e mbështetës).

-Ditaret e bankës, magazinës, pagave, veprimeve të ndryshme, etj.

-Kartelat e magazinës dhe fletë-udhëtimet e karburantit.

-Inventaret fizike dhe kontabël të viteve 2017, 2018. Dokumentacioni i kryerjes së inventareve të aktiveve, libri i aktiveve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare

Administrimi vlerave monetare në arkë :

Ky institucion për periudhën objekt auditimi nuk ka kryer asnjë veprim me arkë pasi veprimet likuiduese dhe transaksionet financiare janë kryer nëpërmjet bankës.

Administrimi vlerave monetare në bankë.

Drejtorja e ALUIZNI-t Elbasane mban llogaritë e saj dhe kryen veprime pagesash e arkëtimesh me Bankën “RAIFFESEN BANK”. Urdhër shpenzimet janë konfirmuar nga Dega e Thesarit dhe xhiroja kreditore e llogarive disponibël në Thesar është e njëjtë me rakordimet me thesarin, të cilat janë mbështetur ne dokumente justifikues.

Lidhur me të ardhurat nga tarifat e shërbimit dhe vlerën e parcelave ndërtimore, gjendja e llogarive disponibël në Thesar e rakorduar është e njëjtë me evidencat e këtyre të ardhurave për çdo muaj të nxjerra nga ALUIZNI Elbasan.

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin.

Të ardhurat dhe shpenzimet i përkasin periudhës raportuese, të rakorduar këto me Degën e Thesarit. Llogaria e disponibiliteteve në Thesar është e barabartë me rezultatin e ushtrimit e rakorduar me Degën e Thesarit. Dokumentacioni bazë që pasqyron veprimet e kryera me bankë e magazinë është pasqyruar në ditarët përkatës, ku veprimet janë kryer me bankë, magazinë dhe me listë-pagesa. Për periudhën e audituar për vitet 2017 dhe vitin 2018, dhe 5-mujorin e parë të vitit 2019, rezultoi se kontabilizimi i veprimeve është bërë në llogaritë që përcakton plani kontabël sipas klasifikimit buxhetor.

Nga auditimi i këtyre procedurave me zgjedhje u konkludua se:

Administrimi vlerave materiale, magazinimi dhe qarkullimi i tyre

Magazina ka funksionuar normalisht duke administruar dhe dokumentuar lëvizjen e vlerave materiale sipas kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe auditimin”, si dhe aktet nënligjore të dalë në zbatim.

Dokumentimi i vlerave materiale në kontabilitet, rakordomi dhe kuadrimi i tyre analitikisht është pasqyruar saktësisht edhe në bilancin kontabël.

Mbështetur në dokumentet e vëna në dispozicion, rezultoi se në drejtim të hyrjeve dhe daljeve të aktiveve nga ky institucion konstatohet se veprimet kryhen në zbatim të udhëzimit nr. 30, datë



27.12.2011.

Nga grupi i auditimit u krye verifikimi për disa artikuj të përdorimit të gjerë nga ku rezulton se Mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë në lidhje me kryerjen e shpenzimeve, magazinimin dhe përdorimin e karburantit”.

Veprimet nëpërmjet magazinës

Nga auditimi i dokumentacionit i veprimeve nëpërmjet magazinës rezultoi se:

-Mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhej në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike. Çdo regjistrim kontabël bëhej sipas dokumentacionit bazë si flet-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit. Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje rezultoi se veprimet ishin kontabilizuar saktë.

-Fletë daljet e magazinës janë hartuar dhe firmosur nga magazinieri, ku për mallra të ndryshëm ishin të shoqëruara me plan-shpërndarje të miratuara nga drejtori.

-Është mbajtur libri inventar me të dhënat e aktiveve të trupëzuara me azhurnimet e përditësuara deri në momentin aktual, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit në përputhje me kap III pika 30 të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Janë hapur kartela e zyrave inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina, në mënyrë që sektori ekonomik të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës, që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjësisë në çdo rast të lëvizjeve, të shpërdorimeve, të dëmtimeve apo humbjeve.

- Nga auditimi me përzgjedhje i dokumentacionit kartela e magazinës rezultoi se nuk ka diferenca ndërmjet vlerës kontabile të paraqitur në bilanc dhe vlerës kontabël të kartelave të magazinës më 31.12.2017 dhe 31.12.2018.

Administrimi i karburantit.

Drejtorja e ALUIZNI-t Elbasan nuk disponon një automjet në shërbim të administratës. Ne zbatim të ligjit nr.7961 dt.12.07.1995” kodi i punes se Republikes se Shqiperise “i ndryshuar dhe kerkesave qe ka bere Drejtorja e ALUIZNI-t Elbasan per miratimin e perkohshem te automejteve vetjake dhe furnizimin me karburant per nevojat e punes gjate vitit 2017 dhe 2018 ka pasur furnizime me nafte nga magazina e Drejtorise se Pergjitheshme te Aluiznit.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe krahasimi i fletëdaljeve të prera për mjetin në përdorim me kilometrat e shënuara në fletë udhëtime dhe normën e harxhimit për 100 km nuk rezultoi se për lëvizjet e kryera nuk ka diferenca. Norma e harxhimit për 100 km është përcaktuar nga procesverbal konsumi të mbajtur nga komisioni i punonjesve i ngritur me urdher të drejtorit për këto qellim.

Për lëvizjet e automjeteve janë mbajtur për çdo datë fletë-udhëtime të firmosur nga personi udhëtues, drejtori i Institucionit dhe drejtuesi i automjetit. Për çdo rast janë plotësuar të gjitha lëvizjet me destinacionet përkatëse, duke shënuar distancat në kilometra të tyre dhe duke u nënshkruar nga nëpunësi apo punonjësi në shërbim të cilit është vënë mjeti.

Daljet e karburantit janë bërë personave përdorues bazuar në planin e punes, urdherin e titullarit, autorizimit për përdorimin e automjetit dhe flete udhëtimeve për justifikimin e konsumit të sasisë së tërhequr. Veprimet janë kontabilizuar si shpenzim (llogarinë 60222) për çdo rast për vlerën e bërë dalje magazine..

Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave.



Për vitin 2017

Urdhër i brendshëm nr. 498 prot. datë 26.12.2017 “Për krijimin e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese për vitin 2017”, bazuar në ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve Informale“, i ndryshuar, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 20, datë 17.11.2014. Komisioni i inventarizimit përbehet nga: V B, M S, K T, H P, J S, E K dhe R B. Gjatë kryerjes së inventarit komisioni ka mbajtur procesverbalet përkatës sipas objekteve të inventarit dhe njëkohësisht ka konstatuar artikuj të ndryshme si automjetin e institucionit (Volksëagen me targë TR 7716 N) në gjendje të papërdorshme për efekt të dhunimit, konsumit fizik e moral të tij.

Në përfundim të inventarit vlera në lekë e llogarisë 327 (Inventar i imët) pasqyrohet në bilancin e vitit 2017 për vlerën e mbetur 242,214 lekë.

Për vitin 2018

Urdhër i brendshëm nr.613, datë 24.12.2018 “Për krijimin e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese për vitin 2018”, bazuar në ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve Informale“, i ndryshuar, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 20, datë 17.11.2014. Komisioni i inventarizimit përbehet V B, kryetare, M S dhe J S. Gjatë kryerjes së inventarit komisioni ka mbajtur procesverbalet përkatës sipas objekteve të inventarit .

Në vijim të procedurave të daljes jashtë përdorimit nga viti 2017 të automjetit të institucionit pasi është marrë Miratimi nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t, me shkresë nr. 1203/1, datë 14.02.2018 "Për miratimin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara" është vijuar me procedurat e ankandit.

Drejtori i ALUIZNI-t ka nxjerrë Urdhër nr. 546, datë 08.11.018 "Për shitjen e mjetit si skrap hekur" si dhe me Urdhër nr. 547, datë 08.11.2018 ka ngritur komisionin "Për krijimin e njësisë së ankandit"

Pasi janë përcaktuar vlera fillestare nga testimi i tregut ku është marrë për bazë vlera më e lartë 26,400 lekë dhe pasi janë përgatitur dokumentat sipas dokumentave standarte të miratuar nga APP, Ligjit nr. 9874, datë 14.02.2008 "Për Ankandin Publik" është bërë publikimi i Njoftimit të Ankandit në Buletinin nr. 46, datë 19.11.2018 të Agjencisë së Prokurimeve Publike. Në datë 12.12.2018 është paraqitur vetëm një ofertues "Xh H" i cili ka ofertuar me vlerën 26,400 lekë, i cili është shpallur fitues dhe është nënshkruar kontrata 9604 datë 31.12.2018 në bazë të së cilës është bërë dhe arkëtimi i vlerës në B A I në datë 31.12.2018 nga Fituesi i ankandit, operatori "X H" në Vlerën 26,400 lekë.

Në përfundim të inventarit vlera në lekë e llogarisë 215 (Mjete transporti) pasqyrohet në bilancin e vitit 2018 për vlerën e mbetur 0 lekë.

Në përfundim të inventarit vlera në lekë e llogarisë 327 (Inventar i imët) pasqyrohet në bilancin e vitit 2018 për vlerën e mbetur 332,424 lekë.

Mbi auditimin dhe zbatimin e procedurave ligjore për rikthim vlerë parcele për subjektet që i është ndërprerë procesi i legalizimit.

Në auditimin e veprimeve të kryera me bankë, rezulton se në vitin 2017, 2018 ka 2 raste kthime vlere për subjektet që u është ndërprerë procesi i legalizimit të objektit:

Për vitin 2017 eshte paguar 1 rast dhe konkretisht:

- Urdhër shpenzimi nr.204, datë 28.12.2017, vlera 53910 leke nga parcela nderimore lekë qytetari



Kh M Sh, i cili ka paraqitur kërkesën nr. 14393 Prot., datë 22.12.2017, në vijim të së cilës është bërë kthim për anulim pronësie pasi e zotëronte me çertifikatë pronësie parcelën për të cilën kishte paguar, sipas shkresës nr.14393/1 prot, dt.22.12.2017, si dhe urdher i Drejtorit të Drejtorisë nr. 495, datë 22.12.2017 "Për rikthimin e vlerave të derdhura gabim".

Veprimet e mësipërme janë zbatuar në mbështetje të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", Udhëzimi plotësues i Ministrisë Financave nr. 2/1, datë 11.02.2015 për disa shtesa në udhëzimin plotësues nr. 8, datë 13.01.2017 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017", udhëzimit nr. 2, datë 09.01.2015 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2015", udhëzimit nr. 3, datë 16.01.2016 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016".

- Urdhër shpenzimi nr.138, datë 05.10.2018, vlera 1446392 lekë nga parcela nderimore qytetari K Ll P (trashëgimtarët) të cilët kanë paraqitur kërkesën nr. 2722 Prot., datë 12.04.2017, në vijim të së cilës janë mbajtur procesverbalit datë 12.04.2018 si dhe urdher i Drejtorit të Drejtorisë nr. 140, datë 12.04.2018 "Për rikthimin e vlerave të derdhura gabim". Për dosjen nr. 7150, datë 26.09.2006 dhe nr.1683, datë 07.07.2013 është bërë skualifikimi i objektit me vendim të skualifikimit nr. 21812, datë 08.03.2018 dhe shkresa nr. 1518 Prot., datë 13.02.2018 "Dergim dokumentacioni tekniko ligjor për korigjim gabimi" si dhe kthim për anulim pronësie sipas shkresës nr.2722/1 prot, dt.17.04.2018.

Veprimet e mësipërme janë zbatuar në mbështetje të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", Udhëzimi plotësues i Ministrisë Financave nr. 2/1, datë 11.02.2015 për disa shtesa në udhëzimin plotësues nr. 8, datë 13.01.2017 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017, udhëzimit 2, datë 19.01.2018 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018" pika 6 e tij.

Sipas kësaj dispozite kërkohet që: "Zbatimi i vendimeve gjyqësore që lidhen me procesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje, si dhe rikthimi i vlerave të arkëtuara, subjekteve që u është ndërprerë procesi i legalizimit në përputhje me aktet nënligjore në zbatim të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve Informale" i ndryshuar, do të përballohen me të ardhurat e realizuara nga transferimi i parcelës ndërtimore, të cilat nuk janë transferuar në llogarinë e kompensimit të pronave".

Sipas kësaj dispozite kërkohet që "Zbatimi i vendimeve gjyqësore që lidhen me procesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje, si dhe rikthimi i vlerave të arkëtuara, subjekteve që u është ndërprerë procesi i legalizimit në përputhje me aktet nënligjore në zbatim të ligjit nr. 9482, datë 3.04.2006 "Për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve Informale", i ndryshuar, do të përballohen me të ardhurat e realizuara nga transferimi i parcelës ndërtimore, të cilat nuk janë transferuar në llogarinë e kompensimit të pronave".

Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për derdhjen e detyrimeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe tatimit për të ardhurat personale".

Janë llogaritur pagesat për "Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore" dhe "Tatim page", të mbajtura në kohë, në shumën e përgjithshme 5,768,810 lekë detyrime tatimit mbi page dhe 25, 188,751 lekë për kontributin e sigurimeve shoqërore. Nga verifikimi në borderotë e pagesave rezulton se nuk ka penalitete dhe gjoba, sipas tabelës së mëposhtme:

Për ALUIZNIN Elbasan

Viti	Tatim page	Interesa të paguara Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan për mos likuidim në afat të
------	------------	--



	Totali pagave		TAP-it dhe Sigurimeve .		
			Tatimin pages e	Kontributin e sigurimeve shoqërore	Shuma e interesit e
		(1)	(2)	(3)	(2+3=4)
Viti 2017	47,731,345				
Viti 2018	30,336,524	0	0	0	0
5-mujori 2019	10,606,241	0	0	0	0
Shuma	88,674,110	0	0	0	0

(Problematikat e mësipërme janë trajtuar në Akt-Verifikimin nr. 1, datë 29.07.2019, dorëzuar zyrtarisht në Zyrën e Protokollit të DR të ASHK-së Elbasan).

III.5. Prokurimi i fondeve publike për mallra, ndërtime dhe shërbime

- Argumentimi ligjor i procedurave të prokurimit, zbatimi i procedurave të prokurimit, nga nxjerrja e urdhërit të prokurimit deri në shpalljen e fituesit, lidhja dhe zbatimi i kontratave, kontrolli fizik për marrjen në dorëzim të mallrave.

- Ish Agjencia Aluiznit (aktualisht ASHK) Elbasan, në **organizimin e procedurës së blerjeve me vlerë të vogël** për periudhat objekt auditimi të viteve 2017 dhe 2018, ka vepruar duke mbajtur regjistrat e parashikimit të prokurimeve publike të cilët i ka dërguar në Agjencinë e Prokurimit Publik brenda datës 15 janar të çdo viti, si dhe shtesat apo pakësimet për gjatë vitit shoqëruar me regjistra shtesë në përputhje me nenin 4 “Regjistri i parashikimeve të prokurimeve publike” të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Pasqyra për paraqitjen e prokurimeve me vlerë të vogël 000 lekë;

Nr	viti	Objekti	Fondi	Fakt	%	Vlera me tvsh
1	2017	Kancelari	800	779	97,3	935
		Mat tjer funks zyrove	800	765	95,6	918
		Furnizime tjera zyre	100	55	55	66
		Blerje dokumentacioni	100	99	99	99
		Blerje karburant	800	800	100	960
		Shp për sig e automjet	20	15	75	18
		Shp për pjes këmb	100	95	95	115
		Shp për ruajtje objekti	560	545	97,3	654
		Blerje paisje zyre	800	788	98,5	945
		Totali	4080	3941	96,6	4710
2	2018	Blerje dokumentacioni	100	100	100	120
		Blerje karburant	800	800	100	960
		Blerje mat e kanceleri	800	717,1	89	860
		Detergjent mat pastrimi	100	93,3	93	111
		Furnizimi mat zyre të përgjithshme	100	97,9	98	109
		Shërbim sig roje	800	697,4	87,1	837
		Sherbime te printimit	100	97,8	98	117
		Shp tjera transporti	99	98	100	117



		Shp për mbajtjen e paisjeve zyrës	99	96,6	97,5	118
		Shjp mirmb e rrjeteve	90	89	100	108
		Blerje mat per funk e paisjeve	800	786	98,2	944
		Shp për mirmb object ndertimor	498	386,6	77,6	463
		Furnizime tjera zyre	100	91,1	91	109
		Totali	4486	4176.9	93.1	4973

Për organizimin e procedurës së blerjeve Titullari ka nxjerr urdhërat e prokurimit për krijimin e komisioni të blerjeve me vlerë të vogël i përbërë nga A H kryetar, H P dhe N S anëtar.

Në regjistrat e prokurimeve janë parashikuar shpenzime për t'u kryer me procedurë "blerje e vogël" dhe konstatohet se komisioni i autorizuar për realizimin e procedurës së blerjes në vitin 2017-2018 në të gjithë rastet ka evidentuar dhe kryer procedurën me prokurim elektronik, ku fituese është ofertuesi i parë, veprim në përputhje me Udhëzimin nr.3, datë 27.01.2015 "Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël" i ndryshuar dhe në 7 raste ka qenë e nevojshme zbatimi i pikës 5 e riformuluar ku citohet qartë; "Kur Autoriteti Kontraktor kalon tek ofertuesi i renditur në vend të dytë dhe në vijim, ka detyrimin ta njoftojë atë menjëherë nëpërmjet sistemit elektronik (menusë së mesazheve), mbi klasifikimin e ri të procedurës", në mospërputhje me pikat 1 dhe 3 të Udhëzimit nr. 3, datë 27.01.2015 "Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël" i ndryshuar.

Nga verifikimi i shpenzimeve të kryera për "blerjet e vogla" për likuidimin e faturave nëpërmjet veprimeve me bankë subjektit furnizues, nuk u konstatuan mangësi e shkelje.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

-Me urdhër-shpenzimin nr. 11, datë 16.01.2017, janë kryer shpenzime në shumën 90,000 lekë, me objekt "Shpenzime të tjera materiale dhe operative", në kredi të përfituesit: "A" PSP, me xhirim datë 16.01.2017, sipas faturës nr. 278, nr. Serie 33706929 dt. 27.12.2016, UP nr. 33, datë 23.12.2016, F.Hyrje nr. 30, datë 27.12.2016, prej ku u konstatua se:

Nga, Përgjegjësja e Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse znj. V B, është përgatitur shkresa nr. 9828 Prot., datë 23.12.2016, "Kërkesë për blerje posterit me Logon e ALUIZNI-t, drejtuar Drejtorit të ALUIZNI-t Elbasan, sasia 7 m² (2.5x2.8) ku cilësohet "Preventiv" dhe është përcaktuar sasia në metër/katror. Kjo kërkesë është miratuar nga Drejtori z. M D. Në praktikë rezultoi i argumentuar vlera limit 100,000 lekë, pra kërkesa dhe nevojat për këtë aktiv mbeten të justifikuara, duke vepruar në përputhje me nenet 26-33, të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

-Urdhër prokurimi nr. 33, datë 23.12.2016, i është referuar VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i cili është shfuqizuar me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Në kërkesë dhe në urdhrin e prokurimit janë përcaktuar specifikimet teknike dhe cilësia e mallit të kërkuar.

Përveç sa më sipër, konstatohet, se ndërsakërkesa për blerje dhe urdhëri i prokurimit, mbajnë datën 23.12.2016, ofertat e marra nga operatorët ekonomike: "A" PSP, A dhe I shpk, mbajnë datën 20.12.2016, pra janë marrë përpara fillimit të procedurës së prokurimit me vlera të vogla. Prokurimi i kryer në këtë mënyrë mbetet formal.

-Më datë 27.12.2016, nga komisioni i përbërë prej z. H P, z. A H dhe z. A M, është mbajtur Akti i pritjes së Mallit. Konstatohet se z. I D, punonjësi më përgjegjësja materiale nuk përfshihet në komisionin e marrjes në dorëzim, në kundërshtim me pikën 43, të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".



Akti i mbajtur për verifikimin fizik të sasisë, cilësisë dhe çmimit, referuar këkresave të përcaktuara, përbëhet vetëm nga një frazë ku thuhet: *“Artikujt e mësipërm pasi u verifikuan sipas kushteve dhe specifikimeve të kërkuara, rezultojnë të cilësisë së parë dhe përputhen me dokumentat shoqëruese të tyre në sasi të plotë pa mungesa”*.

Por, siç u përmend edhe më sipër, në kërkesë, në urdhrin e prokurimit por edhe në dokumentat e tjera si: oferta e kontraktuesit, fatura nuk përcaktohet në asnjë rast cilësia dhe specifikimet teknike, mbi bazën e të cilave komisioni duhej të kryente verifikimin fizik të aktiveve në sasi, cilësi dhe çmim. Këto të dhëna nuk ndodhen dokumente kështu që komisioni realisht nuk ka kryer verifikim.

Sipas proces-verbalit të marrjes në dorëzim, nuk rezultojnë të jenë kryer verifikime, duke përfshirur procedurën e kryer, përkrahimin e veprimeve të kryer, krahasimet e faktit me dokumentacionin e ofertës fituese, si certifikata origjinale dhe cilësie, kryerjen e provave me zgjedhje, fleta analize laboratorike, garanci malli, etj.

Sa më sipër procedura e marrjes në dorëzim të mallit mbetet fiktive.

Këto veprime janë në kundërshtim me pikat 42-50, të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Miraturar praktika nga Përgjegjësjë e Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse znj V B. Komisioni i marrjes në dorëzim: z.H P, z.A H, A M.

-Me urdhër-shpenzimin nr. 30, datë 07.03.2017, janë kryer shpenzime në shumën 55,800 lekë, me objekt “Shërbime të sig. dhe ruajtjes”, në kredi të përfituesit: ”B”, me xhirim datë 07.03.2017, Totali i faturës 613,886 lekë, dokumentat ngjitur Urdhër Shpenzimit: fatura nr. 130, datë 28.02.2017 nr. Serie 43938632, U.prok. nr. 1, datë 18.01.2017, Ftesë oferte datë 18.01.2017, Njoftim fituesi dt.19.01.17, kontrata datë 01.02.2017, prej ku u konstatua se:

Nga Përgjegjësjë e Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse znj. V B, është përgatitur shkresa nr. 467 Prot., datë **18.01.2017**, “Kërkesë për shpenzim “Ruajtjen e sigurisë fizike të objektit, veprimtarisë, me roje objekti dhe me përdorim të sistemeve elektronike”, drejtuar Drejtorit të ALUIZNI-t Elbasan, ku është përcaktuar dhe llogaritur vlera limit prej 560,000 lekë pa TVSH, në një kohë që vlera limit përcaktohet në urdhrin e prokurimit, sipas përlllogaritjes dhe preventivit, duke shkelur procedurën e blerjeve me vlera të vogla. Kjo kërkesë është miraturar nga Drejtori z. M D. Urdhëri i prokurimit nuk ka cilësuar si formë prokurimi në rrugë elektronike.

Përlllogaritja e vlerës limitështë realizuar mbi bazën e preventivit i hartuar dhe shqyrtuar nga komisioni i ngritur për këtë qëllim i përbërë prej znj. E T, znj.V B dhe znj. M Y të cilët kanë mbajtur dhe raportin më datë **18.01.2017**, kupreventivi: “Shërbimi i sigurimit dhe ruajtjes me roje private” është **672,000 lekë** dhe “Shpenzime për ruajtjen e objektit me përdorim të sistemeve elektronike” **33,628 lekë**.

-Urdhër prokurimi nr. 1, datë **18.01.2017** (shënuar 2016), i është referuar VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i cili është shfuqizuar me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Ftesa për ofertë e publikua mban datën **18/1/2017**.

Sa më sipër, konstatohen shkelje të procedurës së prokurimit, sepse është e pamundur që në të njëjtën datë (18.01.2017) të realizohen: kërkesa, përlllogaritja, urdhër-prokurimi dhe ftesa për ofertë.

Por, ajo ç`ka është më e evidente në këto shkelje, është fakti se janë 3 oferta për prokurim të cilat janë radhitur si më poshtë:

-Operatori Ekonomik “T”, me ofertën datë **18.01.2017**, preventivi: “Shërbimi i sigurimit dhe ruajtjes me roje private”, 743,084.29 lekë dhe “Shpenzime për ruajtjen e objektit me përdorim të sistemeve elektronike 78,000 lekë.



-Operatori Ekonomik “G” shpk, me ofertën datë **18.01.2017**, preventivi: “Shërbimi i sigurimit dhe ruajtjes me roje private” 710,180.4 lekë dhe “Shpenzime për ruajtjen e objektit me përdorim të sistemeve elektronike 50,000.94 lekë.

-Operatori Ekonomik “B” shpk, me ofertën datë **18.01.2017**, preventivi: “Shërbimi i sigurimit dhe ruajtjes me roje private” **672,000 lekë** dhe “Shpenzime për ruajtjen e objektit me përdorim të sistemeve elektronike **33,628 lekë**.

Sa më sipër konstatohet se të gjitha ofertat kanë të njëjtën datë, pra **datën 18.01.2017**, të nisura nga operatorët ekonomikë, kur në të njëjtën datë janë kryer edhe procedurat: kërkesa, përlllogaritja, urdhër-prokurimi dhe ftesa për ofertë. Kështu kemi shkelje të procedurave të prokurimit.

Përveç sa më sipër, oferta e operatorit ekonomik fitues “B” shpk, është e njëjtë me vlerën limit të llogaritur nga ALUIZNI Elbasan, si dhe në të gjitha zërat e preventivit është i njëjti dokument.

Prokurimi i kryer mbetet formal.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 40.

Përgjegjësja e Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse znj. V B si dhe znj. E T dhe znj. M Y.

Sipas urdhër shpenzimit nr. 31 datë 07.03. 21017 është likujduar për 80233 lekë fatura e pjeshme e blerjeve me vlerë të vogël bazuar në Urdhër prokurimi nr. 3, datë 03.02.2017 i cili është referuar VKM nr. 1, datë 10.01.2007, shfuqizuar me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Ftesa për ofertë është publikuar me datën 03.02.2017.

Sa më sipër, konstatohen shkelje të procedurës së prokurimit lidhur me përcaktimin e specifikimeve teknike pasi në kërkesat për mallra origjinale nuk bëhet e qartë në se janë në përputhje me standartet e tipeve të paisjeve që përdor Aluizni Elbasan, sa është numri i fletëve që kërkohet për çdo tip paisje, përcaktimin e prodhuesit të paisjes, dhe afati i skadencës tonerave. Këto kërkesa nuk janë shënuar as në aktin e marrjes në dorzim por, komisioni shprehet në përgjithsi me fjalët “sipas kontratës”. Pra, konkretisht të dhënat e mësipërme nuk janë përcaktuar në kontratën datë 03.02.2017 dhe as në aktin e marrjes në dorzim, veprime këto që bien në kundërshtim me pikat 42-50, të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Përgjegjësja e Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse znj. V B si dhe znj. E T dhe znj. M Y.

Sipas Urdhër shpenzimit nr. 32, datë 07.03.2017 është likujduar shuma 239,945 lekë vlera e pjeshme e kontratës nr. 1605, prot datë 13.02.2017 për blerje karburant nga zbatimi i Urdhër prokurimit nr. 5, datë 08.02.2017 për vlerën 400,000 lekë aq sa dhe fondi limit është llogaritur. Nga auditimi rezulton se llogaritja e fondit limit është bazuar në çimin në bursë me 554 usd toni, premio 30 usd, taksat dhe marzhi i fitimit 12 %, të cilët formojnë çmimin 161,91 lekë litri duke përcaktuar sasinë gjithsejt të furnizimit për sasinë 2965 litra. Për efekt mosparaqitjes fituesit është shpallur fitues operatori i dytë me çmimin 159.22 lek/lit me sasinë 3000 litra. Furnizimi në fakt për gjithë fondin e llogaritur rezulton me sasi më shumë nga sa është përcaktuar në kontratën e lidhur me fituesit e prokurimit sepse ka rastisur që blerja është favorizuar nga ndryshimi me ulje i cmimit në treg.

Sipas Urdhër shpenzimit nr. 137, datë 29.09.2017 është likujduar në favor të firmës “O S” shpk fatura nr. 41805187 me tvsh, shuma 114,600 lekë vlera e pjesëve të këmbimit të blerjeve të vogla për automjetin e institucionit tip Ëolcvagen me targë TR 7716, në zbatim të Urdhër prokurimit nr. 16 datë 30.08.2017. Nga auditimi rezulton se blerjet janë bazuar në nevojën e paracaktuar sipas aktit teknik të firmosur nga inxhinier A H për të cilin nuk ka asnjë dokument licensimi dhe



komisioni i blerjeve i përbërë nga V B, M Y dhe E T. Kërkesa paraqitet e pa argumentuar sepse mungojnë të dhënat mbi kohën e riparimeve të mëpërshme, afatin e përdorimit të shprehura në km, (p.sh gomat) të përshkruara ose ne nevojën e emergjences dhe shkaqet që e diktojnë atë.

Konkluzion: Nga auditimi konstatohet se në shumicën e rasteve të blerjeve nga Institucioni janë kryer veprime me mangësitë e trajtuar si mësipër ku rregulat e parcaktuara në udhëzimin nr. 3 datë 27.01.2015 “Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël” nuk kanë gjetur zbatim të plotë në aspektet e veçanta të procedurës sidomos marrja në dorzim e mallrave. Veprimet e trajtuara më lart bien në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, ndryshuar, neni 23 *Specifikimet teknike*

1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar: a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të parcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve; b) kërkesave në terma funksionale, kur një gjë e tillë kërkon t’u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; c) të dyja metodave të parcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate.

4. Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevojë, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale. Që të garantohet krahasueshmëria e ofertave për kërkesat objektit të kontratës, për këto punime ose për funksionin e tyre, kërkesat e rendimentit dhe të funksionit duhet të jenë të sakta për t’u dhënë konkurruesve dhe ofertuesve një ide të qartë në përgatitjen e ofertës. Në përshkrimin e punimeve duhet të shënohen, kur është rasti, edhe specifikimet për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve, të përshtatshme për mjedisin.

5. Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 40.

Për vitin 2018.

Urdhër shpenzimi nr. 23 datë 26.02.2018 likujduar subjekti Posta Elbasan për faturën nr. 29 datë 31.01.2018 për shumën lekë 13,734 lekë për shërbimin postar të dërgimit të letrave copë 138 me cimim 100 lekë.

Në të gjitha rastet e likujdimit të faturave për kryerjen e këtij shërbimi bashkëlidhur faturës nuk bashkëlidhet lista e letrave të nisura e cila duhet të firmoset nga punonjësja e protokollit ose nje person tjetër i autorizuar.



Konkluzion: Nga auditimi i veprimeve të shpenzimeve të kaluara me bankë deri në fund të periudhës që auditohet rezulton se, natyra e shpenzimeve është e njejtë, janë zbatuar po të njejtat kritere dhe konstatohet se transaksionet e pagesave për procedurat e prokurimeve për blerjet me vlerë të vogël janë të shoqëruar me dokuimentacion të saktë autorizues e vertetues për kalimin e shumave në bankë dhe të kuadruara me thesarin. Nga sa verifikuam mendojmë se është e mjaftueshëm gjetja mangësive nuk është nevoja të bëjme përsëritura për të njejtat veprime.

III.6. Të ndryshme dhe trajtimi i indiceve të ardhura nga qytetarë në KLSH.

I-Trajtimi i ankesave të ardhura në KLSH

1- Në lidhje me ankesën nr. 1269/4 prot, datë 23.01.2018, ku shtetasi K Xh ka paraqitur pretendime për veprime të paligjshme në legalizimin e objektit në emër të subjektit Ll K P, nga auditimi në ASHK Elbasan (ish-ZVRPP Elbasan), rezulton se dosja me leje legalizimi nr. 99857416, datë 08.06.2016, në emër të Ll K P është sekuestruar nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, sipas Vendimit për suestrimin e dokumenteve datë 04.05.2018, administruar në ALUIZNI Elbasan me nr. 3175/2 prot, datë 04.05.2018. Sa sipër KLSH nuk mund të shprehet deri në momentin e përfundimit të hetimit.

2- Në lidhje me ankesën nr. 46 prot, datë 15.01.2018, ku shtetasi S K ka paraqitur pretendime për veprime të paligjshme në legalizimin e objektit informal të ndërtuar nga shtetasi F T, pasi është fallsifikuar dokumentacioni duke paraqitur si vetdeklarim për ndërtimin e objektit në vitin 2014, ndërkohë që objekti është ndërtuar në vitin 2017 anës rrugës në vendin e quajtur Kanali me Kema, nga auditimi rezultoi se:

- Dosja nr. 372, viti 2006, Leje legalizimi nr. 8958967, datë 23.10.2017, ndërtim për Godinë Shërbimi 1 Kat, pronar i ndërtimit pa leje: T B T, me adresë Bashkia Elbasan Shirgjan, ZK- 8526, sipërfaqe e parcelës ndërtimore 270 m², sipërfaqe ndërtimi 90 m², nga të cilat për aktivitet 90 m², trualli në pritje të VKM-së, u konstatua:

- Nuk është bërë inventari dosjes në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

Në dosje administrohet vetëdeklarimi nr. 372, datë 21.03.2005, për objektin Magazinë plus lokal, në emër të H H, sipas të cilit sipërfaqe e ndërtimit është 200 m², ndërkohë që sipërfaqja e parcelës ndërtimore është 500 m².

- Procesverbalii verifikimit në terren mban datën 21.08.2017, nënshkruar nga specialistët e verifikimit në terren z. Th D dhe z.A S, konfirmuar nga z. Sh P me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë. Procesverbali i verifikimit në terren nuk është plotësuar me distancat përkatëse nga pasuritë kufitare, gjithashtu dhe skicat fushore nuk kanë të dhëna për distancat nga Lumi Shkumbin si dhe rruga Nacionale Elbasan Cerrik.

- Procesverbali i vlerësimit të dosjes nuk është plotësuar me të gjitha rubrikat, por vetëm është bërë plotësimi formal, nënshkruar nga zj. E C me detyrë Specialiste Sektori i Legalizimit dhe z. Gj G, me detyrë Specialist Sektori i Përpunimit të Dhënave.

- Me deklaratën noteriale nr. 1482 rep, 961 kol, datë 20.10.2017, shtetasit H H dhe M H, deklarojnë se procedura e legalizimit do të vazhdojë në emër të T T, duke qenë se kjo e fundit ka bërë investimin për ndërtimin e objektit.

- Me Urdhër nr. 426, datë 20.10.2017, të z. F D me detyrë ish-Drejtor, është bërë ndryshimi në bazën dixhitale të të dhënave, në emër të T T.



- Shkresa për taksën e ndikimit në infrastrukturë nr. 12302 prot, datë 23.10.2019, është nisur në datën e lëshimit të lejes së legalizimit.

- Në dosje administrohet shkresa nr. 125 prot, datë 31.10.2017, nga Agjencia e Basenit Ujor Shkumbin, kthim përgjigje për shkresën nr. 2576/1 port, datë 30.10.2017 të ALUIZNI Elbasan, kërkesë për konfirmim të pasurisë nr. 407/20, sipas të cilës Agjencia e Basenit Ujor Shkumbin nuk shprehet për konfirmim por vetëm citon nenin 8 të ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, si referencë për distancat nga brigjet e lumejnve.

Theksojmë se shkresa e drejtuar ABUS Elbasan është bërë më pas në kohë nga data e lëshimit të lejes së legalizimit.

Nga verifikimi i imazheve dhe i ortofotos rezulton se objekti ndodhet në një distance prej 115 m nga bregu i Lumit Shkumbin dhe sipas përcaktimeve të nenin 4, pika 8 të ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, ku citohet se: *b) me gjerësi 100 m në drejtim normal me tokën nga brinja e sipërme e shtratit natyror në brigjet e pjerrëta dhe 200 m nga vija e nivelit maksimal të plotave me probabilitet përsëritjeje një herë në 25 vjet të ujit në brigjet e sheshta, në të cilën çdo veprimtari e zhvilluar përcaktohet nga organet e administrimit a menaxhimit të burimeve ujore. Kufiri i ndarjes së bregut të pjerrët me bregun e sheshtë është pjerrësia 10 për qind në drejtim normal me bregun, në të tilla raste kërkohet miratimi paraprak.* Nga ish-ALUIZNI Elbasan është kërkuar konfirmimi me shkresë të hartuar më pas në kohë nga data e lëshimit të lejes së legalizimit, që nuk ka asnjë vlerë ligjore pasi akti është nxjerrë, por edhe në shkresën kthim përgjigj të ABUS Elbasan nuk është dhënë konfirmimi për vazhdimin e procedurave të legalizimit.

- Gjithashtu nga verifikimi i ortofotos datë 27.06.2014, si dhe imazheve dixhitale rezulton se objekti nuk është ndërtuar para datës 27.06.2014, e për pasojë nuk duhet ti nështrohej procesit të legalizimit, veprime këto që bien në kundërshtim me Nenin 1, pika 1 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

- Vendimi i kualifikimit nr. 21291, datë 20.10.2017, është nënshkruar nga z. A B, me detyrë ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. A H, me detyrë Specialist i Sektorit të Legalizimit, konfirmuar nga z. F D me detyrë ish-Drejtor.

- Me shkresën nr. 12414 prot, datë 25.10.2017, drejtuar ZVRPP Elbasan, është përcjellë për regjistrim leja e legalizimit.

- Me shkresën nr. 7089 prot, datë 10.10.2018, drejtuar ZVRPP Elbasan, është përcjellë për regjistrim dokumentacioni për parcelën ndërtimore, bashkangjitur faturat, nënshkruar shkresa nga z. A G me detyrë ish-Drejtor.

- Me shkresën nr. 2836/2 prot, datë 30.10.2018, ZVRPP Elbasan, administruar në ish-ALUIZNI Elbasan me nr. 7089/1 prot, datë 31.10.2018, ka kthyer dokumentacionin për regjistrimin e parcelës ndërtimore pasi objekti nuk figuron në ortofoton e datës 27.06.2014, si dhe ka kërkuar anulimin e lejes së legalizimit.

- Me shkresën nr. 7089/2 prot, datë 22.02.2019, kërkesë për çregjistrim, ish-ALUIZNI Elbasan drejtuar ish-ZVRPP Elbasan, ka kërkuar çregjistrimin e objektit të regjistruar në emër të T B T dhe kthimin e dokumentacionit origjinal në mënyrë që të bëhet shfuqizimi i lejes së legalizimit.

Praktika është punuar nga specialistët z. A B, me detyrë ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, z. A H, me detyrë Specialist i Sektorit të Legalizimit, z. Th D, me detyrë Specialist i verifikimit në terren, z. A S me detyrë Specialist i verifikimit në terren, z. Sh P me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, z. Gj G me detyrë Specialist i Sektorit të Hartografisë, zj. M S me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Kalimit të Pronësisë, z. B B me detyrë Specialist i Sektorit të Kalimit të Pronësisë si dhe z. F D me detyrë ish-Drejtor.

Për sa më sipër është mbajtur procesverbali nr.9, datë 31.07.2019.



- Në lidhje me pretendimin e z. Gj G, i cili sqaron se objekti është në ortofoton dixhitale si dhe pamjet google maps e geoportalin asig kopje të fotografimit ajror, gjithashtu skicat dhe matjet fushore janë në dosje dhe se për hartimin e gent planit është bazuar në skicat fushore. Detyra e tij është digitalizimi materialit sipas pozicionit faktik në terren.

Qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH: Observacioni juaj nuk qëndron pasi përveç evidentimit nga skicat fushore dhe procesverbali i verifikimit në terren, ju nuk mund të shmangeni nga përgjegjësi për verifikimin nëse objekti është ndërtuar brënda afatit ligjor, çka nuk dokumentohet nga dokumentacioni i administruar në dosje verifikuar gjatë auditimit.

- Në lidhje me pretendimin e z. B B, i cili sqaron se dosja në proces nuk ka dokument pronësie dhe me shkresën nr. 1472/2, datë 30.06.2016 është saktësuar se statusi juridik i pronës është me shënimin “zona nuk është në sistem”.

Qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH: Observacioni juaj nuk merret në konsideratë pasi është i pambështetur në argumente dhe dokumentacion shoqërues gjithashtu procedura e pajisjes me leje legalizimi nuk është e rregullt, trajtuar hollësisht në material.

- Në lidhje me pretendimin e z. A H, i cili sqaron se përgjegjësia e tij është në plotësimin e vendimit të kualifikimit dhe jo verifikimi i ortofotos dhe vitit të ndërtimit, gjithashtu nga ALUIZNI është hartuar shkresa drejtuar ZVRPP për cregjistrimin e objektit.

Qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH: Observacioni juaj nuk merret në konsideratë pasi edhe pas shkresës së ZVRPP Elbasan për anulimin e lejes së legalizimit, nga ALUIZNI nuk është vepruar në kohë, duke dërguar shkresën për shfuqizim gati 3 muaj më vonë. Në lidhje me pozicionin tuaj si Specialist i Sektorit të Legalizimit, sqarojmë se adresimi i përgjegjësive do të bëhet në raport me shkeljet e konstatuara rast pas rasti.

- Në lidhje me pretendimin e z. Sh P, i cili sqaron janë zbatuar procedurat ligjore në lidhje me dosjen e T B T.

Qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH: Observacioni juaj nuk merret në konsideratë pasi është i pambështetur në argumente dhe dokumentacion shoqërues, gjithashtu në trajtimin e dosjes janë trajtuar mangësi në zbatimin e procedurave.

- Në lidhje me observacionet e z. F D, i cili sqaron në bazë të urdhrave të punës, kompetencave për secilin pozicion, është përcaktuar se përgjegjësit e sektorëve kanë përgjegjësi të drejtëpërdrejtë ligjore në lidhje me mangësitë e konstatuara në dokumentacionin e hartuar dhe nënshkruar nga ana e specialistëve, ku përcaktohen qartë detyrat dhe përgjegjësit e gjithësecilit. Verifikimi i afatit të ndërtimit të objekteve është detyrë e qartë e sektorit të Hartografisë, verifikimi i distancës nga lumi është përgjegjësi dhe detyrë e Sektorit të Legalizimit dhe Planifikimit Urban.

Qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH: Në trajtimin e dosjes janë konstatuar mangësi në zbatimin e procedurave, për secilin nga specialistët që kanë marrë pjesë në hartimin e dokumentacionit do të adresohen përgjegjësit individuale në raport me shkeljet e konstatuara, si dhe mangësi e tjera të trajtuara rast pas rasti, gjithashtu do merret në konsideratë dhe pozicioni juaj sipas konstatimeve të bëra në material.

II- Procese gjyqësore

Në zbatim të pikës 5 të programit të auditimit “Nr. 380/1, datë 28.05.2019”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1- Evidencat e proceseve gjyqësore

2- Dokumentacioni sipas inventarizimit bashkëlidhur dosjeve përkatëse, si dhe korespondencat shkresore me institucionet përkatëse, vendime gjykatash, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:



Nga ana e ALUIZNI Elbasannuk janë zbatuar përcaktimet ligjore në çdo rast përsa i përket ankimimit dhe pjesëmarrjes në proceset gjyqësore, referuar:

- 6) Ligjinr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar,
- 7) Nenin 391, 442, 443, 444 të Ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenin 45 të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.
- 8) Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”
- 9) LigjiNr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.
- 10) VKM nr.465, datë 22.06.2016” pika 10.
- 11) VKM nr. 280, datë 01.04.2015, pika 8 dhe (i ndryshuar me VKM 756, datë 26.10.2016), kreu i I pika 1/4 dhe kreu i 4, pika 8.

ASHK Elbasan (ish-ALUIZNI Elbasan) nuk ka një evidencë të saktë të proceseve gjyqësore ndër vite, mungon data-base dhe evidentimi rast pas rasti, për ecurinë e tyre, ankimimet dhe krijimin e një praktike më vete duke hapur dosje për çdo proces gjyqësor, në përfundim të cilit do ti nënshtrohet arshivimit. Nuk u paraqitën prapësimet e bëra për çdo proces gjyqësor. Nga informacioni i paraqitur në total gjatë periudhës së auditimit 01.01.2017 deri në datë 01.05.2019 ALUIZNI Elbasan, ka qenë pjesë e 11 proceseve gjyqësore si palë paditëse, e paditur apo palë e tretë, më hollësisht sipas viteve si vijon:

Tabela “Përmbledhëse e procesve gjyqësore”

Nr	Viti	Numri proceseve gjyqësore	Në mungesë në shpalljen e vendimit	Pranuar padia	Shenime
1	2017	2	në zhvillim		
2	2018	5	3 në zhvillim	2	
3	2019	4	në zhvillim		1 në Apel, 1 rrëzim padie
	Total	11			

Theksojmë se informacioni i paraqitur nga specialistët nuk është i plotë për të gjithë periudhën e auditimit dhe ka mangësi. Në vitin 2017 kanë qënë 2 procese gjyqësore, nuk kanë përfunduar, janë në zhvillim, në vitin 2018 kanë qënë 5 procese gjyqësore, 1 është apeluar, 1 është vendosur rrëzim padie ku ALUIZNI ka qënë palë e paditur, 3 janë në zhvillim, në vitin 2019 janë 4 procese gjyqësore, ku është palë e paditur ALUIZNI Elbasan, të cilët janë në zhvillim.

Për mos administrimin, regjistrimin dhe ndjekjen e ecurisë së proceseve gjyqësore ngarkohet me përgjegjësi z. M D me detyrë ish-Drejtor nga data 01.01.2017-22.05.2017, dhe 22.06.2017-03.10.2017, znj. A T, me detyrë ish-Drejtor, nga data 22.05.2017-22.06.2017, z. F D me detyrë ish-Drejtor, nga data 03.10.2017- 12.02.2018, dhe z. A G me detyrë ish-Drejtor nga data 12.02.2018-08.05.2019.

Për sa më sipër është mbajtur procesverbali nr.9, datë 31.07.2019.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET



A. MASA ORGANIZATIVE

1- Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (aktualisht pjesë e Drejtorisë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan) në marrjen e vendimeve “Për kualifikimin për legalizim të objektit informal”, në të gjitha rastet e audituara ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” nenin 27 “Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit”, pika “ç” –*“vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi”*. Në kualifikimin e objekteve informale, ka dërguar pranë bashkive të Qarkut Elbasan, vetëm shkresën për llogaritjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për **1616 objekte informale** dhe pa marrë konfirmim mbi pagesën e saj për dalje me vendim kualifikimi, duke krijuar një **mungesë të ardhurash në buxhetin e shtetit në vlerën 42,986,822 lekë** (Trajtuar në pikën 1, faqet 30-198 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1- Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan për nevoja të plotësimin të dokumentacionit tekniko-ligjor të objekteve me leje legalizimit të lëshuara, t’i kërkojë bashkive Elbasan, Prenjas, Librazhd, Gramsh, Cerik, Peqin, Belsh, vërtetimet mbi llogaritjen dhe pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë në **vlerën prej 42,986,822 lekë, si dhe të kërkojë që të bëhet regjistrimi në sektorin përkatës të kartelës** në Drejtorinë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, **në refuzim të vendosen masa për kufizimin deri në arkëtimin e plotë të detyrimeve të papaguara.**

Brenda datës 31.12.2019

2- Gjetje nga auditimi: Në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Elbasan (aktualisht pjesë e Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan) për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2017 deri 31.05.2019, janë lëshuar **6243 leje legalizimi** për objektet informale të legalizuara. Nga **6243 leje legalizimi të lëshuara, 2130 leje legalizimi** ose rreth 34 % e këtyre lejeve të legalizimit (6243) janë lëshuar vetëm për objektin me shënimin në lejen e legalizimit *“Kalimi i pronësisë për parcelën ndërtimore do miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave”*, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 me ndryshime, neni 17, pika 5 (Trajtuar në pikën 1, faqet 30-198 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1- Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore deri në daljen e VKM-ve, për **2130 dosje** të objekteve informale të pajisur me Leje legalizimi të objektit, **për të mundësuar brenda afateve ligjore** likuidimin të vleftës përkatëse të parcelave ndërtimore.

Brenda datës 31.12.2019

3- Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (aktualisht pjesë e Drejtorisë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan) për periudhën objekt auditimi ka lëshuar gjithsej 6243 leje legalizimi për objekte informale, ndërsa sipas të dhënave konstatohet se periodikisht brenda periudhës objekt auditimi, kanë dalë nga arkiva e institucionit për tu punuar **11387 dosje** të objekteve informale, për një pjesë të të cilave është kryer edhe kualifikimi i objekteve informale për të vazhduar procedurat deri në lëshimin e lejes së legalizimit, ndërkohë sipas pasqyrave të paraqitura konstatohet se janë kthyer 4,309 dosje pra **me një diferencë 835 dosje** të cilat kanë dalë dhe **nuk janë bërë hyrje në arshivë** dhe nuk ka asnjë të dhënë apo dokument për administrimin e tyre, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet ligjore për



administrimin dhe arshivimin e dokumentacionit. Gjithashtu theksojmë se në dosjet e kthyer plotë raste janë rikthyer dhe nxjerrë disa herë dosjet dhe pa as një motiv, nuk përshkruhet arsyeja e tyre e rikthimit në arshivë në sasinë **4,309** kur rezulton se për këto subjekte janë kryer matjet, gent planet, planimetritë dhe nuk kanë marrë vendime duke shkelur të gjitha afatet ligjore dhe deri tani nuk janë legalizuar duke e zgjatur këtë afat me vite, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, neni 27, 28, ligjin Nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat” si dhe VKM nr. 589, datë 10.09.2014, pika 10 i ndryshuar me VKM nr. 634, datë 07.09.2016 si dhe VKM nr. 280, datë 01.04.2015 i ndryshuar, kreu i IV, pika (8), si dhe VKM nr.1095, datë 28.12.2015 pika 2, si dhe me nenin 15 pika 4 e Rregullores me nr.117, datë 14.07.2015 (*Trajtuar në pikën 1, faqet 30-198 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1- Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, të marrë masa që në vazhdimësi për objekte informalë të pajisur me leje legalizimi të evidentojë respektimin e afateve të matjeve në terren, kualifikimin e tyre deri në lëshimin e lejes së legalizimit, si dhe për objektet informalë për të cilat kanë përfunduar evidentimin faktik në terren të ndërtimeve pa leje, evidentimi i gjendjes juridike të truallit, si dhe hartimi i genplanit dhe planimetrive, por pa përfunduar procesi i legalizimit. Të operojë me vazhdimin e procedurave të legalizimit, duke i trajtuar në funksion të afatit kohor të qëndrimit në arkivë si dhe të bëhet dokumentimi i vazhdueshëm i lëvizjes së dosjeve që futen dhe nxirren nga arkiva për punë.

Në vijimësi

4- Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (aktualisht pjesë e Drejtorisë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan) nuk ka mbajtur evidencë më vete të ankesave të trajtuara ndër vite, afatet e shqyrtimit të tyre, përgjigjet dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre, gjithashtu nuk është ngarkuar me urdhër të veçantë një person kompetent apo një grup specialistësh për shqyrtimin e ankesave, në asnjë nga dokumentet e punës të paraqitura për auditim nuk është adresuar përgjegjësia për shqyrtimin e ankesave, por ato i janë adresuar specialistëve përkatës rast pas rasti. Gjithashtu ka munguar bashkëpunimi dhe rakordimi ndërmjet sektorëve madje duke lënë pa adresuar problematikat e ngritura në ankesat e qytetarëve si dhe zgjidhjen brenda afateve ligjore, konkretisht gjatë periudhës 01.01.2017-31.05.2019, në 779 raste nuk është kthyer asnjë përgjigje për ankesat e bëra nga qytetarët apo institucione të ndryshme. Veprimet dhe mosveprimet më sipër bien në kundërshtim me kërkesat e Kodit të Procedurës Administrative, ligji nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (*Trajtuar në pikën 1, faqet 30-198, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1- Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, të marrë masa dhe të caktojë me urdhër një person kompetent për mbajtjen e evidencave të ankesave të trajtuara ndër vite, afatet e shqyrtimit të tyre, përgjigjet dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre, arshivimin e dokumentacionit që fakton kthimin e përgjigjes, si dhe të marrë masa të rrisë bashkëpunimin ndërmjet sektorëve duke adresuar problematikat e ngritura në ankesa si dhe dhënien e zgjidhjeve ligjore të problemeve.

Në vijimësi

5- Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (aktualisht pjesë e Drejtorisë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), në 56 raste, sipas Aneksit nr. 8 “*Dosje të lejeve legalizimit pa plotësuar inventarin*”, ka kryer legalizime dhe dokumentacioni i dosjeve së këtyre lejeve legalizimi është i pa plotësuar me inventarin e përkatës të rregullt të



dokumentacionit dhe numrit të fletëve për çdo dokument, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit Nr.9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” (*Trajtuar në pikën 1, faqet 30-198 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1- Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, të marrë masa duke plotësuar me inventarët e dosjeve 56 rastet e konstatuara, si dhe të gjithë dosjet e tjera që janë të painventarizuara, e në të ardhmen ky proces të kryhet menjëherë pas lëshimit të lejeve të legalizimit, duke vepruar sipas ligjit.

Deri më datë 31.12.2019

6- Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (aktualisht pjesë e Drejtorisë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), në 6 raste, sipas lejeve të legalizimit nr. 2578009, datë 28.09.2018, nr. 2580609, datë 09.04.2019, nr. 2578351, datë 31.10.2018, nr. 2578186, datë 24.10.2018, nr. 2578530, datë 22.11.2018, nr. 2580608, datë 09.04.2019 dhe ka kryer legalizime të objekteve social-ekonomikë, të kombinuara, banimi, ku nga auditimi konstatohet se ka patur shkëmbim informacioni mes Drejtorisë së ALUIZNI-t Elbasan dhe strukturave përkatëse që përcaktojnë vendndodhjen e objekteve të legalizuara, prej ku rezulton se objektet ndodhen në Zonën e Mbrojtur të Parkut Kombëtar “Shebenik-Jabllanicë”, sipas VKM nr. 640, datë 21.05.2008, kategoria e dytë e zonave të mbrojtura.

Sa më sipër konfirmohet nëpërmjet shkresave nr. 774/1, datë 03.07.2018, shkresës nr. 227, datë 18.09.2018, të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe shkresa të tjera të Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura Elbasan, në të cilat nuk ka konfirmim për legalizim të objekteve informale dhe shprehet se “Përsa i përket legalizimit të tyre nuk është në kompetencën tonë shqyrtimi dhe vlerësimi i këtij procesi”. Përveç se nga këmbimi i informacionit vendodhja e **7 objekteve** në Zonën e Mbrojtur të Parkut Kombëtar “Shebenik-Jabllanicë”, sipas VKM nr. 640, datë 21.05.2008, kategoria e dytë e zonave të mbrojtura, u përcaktua edhe nga verifikimi me sistemin geoportal të rakorduar me hartën dixhitale të legalizimeve që na u vu në dispozicion nga ASHK Elbasan.

Meqenëse ky proces nuk është në kompetencën e AKZM, do të merren për referencë dispozitat ligjore të cilat bëjnë të domosdoshme pajisjen me lejet mjedisore dhe miratimin paraprak nga Këshilli Kombëtar i Territorit. Në kushtet kur kritere të tilla nuk gjenden të dokumentuara në praktikën e lejes së legalizimit, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Elbasan duhej të kishte refuzuar lëshimin e lejes së legalizimit dhe duhej të kishte kryer skualifikimin e objektit.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 280, datë 01.04.2015, të këshillit të ministrave, “për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, pika 2, germa “ë” ku citohet: Ndërtimi informal i llojit “objekt”, i ngritur brenda vijës kufizuese të zonës informale të miratuar dhe i përfshirë në fushën e zbatimit të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, përjashtohet nga legalizimi në një nga rastet e mëposhtme: “Është ngritur brenda zonave dhe/ose nënzonave të mbrojtura, shkalla e mbrojtjes të të cilave nuk lejon ndërtime, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 8906, datë 6.6.2002, “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij”, Ligji nr. 8906, datë 6.6.2002 është shfuqizuar nga ligji nr. 81/2017, datë 04.05.2017 “Për zonat e mbrojtura”, neni 16, pika 2, germa “a”, nenin 33, të ligjit nr. 81/2017, datë 04.05.2017, “Veprimtaritë që lejohen pasi të jenë pajisur me miratim paraprak”, VKM nr. 640,



datë 21.05.2018 “Për shpalljen “Park Kombëtar” të ekosistemit natyror Shebenik-Jabllanicë”, pika 4, germa “ç” (*Trajtuar në pikën 1, faqet 30-198 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1- Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan të marrë masa të vendosë masë kufizimi dhe të fillojë procedurat me grup pune për rivlerësimin edhe një herë të dokumentacionit tekniko ligjor mbi bazën e të cilit janë lëshuar 7 lejet e legalizimit, duke njoftuar subjektet për fillimin e procedurave përkatëse sipas kërkesave të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”.

Gjithashtu të merren masa për të ardhmen duke lëshuar leje legalizimi për objekte informale, në kushtet e respektimit të zonës së mbrojtur të miratuar me akte ligjore e nënligjore, mbi bazën e konfirmimit nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe lejeve të lëshuara nga ana e këtij institucioni, për vazhdimin e procesit të legalizimit, vetëm mbi bazën e lejeve mjedisore në zona ku mundësohet vazhdimi i veprimtarive tradicionale dhe ekonomike, e ku mund të ushtrohen veprimtari të reja, dhe për rastet e trashëgimisë kulturore me leje të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe të shërbimit arkeologjik, duke vepruar sipas ligjit.

Menjëherë dhe në vijimësi

7- Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (aktualisht pjesë e Drejtorisë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), në **5 raste**, sipas lejeve tëlegalizimit nr. 2580387, datë 31.01.2019, nr. 2580609, datë 09.04.2019, nr. 74854213, datë 28.06.2018, nr. 2580387, datë 31.01.20018, nr. 2580608, datë 09.04.2019ka kryer legalizime për objekt social-ekonomik, të ndodhur ne zonën kadastrale nr. 1742, Gjinar, 1715, Dorëz, ku nga auditimi konstatohet se sipas shkresave të ZVRPP Elbasan, pasuritë në fjalë ndodhen brenda pasurisë “**Pyll**” dhe “**Shkëmb**”, me status juridik “Shtet”.

Sa sipër, nga ana e ALUIZNI-t Elbasan, janë miratuar leje legalizimi për godinë social-ekonomike në tokë “Pyll” e “Shkëmb” dhe përveç kësaj është ndryshuar edhe zëri kadastral dhe regjimi i tokës në “Truall”, në një kohë që kompetenca për ndryshimin e zërit kadastral nga “Pyll” e “Shkëmb” në “Truall”, për pyjet dhe tokat me bimësi pyjore, me sipërfaqe deri në 1 ha i takon Ministrit të Mjedisit, vetëm në kushtet e një investimi afatgjatë për ndërtimin e strukturave turistike, etj. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar. Siç shihet sa më sipër, legalizimi i 5 objekteve informale dhe ndryshimi i destinacionit të sipërfaqeve të zërit kadastral “Pyll” në “Truall”, është i paligjshëm, pasi **nuk përfshihet në asnjërën nga veprimtaritë e përmendura** më sipër dhe nuk ka kërkesë për heqjen nga fondi kullosor apo urdhër Ministri që të ketë bërë miratim për këtë ndryshim destinacioni (*Trajtuar në pikën 1, faqet 30-198 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1- Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan të marrë masa të vendosë masë kufizimi dhe të fillojë procedurat me grup pune për rivlerësimin edhe një herë të dokumentacionit tekniko ligjor mbi bazën e të cilit janë lëshuar 5 lejet e legalizimit, duke njoftuar subjektet për fillimin e procedurave përkatëse sipas kërkesave të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.

Gjithashtu të merren masa për të ardhmenduke lëshuar leje legalizimi për objekte informale, në kushtet e respektimit të zonave pyjore e kullosore, në zërat kadastrale “Pyll”, “Shkëmb”, tokë e pafrytshme (TPF), zallishte, ranishte, etj., duke ndikuar në ruajtjen e ekosistemit, përjashtuar vetëm në rastet dhe qëllime publike, duke marrë konfirmimin zyrtar nga ana e Ministrit përkatës për sipërfaqet deri në 1 ha, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

8- Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (aktualisht pjesë e Drejtorisë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), në **2 raste**, sipas lejeve të



legalizimit nr. 2579709, datë 31.07.2018, nr. 2579037, datë 21.09.2018, nr. 2580523, datë 25.03.2019, ka kryer legalizime të ndërtimeve informale, ku nga auditimi dhe verifikimi sipas hartave dixhitale që na u vunë në dispozicion nga DVSHK Elbasan, konkretisht harta me emërtimin: “Leje 2018-2019 Totale.dëg”, konstatohen se janë kryer legalizime të objekteve social-ekonomike dhe banimi, të cilat ndodhen pjesërisht në territore të institucioneve publike dhe shtetërore, brenda vijës kufizuese të Spitalit “Baki Kongoli”, dhe brenda vijës kufizuese të objektit shtetëror të ujësjellësit “Pompë uji”. Sa sipër është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar me vendimin e KM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dheshesa në vendimin nr. 280, datë 1.4.2015, të këshillit të ministrave”, pika 2, germa “c”, dhe Drejtoria e ALUIZNI-t Elbasan duhej të kishte proceduar me refuzimin e kërkesave, mos lëshimin e lejeve së legalizimit si dhe skualifikimin e objekteve (Trajtuar në pikën 1, faqet 30-198 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1- Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan të marrë masa të vendosë masë kufizimi dhe të fillojë procedurat me grup pune për rivlerësimin edhe një herë të dokumentacionit tekniko ligjor mbi bazën e të cilit janë lëshuar 2 lejet e legalizimit, duke njoftuar subjektet për fillimin e procedurave përkatëse sipas kërkesave të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.

Menjëherë

9- Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (aktualisht pjesë e Drejtorisë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), në 2 raste, sipas lejeve të legalizimit nr. 2570569, datë 23.07.2018, nr. 2570316, datë 31.05.2018, ka kryer legalizimin e objekteve informale, ku nga verifikimi në dokumentacionin hartografik të paraqitur, në gjenplanin, në proces-verbalin e verifikimit në terren, në skicën fushore, si dhe nga matja e kryer në hartën vektoriale dhe në sistemin dixhital zyrtar “geoportal-albania”, u konstatua se legalizimi i këtyre objekteve ishte kryer në pozicionimin e pronës, në një distancë prej 69-94 m nga bregu i Lumit Devoll, me të cilin kufizohen objektet e legalizuara, distancë brenda së cilës pasuria shtetërore është e patjetërsueshme dhe e paparashkrueshme. Në dosje nuk u gjetën plane ose studime të planifikimit dhe rregullimit të territorit, ose dokumente të miratuara në Këshillin Kombëtar të Ujit, për rrjedhojë nuk duhej të ishin pranuar për legalizim këto 2 objekte. Veprimet e kryera më sipër, janë kryer në kundërshtim me ligjin nr. 111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, neni 2, neni 4, pika 8; neni 5 dhe neni 84 (Trajtuar në pikën 1, faqet 30-198 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1- Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan të marrë masa të vendosë masë kufizimi dhe të fillojë procedurat me grup pune për rivlerësimin edhe një herë të dokumentacionit tekniko ligjor mbi bazën e të cilit janë lëshuar 2 lejet e legalizimit, duke njoftuar subjektet për fillimin e procedurave përkatëse sipas kërkesave të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.

Gjithashtu të merren masa për të ardhmenduke lëshuar leje legalizimi për objekte informale, në kushtet e respektimit të zonave të brigjeve të ujrave sipërfaqësore, si lumenj, përrenj, rezervuare, etj., vetëm mbi bazën e planeve dhe studimeve të planifikimit dhe rregullimit të territorit, të miratuara paraprakisht në Këshillin Kombëtar të Ujit, duke vepruar sipas ligjit.

Menjëherë dhe në vijimësi



10- Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (aktualisht pjesë e Drejtorisë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), në **3 raste**, sipas lejeve të legalizimit nr. 8555516, datë 25.10.2017, nr. 306028, datë 20.11.2017, nr. 85585968, datë 21.10.2017, ka kryer legalizimin e ndërtimeve informale, ku nga verifikimi në dokumentacionin hartografik të paraqitur, në Gen-Planin me shkallë zvogëlimi 1:500 dhe 1:2500, në proces-verbalin e verifikimit në terren, në skicën fushore, si dhe nga matja e kryer në hartën vektoriale dhe në sistemin dixhital zyrtar “geoportal-albania”, u konstatua se legalizimi i objekteve ishte kryer në pozicionimin e pronës, në një distancë prej 12 m – 21 m nga bregu i përrenjve, me të cilin kufizohen objektet e legalizuara, distancë brenda së cilës pasuria shtetërore është e patjetërsueshme dhe e paparashkrueshme, për rrjedhojë nuk duhej pranuar për legalizim objektet në fjalë. Veprimet e kryera më sipër, janë kryer në kundërshtim me ligjin nr. 111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 1, pika 2, germa “a”; neni 4, pika 8; neni 5 dhe neni 84, si dhe me VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dheshtesa në vendimin nr. 280, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, Kreu II, pika 2, germa “h” (Trajtuar në pikën 1, faqet 30-198 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1- Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan të marrë masa të vendosë masë kufizimi dhe të fillojë procedurat me grup pune për rivlerësimin edhe një herë të dokumentacionit tekniko ligjor mbi bazën e të cilit janë lëshuar 3 lejet e legalizimit, duke njoftuar subjektet për fillimin e procedurave përkatëse sipas kërkesave të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.

Gjithashtu të merren masa për të ardhmenduke lëshuar leje legalizimi për objekte informale, në kushtet e respektimit të zonave të brigjeve të ujrave sipërfaqësore, si lumenj, përrenj, rezervuare, etj, brenda largësisë të përcaktuar mbi bazën e planeve dhe studimeve të planifikimit dhe rregullimit të territorit, të miratuara (këto të fundit) paraprakisht në Këshillin Kombëtar të Ujit, duke vepruar sipas ligjit.

Menjëherë dhe në vijimësi

11- Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (aktualisht pjesë e Drejtorisë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), në **3 raste**, sipas lejeve të legalizimit nr.3040868, datë 19.06.2017, nr.988658, datë 30.06.2017, nr.2578479, datë 21.11.2018, ka kryer legalizim e objekteve informale, në kushtet ku konstatohet se sipas azhurnimit me sistemin zyrtar geoportal-albania, proces-verbalit të verifikimit në terren dhe skicën fushore, si dhe nga matja e kryer në 2 harta vektoriale Gen-planet me shkallë 1:500 dhe 1:2500, konstatohet se objektet e legalizuara ndodhen në distancë me të vogël se 10 m nga rrugët nacionale të kategorisë “C”, dhe më pak se 5 m prej rrugës rajonale të kategorisë “F”. Veprimet më sipër bien në kundërshtim me VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dheshtesa në vendimin nr. 280, datë 01.04.2015, të Këshillit të Ministrave, ...”, pika 4, germa “b”/i, VKKT me nr. 5, datë 29.12.2014, pika 7, VKM Nr.153 datë 07.04.2000 “Për miratimin e Rregullores në zbatim të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, Neni 27, pika 3 (Trajtuar në pikën 1, faqet 30-198 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1- Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan të marrë masa të vendosë masë kufizimi dhe të fillojë procedurat me grup pune për rivlerësimin edhe një



herë të dokumentacionit tekniko ligjor mbi bazën e të cilit janë lëshuar 3 lejet e legalizimit, duke njoftuar subjektet për fillimin e procedurave përkatëse sipas kërkesave të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.

Brenda datës 31.12.2019

12- Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (aktualisht pjesë e Drejtorisë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), **në 3 raste**, sipas lejeve të legalizimit nr.3054852, datë 21.06.2017, nr. 2526985, datë 10.11.2017, nr. 2580684, datë 15.04.2019, ka kryer legalizimin e objekteve informalë, në kushtet kur konstatohet se sipas materialit hartografik dhe pozicionimit të pronës, të paraqitur në 2 gen-planet me shkallë zvogëlimi 1:500 dhe 1:2500, nga matjet që u bënë në këto gen-plane, 3 objektet informalë të legalizuar **janë ndërtuar në një distancë shumë afër hekurudhës më pak 25 m** dhe në dosje nuk ka asnjë dokumentacion që vërteton marrjen e konfirmimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave për legalizimin e objektit, veprime këto që bien në kundërshtim me nenin 45, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, pika 5 e Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”, Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, të ndryshuar dhe pika 2, gërma “b”, pika 3, pika 4, germë “a”, pika 5 të VKM nr. 280, date 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” (Trajtuar në pikën 1, faqet 30-198 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1- Rekomandim:Drejtorja Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan të marrë masa të vendosë masë kufizimi dhe të fillojë procedurat me grup pune për rivlerësimin edhe një herë të dokumentacionit tekniko ligjor mbi bazën e të cilit janë lëshuar 3 lejet e legalizimit, duke njoftuar subjektet për fillimin e procedurave përkatëse sipas kërkesave të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.

Brenda datës 31.12.2019

13- Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (aktualisht pjesë e Drejtorisë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), **në 33 raste**, sipas lejeve të legalizimit në Aneksin nr.9 “Objekte social ekonomike pa paguar parcelën ndërtimore”, ka kryer legalizime të objekteve **social-ekonomikë dhe të kombinuar**, duke i kaluar në ZVRPP për t'u regjistruar me kufizime sipas hipotekës ligjore, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr.9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1.

Në dosje nuk rezultojnë të ketë dokument financiar për pagesën e parcelës ndërtimore, pra nuk është paguar vlera e parcelës ndërtimore, në një kohë që objektet janë me funksion “**Social-Ekonomik**” ose “**I Kombinuar**” dhe nuk duhej vendosur hipotekë ligjore si dhe nuk duhej lëshuar leja e legalizimit pa u paguar vlera e parcelës ndërtimore sipas vendimit të KM për këtë qëllim. Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr.9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30, pika 2/1 dhe VKM nr. 1095, datë 28.12.2015 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës,ndërmjet ALUIZNI-t dhe ZQRPP-së,dhe të procedurave apokufizimeve që zbatohen përfekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara”, Kreu III (Trajtuar në pikën 1, faqet 30-198 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1- Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan,të marrë masa për të ardhmen, duke lëshuar leje legalizimi për objekte informale, vetëm në rastin kur subjekti apo njëri prej subjekteve që disponojnë ndërtimin **me funksion banimi** nuk shlyejnë detyrimet financiare të parashikuara në ligj për vlerën e parcelës ndërtimore të objektit pa leje. Në



këto raste të mos përfshihen rastet e **objekteve social-ekonomike dhe të kombinuara**, për të cilat lejet e legalizimit të lëshohen vetëm në rastin e kryerjes së pagesës për parcelën ndërtimore, të miratuar me VKM, duke vepruar sipas ligjit.

Menjëherë dhe në vijimësi

14- Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (aktualisht pjesë e Drejtorisë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), **në 73 raste**, ka kryer legalizime të objekteve informale në kushtet kur në dosjet mungojnë vërtetimet për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 27, germa “ç”, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar (*Trajtuar në pikën 1, faqet 30-198 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

14.1- Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, të plotësojë dosjet më vërtetimet për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, të lëshuara nga organet e pushtetit vendor dhe të marrë masa për të ardhmen, duke lëshuar leje legalizimi për objekte informale, në kushtet e disponimit në dosjet përkatëse të këtyre vërtetimeve, sipas ligjit.

Menjëherë dhe në vijimësi

15- Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (aktualisht pjesë e Drejtorisë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), **në 56 raste**, ka kryer legalizime të objekteve informale, në kushtet kur në proces-verbalet e verifikimit në terren mungojnë datat e mbajtjes së tij dhe nuk mund të përcaktohet afati kohor proces-verbal verifikimi – vendim kualifikimi, ose në kushte kur ky afat kohor është më shumë se 60 ditë, duke vepruar kështu në kundërshtim me VKM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose nëlartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar, pika 8 (*Trajtuar në pikën 1, faqet 30-198 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

15.1- Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, të marrë masa për të ardhmen, duke lëshuar leje legalizimi për objekte informale, sipas afateve të përcaktuara në limitin prej 60 ditësh i afatit kohor proces-verbal verifikimi–vendim kualifikimi, sipas ligjit.

Menjëherë dhe në vijimësi

16- Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (aktualisht pjesë e Drejtorisë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), **në 28 raste**, ka kryer legalizimin e objekteve informale në kushtet kur afati kohor ndërmjet datës së vendimit për kualifikim dhe datës së lejes së legalizimit është më shumë se 30 ditë, duke vepruar në kundërshtim me Urdhrin nr. 37, datë 19.01.2016 “Për miratimin e plan veprimit për shqyrtimin administrativ të praktikave të legalizimit të ndërtimeve pa leje”, pika 6- Miratimi i lejes së legalizimit përpara kalimit të pronësisë, germa “a” (*Trajtuar në pikën 1, faqet 30-198 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

16.1- Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, të marrë masa për të ardhmen, duke lëshuar leje legalizimi për objekte informale, sipas afateve të përcaktuara në limitin prej 30 ditësh i afatit vendim kualifikimi – leje legalizimi, sipas ligjit.

Menjëherë dhe në vijimësi

17- Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (aktualisht pjesë e Drejtorisë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), **në 97 raste**, ka kryer legalizimin e objekteve informale, në kushtet kur proces-verbalet e verifikimit në terren nuk janë



plotësuar me rubrikat për: datën e mbajtjes, sipërfaqet e parcelës ndërtimore, njolla e objektit, numri i kateve dhe destinacioni i sipërfaqeve. Përsa i përket pasurive kufitare (të saktësuara në përshkrim) nuk janë shënuar numrat e pasurive dhe distancat nga pasuritë kufitare. Këto mungesa, veçanërisht mungesa e sipërfaqes së parcelës ndërtimore dhe distancave nga objektet kufitare e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale. Sa sipër është në kundërshtim me rubrikat sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t (Trajtuar në pikën 1, faqet 30-198 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1- Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, të marrë masa për të ardhmen, duke lëshuar leje legalizimi për objekte informale, në kushtet e plotësimit të rregullt dhe pa mangësi të proces-verbaleve të verifikimit në terren, në rubrikat sipas formularit: datën e mbajtjes, sipërfaqet e parcelës ndërtimore, njolla e objektit, numri i kateve dhe destinacioni i sipërfaqeve, numrat e pasurive kufitare (të saktësuara në përshkrim) dhe distancat e objektit nga këto pasuri kufitare, duke e kthyer proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument të vërtetë, si dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale, sipas ligjit.

Menjëherë dhe në vijimësi

18- Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (aktualisht pjesë e Drejtorisë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), sipas lejeve të legalizimit nr.2578564, datë 23.11.2018; nr.2578574, datë 23.11.2018; nr.2578732, datë 28.03.2018; nr.2578524, datë 22.11.2018; nr.2578501, datë 21.11.2018; nr.2578729, datë 28.03.2018; nr.2578140, datë 22.10.2018; nr.2580216, datë 20.12.2018, ka kryer legalizimin e objekteve informale, në kushtet kur në dosje disponohen të panënshkruara nga deklaruesi:

-deklarata personale, që merr përsipër përgjegjësinë për çdo pasojë, që mund të rrjedhë nga shkaqe natyrore dhe/ose nga përdorimi i banesës. Sipas këtij ligji, shteti nuk është përgjegjës për kompensimin ose dëmshpërblim në raste fatkeqësish, për shkak faktorëve, që ndikojnë në qëndrueshmërinë e objektit.

-deklarata për zbatimin e planit rregullues, sipas së cilës deklaruesi pranon zbatimin e planit rregullues/studimit urbanistik pjesor, përfshirë këtu: respektimin e hapësirave publike, gjelbërimin, tipin e rrethimit, ngjyrat, ndriçimin, parkimin, etj.

Sa më sipër është në kundërshtim me nenin 27, germa “dh”, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar (Trajtuar në pikën 1, faqet 30-198 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1- Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, të marrë masa për të ardhmen, duke lëshuar leje legalizimi për objekte informale, në kushtet e plotësimit të dosjeve të legalizimit me dokumente të nënshkruara nga deklaruesi, përkatësisht deklarata personale dhe deklarata për zbatimin e planit rregullues.

Menjëherë dhe në vijimësi

19- Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (aktualisht pjesë e Drejtorisë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), në **13 raste**, sipas lejeve të legalizimit nr.2578186, datë 24.10.2018; nr.2570316, datë 31.05.2018; nr.3040868, datë 19.06.2017; nr.2578524, datë 22.11.2018; nr.2030156, datë 30.05.2017; nr.9858742, datë 20.10.2017; nr.2580216, datë 20.12.2018; nr.2578427, datë 20.11.2018; nr.3151001, datë 21.06.2017; nr.3737510, datë 14.11.2017; nr.58598748, datë 16.10.2017; nr.2578197, datë 25.10.2018, nr.2578479, datë 21.11.2018, ka kryer legalizimin e objekteve informale në kushtet



kur parcelat ndërtimore janë në zërat kadastrale “Arë”, “Vreshtë”, “Pemishte”, “Ullishte”, “Ledh”, etj, dhe lejet e legalizimit janë lëshuar në mungesë të dokumentacionit: kërkesa për miratimin në Këshillin e Qarkut, të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Agjencisë Rajonale të Mjedisit. Pra nuk ka asnjë dokumentacion nga këto organe, për t’i dhënë lejen dhe miratimin e këtyre lejeve të legalizimit sjell automatikisht ndryshimin e zërit kadastral gjatë regjistrimit në ZVRPP Elbasan.

Sa më sipër veprimet janë kryer në zonat “Territore të tjera”, në kundërshtim me nenet 10, 11, 14, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar dhe VKM nr. 515, datë 13.5.2009 e VKM nr. 589, datë 10.9.2014, “Për përcaktimin e afateve, të mënyrës dhe kohës së ushtrimit nga ALUIZNI të përgjegjësive të zyrave të urbanistikës dhe të këshillave të qarqeve, gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale” si dhe Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit me nr. 5, datë 29.12.2014 “Për identifikimin e zonave të urbanizuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në miratimin e hartave ku mund të ndërhyhet në funksion të zhvillimit urban”, pika 9 ku përcaktohet: “Konvertimi nga tokë “Arë” në tokë “Truall” për sipërfaqet brenda zonave të urbanizuara do të bëhet sipas procedurave përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi” (Trajtuar në pikën 1, faqet 30-198 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19.1- Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan të marrë masa të vendosë masë kufizimi dhe të fillojë procedurat me grup pune për rivlerësimin edhe një herë të dokumentacionit tekniko ligjor mbi bazën e të cilit janë lëshuar 13 lejet e legalizimit, duke njoftuar subjektet për fillimin e procedurave përkatëse sipas kërkesave të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.

Gjithashtu, të merren masa për të ardhmen duke lëshuar leje legalizimi për objekte informale, në kushtet kur parcelat ndërtimore janë në zërin kadastral “Truall”, ose në zona informale këto të miratuara nga KRRTRSH/KKT. Në rastet kur parcelat ndërtimore janë në zonat “Territore të tjera”, zërat kadastrale “Arë”, “Vreshtë”, “Pemishte”, “Ullishte”, “Ledh”, etj., lejet e legalizimit të lëshohen në disponim të dokumentacionit: kërkesa për miratimin në Këshillin e Qarkut, të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Agjencisë Rajonale të Mjedisit.

Menjëherë dhe në vijimësi

20- Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (aktualisht pjesë e Drejtorisë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), ka lëshuar leje e legalizimi në kushtet kur proces-verbalet e verifikimit në terren mbajnë datë më të vonshme se vendimet për kualifikim të objekteve informale dhe lejet e legalizimit, pra procedurat janë bërë formale (Trajtuar në pikën 1, faqet 30-198 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20.1- Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, të marrë masa për të ardhmen, duke lëshuar leje legalizimi për objekte informale, në kushtet e plotësimit rrjedhës kronologjike të dokumentacionit të miratuar, duke shmangur dokumentat formale.

Menjëherë dhe në vijimësi

21- Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (aktualisht pjesë e Drejtorisë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), në 4 raste, sipas lejeve të legalizimit nr.402604, datë 24.04.2017; nr.4050132, datë 28.04.2017; nr.5030602, datë 28.04.2017; nr.4150123, datë 28.04.2017, ka kryer legalizimin e objekteve informale në kushtet kur në dosje mungojnë fotografitë të 1 ose 2 pamjeve të objektit, në kundërshtim me urdhërin nr. 46, datë 18.7.2006 dhe “Manual i procedurave mbi procesin e vetëdeklarimit”, pika 7/1 (Trajtuar në pikën 1, faqet 30-198 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).



21.1- Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, të marrë masa për të ardhmen, duke lëshuar leje legalizimi për objekte informale, në kushtet e plotësimit të dosjeve të legalizimit me fotografitë në të katër pamjet.

Menjëherë dhe në vijimësi

22- Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (aktualisht pjesë e Drejtorisë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), në 1 rast, ka kryer legalizimin e objektit informal sipas Leje legalizimi nr. 2578256, datë 29.10.2018, ndërtim për Godinë banim 5 Kat, në emër të I Q S, pa marrë konfirmimin nga OSHE nëse nga ndërtimi informal çenohet linja e tensionit të lartë. Me shkresën nr. 4529 prot, datë 25.06.2018, kërkesë për informacion, drejtuar OSHE Elbasan, ALUIZNI Elbasan ka kërkuar informacion nëse pranë objektit informal ka linjë të tensionit të lartë dhe nëse ky objekt është ndërtuar në kundërshtim me Rregulloren e Shfrytëzimit teknik të Nën Stacioneve dhe Linjave Elektrike të sistemit energjitik. Në dosje nuk administrohet kthimi përgjigje për shkresën e sipërcituar. Nga verifikimi imazheve dixhitale dhe hartografike rezulton se objekti është ndërtuar në distancë shumë të afërt me linjën e tensionit të lartë dhe parcela ndërtimore shtrihet nën linjën e tensionit të lartë. Sa sipër veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me VKM nr.280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar me VKM nr.756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dheshtesa në vendimin nr.280, datë 1.4.2015, të këshillit të ministrave, “për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, pika 2, germa “ç” dhe “g” dhe përcaktimet e Ligjit nr.9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” (Trajtuar në pikën 1, faqet 30-198 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

22.1- Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan të marrë masa të vendosë masë kufizimi dhe të fillojë procedurat me grup pune për rivlerësimin edhe një herë të dokumentacionit tekniko ligjor mbi bazën e të cilit është lëshuar leja e legalizimit nr. 2578256, datë 29.10.2018, në emër të I Q S, duke njoftuar subjektin për fillimin e procedurave përkatëse.

Brenda datës 31.12.2019

23- Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (aktualisht pjesë e Drejtorisë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), në 1 rast, ka kryer legalizimin e objektit informal Leje legalizimi nr. 2580637, datë 09.04.2019, ndërtim për Godinë Social Ekonomike 1 Kat në emër të I Xh H, pa marrë konfirmimin nga Bashkia Belsh nëse çenohet infrastruktura publike si dhe në kushtet kur objekti nuk është ndërtuar para datës 27.06.2014, afati ligjor brenda të cilit duhet të jenë ndërtuar objektet e vetëdeklaruar. Me shkresën nr. 3003 prot, datë 09.04.2019, Kërkesë për informacion dhe miratim, drejtuar Bashkisë Belsh, ALUIZNI Elbasan ka kërkuar informacion nga Bashkia Belsh si autoriteti përgjegjës si dhe konfirmimin në lidhje me vazhdimin e procedurave administrative të legalizimit të objektit informal, dhe nëse ky objekt çenon hapsirat publike ose jo. Në dosje nuk administrohet shkresa kthim përgjigje për këtë shkresë. Me shkresën pa numër prot, datë 10.04.2019, Bashkia Belsh ka lëshuar vërtetim, sipas të cilit vërtetohet se shtetasi I Xh H, posedon një objekt shërbimi të ndërtuar para vitit 2014. Nga verifikimi i imazheve hartografike dhe digjitale rezulton se objekti nuk është ndërtuar para datës 27.06.2014, afati ligjor brenda të cilit duhet të jenë ndërtuar objektet e vetëdeklaruar.

Gjithashtu vërtetimi i dhënë nga Bashkia në lidhje me periudhën e ndërtimit nuk është kompetencë e këtij autoriteti dhe nuk ka vlerë për procesin e legalizimit, pasi nuk prodhon pasojë juridike. Sa sipër veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 280,



datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dheshtesa në vendimin nr. 280, datë 01.04.2015, të këshillit të ministrave, “për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, si dhe Nenin 2, pika 1, përcaktimet e Ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” (*Trajtuar në pikën 1, faqet 30-198 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

23.1- Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan të marrë masa të vendosë masë kufizimi dhe të fillojë procedurat me grup pune për rivlerësimin edhe një herë të dokumentacionit tekniko ligjor mbi bazën e të cilit është lëshuar leja e legalizimit nr. 2580637, datë 09.04.2019, në emër të I Xh H duke njoftuar subjektin për fillimin e procedurave përkatëse sipas kërkesave të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”.

Brenda datës 31.12.2019

24- Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (aktualisht pjesë e Drejtorisë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), në 3 raste, ka vijuar procedurat e lëshimit të lejes së legalizimit bazuar vetëm në deklaratën noteriale të poseduesit të ndërtimit për prishjen e ndërtimit të vjetër, por në dosje nuk ka asnjë dokumentacion tjetër nga institucionet vendore si organet kompetente që japin lejen përkatëse për prishjen e objektit, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 8405 datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar, Neni 49, pikën 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit” (*Trajtuar në pikën 1, faqet 30-198, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

24.1- Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan të marrë masa, që në çdo rast të regjistrimit të lejeve të legalizimit për objektet informalë të ndërtuara mbi objektet e vjetra, të kërkojë paraqitjen e dokumentacionit ligjor lëshuar nga organet kompetente vendore për prishjen e objektit të vjetër në përputhje me përcaktimet ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

25- Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (aktualisht pjesë e Drejtorisë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), në 1 rast, ka vijuar procedurat e lëshimit të lejes së legalizimit nr. 2578217, datë 26.10.2018, në emër të A Sh H, me mangësi në dokumentacion pasi sipas lejes së ndërtimit sipërfaqja sheshit të ndërtimit është 2492 m² dhe sipërfaqja e ndërtimit është 1500 m², ndërkohë që sipas lejes së legalizimit sipërfaqja e parcelës ndërtimore është 1468.3 m² dhe sipërfaqja e ndërtimit është po 1468.3 m², pra jemi në kushtet kur subjekti fillimisht sipas lejes së ndërtimit të miratuar, ka disponuar një sipërfaqe sheshi dhe sipërfaqje ndërtimit më të madhe, ndërkohë që pasi i është nënshtruar procesit të legalizimit për shkak të shmangies nga leja e ndërtimit, sipërfaqja e sheshit është zvogëluar në 1468.3 m² dhe sipërfaqja e ndërtimit është zvogëluar në 1468.3 m² (1343.1 m² + 125.2 m²), pra ka mospërputhje. Gjithashtu referuar Akt-Kolaudimi pa datë, sipërfaqja e sheshit të ndërtimit është 2492 m² dhe sipërfaqja e ndërtimit është 1400 m², ka mospërputhje me lejen e ndërtimit dhe vërtetimet e lëshuara nga Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Elbasan. Zvogëlimi i sipërfaqes së sheshit të ndërtimit si rezultat i kalimit nga leja e ndërtimit drejt procesit të legalizimit, bie në kundërshtim me vet qëllimin dhe objektin e ligjit të legalizimeve nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, Neni 1, pika 1 dhe 2, Neni 15/1, pasi subjekti i nështrohet procesit të legalizimit për shtesat anësore osë në lartësi tej lejes së ndërtimit dhe jo zvogëlimit të sipërfaqes së truallit apo ndërtimit. Gjithashtu në dosje nuk



administrohen planimetrit për të gjitha katet e ndërtimit si dhe përmbledhësja e sipërfaqeve për çdo njësi duke përfshirë dhe ambientet e përbashkëta (*Trajtuar në pikën 1, faqet 30-198 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

25.1- Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan të marrë masa të vendosë masë kufizimi dhe të fillojë procedurat me grup pune për rivlerësimin edhe një herë të dokumentacionit tekniko ligjor mbi bazën e të cilit është lëshuar leja e legalizimit nr. 2578217, datë 26.10.2018, në emër të A Sh H, duke njoftuar subjektin për fillimin e procedurave përkatëse sipas kërkesave të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”.

Brenda datës 31.12.2019

26. Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (aktualisht pjesë e Drejtorisë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), ka vijuar procedurën e lëshimit të lejeve të legalizimit nr.80090065, datë 16.05.2017, nr. 8080059, datë 10.05.2017, nr. 8090078, datë 18.05.2017, nr.2030003, datë 17.05.2017, ma mangësi në dokumentacion pasi procesverbali i përgatitjes dhe vlerësimit të dosjes i mbajtur me datë 11.05.2017, në rubrikën mbi çështjet e pronësisë, ka shënimin *ka përgjigje nga ZVRPP për statusin juridik me cilësimin “në pronë të tretëve”*, ndërsa sipas shkresës së ZVRPP nr. 3476 datë 15.06.2015, kthim përgjigje statusi juridik i aplikimit për legalizim objekti nr. 168 me deklarues Xh A S për pasurinë nr. 36/30 figuron “tokë arë”.

-Në vendime cilësohet se “Subjekti ka më shumë se një ndërtim informal” ndërsa nuk ka deklarata noteriale për përzgjedhjen nga qytetari të objektit që do legalizojë me kushte favorizues dhe pranimin e kushtit që për subjektin tjetër që do të legalizosh detyrimet financiare do të llogariten me çmimet e tregut.

-Gjithashtu ALUIZNI Elbasan ka miratuar lejen e legalizimit për ndërtimin pa leje për këto pasuri, pa konfirmuar statusin juridik të pasurisë, çka sjell ndryshimin automatikisht të zërit kadastral gjatë regjistrimit në ZVRPP në mungesë të dokumentacionit; kërkesa për miratimin në Këshillin e Qarkut, të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Agjencisë Rajonale të Mjedisit. Pra, nuk ka asnjë dokumentacion nga këto organe, për t'i dhënë lejen, veprimin të kryer për legalizim në zonat “Territore të tjera”, gjë e cila bie në kundërshtim me nenet 10, 11, 14, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar dhe VKM nr. 515, datë 13.5.2009 e VKM nr. 589, datë 10.9.2014, “Për përcaktimin e afateve, të mënyrës dhe kohës së ushtrimit nga ALUIZNI të përgjegjësive të zyrave të urbanistikës dhe të këshillave të qarqeve, gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale” si dhe Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit me nr. 5, datë 29.12.2014 “Për identifikimin e zonave të urbanizuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në miratimin e hartave ku mund të ndërhyhet në funksion të zhvillimit urban”, pika 9 ku përcaktohet: “Konvertimi nga tokë “Arë” në tokë “Truall” për sipërfaqet brenda zonave të urbanizuara do të bëhet sipas procedurave përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi”(Trajtuar në pikën 1, faqet 30-198 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

26.1-Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, të marrë masa për vendosjen e kufizimit mbi pasuritë e regjistruara sipas lejeve të legalizimit nr. 80090065, datë 16.05.2017, nr. 8080059, datë 10.05.2017, nr. 8090078, datë 18.05.2017, nr. 2030003, datë 17.05.2017 dhe nr. 2090058, datë 17.05.2017, deri në plotësimin dhe rregullimin e të metave në procedurën e regjistrimit në zbatim të pikës b, nenit 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”.

Brenda datës 31.12.2019



27- Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (aktualisht pjesë e Drejtorisë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), ka vijuar procedurën e lëshimit të lejeve të legalizimit nr.8090078, datë 18.05.2017, nr. 8090087, datë 17.05. 2017, me mangësi në dokumentacion pasi në dosje nuk ka korrespondencë shkresore me Autoritetin Rrugor Shqiptar për të përcaktuar nëse parcela ndërtimore bie mbi projektin infrastrukturor, gjithashtu kartela e pasurisë e administruar në dosje mban datën 08.07.2000, ndërkohë që vendimi i kualifikimit mban nr. 20213 datë 10.05 2017, ndërsa leja e llegalizimit është dhënë në datë 18.05.2017, pra kartela nuk është e rifreskuar për të paraqitur gjedjen juridike të pronës në muajin e fundit. *(Trajtuar në pikën 1, faqet 30-198 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

27.1-Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, të marrë masa për vendosjen e kufizimit mbi pasuritë e regjistruara sipas lejeve të legalizimit nr.8090078, datë 18.05.2017 dhe nr.8090087, datë 17.05. 2017 deri në plotësimin dhe rregullimin e të metave në procedurën e regjistrimit në zbatim të pikës b, nenit 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”.

Brenda datës 31.12.2019

28- Gjetje nga auditim: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (aktualisht pjesë e Drejtorisë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), ka vijuar procedurën e lëshimit të lejeve të legalizimit nr. 1020033 datë 18.06.2017, dhe nr. 1020034, datë 18.05.2017, në kushtet kur në dosje gjenden dy leje legalizimi por nuk administrohet vërtetimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë sipas shkresës nr. 5405 prot, datë 31.05.2017, drejtuar njësisë së qeverisjes vendore, sipas deklaratave noteriale të qytetarit është një objekt dy katesh sipas dosjes 840 e cila legalizohet sipas kriterëve favorizuese të ligjit dhe objekti tjetër i cili duhet të legalizohet me çmimet e tregut, gjithashtu në leje nuk është cilësuar që objekti njëkatësh është për aktivitet social.

- Me shkresën nr. 8075 prot, datë 31.10.2016 ALUIZNI Elbasan drejtuar ZVRPP, ka kërkuar informacion për gjëndjen juridike të pronës. ZVRPP nuk sqaron për gjëndjen juridike të parcelave mbi të cilën janë ndërtuar dy objektet informalë. Në procesverbalin e verifikimit në terren datë 09.10.2017, nuk janë shënuar kërkesat për qëllimin e shfrytëzimit të objekteve, funksionin e hapësirave sipas faktit dhe pasuritë kufitare të saktësuara më shkrim me numra dhe fjalë *(Trajtuar në pikën 1, faqet 30-198 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

28.1- Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, të marrë masa për vendosjen e kufizimit mbi pasuritë e regjistruara sipas lejeve të legalizimit nr.1020033 në emër të P H Sh dhe nr.1020034, datë 18.05.2017, në emër të P H deri në plotësimin dhe rregullimin e të metave në procedurën e regjistrimit në zbatim të pikës b, nenit 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”.

Brenda datës 31.12.2019

29- Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (aktualisht pjesë e Drejtorisë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), **në 1 rast**, me urdhër-shpenzimin nr. 38, datë 27.03.2018, janë kryer shpenzime në shumën 1,395,520 lekë, me objekt “Ekzekutim Vendim Gjyqi”: 1,246,000 lekë dhe “Tarifë shërbimi përmbarimor”: 149,520 lekë, në kredi të përfituesit: shoqërisë përmbarimore” S” shpk, me xhirim datë 27.03.2018, sipas faturës nr. 144, nr. Serie 58125174, dt. 23.03.2018, vendim gjyqi nr. (82-2016-1084) 706, dt.14.07.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, vendim gjykate nr. 4443, datë 26.10.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, Urdhër 94, datë 23.03.2018.

-Në pjesën vërejtëse dhe arësytimit ligjor dhe analizës së fakteve të vendimit nr.(82-2016-1084) 706, dt.14.07.2016, të gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, si indice për fillimin e



procedurës gjyqësore është marrë urdhëri nr. 477, datë 25.04.2016 i Titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, sipas të cilit punonjësja e financës lirohet nga detyra si specialiste në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe emërohet si specialiste në Sektorin e legalizimit Librazhd, pranë Drejtorisë së ALUIZNI-t Elbasan. Gjykata e ka çmuar të arësyeshme duke e marrë këtë shkresë de fakto, si masë largimi nga puna, kjo e arësytuar proceduralisht nga rrethanat objektive dhe subjektive të çështjes, mosndjekjen e procedurave administrativo-ligjore sipas kontratës së punës së lidhur me punëdhënësit dhe punëmarrësit dhe mosrespektimin e dispozitave të Kodit të Punës, lidhur me këtë.

-Në pjesën “Arësytimi ligjor dhe analiza e fakteve”, gjykata parashtron se “Shkaku për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës jo vetëm që nuk argumentohet nga pala e paditur (ALUIZNI Elbasan), por është edhe një interpretim abuziv me dispozitat e Kodit të Punës, duke mos argumentuar shkurtime të vendeve të punës”. Pas daljes së urdhërit të largimit nga puna, punonjësja e larguar është zëvendësuar me një specialiste tjetër.

Sa sipër duke kryer mesatarizimin e pagesës kemi për 17 muaj një pagesë prej 1,395,520 lekë, periudhë në të cilën janë paguar de fakto në Sektorin e ALUIZNI-t Librazhd, për një pozicion pune njëkohësisht dy persona, për një periudhë 17 muaj, siç ka përcaktuar gjykata, duke u shpenzuar shuma 1,395,520 lekë, veprim i cili ka efekte financiare negative, me shkak mosndjekjen e procedurave të rregullta ligjore sipas Kodit të Punës dhe kontratës së lidhur, nga strukturat e Drejtorisë së ALUIZNI-t Elbasan. *(Trajtuar në pikën 3, faqet 202-207 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

29.1- Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, të marrë masa për të ardhmen, të zbatojë të gjitha procedurat ligjore lidhur me masat që merren ndaj punonjësve e specialistëve, për “Zgjidhje e kontratës së punës”, duke mos i dhënë shkas punonjësve t’i drejtohen gjykatave dhe të fitojnë të drejtën e mohuar, e ngarkuar shpenzimet buxhetore me mbishpenzime me efekte financiare negative. Në rast të marrjes së vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të zbatohen vendimet vullnetarisht pa qenë e nevojshme ndërhyrja e strukturave të përmbartimit, duke rritur më shumë akoma shpenzimet buxhetore.

Në vijimësi

30- Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi dhe verifikimi i ankesës së shtetasit S K, administruar në KLSH me nr. 46 prot, datë 15.01.2018, ku janë ngritur pretendime për veprime të paligjshme në legalizimin e objektit informal të ndërtuar nga shtetasi F T, pasi është fallsifikuar dokumentacioni duke paraqitur si vetdeklarim për ndërtimin e objektit në vitin 2014, ndërkohë që objekti është ndërtuar në vitin 2017 anës rrugës në vendin e quajtur Kanali me Kamba, **nga auditimi u konstatua:**

Në dosje administrohet vetëdeklarimi nr. 372, datë 21.03.2005, për objektin Magazinë plus lokal, në emër të H H, sipas të cilit sipërfaqe e ndërtimit është 200 m², ndërkohë që sipërfaqja e parcelës ndërtimore është 500 m². Me deklaratën noteriale nr. 1482 rep, 961 kol, datë 20.10.2017, shtetasit H H dhe M H, deklarojnë se procedura e legalizimit do të vazhdojë në emër të T T, duke qenë se kjo e fundit ka bërë investimin për ndërtimin e objektit. Procesverbali i verifikimit datë 21.08.2017, nuk është plotësuar me distancat përkatëse nga pasuritë kufitare, gjithashtu dhe skicat fushore nuk kanë të dhëna për distancat nga Lumi Shkumbin si dhe rruga Nacionale Elbasan Cerrik. - Në dosje administrohet shkresa nr. 125 prot, datë 31.10.2017, nga Agjencia e Basenit Ujor Shkumbin, kthim përgjigje për shkresën nr. 2576/1 port, datë 30.10.2017 të ALUINI Elbasan, kërkesë për konfirmim të pasurisë nr. 407/20, sipas të cilës Agjencia e Basenit Ujor Shkumbin nuk shprehet për konfirmim por vetëm citon nenin 8 të ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, si referencë për distancat nga brigjet e lumejnve.



Theksojmë se shkresa e drejtuar ABUS Elbasan është bërë më pas në kohë nga data e lëshimit të lejes së legalizimit.

Nga verifikimi i imazheve dhe i ortofotos rezulton se objekti ndodhet në një distance prej 115 m nga bregu i Lumit Shkumbin dhe sipas përcaktimeve të nenin 4, pika 8 të ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, në të tilla raste kërkohet miratimi paraprak. Nga ish-ALUIZNI Elbasan është kërkuar konfirmimi me shkresë të hartuar më pas në kohë nga data e lëshimit të lejes së legalizimit, që nuk ka asnjë vlerë ligjore pasi akti është nxjerrë, por edhe në shkresën kthim përgjigj të ABUS Elbasan nuk është dhënë konfirmimi për vazhdimin e procedurave të legalizimit.

- Gjithashtu nga verifikimi i ortofotos datë 27.06.2014, si dhe imazheve dixhitale rezulton se objekti nuk është ndërtuar para datës 27.06.2014, e për pasojë nuk duhet ti nështrohej procesit të legalizimit, veprime këto që bien në kundërshtim me Nenin 1, pika 1 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

- Me shkresën nr. 12414 prot, datë 25.10.2017, drejtuar ZVRPP Elbasan, është përcjellë për regjistrim leja e legalizimit. Me shkresën nr. 7089 prot, datë 10.10.2018, drejtuar ZVRPP Elbasan, është përcjellë për regjistrim dokumentacioni për parcelën ndërtimore, bashkangjitur faturat.

- Me shkresën nr. 2836/2 prot, datë 30.10.2018, ZVRPP Elbasan, administruar në ish-ALUIZNI Elbasan me nr. 7089/1 prot, datë 31.10.2018, ka kthyer dokumentacionin për regjistrimin e parcelës ndërtimore pasi objekti nuk figuron në ortofoton e datës 27.06.2014, si dhe ka kërkuar anulimin e lejes së legalizimit.

- Me shkresën nr. 7089/2 prot, datë 22.02.2019, kërkesë për çregjistrim, ish-ALUIZNI Elbasan drejtuar ish-ZVRPP Elbasan, ka kërkuar çregjistrimin e objektit të regjistruar në emër të T B T dhe kthimin e dokumentacionit origjinal në mënyrë që të bëhet shfuqizimi i lejes së legalizimit (*Trajtuar në pikën 6, faqet 217-221 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

30.1- Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan të marrë masa të menjëhershme të çregjistrojë objektin e regjistruar në emër të T B T dhe të bëjë shfuqizimi i lejes së legalizimit. Gjithashtu të ndjekë të gjithë procedurat ligjore në plotësimin e kriterëve për kualifikim të objekteve informale në vazhdimësi.

Menjëherë dhe në vijimësi

31- Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (aktualisht pjesë e Drejtorisë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), gjatë periudhës 01.01.2017-31.05.2019, rezultoi se nuk ka një evidencë të saktë të proceseve gjyqësore ndër vite, mungon data-base dhe evidentimi rast pas rasti për ecurinë e tyre, ankimimet dhe krijimin e një praktike më vete duke hapur dosje për çdo proces gjyqësor, në përfundim të cilit do t’i nënshtrohet arshivimit, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, neni 26 dhe 40, si dhe ligjit Nr.9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat” (*Trajtuar në pikën 6, faqet 217-221 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

31.1- Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan të marrë masa të menjëhershme të caktojë me urdhër të brëndshëm një specialist i cili do të përfaqësojë në vazhdimësi zyrën në proceset gjyqësore, të ndjekë të gjithë shkallët e gjyqësorit duke bërë ankimimet përkatëse si dhe të krijojë database duke evidentuar të gjitha proceset gjyqësore si dhe ecurinë e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi



32- Gjetje nga auditmi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (aktualisht pjesë e Drejtorisë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), në zbatimin, ndjekjen dhe menaxhimin e realizimit të treguesve të Buxhetit për veprimtarinë e viteve 2017 dhe 2018, sipas të dhënave të pasqyruara në tabelë rezulton se, realizimi i fondeve të alokuara është në masën 82 %, me realizim me të ulët paraqitet fondi i parcelës ndërtimore i ndikuar nga mos paraqitja e personave për pagesë si dhe ndryshimi i dispozitave ligjore që favorizon me tej legalizimet deri tek regjistrimi pa pagesë i objekteve ndërtimore. Ky faktor ka ndikuar negativisht në veprimtarinë ekonomiko financiare të Institucionit. Nga analizat e relacionet e paraqitura konstatohet se nuk janë vënë në dukje se këto fonde janë të pamjaftueshme për vazhdimësinë funksionale të institucionit, apo nevojat për rritjen e tyre për të realizuar objektivat e përcaktuara për plotësimin e detyrave të objekteve për legalizim. Mungesa e herëpashershme e fondeve nga mos arkëtimi i të ardhurave ka bërë të pamundur sigurimin e numrit të nevojshëm të punonjësve me kontratë i domosdoshëm për ndjekjen e procesit të legalizimit (*Trajtuar në pikën 2, faqet 198-202 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

32.1- Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, si dhe Drejtoria e Burimeve Mbështetëse të marrin masa për hartimin e buxhetit në periudhat e ardhshme me të ardhurat e arkëtuara nga pagesa e parcelës ndërtimore dhe shërbimet e tjera të institucionit për të siguruar një përputhje të nevojave për fonde me treguesit e shpenzimeve (kryesisht pagat e punonjësve me kontratë) dhe objektivave të vëna për përfundimin e procesit të legalizimit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

33- Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (aktualisht pjesë e Drejtorisë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), për vitin 2017 dhe 2018 në organizimin procedurave të prokurimit me vlerë të vogël është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të mallit, procesverbali për marrjen në dorëzim të mallit, janë të detajuara sipas artikujve dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë, por vetëm është shënuar sasia totale e mallit dhe vlera përkatëse sipas kontratës, pa i shënuar ato konkretisht edhe në procesverbalin e marrjes në dorëzim. veprime këto që bien në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 23 “Specifikimet teknike” dhe nenin 62 “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës”, VKM nr.914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, Kreu VI, pika 2, shkronja “ç”, Kreu IX, Neni 77, Mbikëqyrja e kontratës”, pika 1, 2, 3 dhe 4, dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 42 e 43, pika 45. Përveç sa më sipër, konstatohet, se ndërsa kërkesa për blerje dhe urdhëri i prokurimit, mbajnë datën 23.12.2016, ofertat e marra nga operatorët ekonomike: “A” P, A dhe I shpk, mbajnë datën 20.12.2016, pra janë marrë përpara fillimit të procedurës së prokurimit me vlera të vogla. Prokurimi i kryer në këtë mënyrë mbetet formal (*Trajtuar në pikën 5, faqet 212-217 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

33.1- Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, të marrë masa, për çdo rast në procedurat e prokurimit me vlera të vogla, të kryet inventari i dokumentacionit shoqëruar, në ftesat për ofertë të përcaktohen specifikimet teknike, të hartohet relacioni konstatues, të hartohet procesverbali i marrjes në dorëzim të mallit me specifikime të sakta shoqëruar me faturën tatimore.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

B- MASA SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, pjesa e VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr 30,



datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike të nxirren aktet administrative duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore, administrative dhe procedurat përmbartimore me qëllim kërkimin për shpërbllimin e dëmit, **në vlerat 2,148,336 lekë** analizuar si me poshtë:

1- Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Elbasan (aktualisht pjesë e Drejtorisë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan), **në 1 rast**, sipas lejes së legalizimit nr. 9898592, datë 22.06.2017, është legalizuar objekti informal “Godinë e kombinuar 9 Kat+1 kat nën tokë”, ku nga auditimi i dosjes plotësuese, rezulton leja e sheshit dhe e ndërtimit, të njëhuara me origjinalin nr. 07, datë 16.05.2003, është lëshuar nga KRRT Bashkia Elbasan, objekti: “7 kat +podrum (2 katet e para lokale). Sipërfaqja e sheshit 538.75; sipërfaqja e ndërtimit në bazë 370 m². Leja është lëshuar në favor të subjektit “N”, me investitorë A S dhe L Gj, në truallin e z. I Z, z. S P, z. R M.

Sa sipër, rezulton se kemi të bëjmë me shtesa (anësore apo në lartësi) tej lejes së ndërtimit, me qëllim kalimin e së drejtës së pronësisë apo qiradhënien dhe jo objekt informal, siç del nga leja e legalizimit, për rrjedhojë duhej që investitori të paguante për efekt të legalizimit, 2 përqind të çmimit minimal fiskal, për çdo m2 sipërfaqe banimi dhe 5 përqind për veprimtari social ekonomike.

Sipas Aktit të Kolaudimit të disponuar në dosje dhe të firmosur vetëm nga kolaudatori dhe sipas projektit të zbatimit të disponuar gjithashtu në dosje, rezulton se sipas lejes së ndërtimit janë parashikuar sipërfaqe lokal, shërbimi 789 m2, ndërsa sipërfaqe banimi janë parashikuar 1769 m2.

Sipas lejes së legalizimit janë legalizuar 2470 m2 sipërfaqe banimi me një shtesë prej 701 m2 (2470-1769), krahasuar me sipërfaqen sipas lejes së ndërtimit. Çmimi minimal fiskal për qytetin e Elbasanit, sipas VKM nr. 132, datë 07.03.2018, është 50,300 lekë/m2. Rrjedhimisht për shtesën e mësipërme investitori duhej të paguante një penaltet prej 705,206 (701x50,300x2%).

